# RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI
# Mbi
# "Auditimin financiar dhe të Përputhshmërisë në Bashkinë Shkodër"

**Tiranë, 2021**

## 🕮 PËRMBAJTJA:


| NR | EMËRTIMI I KAPITUJVE | FAQE |
|---|---|---|
| **I** | **PËRMBLEDHJA EKZEKUTIVE** | **4 – 20** |
| **I.2** | **Konkluzioni dhe Opinioni Auditmit** | **20 - 22** |
| **II** | **HYRJA** | **22 – 29** |
| | *a. Titulli.............................................................................................................* <br> *b. Marrrësi.........................................................................................................* <br> *c. Objektivat dhe qëllimi.......................................................................................* <br> *d. Identifikimi i çështjes.......................................................................................* <br> *e. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese..................................................................* <br> *f. Përgjegjësitë e Audituesve.................................................................................* <br> *g. Kriteret e vlerësimit ........................................................................................* <br> *h. Standardet e auditimit......................................................................................* <br> *i. Metodat e auditimi .........................................................................................* <br> *j. Dokumenti i auditimit.......................................................................................* | |
| **III.** | **PËRSHKRIMI I AUDITIMIT.........................................................................** | **29 – 162** |
| **III.1.** | **Informacion i përgjithshëm mbi subjektin nën auditim.......................................** | **29 – 29** |
| **III.2.** | **Përshkrimi i rezultateve sipas drejtimeve të audimit...........................................** | **29 – 162** |
| *III.2/1.* | *Auditim mbi menaxhimin financiar, kontrollin dhe Auditi i Brendshëm...............* | *29 – 37* |
| *III.2/2.* | *Mbi planifikimin dhe zbatimin e planit të buxhetit, bazuar në ligjin organik të buxhetit të shtetit, nr. 9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH", ligjet vjetore "Për buxhetin e shtetit" të vitit 2019 dhe 2020, si dhe aktet nënligjore mbi planifikimin, monitorimin dhe zbatimin e buxhetit...............................* | *37 – 54* |
| *III.2/2.6* | *Burimi i krijimit të të ardhurave bazuar në kuadrin rregullator ligjor/nënligjor në fuqi. Vlerësimi i mbledhjes së të ardhurave në përputhje me dispozitat ligjore dhe borxhi tatimor.......* | *54 – 83* |
| *III.2/3.* | *Vlerësimi Raportimit Financiar, për të arritur në opinionin në se pasqyrat financiare për vitet 2019-2020, japin një paraqitje të vërtetë e të drejtë të pozicionit financiar, performancës financiare dhe fluksit të parasë, bazuar në kuadrin rregullator në fuqi dhe konkretisht, ligjin nr. 24/2018, datë 10.05.2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare" si dhe udhëzimi MFE nr.08, datë 09.03.2018 "Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme"......................................................* | *83 – 90* |
| *III.2/4* | *Mbi planifikimin dhe zhvillimin e procedurave të prokurimit publik, me vlera të larta dhe të vogla, si dhe zbatimin e kontratave të punimeve, bazuar në kërkesat e ligjit nr. 9643, datë 20.11.2016 "Për Prokurimin Publik" i ndryshuar, VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar, Manualeve përkatëse të punimeve, udhëzimeve të Agjencisë së Prokurimit Publik etj..................* | *90 – 140* |
| *III.2/4.4* | *Auditim mbi hartimin e projekteve, zbatimin e kontratave të punimeve në investimet publike, kolaudimi dhe marrja në dorëzim e punimeve të kryera, sipas kontratave të lidhura me operatorët ekonomike fitues.....................................................................* | *140 – 146* |
| *III.2/5.* | *Auditimi i zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimet e mëparshme..................* | *146 – 153* |
| *III.2/6.* | *Auditimi i procedurave mbi lejet e ndërtimit/ zhvillimit dhe përdormi.....................* | *153 – 160* |
| *III.2/7.* | *Të ndryshëm (ankesa)..........................................................................................* | *160 – 162* |
| **IV.** | **GJETJE DHE REKOMANDIMI..........................................................................** | **162 – 188** |
| **V.** | **ANEKSE..........................................................................................................** | **188 - 236** |

# SHKURTIME

| | |
|---|---|
| **KLSH** | Kontrolli i Lartë i Shtetit. |
| **MFK** | Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli. |
| **NA** | Nëpunës Autorizues. |
| **NZ** | Nëpunës Zbatues. |
| **GSM** | Grupi i Menaxhimit Strategjik. |
| **NJAB** | Njësia e Auditimit të Brendshëm. |
| **AB** | Auditi i Brendshëm |
| **MAB** | Manuali i Auditimit të Brendshëm. |
| **FZHR** | Fondi i Zhvillimit të Rajoneve |
| **AQT** | Aktive të Qëndrueshme të Trupëzuara. |
| **UMF** | Udhëzim i Ministrisë së Financave |
| **VKM** | Vendim i Këshillit të Ministrave. |
| **VKB** | Vendim i Këshillit Bashkiak. |
| **ISSAI** | Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit. |
| **INOTSAI** | Organizata Ndërkombëtare e Institucioneve Supreme të Auditimit. |
| **ISA** | Standardet Ndërkombëtare të Auditimit |
| **IFAC** | Federatës Ndërkombëtarë të Kontabilistëve |
| **IPSAS** | Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit të Sektorit Publik |
| **IT** | Teknologjia e Informacionit. |
| **NJA** | Njësi Administrative. |
| **SHA** | Shoqëri Anonimë. |
| **BOE** | Bashkim i Operatorëve Ekonomikë. |
| **OE** | Operatori Ekonomik |
| **IVMT** | Inspektorati Vendor i Mbrojtjes së Territorit |
| **DAV** | Drejtoria e të Ardhurave Vendore, Bashkia Shkodër |

# I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE.

KLSH në periudhën nga data 6.4.2021 deri me datë 4.6.2021 kreu auditimin financiar dhe të përputhshmërisë të veprimtarisë ekonomike dhe financiare të Bashkisë Shkodër për aktivitetin ekonomik dhe financiar të periudhës nga data 01.9.2019 deri më 31.12.2020, duke u përqendruar kryesisht në organizimin dhe funksionimin e organeve drejtuese, planifikimin, hartimin dhe realizimin e buxheteve; zbatimin e strukturës organizative; realizimi dhe përdorimi i të ardhurave nga taksat e tarifat vendore; auditimin me zgjedhje i transaksioneve financiare nëse janë në përputhje me kërkesat ligjore; zbatimin e dispozitave ligjore në fushën e prokurimeve të fondeve publike, lidhjen e zbatimin e kontratave; mbajtjen e evidencës kontabël; zbatimin e ligjshmërisë për organizimin dhe funksionimin e sistemit të menaxhimit financiar dhe të kontrollit, si dhe auditit të brendshëm; administrimin e pronës dhe dhënia e lejeve të zhvillimit/përdorimit dhe shfrytëzimit etj.

Grupi i auditimit të KLSH shqyrtoj, analizoj dhe arriti në konkluzione mbi secilën prej drejtimeve të auditimit, në bazë të dokumentacionit të kërkuar dhe të vënë në dispozicion, me zgjedhje, për të arritur në një siguri të arsyeshme në dhënien e opinionit të auditimit.

Gjatë gjithë procedurës së këtij auditimi, janë mbajtur në konsideratë Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (ISSAI), Manuali i auditimit financiar dhe të përputhshmërisë të KLSH, Rregullorja funksionimit organizativ dhe administrativ të KLSH, Rregullorja e procedurave të auditimit, Kodi i etikës, si dhe praktikat më të mira audituese të fushës.

Në arritjen e konkluzioneve dhe përfundimeve mbi auditimin financiar dhe përputhshmërisë së veprimtarisë ekonomike dhe financiare me kuadrin ligjor dhe rregullator përkatës, krahas njohjes së detajuar të tyre të cilat kanë shërbyer si burim i kritereve të auditimit, ne kemi përdorur metoda dhe tekN... efikase si verifikimi i transaksioneve, intervistimi, raporte dhe informacione, verifikime në terren etj.

Gjetjet e këtij auditimi të karakterit organizativ, të shpërblimeve të dëmit, mungesë së të ardhurave dhe të përdorimit me jo me efektivitet të fondeve publike, i janë nënshtruar skepticizmit profesional dhe gjykimit objektiv të Audituesve, duke i dhënë mundësi KLSH në dhënien e rekomandimeve përkatëse për përmirësimin e gjendjes, si dhe për të evidentuar përgjegjësitë nëpërmjet rekomandimit të masave disiplinore.

Bazuar në rezultatet e auditimit të Bashkisë Shkodër për periudhën nga data 01.9.2019 deri më datë 31.12.2020, grupi i auditimit me një siguri të arsyeshme ka dhënë "*Opinion i pamodifikuar, me "theksim çështjeje",* për pasqyrat financiare dhe të përputhshmërisë, për veprimtarinë ekonomike dhe financiare të këtij subjekti.

Raporti Përfundimtar i Auditimit është i strukturuar në pesë kapituj: përmbledhja ekzekutive; hyrja, me çështjet e objektivave dhe qëllimi i auditimit, përgjegjësitë e strukturave drejtuese dhe të Audituesve, kriteret, identifikimi i çështjeve etj.; përshkrimi i auditimit, në të cilin paraprin një informacion i përgjithshëm mbi subjektin e audituar dhe vazhdon me trajtimin e rezultateve të auditimit për secilin prej 7 drejtimeve të auditimit; në kapitullin e katërt jepen gjetjet dhe rekomandimet dhe në fund janë anekset.

## I.1. Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit

| Gjetja Nr. | Përmbledhje e gjetjes | Rëndësia | Referenca me Raportin | Rekomandimi |
|---|---|---|---|---|
| 1. | Nga auditimi i dokumentacionit mbi zbatimin e buxhetit, u konstatua se:<br>-*Për vitin 2019* buxheti është realizuar në masën 79% ose nga 3,670,148 mijë lekë të planifikuara, | 39-56 | E mesme | Drejtoria e Analizës dhe e Programimit Buxhetor në bashkëpunim me Drejtoritë/ Sektorët e tjerë Bashkia Shkodër, gjatë hartimit dhe miratimit të buxhetit të planifikojë fonde për investime në raport |

| Gjetja Nr. | Përmbledhje e gjetjes | Rëndësia | Referenca me Raportin | Rekomandimi |
|---|---|---|---|---|
| | janë realizuar 2,897,989 mijë lekë, ndërsa *për vitin 2020* është realizuar në masën 76% ose nga 3,671,412 mijë lekë të planifikuara, janë realizuar 2,774,458 mijë lekë.<br>- Niveli i realizmit të investimeve të planifikuara është shumë i ulët, ku *për vitin 2019* paraqitet në masën 65 %, ose nga vlera planifikuar prej 939,887 mijë lekë është realizuar vlera prej 609,647 mijë lekë dhe në *vitin 2020* në masën 58 %, ose nga vlera planifikuar prej 731,594 mijë lekë është realizuar vlera prej 425,959 mijë lekë, pavarësisht faktit se niveli i investimeve nga njëra periudhë në tjetrën është në ulje për vlerën 208 milion lekë.<br>Në planifikimin e buxheteve për investime, konstatohet se të gjitha investimet janë planifikuar me afat pagese nga 2 - 3 vjeçare, të cilat janë miratuar në PBA respektive, në vlera të vogla që variojnë nga 10 deri në 20 milionë lekë dhe me afat zbatimi deri në 60 ditë, ku subjektet sipërmarrëse kanë paraqitur në afat situacionit përfundimtar dhe faturën bashkëshoqërues, por që pagesa nuk është bërë në vlerën e plotë të sajë, duke bërë copëzim të faturës dhe mbi bazën e PBA të miratuara, veprime në kundërshtim me nenet 42,43,47,50,51,52 dhe 65, të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 "Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar; pika 101 dhe 102 të udhëzimi të MFE nr. 2, datë 06.02.2012 "Për Procedurat Standarde të Zbatimit të Buxhetit" me ndryshime; neni 47 të ligjit nr. 68/2017 "Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore"; nenet 79 -80 -81, të udhëzimit të MFE nr. 9,datë 20.03.2018 "Për Procedurat Standarde të Zbatimit të Buxhetit" me ndryshime; Ligji nr. 68-2017, "Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore", Ligji nr. 139/2015, datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore", Udhëzimi nr. 23 datë 22.11.2016, "Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm" dhe Vendimet përkatëse të Këshillit Bashkiak dhe | | | me nivelin e të ardhurave të realizuara për vitin dhe grandeve të planifikuara nga qeveris, në raport me përqindjen e planifikuar për këtë zë.<br>Planifikimi i të ardhurave të bëhet mbi baza reale dhe shpërndarja e fondeve buxhetore të bazohet në parashikimin e fluksit të hyrjeve të parasë dhe të angazhimeve, ku të sigurohet një përdorim eficent i burimeve financiare, duke rritur financimet nga të ardhurat e veta. |

| Gjetja Nr. | Përmbledhje e gjetjes | Rëndësia | Referenca me Raportin | Rekomandimi |
|---|---|---|---|---|
| | Udhëzimin e MF nr. 2 datë 06.02.2012 "Për procedurat standarte të zbatimit të Buxhetit" i ndryshuar, pikat 253 dhe 354 | | | |
| 2. | Nga të dhënat e pasqyrës, rezulton se gjendja e faturave të palikuiduara në fund të ***vitit 2019*** është në shumën 375,509 mijë lekë dhe në fund të ***vitit 2020*** është në shumën 196,658 mijë lekë, pra me një ulje për shumën 178,851 mijë lekë.<br>Në të dy periudhat peshën kryesore të faturave të palikuiduara e zënë investimet (llog 231), ku për vitin 2019 zënë 74.4% dhe për vitin 2020 zënë 78% të totalit të faturave.<br>Nga krahasimi i të dhënave të analizës së faturave të palikuiduara me raportet e detyrimeve të prapambetura në MFE dhe me gjendjet e llogarive të klasës 4 në bilanc në fund të periudhave ushtrimore, rezultoi se:<br>*<u>Për vitin 2019</u>*, detyrimet e raportuara në MFE janë vlerën 54,532 mijë lekë, ndërsa në PF të vitit 2019 gjendjet e llogarive të klasës 4 të detyrimeve (pasiv bilancit) janë në vlerën 375,509 mijë lekë, pra me një diferencë prej 320,970 mijë lekë më pak në të dhënat e dërguara në MFE.<br>*<u>Për vitin 2020</u>*, detyrimet e raportuara në MFE janë vlerën 51,304 mijë lekë, në PF të vitit 2020 gjendjet e llogarive të klasës 4 të detyrimeve (pasiv bilancit) janë në vlerën 196,658 mijë lekë, pra me një diferencë prej 145,354 mijë lekë më pak në të dhënat e dërguara në MFE**.**<br>**-** Nga auditimi i pagesave të kryera nëpërmjet Bankës dhe testimi i tyre në lidhje me respektimin afatit **30-ditor** të paraqitjes në Degën e Thesarit Shkodër të urdhër-shpenzimit me dokumentacionin shoqërues nga data e faturës së operatorit ekonomik, u konstatua se për periudhën objekt auditimi, janë kryer pagesa mbi afatin 30 ditor të faturave për shpenzime/ shërbime/investime të mbërritura në institucion në **29** raste në vlerën **55,314 mijë lekë**. | 39-56 | E larte | -Drejtoria e Financë Bashkia Shkodër, të marrë masa për sigurimin e likuiditeteve në kohë, në mënyrë që të mos krijojë kufizime limiti të arkës *(përjashtuar kufizimet e MFE)*, për likuidimin e faturave, me qëllim që të mos akumulohet borxh për fatura të palikuiduara dhe përfshirjen e institucionit në vështirësi financiare.<br>Gjithashtu, planifikimi i procedurave të prokurimit të jetë në raport të drejtë me fondet në dispozicion, vlerën e faturave të palikuiduara në fund të periudhës dhe vlerën e kontratave të lidhura me likuidim me këste, veprime të cilat do të ulnin vlerën e faturave të palikuiduara në fund të periudhave ushtrimore.<br>- Kryetari i Bashkinë në cilësinë e Nëpunësit Autorizues, në bashkëpunim me Drejtorin e Financës në cilësinë e Nëpunësit Zbatues dhe Drejtorin e Buxhetit, të marrin masa që në hartimin e buxheteve të viteve në vijim, të planifikojnë procedura prokurimi me fonde publike në raport të drejtë me fondet në dispozicion, vlerën e faturave të palikuiduara në fund të periudhës dhe vlerën e kontratave të lidhura me likuidim me këste, veprime të cilat do të ulnin vlerën e faturave të palikuiduara në fund të periudhave ushtrimore. |

| Gjetja Nr. | Përmbledhje e gjetjes | Rëndësia | Referenca me Raportin | Rekomandimi |
|---|---|---|---|---|
| | - Është konstatuar se jo në të gjitha rastet janë ndjekur hapat për realizmin e pagesave sipas afateve, megjithëse dokumentacioni që shoqëron pagesën është i plotë, pasi ka kontrata të cilat nuk paguhen, pavarësisht faktit se investimet janë planifikuar si financim në periudha 2 – 3 vjeçare, konstatohet se financimet e periudhës përkatëse nuk është mundësuar likuidimi i tyre, kjo për mungesë fondesh nga realizmi i të ardhurave, *konkretisht*:<br>Ne periudhën e **vitit 2019** nga vlera e kontrata të planifikuara për likuidim prej 558,352 mijë lekë është likuiduar për këtë periudhë vlera 469,449 mijë lekë, duke mos likuiduar shumën 88,902 mijë lekë. Ndërsa për aktivitetin e **vitit 2020** nga vlera e planifikuar për likuidim prej 584,976 mijë lekë është likuiduar vlera 287,211 mijë lekë duke lënë për likuidim vlera 297,764 mijë lekë, të dhëna këto të nxjerra nga pagesat e kryera sipas procedurave në vitet respektove.<br>Për të dy periudhat, mospagesën lidhet me faktin me faktin se nga Bashkia Shkodër, nuk janë realizuar të ardhurat e planifikuara dhe të destinuara për likuidimin e fondeve të prokuruar. Pra nga sa mësipërm nuk janë respektuar dhe këstet e parashikuara në PBA, veprime në kundërshtim me nenin 40 të ligjit 139/2015, datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore"; paragrafin e parë të nenit 40 dhe neni 52 të ligjit nr.9936, datë 26.06.2008 "Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar; nenin 40, 47 pika 3 dhe 48 të ligjit 68/2017, "Për financat e vetëqeverisjes vendore"; UMF nr. 5, datë 27.12.2014 "Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura", pikat 82-91 | | | |
| 3. | Nga auditimi i pasqyrave financiare të vitit 2020, u konstatua se:<br>- Llogaria 466 "Kreditore për mjete nën ruajtje", sipas Pasqyrës së Pozicionit Financiar të Bashkisë Shkodër, në fund të vitit 2019 paraqitet në vlerën 92,179,959 lekë | 84-91 | E lartë | - Drejtoria e Financës në bashkëpunim me Drejtorinë e Shërbimeve Publike, të marrin masa për të bërë sistemimin e llogarisë 466 "*Kreditore për mjete nën ruajtje*" rakorduar drejtoritë njëra me tjetrën çdo muaj mbi balancat e llogarisë 466 si dhe duke njoftuar subjektet për paraqitjen e |

| Gjetja Nr. | Përmbledhje e gjetjes | Rëndësia | Referenca me Raportin | Rekomandimi |
|---|---|---|---|---|
| | dhe në fund të vitit 2020 paraqitet në vlerën 93,508,882 lekë, e cila përfaqëson vlerën e garancisë së kontratave në masën 5%<br>Nga analiza e kësaj llogarie rezultoi se vlera në fund të vitit 2019 dhe 2020, ka pasur në përbërje të llogarisë detyrime për garanci punimesh të bashkisë ndaj subjekteve privatë, garanci këto të cilave u ka kaluar afati i përcaktuar në kontratat përkatëse të investimit dhe përsëri janë akoma gjendje në llogarinë 466. Sistemimi i vlerës totale të llogarisë 466 "Kreditore për mjete nën ruajtje" duhet të bëhet duke njoftuar subjektet për paraqitjen e dokumentacionit të nevojshëm për të sistemuar dhe pastruar garancitë të cilat tashmë u ka kaluar afati i përcaktuar në kontratën e investimit përkatës.<br>Përfundimisht për vitin 2019 dhe 2020 llogaria 466 "Kreditore për mjete nën ruajtje" është mbivlerësuar për 3,670,249 lekë për vitin 2020 dhe 690,238 lekë për vitin 2019, për të cilat duhet të bëhet sistemimi i llogarisë.<br>- Llogaria 401- 408 "*Furnitorë e llogari te lidhura me to" si dhe* 467 "*Kreditorë të ndryshëm*" **"** përfaqësojnë detyrimet e vitit si dhe detyrimet e prapambetura ndaj të tretëve, për shpenzime, shërbime apo investime të kryera. Është vënë re fenomeni i likuidimit pjesor të faturave që janë pranuar nga Drejtoria e Financës. Kjo ka ardhur si shkak i lidhjes së kontratave të investimeve, zbatimi i të cilave nuk përputhet në kohë me kohën e financimit të tyre. Praktikisht zbatimi i kontratave arrin nga 3 deri në 6 muaj, ndërsa financimi i pikërisht këtyre kontratave shkon deri në 3 vjet, sipas planit të pagesave dhe PBA 3vjecare. Duke analizuar faturat e investimeve të regjistruara për vitet 2019, u vu re se regjistrimi i disa prej tyre nuk ishte bërë për vlerën e plotë të faturës. Për pasojë llogaria 401-408 "Furnitorë e llogari të lidhura me to" është nënvlerësuar për 22,586,833 lekë dhe llogaria 467 | | | dokumentacionit të nevojshëm për të sistemuar dhe pastruar garancitë të cilat tashmë u ka kaluar afati i përcaktuar në kontratën e investimit përkatës.<br>- Nga Drejtoria e Financës, të merren masa për të bërë sistemimin e llogarisë 401-408 "*Furnitorë e llogari të lidhura me to*" dhe 467 "*Kreditorë të ndryshëm*", të cilat janë nënvlerësuar përkatësisht me 22,586,833 lekë dhe 4,099,781 lekë për vitin 2019. Gjithashtu, pas saktësimit të detyrimeve të prapambetura, duhet të merren masa për raportimin e tyre në Ministrinë e Financave, raportim i cili aktualisht nuk është real. |

| Gjetja Nr. | Përmbledhje e gjetjes | Rëndësia | Referenca me Raportin | Rekomandimi |
|---|---|---|---|---|
| | "Kreditorë të ndryshëm" është nënvlerësuar me 4,099,781 lekë llogarisë | | | |
| 4. | Regjistrimi në kontabilitet i debitorëve, të cilët në analitikën e tyre përbëhen nga debitorët nga taksat dhe tarifat vendore për subjektet private, abonentë familjar, gjobat e IMTV ndër vite, debitorët e trashëguar ndër vite nga ish-Komunat, sot Njësit Administrative, si dhe nga kamatëvonesa të cilat përbëjnë të ardhura të paarkëtuara, për vitin 2020, si më poshtë;<br>*Llogaria 468 "Debitorë të ndryshëm" në shumën 1,174,224,674 lekë te 475 "Te ardhura për t'u regjistruar vitet pasardhëse" në shumën 1,174,224,674 lekë*<br>Në nivel llogarie, regjistrimi i të ardhurës sipas dhe udhëzimit nr. 8 datë 9.3.2018, "*Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme*", në momentin e njohjes apo konstatimit të të ardhurës, në varësi të llojit të të ardhurës, bëhet regjistrimi kontabël dhe debitohet 468 "*Debitorë të ndryshëm*" e vitit përkatës, duke kredituar klasa 70 "*Të ardhurave të vitit përkatës*", në të cilën është njohur debitori. Pra debitorët, në rastin konkret si kundërparti kanë pasur llogarinë 475 "*Te ardhura për t'u regjistruar vitet pasardhëse*", kur në fakt duhej të kreditohej klasa 7, pra e ardhura përkatëse e çdo viti në të cilin është njohur debitori.<br>Përfundimisht për vitin 2020 duhet të bëhet sistemimi i llogarisë 475 "*Te ardhura për t'u regjistruar vitet pasardhëse*" për vlerën 1,174,224,674 lekë në 2020, duke transferuar njohjen e të ardhurave përkatëse në secilin vit llogarisë | 84-91 | E lartë | Nga Drejtoria e Financës, të merren masa për të bërë sistemimin në kontabilitet të llogarive kontabël *475 Te ardhura për t'u regjistruar vitet pasardhëse si dhe llogarive vjetore të të ardhurave të klasës 70 "Tatime dhe taksat dhe tatimet"* Gjithashtu të sistemohet e ardhura e akumuluar ndër vite nga taksat dhe tarifat vendore për secilin vit përkatës në llogarinë *1210 "Rezultat i mbartur i seksionit të funksionimit"* të vitit në vazhdim |
| 5. | Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt *"Rikonstruksion rruga Velipojë Plazh, Loti I-rë", Bashkia Shkodër,* me vlerë 31,876,487 lekë me TVSh, fituar nga BOE "N..." & "A..." SHPK, rezultuan diferenca në | 141-148 | E lartë | Drejtoria e Financës në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike, Bashkia Shkodër të marrë masa për arkëtimin e vlerës prej **1,065,759 lekë pa TVSh** nga BOE "N..." & "A..." SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 3349/13 prot datë 24.05.2019, me objekt "*Rikonstruksion* |

| Gjetja Nr. | Përmbledhje e gjetjes | Rëndësia | Referenca me Raportin | Rekomandimi |
|---|---|---|---|---|
| | volume pune të pakryera në fakt në vlerën 1,065,759 lekë pa TVSh, veprimet në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes nr. 3349/13 prot datë 24.05.2019 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkia Shkodër dhe BOE "N..." & "A..." SHPK | | | *rruga Velipojë Plazh, Loti I-rë*", Bashkia Shkodër, duke ndjekur të gjitha procedurat administrative e ligjore në të gjitha shkallët e gjykimit, vlerë kjo e cila përfaqëson punimeve të pakryera. |
| 6. | Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt *"Rikonstruksion rruga Velipojë Plazh, Loti II-të", Bashkia Shkodër,* me vlerë 47,839,706 lekë me TVSh, fituar nga OE "C..." SHPK, rezultuan diferenca në volume pune të pakryera në fakt në vlerën 337,290 lekë pa TVSh, veprimet në kundërshtim me kontratën nr. 3349/12 prot datë 22.05.2019 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkia Shkodër dhe OE "C..." SHPK | 141-148 | E lartë | Drejtoria e Financës në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike, Bashkia Shkodër të marrë masa për arkëtimin e vlerës prej **337,290 lekë pa TVSh** nga OE "C..." SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 3349/12 prot datë 22.05.2019, me objekt *"Rikonstruksion rruga Velipojë Plazh, Loti II-të*", Bashkia Shkodër, duke ndjekur të gjitha procedurat administrative e ligjore në të gjitha shkallët e gjykimit, vlerë kjo e cila përfaqëson punimeve të pakryera. |
| 7. | Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt *"Rikonstruksion rruga Udha kryq", Bashkia Shkodër,* me vlerë të kontratës 24,973,654 lekë me TVSh, fituar nga BOE "S..." & "S..." SHPK, rezultuan diferenca në volume pune të pakryera në fakt në vlerën 369,055 lekë pa TVSh, veprimet në kundërshtim me kontratën nr. 1931/12 prot datë 10.04.2019 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkia Shkodër dhe BOE "S..." & "S..." SHPK | 141-148 | E lartë | Drejtoria e Financës në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike, Bashkia Shkodër të marrë masa për arkëtimin e vlerës prej **369,055 lekë pa TVSh** nga BOE "S..." & "S..." SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 1931/12 prot datë 10.04.2019, me objekt "*Rikonstruksion rruga Udha kryq*", Bashkia Shkodër, duke ndjekur të gjitha procedurat administrative e ligjore në të gjitha shkallët e gjykimit, vlerë kjo e cila përfaqëson punimeve të pakryera |
| 8. | Autoriteti kontraktor për llogaritjen e çmimit të karburanteve nuk është mbështetur në buletinet e APP në çmimet referuar bursës REUTERS për datën e furniturës lëvruar *sipas kushtit CIF-Shqipëri në këtë moment*, sipas raporteve të analizave nga Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial për sasinë e importuar**,** gjithashtu janë shtuar elementë fiskalë si "*taksa e markimit*" jo në përputhje me ligjin nr. 9975, datë 28.07.2008, "*Për taksat Kombëtare*", të ndryshuar, pasi është shtuar dhe taksa e shënjimit të naftës bruto dhe nënprodukteve të naftës sipas VKM nr. 498, datë 30.05.2013 dhe në kundërshtime me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "*Për miratimin e* | 84-91 | E lartë | Nga ana e Bashkisë Shkodër, në llogaritjen e çmimit të karburanteve, duhet të mbështetet në buletinet e APP, me çmimet referuar bursës REUTERS për datën e furniturës, sipas *kushtit CIF-Shqipëri*, raporteve të analizave sipas datës respektive të lëshuara nga Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial për sasinë e produktit të importuar, referuar elementëve fiskalë të përcaktuara me ligj.<br>Nga ana e Bashkisë Shkodër dhe Drejtorisë së Financës, të ndiqen të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, për arkëtimin e vlerës prej **239,068 lekë me TVSh** e cila duhet ti kthehet bashkisë nga subjekti "K... " ShPK. |

| Gjetja Nr. | Përmbledhje e gjetjes | Rëndësia | Referenca me Raportin | Rekomandimi |
|---|---|---|---|---|
| | *rregullave të prokurimit publik"*, neni 77, pika 5. Nga auditimi i zbatimit të kontratave të blerjes së karburantit rezultoi se në likuidimin e sasisë së karburantit gazoil dhe benzol nga Bashkia Shkodër, nuk është respektuar çmimi i miratuar sipas kontratës për furniturën bazuar çmimit referuar bursës REUTERS për datën e furniturës *lëvruar sipas kushtit CIF-Shqipëri në këtë moment*, gjithashtu si element i çmimit është llogaritur edhe markimi i karburantit, *si rrjedhojë janë kryer pagesa të tepërta për gazoilin dhe benzolin e likuiduar në vlerën 239,068 lekë me TVSh e cila duhet ti kthehet bashkisë nga subjekti "K..." ShPK*. pasi është përfituar në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", neni 77, pika 5 | | | |
| 9. | Nga auditimi i procedurave të prokurimit me objekt "Ruajtje e godinës për Administrimin dhe Mirëmbajtjen e Stadiumit "Loro Boriçi" dhe "Shpenzime të tjera për Administrim dhe Mirëmbajtje e Stadiumit 'Loro Borici'", u konstatua se investimi primar mbi stadiumin "Loro Borici" ishte "Ndërtimi i tribunës kryesore në perëndim dhe të tribunës në jug, rikonstruksion i tribunës kryesore në veri dhe në lindje në stadiumin Loro Borici". Ky investim, ka ardhur pas nënshkrimit të marrëveshjes së protokolluar në Bashkinë Shkodër me nr. prot 11445 datë 07.12.2015, midis Federatës Shqiptare të Futbollit dhe Bashkisë Shkodër. Origjina e financimit të këtij investimi është përcaktuar në VKM nr. 732 datë 02.09.20015 "Për bashkëfinancimin e Stadiumit Loro Borici" ku nga buxheti i shtetit i akordohej fondi prej 1.5 miliard lekësh i cili i vihet në dispozicion Ministrisë së Arsimit dhe të Sporteve, në programin buxhetor 08140 "Programi për Sportin" dhe pas miratimit nga Komiteti i Ndihmës Shtetërore, i transferohet Federatës Shqiptare të Futbollit. Pjesa tjetër e investimit do të | 155-163 | E lartë | Titullari i Bashkisë Shkodër në bashkëpunim me Drejtorinë e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit, të marrin masa për arkëtimin e vlerës **14,418,295 lekë** nga **Federata Shqiptare e Futbollit,** duke ndjekur procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit |

| Gjetja Nr. | Përmbledhje e gjetjes | Rëndësia | Referenca me Raportin | Rekomandimi |
|---|---|---|---|---|
| | mbulohet nga UEFA, FIFA dhe vet FSHF.<br>Për sa i përket pronësisë së stadiumit "Loro Borici", theksojmë se nëpërmjet VKM-së nr.421 datë 02.06.2010 " *Për miratimin e listës përfundimtare (të pjesshme) të pronave të paluajtshme publike, që transferohen në pronësi ose në përdorim të bashkisë Shkodër, të qarkut të Shkodrës*" është transferuar ,ndër te tjera nga lista e inventarit publik , edhe stadium "Loro Borici" nga lista e inventarit të pronave publike në listën e inventarit të Bashkisë Shkodër. Në kolaudim kjo pronë është e paregjistruar si dhe nuk bën pjesë në Aktivet Afatgjata Materiale të Pasqyrave Financiare të Bashkisë Shkodër.<br>Duke marrë shkas nga sa më sipër, në mbështetje të marrëveshjes së FSHF-së dhe Bashkisë Shkodër , e cila u miratua me Vendim të Këshillit Bashkiak nr. 50 datë 04.12.2015., u sigurua dhe leja e ndërtimit për objektin nga ana e Këshillit Kombëtar të Territorit me vendim të KKT nr.1 datë 01.04.2015. Në këtë vendim të KKT-së, përcaktohet qartë se subjekti kërkues për leje është Federata Shqiptare e Futbollit, e cila, sipas pikës 4 të vendimit, duhet ti jepej Formular i Lejes së Ndërtimit (zbardhja e lejes së ndërtimit nga Bashkia Shkodër) *vetëm pasi subjekti kërkues FSHF të ketë paguar taksën e ndikimit në infrastrukturë për llogari të Bashkisë Shkodër*. Pas ballafaqimit me subjektin Bashkia Shkodër, u arrit në konkluzionin se taksa e ndikimit ne infrastrukturë nuk ishte llogaritur për shkak se nuk është bërë një aplikim për leje ndërtimi nga ana e subjektit kërkues që është Federata Shqiptare e Futbollit (referuar dhe Vendimit të KKT-së nr.1 datë 01.04.2015 pikës 1 dhe 4) Si konkluzion, nisur nga ligji 145/2015, datë 17.12.2015 dhe nga Paketa Fiskale e vitit 2015, taksa e ndikimit në infrastrukturë që duhet të ishte llogaritur nga Drejtoria e Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit | | | |

| Gjetja Nr. | Përmbledhje e gjetjes | Rëndësia | Referenca me Raportin | Rekomandimi |
|---|---|---|---|---|
| | si dhe paguar nga Federata Shqiptare e Futbollit, llogaritet si më poshtë;<br>*<u>Llogaritja sipas situacionit përfundimtar;</u>*<br>Nisur nga situacionit përfundimtar i sjellë nga ndërtuesit "T...SHPK", vlera e TNI-së llogaritur sipas legjislacionit të sipërpërmendur është:<br>***TNI=*** Situacioni përfundimtar pa pjesën e financimit të buxhetit të shtetit x 2% = 720,914,773 lekë x 2%= 14,418,295 lekë.<br>Vlera prej **14,418,295 lekë** për shkak të mosllogaritjes së taksës së ndikimit në infrastrukturë, përbën dëm ekonomik shkaktuar buxhetit të Bashkisë Shkodër. | | | |
| 10. | Në Bashkinë Shkodër për periudhën objekt auditimi 01.7.2019 – 31.12.2019, janë realizuar gjithsej **260** procedura me fond limit 1,633,987 mijë lekë dhe vlerë kontrate 1,422,698 mijë lekë. Grupi i KLSH-së, referuar të dhënave të riskut nga **260** procedura me fond limit 1,633,987 mijë lekë ka vlerësuar për auditim **89** procedura me fond limit 1,102,197 mijë lekë ose 67.4% të fondit të prokuruar.<br>Nga auditimi i 89 procedura me fond limit 1,102,197 mijë lekë, u konstatua se në **11** procedura mos zbatimit të kërkesave ligjore gjatë zhvillimit të procedurave të prokurimit publik, si në aplikimin e kritereve dhe në shpalljen fitues të operatorë ekonomikë të cilët nuk plotësojnë disa nga kriteret e veçanta për kualifikim, të përcaktuara në DT, duke përdorur fonde publike në kundërshtim me kërkesat ligjore, në vlerën **135,672 mijë lekë** ose 13 % e fondit limit të audituar, veprime në kundërshtim me ligji nr. 9643, datë 20.11.2006, "Për prokurimin publik", i ndryshuar, përkatësisht: neni 2, *"Parimet e përzgjedhjeje"*, neni 24, *"Anulimi i një procedure"*, neni 46, *"Kualifikimi i ofertuesve"*, pika 1, neni 47, "*S`kualifikimi i ofertuesve*", neni 53, *"Shqyrtimi i ofertave"*, neni 55, *"Kriteret e përcaktimit të ofertës"*, neni 58, *"Njoftimi i fituesit dhe nënshkrimi i* | 91-141 | E lartë | Kryetari i Bashkisë Shkodër, në cilësinë e Titullarit të AK, të marrë masa që në komisionet e NHDT dhe KVO, të emërojë persona me profil sipas llojit të procedurës, ku të aplikojnë kritere në përputhje me natyrën e procedurës së zhvilluar.<br>Gjithashtu të analizojë arsyet e kualifikimit të padrejtë të operatorëve ekonomikë, dhe të marrë masa për eliminimin e praktikave të tilla, kjo për të bërë të mundur përdorimin më me efektiv të fondeve të prokura. |

| Gjetja Nr. | Përmbledhje e gjetjes | Rëndësia | Referenca me Raportin | Rekomandimi |
|---|---|---|---|---|
| | *kontratës"*, pika 1; VKM nr. 914, datë 29.12.2014, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, nenet: 26, "*Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave*", pika 5, neni 66, "*Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave*", neni 67, *"Klasifikimi i ofertave"*, neni 69, *"Njoftimi i fituesit"*, neni 70 *"Lidhja e kontratës"*, neni 78 "*Ankesat në autoritetin kontraktor,* si dhe Vendimi i KM nr. 514, datë 20.9.2017 "Për miratimin e listës kombëtare të profesioneve (LKP)", të rishikuar | | | |
| 11. | Nga auditimi i dokumentacionit të paraqitur nga DAV Bashkia Shkodër, u konstatua se referuar Vendimit të KB për paketën fiskale, taksa e ndërtesës për familjarët në mungesë të dokumentacionit ligjorë *(genplani për sipërfaqet ose të dhënave nga ASHK)* është lënë 100 $m^2$, mbi të cilën janë aplikuar tarifat sipas ligjit (çmim/$m^2$). Kjo mënyrë e aplikimit të taksës së ndërtesës për familjarët, favorizon disa dhe penalizon disa të tjerë, pasi pas viteve 90 ka shumë ndërtime me sipërfaqe mbi 100 $m^2$ *(2 dhe 3 kate)*, të cilat nuk janë identifikuar, duke bërë që ndajë tyre të mos aplikohet saktë taksa e ndërtesës, veprime të cilat çojnë në mungesë të ardhurave nga kjo takes.<br>Gjithashtu, referuar të dhënave të marra nga Drejtoria e Planifikim Zhvillim Territorit (PZHT) Bashkia Shkodër, u konstatua të jenë dhënë këto leje ndërtimi/ zhvillimi investitorëve të ndryshëm, ndajë të cilave DAV Bashkia Shkodër nuk ka aplikuar saktë taksës e ndërtesës sipas sipërfaqeve të ndërtimit që ato disponojnë, sipas të dhënave të marra në DPZHT për **6** subjekte, duke krijuar të ardhura të munguara në buxhetin e Bashkisë Shkodër në shumën **648,359 lekë** për vitin 2020**,** veprime në kundërshtim me nenet 20, 21 dhe 22, të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 "Për Taksat vendore" i ndryshuar dhe pikës 4 të VKM nr. 132, datë 7.3.2018 "Për metodologjinë për përcaktimin e vlerës së taksueshme të pasurisë së paluajtshme "ndërtesa", e bazës së | 56-84 | E lartë | Drejtoria e të Ardhurave Vendore Bashkia Shkodër në bashkëpunim me strukturat e tjera të Bashkisë Shkodër, të marrë masa për evidentimin e objekteve të abonentëve familjarë dhe jo vetëm me sipërfaqe mbi 100 $m^2$, duke aplikuar saktë taksës e ndërtesës, kryesisht të objekteve të dyta dh të ndërtuara pas viteve 90.<br>- Drejtoria e të Ardhurave Vendore, të ndjekë të gjitha proçedurat administrative e ligjore për arkëtimin e taksës së ndërtesë ndaj **6** subjekteve për vlerën **648,359 lekë**, të pataksuar si më poshtë:<br>**- vlera 271,788 lekë**, ndajë subjektit "C...".<br>**- vlera 157,992 lekë**, ndajë subjektit "A...".<br>**- vlera 74,820 lekë**, ndajë subjektit "P...".<br>**- vlera 17,910 lekë**, ndajë subjektit "V...".<br>**- vlera 103,617 lekë**, ndajë subjektit "D.. ". |

| Gjetja Nr. | Përmbledhje e gjetjes | Rëndësia | Referenca me Raportin | Rekomandimi |
|---|---|---|---|---|
| | taksës për kategori specifike, natyrën dhe prioritetin e informacionit dhe të dhënave për përcaktimin e bazës së taksës, si dhe të kritereve dhe rregullave për vlerësimin alternativ të detyrimit të taksës” | | | |
| 12. | Nga auditimi i dokumentacionit mbi pasjen<br>Sipas të dhënave të paraqitura nga DAV Bashkia Shkodër dhe Drejtoria e Shërbimeve për vitin 2019 ushtrojnë aktivitet në këtë fushë **43** subjekte, ku vetëm 1 subjekt është licencuar për vlerën 1,000,000 lekë (e paguar). Ndërsa për vitin 2020 ushtrojnë këtë aktivitet **45** subjekte, ku vetëm 13 prej tyre janë licencuar. Nga vlera e tarifës prej 10,069,966 lekë është paguar vlera 9,769,966 lekë, duke mbetur pa arkëtuar vlera 300,000 lekë, kjo për 13 subjektet e liçensuar, pasi pagesa është ndarë me këste mujore.<br>Nga të dhënat e mësipërme, konstatohet se nuk janë licencuar me leje tregtim karburanti, gjithsej **40** subjekte të cilët ushtrojnë aktivitet dhe papaguar detyrimin fiskal në **vlerën 40,000,000 lekë,** e ardhur e munguar në buxhetin e Bashkisë Shkodër**,** *të dhëna të cilat paraqiten në pasqyrën Aneks III/2.6.3, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit*, veprime në kundërshtim me ligji nr. 8450, datë 24.2.1999 “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre”, i ndryshuar me ligjin nr. 71/2014 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8450, datë 24.2.1999, “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre”, të ndryshuar, neni 4, neni 20, pika 2 dhe VKM-së nr. 344, datë 19.04.2017, kreu II, pika 9 dhe 10 | 56-84 | E lartë | Drejtoria e Shërbimeve Publike në bashkëpunim me Drejtorinë e të Ardhurave Vendore dhe Policinë Bashkiake, Bashkia Shkodër, të ndjekë të gjitha rrugët administrative e ligjore për pajisen me liçensa të subjekteve që tregtojnë hidrokarbure dhe derivatet e tyre dhe arkëtimin e tarifës së pataksuar prej **40,000,000 lekë** ndajë **40** subjekteve, *sipas pasqyrës Aneks III/2.6.3 bashkëlidhur Projekt Raport Auditmit* |
| 13. | Sipas të dhënave për strukturën organike të DAV Bashkia Shkodër, konstatohet se nuk ka një strukturë përgjegjëse për menaxhimin e borxhit (debitorëve nga taksat/ tarifat vendore). Kështu referuar të dhënave të paraqitura nga kjo drejtori, detyrimet për taksat e tarifat vendore | 56-84 | E lartë | - Drejtoria e të Ardhurave Vendore Bashkia Shkodër, bazuar në nenin 70 pika 3 “*E drejta për të nxjerrë njoftimin e vlerësimit tatimor*”, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat tatimore në R.SH”, i ndryshuar, të marrë masa për nxjerrjen e njoftim vlerësimet tatimore për debitorët duke ndjekur të gjitha rrugët për arkëtimin |

| Gjetja Nr. | Përmbledhje e gjetjes | Rëndësi a | Referenc a me Raportin | Rekomandimi |
|---|---|---|---|---|
| | për subjektet fizik/juridik dhe abonentë familjare paraqitet në vlerën 880,914 mijë lekë.<br>Nga të dhënat konstatohet se detyrimet debitorë paraqiten në rritje nga njëra periudhë në tjetrën, ku nga 8614 subjekte me vlerë 788,835 mijë lekë në fund të vitit 2019, në fund të vitit 2020 kjo gjendje paraqitet për 18035 subjekte me vlerë **880,914 mijë lekë**, *pra shtuar për 9421 subjekte me vlerë 92,079 mijë lekë ose shtuar për 8.5%.*<br>Peshën kryesorëve të detyrimeve për taksat e tarifat vendore e zënë abonentët familjarë, ku në fund të vitit 2020 paraqiten me një vlerë prej 357,295 mijë lekë ose 40.8%, detyrime të cilat mblidhen nga agjenti tatimorë "U..." sh.a.<br>Konstatohet se çdo vit gjendja e detyrimeve të paarkëtuara është më e lartë se arkëtimet e vitit, kjo për vlerën e detyrimeve të mbetura.<br>Referuar dokumentacionit të paraqitur nga DTTV mbi masat e marra në lidhje me punën e kësaj drejtorie ne arkëtimin e debitorëve, në zbatim të ligji nr. 9920, datë 19.05.2008 **"**Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë**"**, me ndryshime, Udhëzimit nr. 24, datë 02.09.2008 **"**Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë**"**, me ndryshime, rezulton se në shkresat përcjellëse (trajtuar në akt-konstatim), nuk janë përcaktuar vlerat për të cilën është kërkuar bllokim dhe sa rezultat ka pasur ky veprim. Nuk i janë dërguar shkresa adresuar Drejtorisë së Transportit për marrjen e masave në arkëtimin e vlera të subjekteve që disponojmë mjete.<br>Në raport me numrin e subjekteve debitorë në fund të periudhave ushtrimore dhe subjekteve për të cilat është kërkuar në zbatim të ligjit masa shtrënguese, konstatohet se është shumë i vogël, kështu nga 11697 subjekte fizik/ juridik me vlerë 300,632 mijë lekë është zbatuar marrje masa vetëm për 984 subjekte ose 8.4% e totalit të subjekteve. Nuk | | | e detyrimeve për taksat dhe tarifat vendore në vlerën **880,914 mijë lekë** *(sipas listave që disponon DAV Bashkia Shkodër, paraqitur në CD)*, duke ndjekur procedurat si më poshtë vijon**:**<br>a- Tu dërgohen bankave të nivelit të dytë urdhrat e bllokimit të llogarive bankare.<br>b- Të dërgohet në Drejtorinë Rajonale të Transportit, kërkesa për vendosjen e barrës siguruese (për mjetet) dhe në AKSH (për pasuritë e paluajtshme).<br>c- Për subjektet të cilët nuk kanë paguar detyrimet tatimore në afat, ndaj tyre të aplikohet llogaritja e gjobës në masën 0.06% të shumës së detyrimit të papaguar për çdo dit gjatë së cilës pagesa nuk është kryer, por jo më shumë se 365 ditë (gjobë).<br>d- Në rast se bizneset private edhe pas njoftimeve zyrtare dhe dërgimit të urdhër bllokimeve në bankë nuk kryejnë pagesën e detyrimeve, pasi të merren masat administrative apo sekuestro, të bëhet kallëzim penal, bazuar në Kodin Penal të RSH, miratuar me ligjin nr. 7895, datë 27.1.1995 me ndryshimet e mëvonshme, neni 181 "Mospagimi i taksave dhe tatimeve".<br>e- Drejtoria e të Ardhurave Vendore Bashkia Shkodër, në bashkëpunim me Njësitë Administrative, të evidentojë listat emërore të debitorëve familjarë në mënyrë elektronike, duke të njoftojë nëpërmjet postës (dhe jo vetëm) familjet të cilët nuk kanë paguar detyrimet për taksën e tokës/ tarifën e pastrimit, ndriçimit, banesave dhe gjelbërimit.<br>- Të bashkëpunimet me QKB për mos lejimin e mbylljes së aktivitetit ose kalimi në pasiv të subjekteve me detyrime të paarkëtuara, të cilat kanë premisë për kalimin në debitorë pa shpresë arkëtimi, si dhe të kryhen kontrolle të vazhdueshme në bashkëpunim dhe me Policinë Bashkiake për evidentimin dhe vjeljen e detyrimeve debitorë.<br>**-__**Kryetari i Bashkisë Shkodër në bashkëpunim me Drejtorinë e të Ardhurave vendore, të marrin masa që brenda strukturës së DAV Bashkia Shkodër, të krijojnë "Sektorin e Menaxhimit të Borxhit", si një sektor i rëndësishëm në punën për arkëtimin e debitorëve, nisu kjo dhe nga vlera e lartë e detyrimeve të paarkëtuara dhe që vijnë në rritje nga njëra periudhë në tjetrën. |

| Gjetja Nr. | Përmbledhje e gjetjes | Rëndësia | Referenca me Raportin | Rekomandimi |
|---|---|---|---|---|
| | konstatohet të jenë dërguar njoftim detyrimi për vlerën e borxhit, bllokim të aktivitet për mos likuidim të detyrimeve, vendosja sekuestro dhe deri në kallëzim penal për mos pagës taksa në zbatim të kodi penal, nisur dhe nga fakti se një pjesë e subjekteve janë debitorë në vite dhe për çdo vit ju planifikohen detyrime fiskale të vitit ne vijim.<br>Veprimet e mos veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Pikat 3,4, 5 dhe 5, të nenin 45 – *"Çregjistrimi i subjekteve tatimore"* dhe Kreun XI-*Mbledhja me forcë e detyrimit tatimor të papaguar*, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", me ndryshimet dhe Udhëzimit nr. 24, datë 02.09.2008 **"**Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë**"**, me ndryshime; ligjin nr. 7895, datë 27.01.1995, me ndryshimet e mëvonshme, neni 181 -Mospagimi i taksave dhe tatimeve | | | |
| 14. | Për periudhën nga 01.01.2016 deri më 31.12.2020, sipas listave të vëna në dispozicion me leje legalizimi dhe kryqëzimi i tyre me personat që kanë bërë të mundur likuidimin e taksës së ndikimit në infrastrukturës, rezulton se detyrimi për këtë taksë është në vlerën 250,613,179 lekë për 2016 persona, kanë paguar detyrimet 115 persona me vlerë 30,232,524 lekë dhe kanë mbetur për likuidim deri datë 31.12.2020 gjithsej **1901 persona me vlerë 220,380,615 lekë,** *e ardhur e munguar në buxhetin e Bashkisë Shkodër (sipas listës të administruar në CD).*<br>Nga dokumentacioni i paraqitur, nuk u evidentuan raste që Bashkia Shkodër ti jetë drejtuar ASHK Dega Shkodër, për bllokimin e pasurisë dhe mos kryerjen veprimeve hipotekore ose bllokimin e marrjes së lejes së legalizimit dhe certifikatës pa bërë më parë pagesën taksës së ndikimit në infrastrukturë, veprime në kundërshtim me nenin 27 pika (d), të ligjit nr. 9482, datë 03.04.2006 "Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje,,,"; | 56-84 | E lartë | - Drejtoria e të Ardhurave Vendore Bashkia Shkodër, të marrë masa duke ndjekur të gjitha procedurat administrative dhe ligjore për arkëtimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë për ndërtimet pa leje në vlerën **220,380,615 lekë** ndaj **1901** personave.<br>- Drejtoria e Planifikim Zhvillim Territorit në bashkëpunim me Drejtorinë e të Ardhurave Vendore Bashkia Shkodër, për personat të cilat nuk kanë kryer pagesën e taksës së ndikimit në infrastrukturë për ndërtimet pa leja, t'i kërkojnë Drejtorisë Rajonale Vendore ASHK Shkodër, vendosjen e urdhër kufizimit mbi pasurinë, deri në pagesës e taksës së ndikimit në infrastrukturë.<br>- Drejtoria e Planifikim Zhvillim Territorit, në planifikimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë të bazohet në kërkesat e personave për leje dhe faktin e vitit që mbyllet dhe të mos aplikojë apriori vlera të cilat nuk kanë bazë. |

| Gjetja Nr. | Përmbledhje e gjetjes | Rëndësia | Referenca me Raportin | Rekomandimi |
|---|---|---|---|---|
| | VKM nr. 860, datë 10.12.2014 "Për përcaktimin e mënyrës së mbledhjes dhe administrimit të të ardhurave për ndërtimet pa leje dhe vlerave të zbatueshme për legalizim" i ndryshuar, pika 5 dhe ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 "Për Sistemin e Taksave vendore", i ndryshuar, neni 27- *Taksa e ndikimit në infrastrukturë*, pika 2/1 | | | |

## I.2. Konkluzioni dhe Opinioni i Auditimit

- **<u>Opinioni mbi pasqyrat financiare</u>**

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të Bashkisë Shkodër, për vitin ushtrimor 2020 , të cilat përfshijnë pasqyrat e pozicionit financiar, pasqyrat e performancës financiare, pasqyrat e ndryshimeve të aktiveve, pasqyrat e fluksit të mjeteve monetare dhe pasqyrat e shënimeve shpjeguese. Auditimi ka përfshirë ekzaminimin, në bazë testimesh, të dokumenteve që mbështesin shumat dhe shpalosjet në pasqyrat financiare, ku u bë vlerësimi i parimeve kontabël të përdorura dhe vlerësimeve të bëra nga drejtuesit, si dhe vlerësimi i paraqitjes së përgjithshme të pasqyrave financiare.

**Opinion i pamodifikuar, me "theksim çështjeje"[1]:**
Sipas mendimit tonë, mbështetur në standardet ISSAI 1705[2], dhe ISSAI 1200[3], pasqyrat financiare veprimet përgjatë raportimit financiar dhe transaksionet e kryera për ekzekutimin e buxhetit janë në përputhje me ligjin për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare, si dhe me ligjet dhe rregullat përkatëse të financave publike, përfshirë rregullat për prokurimet dhe ato të buxhetit. Për përmirësimin e mëtejshëm të gjendjes janë adresuar disa çështje të cilat paraqiten te paragrafi "Theksimi i Çështjes".

**Baza për opinionin e pamodifikuar, me theksim çështjeje:**
Ne e kryem auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona, sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit, ku jepen Përgjegjësitë e Audituesit për Pasqyrat Financiare. Ne jemi të pavarur nga Bashkia Shkodër, sipas kërkesave etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare dhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike, në përputhje me këto kërkesa. Ne besojmë se, evidenca e auditimit që kemi siguruar, është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të marrë siguri të arsyeshme, si dhe për të bazuar dhënien e opinionit tonë. (ISA 700). Gjithashtu, ne besojmë se

[1] ***Opinioni i pamodifikuar me theksim cështjeje.*** *Në rrethana të caktuara, audituesi mund të marrë në konsideratë faktin se lexuesi nuk do të arrijë në kuptimin e saktë të pasqyrave financiare nëse atij nuk do t'i tërhiqet vëmendja mbi çështjet të pazakonta ose të rëndësishme. Si parim i përgjithshëm, audituesi nuk i referohet aspekteve specifike të pasqyrave financiare kur jep një opinion të pamodifikuar, në rast se kjo ndodh mund të keqinterpretohet si modifikim. Për të evituar dhënien e kësaj përshtypje të gabuar, referencat e menduara si "theksimi i çështjes" përfshihen në një paragraf të veçuar nga ai i opinionit.*
[2] *Objektivi i audituesit është të formulojë një opinion mbi besueshmërinë e llogarive vjetore dhe llogarive bazuar në një vlerësim të përfundimeve të hartuara nga evidencat e marra të auditimit dhe të shprehë qartë opinionin nëpërmjet një raporti të shkruar që shpjegon bazat e opinionit.*
[3] *Objektivi i audituesit është të ofrojë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat si një e tërë nuk përmbajnë anomali materiale, raste mashtrimi ose gabime, si edhe të raportojë mbi këto pasqyra përsa i takon gjetjeve nga auditimi*

dëshmitë e mara gjatë punës sonë audituese janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazat për përgatitjen e opinionit të pakualifikuar të auditimit.

***Theksimi i çështjeve*:**

Theksojmë nevojën e marrjes së masave nga ana e drejtimit e më pas në linjë hierarkike nga gjithë personeli i subjektit Bashkia Shkodër, sa i takon llogarive të mëposhtme**:**

- *Llogaria 466 "Kreditore për mjete nën ruajtje", është mbivlerësuar për 3,670,249 lekë për vitin 2020 dhe 690,238 lekë për vitin 2019*
- *Llogaria 401-408 ""Furnitorë e llogari të lidhura me to"", është nënvlerësuar për 22,586,833 lekë dhe llogaria 467 "Kreditorë të ndryshëm" është nënvlerësuar me 4,099,781 lekë.*
- *Llogaria 467 "Kreditorë të ndryshëm" është nënvlerësuar me 120,321,483 lekë për vitin 2019 dhe 42,624,355 lekë për vitin 2020.*
- *Llogaria 150 "Shuma të parashikuara për rreziqe e shpenzime" dhe llogaria 683 "Shuma të parashikuara të shfrytëzimit", janë nënvlerësuar me 29,911,758 lekë për vitin 2019 dhe* 2020

- **Opinioni i auditimit mbi përputhshmërinë**

Ne kemi audituar përputhshmërinë[4/5] e subjektit sa i takon shkallës së zbatueshmërisë të ligjeve rregullave dhe rregulloreve, termave apo kushteve të vendosura, mbi të cilat është rënë dakord (kriteret e auditimit të përputhshmërisë), në fushën e prokurimeve publike.

**Opinion i pamodifikuar me "Theksim çështjeje":**

Sipas mendimit tonë, gjatë auditimit të procedurave të prokurimit, u evidentuan devijime nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi (kriteret), të përshkruara në paragrafin e "Bazës për Opinionin e pamodifikuar me theksim çështjeje", që nën gjykimin profesional të audituesit të pavarur janë materiale dhe jo të përhapura.

**Baza për opinion e pamodifikuar me "Theksim çështjeje":**

Ne e kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (ISSAI). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit ku jepen Përgjegjësitë e Audituesit. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme[6], për të bazuar opinionin tonë.

Opinionin e dhënë e mbështesim në faktin se, subjekti i audituar përgjithësisht ka vepruar në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi, me përjashtim të disa çështjeve (jo materiale dhe të përhapura), për të cilat duam të tërheqim vëmendjen e subjektit.

***Theksimi i çështjeve*:**

*-Mbi përcaktimin e kritereve dhe specifikimeve teknike për kualifikim, ku janë evidentuar kritere të cilat nuk janë në përputhje me kushtet e zhvillimit të procedurës ose zërat e preventivit në rastin e investimeve publike. Është konstatuar se nga AK Bashkia Shkodër për hartimin e specifikimeve teknike nuk angazhohej një komision i veçantë, por hartoheshin nga NJHDT e cila nuk ka në përbërje specialit të fushës në përcaktimin e specifikimeve teknike, të cilat hollësisht janë trajtuar në kapitulli III/2.4 të Raport Auditmit.*

*-Mbi zhvillimin e procedurave, është konstatuar se në një pjesë të proçedurave OE e shpallur fitues nuk plotësojnë të gjitha kriteret e DST të miratuara nga AK, pasi ka mangësi në plotësimin e tyre, proceduara të cilat duhej anuloheshin dhe zhvilluar të tjerë me kushte me të favorshme për të garantuar një përdorim më efikas të fondeve publike me vlerë 135,672 mijë lekë.*

---

[4] *Mbështetur mbi Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e KLSH-së".*

[5] *ISSAI 4100 – Objektivi i audituesve në një auditim përputhshmërie është të japë siguri të arsyeshme nëse informacioni i mbledhur sa i takon një çështjeje të veçantë është në përputhje, në të gjitha aspektet materiale, me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi, kur auditimi bëhet lidhur me çështje të veçanta.*

[6] *Objektivi i audituesve është të hartojnë dhe kryejnë ato procedura auditimi që ju japin mundësi të sigurojnë evidencën e auditimit e cila duhet të jetë e mjaftueshme, përkatëse dhe e besueshme (ISSAI 1500, ISA 300).*

Auditimi, ka përfshirë ekzaminimin në bazë testimesh, të dokumenteve që mbështesin kryerjen e procedurave të prokurimit dhe zbatimin e kontratave, si dhe çdo dokument të ndodhur në Sistemin e Prokurimeve Elektronike (SPE). Në auditimin e prokurimeve me fonde publike, ne u mbështetëm në analizë risku, duke vlerësuar paraprakisht funksionimin e menaxhimit financiar dhe sistemit të kontrollit të brendshëm në njësi, etj.
Auditimi u krye në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e Raport auditimit (kapitulli III/2.4), ku jepen Përgjegjësitë e Audituesit për përputhshmërinë.
Ne jemi të pavarur nga Njësia shpenzuese Bashkia Shkodër, në përputhje me kërkesat etike që janë të zbatueshme për auditimin e përputhshmërisë, si dhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike, në përputhje me këto kërkesa. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë. (ISSAI 400 & ISSAI 4000).

**Përgjegjësitë e Drejtuesve të Bashkisë Shkodër*:***
Strukturat drejtuese të Bashkisë Shkodër, janë përgjegjëse për përdorimin e burimeve financiare në përputhje me politikat, ligjet dhe rregulloret e aplikuara (*kriteret e vlerësimit*). Ato janë përgjegjëse për zbatimin e gjithë kuadrit regullative në prokurimin e fondeve publike. Gjithashtu, strukturat drejtuese të Bashkisë Shkodër janë përgjegjëse funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm, që ka rezultuar i nevojshëm për përgatitjen e pasqyrave financiare, për të shmangur gabimet apo mashtrimet. Stafi drejtues është gjithashtu përgjegjës Personat përgjegjës për drejtimin janë përgjegjës për kontrollin e procesit të raportimit financiar.

**Përgjegjësitë e Audituesve të KLSH-së:**
Objektivi i audituesit të jashtëm publik lidhet me garantimin e sigurisë së arsyeshme[7], nëse pasqyrat financiare në tërësi, nuk paraqesin anomali materiale, kështu si pasaktësi apo gabime që mund të kenë ekzistuar, nëse veprimtaria e subjektit të audituar është zhvilluar në përputhje me kriteret e paracaktuara, si dhe për të konkluduar me një raport auditimi që përfshin një opinion. Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë sigurie, por nuk garanton që auditimi i kryer në përputhje me standardet mundëson identifikimin e çdo gabimi apo anomalie që mund të ekzistojë. Përveç standardeve ISSAI, audituesi i KLSH-së, gjithashtu aplikon edhe gjykimin dhe skepticizmin e tij profesional në punën audituese.
Auditimi identifikon çështjet më të rëndësishme lidhur me auditimin e pasqyrave financiare të periudhës aktuale duke i përshkruar në raportet e auditimit, me përjashtim të rasteve kur kuadri ligjor nuk lejon vënien në dispozicion të tyre për publikun ose në raste të rralla kur vetë ne vendosim që këto çështje nuk duhet të përfshihen në raport për shkak të pasojave negative që publikimi i tyre mund të sjellë në publikun e gjerë.

## II. HYRJA

Mbështetur në ligjin nr.154/14, datë 27.11.2014 "Për Organizimin dhe Funksionimin e KLSH", në zbatim të Projektit dhe Programit të Auditimit nr. 362/1 datë 06.04.2021 "Auditim financiar dhe përputhshmërie në Bashkinë Shkodër", ndryshuar me shkresën nr. 362/2, datë 17.05.2021 "Njoftim për ndryshim në programin e auditimit nr. 362/1, datë 06.04.2021", të miratuara nga Kryetari i

[7] *ISA 200-ISSAI 1200 Objektivi i audituesit është të ofrojë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat si një e tërë nuk përmbajnë anomali materiale, raste mashtrimi ose gabime, si edhe të raportojë mbi këto pasqyra përsa i takon gjetjeve të tij/saj.*

KLSH, nga data 06.04.2021 - 04.06.2021, në subjektin Bashkia Shkodër për periudhën e veprimtarisë nga 01.07.2019 – 31.12.2020, u krye auditimi “Auditim Financiar dhe Përputhshmërie” nga Grupi i Auditimit me përbërje:

1. **K.GJ.,** *Përgjegjës Grupi*
2. **E.C.,** *Auditues*
3. **SH.H.,** *Auditues*
4. **A.Z.,** *(Auditues),*

**a- Titulli:** Auditim financiar dhe përputhshmërie në Bashkinë Shkodër.

**b- Marrësi:** Raporti Përfundimtar i Auditimit i drejtohet subjekti të audituar Bashkia Shkodër.
Raport auditimi i dërgohet subjektit Bashkia Shkodër, pasi nga grupi i auditimit është përgatitur dhe dozuar Projektraport i auditmit në lidhje me problematikat e konstatuara dhe nga subjekti Bashkia Shkodër me shkresën përcjellëse nr. 4597/55, datë 16.7.2021 (prot KLSH nr. 362/16, datë 21.7.2021), janë paraqitur kundërshtitë, të cilat pasi janë analizuar me kujdes, profesionalizim dhe paanshmëri, janë marrë në konsideratë ato raste të cilat kishin mbështetje ligjore, ndërsa për rastet e tjera të cilat kundërshtitë nuk mbështeteshin me argumente ligjore, nuk janë marrë në konsideratë dhe janë trajtuar në këtë Raport Përfundimtar Auditmit, i cili i përcillet subjekti për veprim dhe marrje masa për përmisimin e gjendjes.

**c- Objektivat dhe qëllimi:** Objektivi i auditimit financiar është dhënia e opinionit me siguri të arsyeshme, nëse për vitet 2019 dhe 2020, transaksionet financiare dhe ngjarjet ekonomike janë raportuar drejt dhe saktë në pasqyrat financiare të subjektit të audituar, kjo referuar kuadrit ligjor të raportimit financiar në fuqi.
*- Në auditimin e përputhshmërisë synohet dhënia e një vlerësimi objektiv, profesional e të pavarur, mbi shkallën e ndjekjes nga subjekti i audituar të rregullave, ligjeve dhe rregulloreve, politikave, kodeve të vendosura apo termave dhe kushteve, lidhur me prokurimin e mallra/shërbime e investimeve.*
*- Për auditimin financiar, qëllimi është të vlerësohet nëse rezultatet dhe gjendja financiare e raportuar e subjektit që auditohet, si dhe përdorimi i burimeve janë paraqitur saktë dhe në përputhje me rregullat e raportimit financiar, si në fushën e të ardhurave dhe të shpenzimeve.*
*- Për auditimin e përputhshmërisë, duhet të përcaktohet niveli i zbatimit të kuadrit ligjor në fuqi lidhur me realizimin e procedurave të prokurimit të realizuara në periudhën nën auditim.*

**Qëllimi i auditimit** të pasqyrave financiare është të rrisim shkallën e besimit të përdoruesve të pasqyrave financiare, nëpërmjet shprehjes së një opinioni nga ana jonë nëse pasqyrat financiare janë përgatitur në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kornizën e zbatueshme të raportimit financiar, si një mekanizëm kontrolli për të siguruar përgjegjshmërinë financiare.
Kjo përgjegjshmëri ka të bëjë drejtpërdrejt me menaxhimin e shëndoshë financiar si dhe me faktin që, rezultatet e përdorimi i burimeve janë të paraqitura drejt dhe në përputhshmëri me kornizën e raportimit financiar. Audituesit shtetërorë do të japin sigurinë ose jo nëse informacioni i paraqitur mbi shpenzimin e parave publike në programet publike përfaqëson në mënyrë të përshtatshme situatën financiare.
Gjithashtu, pjesë e Raport Auditimit do të jetë, opinioni mbi përputhshmërinë, nëse procedurat e prokurimit publik janë zhvilluar në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi (kriteret e paracaktuara).

**d- Identifikimi i çështjes:** Të përcaktojë nivelin e duhur të materialitetit, duke i mundësuar kryerjen e saktë të auditimit (ISSAI 13), nëpërmjet një pune audituese sistematike me zgjedhje, duke saktësuar përputhshmërinë ligjore të akteve normative me qëllim që auditimi t’i shërbej subjektit në

marrjen e masave në përmirësimin e punës në të ardhmen dhe për të bërë të mundur evidentimin në kohë të mangësive dhe shkeljeve për përmirësimin e gjendjes.
Sipas përcaktimit të ISSAI 100 "Auditimi i përputhshmërisë, përcakton se deri në çmasë subjekti i audituar ndjek rregullat, legjislacionin dhe aktet normative, politikat, kodet e miratuara apo kushtet e përcaktuara si, kushtet e kontratës apo klauzolat e një marrëveshjeje financimi", duke ofruar raporte të besueshme për fondet nëse janë administruar dhe të drejtat e qytetarëve për një proces të rregullt, nëse janë respektuar siç kërkohet nga kuadri ligjor, rregullator në fuqi.
Raporti i auditimit, synon të identifikojë përmbushjen e rolit të njësisë vendore dhe përgjegjësive të saj, që burojnë nga kuadri ligjor dhe dispozitat në fuqi, për përmirësimin e vazhdueshëm të punëve dhe shërbimeve në dobi të komunitetit, në funksion të zbatimit të strategjive që orientojnë zhvillimin e Bashkisë Shkodër, si dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së shërbimit ndaj komunitetit në plotësimin e kërkesave dhe nevojave të tyre.
Saktësia, rregullshmëria, ndodhja e transaksioneve kontabël dhe regjistrimi i tyre me korrektësi dhe në përputhje me kuadrin e raportimit financiar në fuqi.
Në bazë të kritereve të vlerësimit e gjykimit profesional, audituesit kanë bërë vlerësimin e rezultateve të testeve të kontrollit, analizimin dhe klasifikimin e gabimeve të zbuluara, si dhe është bërë vlerësimi i evidencave të grumbulluara përsa i përket mjaftueshmërisë dhe përshtatshmërisë për qëllimet e auditimit. Procedurat e kryera, varen nga gjykimi profesional i audituesit, përfshirë vlerësimin e rrezikut material, për shkak të mashtrimit apo gabimit që do përdoren për procedura auditimi që janë me të përshtatshme për rrethanat.
Nisur nga procedurat e ndjekura për auditim besojmë se evidencat e mbledhura janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për te dhënë opinionin tonë mbi veprimtarinë ekonomiko financiare të Bashkisë Shkodër.

**e- Përgjegjësitë e strukturave drejtuese:** Administratori i Përgjithshëm, në cilësinë edhe të Nëpunësit Autorizues (NA) znj. V.A. Kryetar i Bashkisë Shkodër dhe Drejtore e Financës, në cilësisë e Nëpunësit Zbatues (NZ) znj. B.M., janë përgjegjës për përgatitjen e pasqyrave financiare në përputhje me kuadrin normativ të zbatueshëm të raportimit financiar në sektorin publik dhe për mirëfunksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm, i cili garanton përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare. Gjithashtu, në cilësinë edhe të NA si dhe NZ, janë përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Bashkisë Shkodër, bazuar në ligjin nr. 139/2015, datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore", konkretisht neni 34, pika 6[8], neni 65, pika 1[9] dhe neni 91, pika 1.3[10].

**f- Përgjegjësitë e Audituesve të KLSH-së:** Përgjegjësia jonë është që të shprehim një opinion në lidhje me pasqyrat financiare Bashkisë Shkodër dhe një opinion në lidhje me përputhshmërinë e aktivitetit të subjektit të audituar në lidhje me aktet ligjore dhe nënligjore për buxhetin, prokurimin dhe menaxhimin financiar dhe kontrollin. Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit ISSAI sipas INOTSAI, të cilat kërkojnë që audituesi të respektojë kërkesat etike dhe të planifikojë dhe kryeje auditimin me qëllim arritjen e një sigurie të arsyeshme në dhënien e opinionit, sipas evidencës së mbledhur të auditimit.

---

[8] "Çdo njësi e vetëqeverisjes vendore harton, miraton, zbaton dhe administron çdo vit buxhetin e vet, pa deficit, si dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi që rregullon administrimin e zbatimin e sistemit buxhetor dhe ligjin për financat vendore"
[9] "Në njësitë administrative funksionon administrata që drejtohet nga administratori".
[10] "Njësitë e vetëqeverisjes vendore kanë këto të drejta dhe përgjegjësi:
a) krijojnë, mbledhin të ardhura dhe bëjnë shpenzime për përmbushjen e funksioneve të tyre;
b) vendosin taksa vendore e tarifa për shërbimet, si dhe nivelin e tyre, në përputhje me legjislacionin në fuqi;
c) hartojnë, miratojnë dhe zbatojnë buxhetin e tyre;
ç) mbajnë llogaritë, në përputhje me legjislacionin në fuqi, dhe ofrojnë informacione ose raporte financiare për hartimin dhe zbatimin e buxhetit për qeverisjen qendrore ose shtetasit".

***Parimet e auditimit financiar***: Në punën tonë audituese jemi mbështetur në parimet e mëposhtme:

- *Etika dhe pavarësia;*
- *Kontrolli i cilësisë*
- *Menaxhimi i grupit të auditimit dhe aftësive të tyre*
- *Parimet lidhur me konceptet bazë të auditimit.*

***Pohimet rreth klasave të transaksioneve dhe ngjarjeve për periudhën nën auditim:***

- *Përkatësia*: Transaksionet dhe ngjarjet që janë të regjistruara kanë ndodhur dhe i përkasin subjektit.
- *Plotësia*: Te gjitha transaksionet dhe ngjarjet që duhet të ishin regjistruar janë regjistruar
- *Saktësia*: Shumat dhe të dhëna të tjera lidhur me transaksionet e regjistruara dhe ngjarjet janë regjistruar në mënyrë të përshtatshme
- *Periudha*: Transaksionet dhe ngjarjet janë regjistruar në periudhën e saktë kontabël
- *Klasifikimi*: Transaksionet dhe ngjarjet janë regjistruar në llogaritë e duhura
- *Ligjshmëria* dhe rregullsia: Janë në përputhje me ndarjet buxhetore në dispozicion

***Pohimet rreth gjendjeve të llogarive në fund të periudhës***

- *Ekzistenca*: asetet, detyrimet dhe interesat e kapitalit neto ekzistojnë
- Të drejtat dhe detyrimet: Subjekti mban ose kontrollon të drejtat për asetet, detyrimet dhe janë obligimet e subjektit
- *Plotësia*: Të gjitha asetet, detyrimet dhe interesat e kapitalit neto që duhet të ishin regjistruar janë regjistruar
- *Vlerësimi dhe alokimi*: Aktivet, pasivet dhe interesat e kapitali janë të përfshira në pasqyrat financiare dhe shumat përkatëse dhe ndonjë vlerësim ose alokim, rregullimet që rezultojnë janë të regjistruara.

***Pohimet rreth prezantimit të shënimeve shpjeguese***

- *Transaksionet*, të drejtat dhe detyrimet: Ngjarjet e shpalosura, transaksionet, si dhe çështje të tjera që kanë ndodhur i përkasin subjektit.
- *Plotësia*: Te gjitha informacionet shpjeguese që duhet të ishin përfshirë në pasqyrat financiare janë përfshirë.
- *Klasifikimi dhe kuptueshmëria*: Informacioni financiar është paraqitur në mënyrë të përshtatshme dhe të përshkruara dhe shënimet e kanë shprehur qartë.
- *Saktësia dhe vlerësimi*: Informacioni financiar dhe të tjera është dhënë në mënyrë të drejtë dhe në sasi të duhur.

**g- Kriteret e vlerësimit**: Auditimi u bazua në ligjin nr. 154/14, datë 27.11.14 "Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", Manualin e Auditimit Financiar, miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH-së nr. 196, datë 29.12.15, referenca të tjera ligjore dhe në kërkesat e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit sa më poshtë:

- **Në fushën e Menaxhimit financiar dhe kontrollit*:***

Ligji nr. 9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar me ligjin nr. 114/2012 datë 07.12.2012 dhe ligjin nr. 57/2016, datë 2.6.2016; Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010, i ndryshuar me ligjin nr. 110/2015, datë 15.10.2015 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin"; Ligji nr. 114/2015, datë 22.10.2015 "Për auditimin e brendshëm publik"; Ligji nr. 139/2015 datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar; Ligji nr. 68/2017, datë 27.04.2017 "Për financat e vetëqeverisjes Vendore"; VKM nr. 83, datë 03.02.2016 "Për Miratimin e kritereve të krijimit të Njësive të Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik"; Udhëzimi i Ministrisë Financave nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik" i ndryshuar; Udhëzimi i Ministrisë Financave nr. 21, datë 25.10.2016, "Për menaxhimin

financiar dhe kontrollin, Nëpunësi Zbatues"; Urdhri i MF nr. 54, datë 15.07.2010 "Për miratimin e manualit të MFK"; Manuali i Auditimit të Brendshëm në sektorin publik urdhri i ministrit Financave nr. 100, dt. 16.10.2017.

- **<u>Në fushën e buxhetit dhe administrimit financiar:</u>**

Ligji nr. 9228, datë 29.4.2004 "Për kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare", i ndryshuar me ligjin nr. 9477, datë 9.2.2006, aktualisht i shfuqizuar; Ligji nr. 109/2017, datë 18.12.2017 "Për buxhetin e vitit 2018", ligji nr. 99/2018, datë 31.12.2018 "Për buxhetin e vitit 2019", Ligji nr. 88/18.12.2019 "Për buxhetin e vitit 2020" dhe aktet normative që ndryshojnë këto ligje; Ligji nr. 9869, datë 04.02.2008 "Për huamarrjen e qeverisjes vendore"; Ligji nr. 48/2014, datë 24.04.2014 "Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare" ndryshuar me ligjin nr. 24/2015, datë 19.903.2015; VKM 783 datë 22.11.2006 "Për përcaktimin e standardeve dhe rregullave kontabël"; Udhëzimi i MF nr. 8, datë 29.03.2012 "Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm"; UMFE nr. 9, datë 20.03.2018 "Për Procedurat Standarde të Zbatimit të Buxhetit", etj.; Udhëzimit i MF nr. 2, datë 02.06.2012 "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit", i ndryshuar; Udhëzimi MFE nr. 8, datë 09.03.2018 "Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit e të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme"; Udhëzimi i Ministrisë së Financave nr. 5, datë 27.02.2014 "Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura" ndryshuar me udhëzimin nr. 5/1 datë 21.05.2014; Udhëzimi i MF nr. 10/1, datë 28.02.2017 "Për përgatitjen e buxhetit vendor"; Udhëzimin plotësues të Ministrisë Financave nr. 02, datë 10.01.2018 "Për buxhetin e vitit 2018", pikat 82-91 "Detyrimet e prapambetura të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore"; Udhëzimin e Ministrisë Financave nr. 22, datë 30.07.2018 "Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit të Njësive të vetëqeverisjes vendore"; Udhëzimi plotësues i Ministrisë Financave nr. 01, datë 17.01.2019 "Për buxhetin e vitit 2019", pikat 106-110, "Detyrimet e prapambetura të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore", dhe pikat 116-117- Raportimi i detyrimeve të prapambetura në njësitë e qeverisjes vendore''.

- **<u>Në fushën e mbajtjes Kontabilitetit dhe Hartimit Pasqyrave Financiare:</u>**

Ligji nr. 9228, datë 24.04.2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare, i ndryshuar ligjin nr. 9477 datë 9.2.2006", aktualisht i shfuqizuar; VKM nr. 248, date 10.4.1998 "Për miratimin e planit kontabël publik, për organet e pushtetit lokal, institucionet shtetërore, qendrore dhe lokale, si dhe te njësive që varen prej tyre" i ndryshuar me VKM nr. 25, datë 20.01.2001; VKM nr. 783, datë 22.11.2006 "Për përcaktimi i standardeve dhe të rregullave kontabël"; VKM nr. 510, datë 10.06.2015 "Për miratimin e procedurave për transferimin e të drejtave dhe detyrimeve, personelit, aktiviteteve dhe çdo dokumentacion tjetër zyrtar në njësitë e qeverisjes vendore, të prekura nga riorganizimi administrativo-territorial"; Udhëzimi i MF nr. 08, datë 09.03.2018 "Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit e të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme"; Udhëzimi përbashkët i Ministrit të Çështjeve Vendore dhe Ministrit Financave nr. 3237 datë 16.07.2015 "Për procedurat afatet kohore standardet dhe kriteret e plotësimit të dokumentacionit të nevojshëm për riorganizimin administrativo-territorial".

- **<u>Në fushën e prokurimeve publike:</u>**

Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar; VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik" dhe akteve të tjera nënligjore të prokurimit publik", i ndryshuar; Udhëzim i Agjencisë Prokurimit Publik nr. 1, datë 01.2.2013 "Për procedurën e prokurimit me vlera të vogla", i ndryshuar; Urdhri i MF nr. 33, datë 11.07.2013 "Për gjurmët standarde të auditimit për prokurimin me vlerë të vogël dhe të lartë".

- **<u>Në fushën e administrimit të taksave dhe tarifave vendore:</u>**

Ligji nr. 9920, datë 19.05.2008 "Për procedurat tatimore në RSH", i ndryshuar"; Ligji nr. 9632, datë 30/10/2006 "Për Sistemin e Taksave Lokale", i ndryshuar; Ligji nr. 9975, datë 28.7.2008, "Për

Taksat Kombëtare”, i ndryshuar; VKM nr. 170, datë 25.4.2002 “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e lejeve e të autorizimeve për tregtimin e naftës, gazit e nënprodukteve të tyre”, me ndryshime; VKM nr. 1064, datë 22.12.2010, “Për disa ndryshime në VKM nr. 391, datë 21.06.2006 “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave”; Udhëzim i MF nr. 24, datë 02.9.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

▪ **Në fushën e ndërtimeve, zbatimit të punimeve dhe kontrollit të territorit:**
Ligji nr. 10279, datë 20.05.2010, “Për kundërvajtjet administrative”; Ligji nr. 10433, datë 16.06.2011 “Për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë”; Ligji nr. 10448, datë 14.7.2011, “Për lejet e mjedisit”; Ligji Nr. 107-2014, “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”; Ligji nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”; VKM nr. 629, datë 15.7.2015, “Për miratimin e manualeve të ndërtimit”; VKM nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit, e përditësuar”; VKM nr. 894, datë 4.11.2015 “Për unifikimin e procedurave të kontrollit të territorit nga inspektorati kombëtar i mbrojtjes së territorit dhe ai i njësisë vendore”; Udhëzimi i KM nr. 1, datë 18.7.2012 “Për procedurat e dhënies me qira të tokave bujqësore të pandara” dhe si dhe akteve të tjera ligjore e nënligjore që kanë si objekt tokën bujqësore.

▪ **Në fushën e marrëdhënieve të punësimit dhe pagave:**
Ligji nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar; Ligji nr. 152-2013, “Për Nëpunësin Civil”, i ndryshuar; Ligji nr. 10405, datë 24.3.2011, “Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve”, i ndryshuar; VKM nr. 187, datë 08.03.2017, “Për Miratimin e Strukturës dhe të Niveleve të Pagave të Nëpunësve Civilë”, i ndryshuar; VKM nr. 165, datë 02.03.2016, “Për Pagat e Vetëqeverisjes Vendore”, i ndryshuar.

**h- Standardet e auditimit:** ISSAI 100 “Parimet themelore të auditimit të sektorit publik”, i cili përcakton parimet themelore për auditimin e sektorit publik në përgjithësi; ISSAI 2000-2899 “Udhëzues të Auditimit Financiar”; ISSAI 2300 “Planifikimi i auditimit të pasqyrave financiare”; INTOSAI GOV 9100 “Udhëzues mbi Standardet e Kontrollit të Brendshëm për Sektorin Publik” si dhe INTOSAI GOV 9110 “Udhëzues mbi raportimin e efektivitetit të kontrolleve të brendshëm”; ISSAI 400 “Parimet themelore të auditimit të përputhshmërisë”, i cili përcakton parimet themelore të ISSAI-t 100 dhe i zhvillon më tej ato duke i përshtatur me kontekstin specifik të auditimit të përputhshmërisë; ISSAI 4000 “Prezantim i përgjithshëm i udhëzimeve për auditimin e përputhshmërisë”; si dhe ISSAI 4200 “Udhëzime për auditimin e përputhshmërisë”; INTOSAI “Për implementimin e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit, ISSAI mbi Auditimin e përputhshmërisë”; etj. Standardet Kombëtare të Kontabilitetit; Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA) të Federatës Ndërkombëtare të kontabilisteve IFAC; Manuali i Auditimit Financiar dhe i Përputhshmërisë të KLSH-së; Manuali i Auditimit të Brendshëm, etj. Standardet Ndërkombëtare të Auditimit mbi Raportimin e Audituesit të Pavarur, (IFAC); Praktika të mira të fushës, si manualet e Gjykatës Evropiane të Audituesve, Kërkesat e Udhërrëfyesit të IDI-t, etj.; Kodit Etik dhe Rregullores së Procedurave të Auditimit të KLSH.

**i- Metodat e auditimit:** Auditim i njëpasnjëshëm dhe me zgjedhje periudhash. Qasja audituese e KLSH-së është metodologji e bazuar në vlerësimin dhe menaxhimin e riskut të auditimit në subjektin që auditohet, e cila shërben për kryerjen e auditimit me efiçencë dhe efektivitet, duke u fokusuar në natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit në fushat materiale dhe që vlerësohen me nivel të lartë risku. Nën gjykimin profesional të Audituesve të pavarur, për përzgjedhjen e kampioneve për ekzaminim, në zërat e shpenzimeve.

*Vlerësimi bazuar në riskun dhe materialitetit*[11].
Nisur nga gjykimi dhe ndjeshmëria e zonave të llogarisë, duke ditur që materialiteti shpreh nivelin maksimal të devijimit, që audituesit e vlerëson si të mundshëm për të influencuar te përdoruesit e informacionit financiar, kemi përcaktuar materialitetit në masën 2% për të gjitha zonat e llogarisë të planifikuara për t'u audituar.

*Për arritjen e konkluzionit vlerësues, u përdorën tekN...t e auditimit:*

- *Kontrolli aritmetik*. Duke konsideruar faktin se kontabiliteti konsiston në thelb në regjistrimin e fakteve në një formë numerike, si dhe në paraqitjen sintetike të tyre, por midis regjistrimit fillestar të fakteve dhe paraqitjes së tyre në formë sintetike, që janë edhe qëllimi i tij, bëhen një seri veprimesh që kanë të bëjnë me evidentimin në llogari, mbartjet, klasifikimin dhe rigrupimin. Kontrolli aritmetik u krye me qëllim që të sigurohemi nëse veprimet e llogaritjes dhe të hedhjeve në llogaritë përkatëse, që përfundojnë me nxjerrjen e gjendjeve sintetike, nuk përmbajnë asnjë gabim. (Ditari i kontabilizimit të urdhër shpenzimeve)
- *Kontrolli me anë të pjesëve justifikuese*. Edhe pse kontabilizimet nuk përmbajnë asnjë gabim aritmetik, ai mund të jetë i gabuar, nëse regjistrimet e bëra nuk korrespondojnë me realitetin. Kontrolli me zgjedhje i pjesëve justifikuese (Urdhër shpenzimeve) konstatoi nëse shifrat e kaluara kanë pasur justifikim të mjaftueshëm dokumentar. UMF nr. 30, datë 27.12.2011 "Mbi menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik".
- *Inspektimi fizik dhe kontrolli i gjendjeve ekzistuese*. Konsistoi në ekzaminimin e aktiveve, të llogarive, të librave kontabël etj. Kontrolli kontabël i ushtruar ekzaminoj përputhjen ndërmjet regjistrimit kontabël dhe pjesëve justifikuese përkatëse, duke u siguruar edhe për ekzistencën reale të aktiveve në subjekt.
- *Kontrolli i vlerësimit*. Kontrolli i vlerësimeve përcaktoi nëse vlerat që u atribuohen gjendjeve ekzistuese janë të sakta, nëse pasuritë duhet të qëndrojnë në bilanc me vlerat që u janë vendosur atyre.
- *Konfirmim nga të tretët*. Nëse subjekti që auditohet ka të konfirmuara (Rakorduar) me të tretët informacionet që vërtetojnë ekzistencën e operacioneve, detyrimeve, të tepricave ose të çdo regjistrimi tjetër.
- *Kontrolli sipas një treguesi*. Përdorimi i treguesve statistikorë me qëllim që të kërkohen fakte ose të dhëna "jashtë normales", që përbëjnë tregues të parregullsive kontabël. Mund të përmendim: mungesa e pjesëve justifikuese, gabimet e shpeshta në datat, numrat, referencat e brendshme, të emrave, regjistrime pak të lexueshme, shifra të renditura keq, korrigjime të shumta të shifrave, etj.
- ***Intervista***
- ***Raporte dhe Informacione***
- ***Pyetësorët për vlerësimin e sistemeve të Kontrollit të Brendshëm dhe MFK***

**j- Dokumentimi i auditimit:** Mbështetur në ISSAI 1315, objektivi i audituesit është identifikimi dhe vlerësimi i risqeve e anomalive materiale në pasqyrat financiare si edhe nivelin e pohimeve, nëpërmjet të kuptuarit të njësisë dhe mjedisit të saj, duke përfshirë kontrollin e brendshëm të njësisë dhe duke krijuar kështu bazën për hartimin dhe implementimin e përgjigjeve kundrejt risqeve të vlerësuara të gabimeve materiale.
Në këtë kontekst merr rëndësi vlerësimi i materialitetit në përputhje me ISSAI 1320 dhe ISSAI 1450, i cili përcakton nivelin e gabimit që audituesi konsideron të mundshëm për të influencuar te

[11] **ISSAI 1320 (ISA 320)** trajtojnë përgjegjësinë e audituesit për të zbatuar konceptin e materialitetit në planifikimin dhe kryerjen e një auditimi të pasqyrave financiare, në funksion të zbulimit dhe korrigjimit të anomalive. Një trajtim i tillë i ngjashëm mund të perdoret edhe në rastet e auditimit të përputhshmërisë, ku natyrisht një rol të rëndësishëm ka gjykimi profesional i audituesit.

përdoruesit e pasqyrave financiare. Nisur nga gjykimi profesional i audituesit dhe ndjeshmëria e zonave të llogarisë, grupi i auditimit përcaktoi materialitetit në masën 2% për të gjitha zonat e llogarisë të planifikuara për t'u audituar, ku si bazë për llogaritjen e tij janë marrë shpenzimet për pagat (600), shpenzimet operative (602) dhe investimet (231). Pas përcaktimit të nivelit të materialitetit, grupi i auditimit ka kryer vlerësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm në institucion sa i takon: (a) hartimit; (b) implementimit; dhe (c) funksionimit të 5 komponentëve të kontrollit të brendshëm. Vlerësimi i kontrollit të brendshëm është bazuar në kryerjen e testeve të kontrolleve. Gjatë kryerjes së testeve të kontrolleve është arritur në përfundimin që sistemet e kontrollit të brendshëm paraqesin risk të moderuar deri të lartë.
Metodologjia e aplikuar gjatë planifikimit, konsiston në auditimin e të dhënave të siguruara nga vetë subjekti. Kemi ndërmarrë procedurat për vlerësimin e riskut (analiza), me qëllim sigurimin e nivelit të kërkuar të njohjes së riskut të brendshëm dhe riskut të kontrollit të subjektit. Informacion të vlefshëm administruam dhe nga procedurat e ndjekura nga vetë subjekti për vlerësimin e riskut, duke iu nënshtruar skepticizmit profesional nga ana e Audituesve. Gjatë vlerësimeve u mbështetëm në Modelin e Riskut që aplikon KLSH-ja[12].
Nisur sa më sipër, jemi përpjekur të ruajmë nivelin e pranuar të Riskut të Auditimit prej 5%, duke shtuar nivelin e procedurave analitike (ISSAI 1520) dhe testeve thelbësore të kryera.
Procedurat e ndjekura nga grupi i auditimit konsistojnë në analizat e marrëdhënieve ndërmjet informacionit financiar dhe jo financiar; inspektimeve që konsistojnë në regjistrimin e dokumenteve në regjistra/ditarë/partitarë ose ne trajtë elektronike por edhe në inspektime fizike; në observime, të cilat kanë të bëjnë me analizën e proceseve ose procedurave të kryera nga të tjerë, me qëllim sigurimin e informacionit rreth performancës së proceseve/procedurave, por kjo mbetet e limituar deri në kohën kur ka ndodhur observimi; dhe së fundmi, kërkimi/hetimi që konsiston në kërkimin e informacionit te personat kompetentë dhe të mirinformuar brenda dhe/ose jashtë njësisë shpenzuese.
Nga audituesit u përgatit dokumentacioni i auditimit, i mjaftueshëm për të mundësuar dhe kuptuar natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit, të kryera në përputhje me standardet përkatëse dhe kërkesat ligjore dhe rregullatorë të zbatueshme. Rezultatet e këtyre procedurave dhe evidencat e marra gjatë auditimit, si dhe çështje të tjera të rëndësishme që dolën gjatë auditimit, janë reflektuar në përfundimet e arritura në drejtim të tyre sipas gjykimit dhe skepticizmit profesional që audituesit ushtruan në arritjen e këtyre konkluzioneve. Ky dokumentacion është i përshtatshëm dhe i rëndësishëm për të konfirmuar dhe mbështetur opinionet dhe raportin e Audituesve dhe ka shërbyer si një burim informacioni për përgatitjen e tyre.
Në përfundim të auditimit në terren (Akt-Konstatimeve dhe Akt-Verifikimeve), të mbajtura mbi bazën e të dhënave të grumbulluara, si dhe pas reflektimit të kundërshtive të subjektit nën auditim të akt-konstatimeve, u përgatit ky Projekt raport Auditimi.

## III. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT.

### III/1. Informacion i përgjithshëm mbi subjektin nën auditim:

Fillimet e institucionit të Bashkisë në Shkodër datojnë në vitin 1865. Bashkia Shkodër shtrihet në Veriperëndim të Shqipërisë, në një territor prej 873 km², dhe kufizohet në veri me Bashkinë e Malësisë së Madhe, në perëndim me Malin e Zi, në lindje me Bashkinë Tropojë, në jug me Bashkinë Vau i Dejës dhe me Bashkinë Lezhë.
Bashkia e Shkodrës është pjesë e Qarkut Shkodër dhe përbëhet nga 11 njësi të qeverisjes vendore, (Shkodër, Rrethina Shalë, Shosh Pult, Postribë, Guri i Zi, Ana e Malit, Bërdicë, Dajç, dhe Velipojë). Në përbërjen e tyre këto njësi administrative përfshijnë gjithsej një qytet dhe 93 fshatra.

[12] Risku i Auditimit = Risku i qenësishëm ∗ Risku i kontrollit ∗ Risku i Zbulimit

Me reformën e re territoriale, popullsia e Bashkisë së Shkodrës është dyfishuar. Aktualisht kjo bashki ka 64888 familje dhe një popullsi prej 209542 banorë. Përqendrimi më i madh i popullsisë është në qytetin e Shkodrës me 55% të popullsisë (115514 banorë), ndërsa për sa i përket njësive administrative, njësia me popullsi më të madhe është ajo e Rrethinave me 27 014 banorë. Njësitë e tjera më të mëdha nisur nga numri i popullsisë janë: Guri i Zi me 12 096 banorë, Postriba me 11 716 banorë, Bërdica me 9 859 banorë, Velipoja me 9 778 banorë dhe Dajçi me 9 077 banorë. Tre njësitë e tjera më të vogla për nga numri i popullsisë janë Ana e Malit me 6 109 banorë, Pulti me 3 043 banorë, si dhe Shalë e Shosh me 5 336 banorë

Me ndarjen e re territoriale dhe administrative ka një pozicion të tillë që mbulon zonën detare dhe bujqësore në jug të saj, gjithashtu edhe zonën më malore të Shqipërisë në veri. Në pjesën perëndimore kufizohet nga Liqeni i Shkodrës, i cili ka një rëndësi mjaft të madhe kombëtare dhe ndërkufitare në marrëdhënie me Malin e Zi. Parë pikërisht nga marrëdhëniet ndërkufitare, pozicioni i favorshëm gjeografik, mundëson lidhjet si territoriale po ashtu edhe ekonomike dhe natyrore të Shkodrës me Malin e Zi dhe Kosovën duke e kthyer kështu në një pozicion mjaft të favorshëm strategjik për gjithë rajonin.




Bashkia Shkodër ka një sipërfaqe te konsiderueshme te tokave bujqësore me një cilësi boniteti te lartë. Tokat bujqësore te kategorisë I-IV janë te shtrira ne njësite administrative Shkodër, Velipoje, Dajçi, Berdice, Ana e Malit dhe Gur i Zi. Njësite e tjera administrative kane një bonitet me te ulet si rrjedhoje e relievit te thyer dhe përbërjes gjeologjike te tokës.

Me zbatimin e reformës se re administrative territoriale, pyjet dhe kullotat iu transferuan Bashkisë se Shkodrës. Ne këtë sipërfaqe gjenden te gjitha kategoritë e pyllit si pyll i rrallë, pyll i dendur, shkurre të rralla, shkurre te dendura dhe livadhe e kullota natyrore. Ndërkohë në lidhje me prodhimin, mund të thuhet se ne Shkodër ka një larmishmeri kulturash bujqësore te cilat prodhohen ne territorin e bashkisë ne periudha te ndryshme kohore.

Në çdo bashki krijohet organi përfaqësues dhe organi ekzekutiv. Organi ekzekutiv i bashkisë është kryetari i bashkisë. Organi përfaqësues i bashkisë është Këshilli Bashkiak. Ky organ përbëhet nga 51 këshilltarë, përfaqësues të subjekteve të ndryshme politike të zgjedhur në zgjedhjet vendore.

- **Familjet që përfitojnë ndihmë ekonomike dhe pagesë të paaftësisë**

*Gjatë viti 2019*, numri i familjeve të trajtuara me ndihmë ekonomike nga sistemi elektronik Kombëtar dhe fondi i kushtëzuar deri në 6 % është mesatarisht 2018 familje/ muaj, financuar me vlerë 120,029,150 lekë. *Gjatë viti 2020*, numri i familjeve të trajtuara me ndihmë ekonomike nga sistemi elektronik kombëtar dhe fondi i kushtëzuar deri në 6 % është mesatarisht 1972 familje/muaj, financuar me vlerë 117,696,628 lekë.

- **Prioritetet e Bashkisë Shkodër për vitet 2019 – 2020.**

Prioritetet e Bashkisë Shkodër për vitet 2019-2020 i shërbejnë përpjekjeve në vazhdim për të përmbushur vizionin e Strategjisë Territoriale për Zhvillim 2015 – 2030, si më poshtë vijon:

Përmirësimin dhe modernizimin e infrastrukturës rrugore urbane dhe rurale duke mundësuar akses të plotë për të gjithë, përmes financimit me fondet e veta, në fondet ndërkombëtare dhe të donatorëve, aksesit në fondet qeveritare;

Përmirësimin e menaxhimit të shërbimeve publike: menaxhimit të mbetjeve, mbrojtjes së mjedisit, ndriçimit rrugor, furnizimit me ujë të pijshëm, hapësirave të gjelbra, etj.;

Përmirësimin e lëvizshmërisë urbane për një siguri dhe cilësi jetese më të mirë;

Përmirësimin e infrastrukturës turistike dhe promovimin e territorit të Bashkisë Shkodër;

Promovimin e produkteve vendore, nxitjen e shumëllojshmërisë së veprimtarive bujqësore dhe ekonomike në zonat rurale në nivelin e fermës dhe të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme.

Mbrojtjen e mjedisit, parandalimin e rreziqeve ndaj jetës e shëndetit të qytetareve;

Projektimin, përmirësimin e kushteve të qendrave shëndetësore parësore në territor dhe mire administrimin e infrastrukturës së ndërtuar;

Nxitjen e pjesëmarrjes së të rinjve në aktivitete sportive si aktorë thelbësorë në zhvillimin e territorit;

Ruajtjen dhe promovimin i trashëgimisë kulturore të zonave të ndryshme të Bashkisë Shkodër;

Sigurimin e ambienteve dhe mjediseve te përshtatshme arsimore, të sigurta dhe drejt përmbushjes së standardeve ligjore;

Krijimin e mundësive të barabarta dhe mosdiskriminim për shkak të aftësive ndryshe, gjinisë, moshës, origjinës, minoritetit;

Parandalimin e kundërvajtjeve administrative, forcimin, inspektimin dhe monitorimin e zbatimit të rregulloreve e të akteve të bashkisë dhe këshillit bashkiak.

**- <u>Fushëveprimi</u>:** Përfshin vlerësimin e përputhshmërisë së Bashkisë Shkodër, në fushën e prokurimeve publike, për periudhën objekt auditimi, vlerësimin mbi funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm, si dhe vlerësimin nëse pasqyrat financiare të njësisë për vitet 2019 - 2020, nëse janë hartuar sipas standardeve të raportimit financiar.

## III/2. <u>PËRSHKRIMI I REZULTATEVE SIPAS DREJTIMEVE TË AUDIMIT</u>.

### III/2.1. <u>Auditim mbi menaxhimin financiar, kontrollin dhe Auditin e Brendshëm</u>.

***<u>1.1.</u>*** *<u>Identifikimi dhe vlerësimi i nivelit të implementimit të komponentëve të MFK: Mjedisi i kontrollit, Menaxhimi i riskut, Veprimtaritë e kontrollit, Informimi dhe komunikimi, Monitorimi. Saktësia e deklaratës vjetore dhe raporti përkatës për cilësinë dhe gjendjen e sistemeve të kontrollit të brendshëm në njësinë publike</u>.*

| |
|---|
| 1. **<u>Titulli i gjetjes</u>:** *KLSH ka konstatuar se në Bashkinë Shkodër ngritja dhe funksionimi i sistemit të kontrollit të brendshëm kuptohen dhe funksionojnë mirë.* |

**<u>Situata</u>:**

**Mjedisi i Kontrollit:** Mjedisi i kontrollit është një element i menaxhimit financiar dhe kontrollit, duke siguruar vendosjen e objektivave në përmbushjen e misionit të institucionit, Integritetin personal dhe etikën profesionale të nivelit menaxhues dhe punonjësve të tjerë të njësisë publike; Politikat menaxheriale dhe stilin e punës; Strukturën organizative, garantimin e ndarjes së detyrës,

hierarkinë dhe rregulla të qarta, të drejtat, përgjegjësitë dhe linjat e raportimit; Politikat dhe praktikat e menaxhimit të burimeve njerëzore dhe aftësitë profesionale të punonjësve.
Bashkia Shkodër ka miratuar Rregulloren e Brendshme me urdhrin e Titullarit me nr. 96, datë 20.03.2017. Rregullorja është e publikuar edhe në faqen ŵeb të Bashkisë Shkodër. Sipas neni 51 të rregullores *"Funksionimi i Drejtorive/Sektorëve"*, përcaktohet detyrimi i drejtorive/sektorëve për hartimin e rregulloreve të brendshme të miratuara nga Titullari për funksionimin e tyre. Nga testimet rezulton se ky angazhim nuk është përmbushur.
-Nëpunësit e këtij institucioni duhet të respektojnë rregullat dhe parimet e ligjit nr. 9131, datë 08.09.2003 "Për rregullat e etikës në administratën publike". Ky institucion, në përputhje me ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin" i ndryshuar, neni 20 "Mjedisi i kontrollit", pika 2 germa a dhe në Manualin për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, të hartuar dhe miratuar nga Ministria e Financës, Kap II, pika 2.5.1 "Mjedisi i Kontrollit (ose mjedisi i brendshëm i njësisë)", paragrafi "Integriteti dhe vlerat etike*",* ka miratuar Kodin Etik i cili është i publikuar në faqen ŵeb të bashkisë http:// ŵŵŵ.bashkiashkoder.gov.al/ŵeb/kodi_etik_217.pdf
-Bashkia Shkodër funksionon me strukturën e miratuar me VKB nr. 26, datë 30.12.2019. Sipas kësaj strukture, konstatohet se Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit Vendor, është strukturë nën varësinë e Drejtorisë së Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit. Praktikisht vendosja e inspektoratit nën varësinë e DKZHT, vendos strukturën që kontrollon zbatimin e ligjshmërisë së lejeve, nën varësinë e strukturës që miraton lejen e ndërtimit.
- Përcaktimi i NA dhe NZ është bërë në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 10296 datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", ligjin "Për menaxhimin e sistemit buxhetor të RSH", si dhe ligjit nr. 90 datë 27.09.2012 "Për organizimin e administratës shtetërore" si dhe janë njoftuar Njësia Qendrore e Harmonizimit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit në Ministrinë e Financës Nëpunësi Autorizues dhe Zbatues plotësojnë kriteret e kërkuara nga ligji si: (kriteri i varësisë NA-NZ, kriteri i arsimimit dhe kriteri i nivelit Menaxheriale).
- *Krijimi i grupeve të menaxhimit strategjik (GMS).* Në zbatim të ligjit nr. 10269 datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", nga Bashkia Shkodër është formuar Grupi i Menaxhimit Strategjik (GMS), me urdhrat nr. 01 datë 03.01.2019 dhe nr. 02, datë 07.01.2020 "Për krijimin e Grupit për Menaxhimin Strategjik" i miratuar nga Kryetarja i Bashkisë.
-Për vitet 2019-2020, punonjësit e Bashkisë Shkodër kanë kryer cikël trajnimesh pranë ASPA. Për vitin 2020, këto trajnime janë kryer online për shkak të situatës COVID-19, megjithatë nga praktika e burimeve njerëzore, mungon një plan strategjik dhe vjetor trajnimi për punonjësit, për të ngritur në vazhdimësi nivelin e tyre profesional, duke u mjaftuar vetëm me trajnimet e organizuara nga ASPA.

**2. Menaxhimi i riskut:** Menaxhimi i riskut është procesi i identifikimit, vlerësimit dhe monitorimit të riskut. Pas planifikimit të fondeve buxhetore, institucioni analizon dhe bën kontrollin e risqeve, të cilët mund të venë në rrezik realizimin e treguesve buxhetore.
*Përgjegjësitë:* Sipas përcaktimeve të bëra në nenin 10 të Ligjit "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin", strukturat përgjegjëse janë:
- Titullari i njësive publike është përgjegjës për hartimin e politikave, miratimin dhe monitorimin e strategjisë për menaxhimin e risqeve brenda njësisë së tij.
- Nëpunësi Autorizues është përgjegjës për zbatimin e sistemeve të menaxhimit financiar; është Koordinatori i Riskut dhe përgjigjet për monitorimin e kontrolleve për minimizimin e risqeve brenda njësisë. Sidoqoftë, sipas Nenit 10 të Ligjit mbi Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, Nëpunësi autorizues mund të delegojë detyra që kanë lidhje me koordinimin e riskut, një menaxheri tjetër te njësisë në vartësi direkt prej tij.
- Auditimi i brendshëm në rolin e vlerësuesit të sistemit të kontrollit të brendshëm dhe këshilluesit.
Nga auditimi rezultoi se me urdhrin nr. 400, datë 01.06.2020 të Titullarit, ka deleguar detyrat e koordinatorit të riskut znj. E.K. me detyrë Zv/Kryetare e Bashkisë Shkodër. Sipas këtij urdhri,

ngarkohen anëtarët e GMS për identifikimin dhe krijimin e regjistrit të riskut, vlerësimin, kontrollin dhe raportimin për risqet që vënë në rrezik arritjen e objektivave dhe realizimin me sukses të veprimtarive të strukturave që ata drejtojnë. Për koordinimin e punës, krijohet ekipi i koordinatorëve nga çdo strukturë e bashkisë.
Për vitet 2019 – 2020 është mbajtur regjistri i riskut i Bashkisë Shkodër, por nga testimet e kryera, rezulton se drejtoritë/sektorët e institucionit nuk kanë bërë evidentimin e fushave me risk sipas objektivave, aktiviteteve dhe proceseve të punës, nuk janë evidentuar dhe vlerësuar risqet, nuk janë caktuar detyrat konkrete në menaxhimin e riskut për punonjësit sipas detyrave funksionale.
Në raportet e auditit të brendshëm trajtohet funksionimi i procesit të menaxhimit të riskut në të gjitha angazhimet e kryera, por mungojnë planet e veprimit dhe zbatimi konkret i rekomandimeve të lëna.

**3. Aktivitetet e kontrollit:** Aktivitetet e kontrollit janë rregullat, procedurat dhe veprimet që kanë si qëllim reduktimin e risqeve me synim arritjen e objektivave. Proceset kryesore të punës janë të shkruara në rregulloren e brendshme, ku në bazë të strukturës së miratuar ekziston dhe ndarja e detyrave.
Për të qenë efektive, aktivitetet e kontrollit duhet të jenë: Të përshtatshme; Efektive nga pikëpamja e kostos; Të gjithanshme; Të dokumentuara qartë etj.
Nga auditimi u konstatua se për vitet objekt auditimi, është hartuar një liste mbi proceset e punës për Drejtorinë e Financës, Njësinë e Prokurimeve, e cila shërben për përgatitjen dhe dokumentimin e gjurmës së auditimit, e cila garanton kryerjen e kontrolleve efektive, si dhe ruan ekuilibrin në zbatimin e një operacioni/transaksioni, ku përgjegjësitë janë ndarë në një mënyrë të tillë, që përjashton mundësinë që një punonjës i vetëm të jetë njëherësh përgjegjës për miratimin, marrjen e vendimit, zbatimit, kontabilitetit dhe kontrollit.
Bashkia Shkodër ka përcaktuara detyrat e funksionet për secilin punonjës, në funksion të ruajtës së të dhënave, të cilat mbrohen përmes një serveri back UP i cili gjithashtu është i mbrojtur përmes inventarit dhe monitorohet me kamera.
"***Gjurmët e auditimit***", institucioni *ka miratuar me dokumentin nr. 11744 prot., datë 10.12.2015 "Dërgim i modelit të gjurmës së auditimit" i miratuar nga Titullari i Bashkisë Shkodër znj. V.A.* ashtu siç përcaktohet në ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin", i ndryshuar neni 16 dhe Manualin për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, Kap. III, e cila ka si qëllim të ndihmojë menaxhimin për të vlerësuar përshtatshmërinë e sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit, të identifikojë boshllëqet, etj. Përgjegjësia për miratimin e gjurmës së auditimit i takon titullarit. Gjurmët e auditimit duhet të përgatiten nga menaxherët për proceset kryesore të punës së njësisë dhe më pas është përgjegjësi e NA të njësisë të sigurojë titullarin se këto procese janë identifikuar dhe janë përgatitur gjurmët e auditimit për to. Gjurmëve të auditimit duhet të përfshijë të paktën proceset kryesore që kontribuojnë në arritjen e objektivave të njësisë dhe që përfshijnë zbatimin e aktiviteteve, programeve dhe projekteve më të rëndësishme të saj. Gjurma e auditimit duhet të rifreskohet në mënyrë të vazhdueshme, për të garantuar pasqyrimin e ecurisë së aktiviteteve dhe dokumenteve që përmban një proces.
***"Ndarja e detyrave"***
Në pjesën më të madhe të njësive publike ekzistojnë përshkrimet e punës, të cilat përfshihen në rregulloren e brendshme ose në kontratat e punës. Në lidhje me kryerjen e transaksioneve financiare është kryer ndarja e detyrave, për të cilën është përdorur sistemi me dy firma, ku janë përcaktuar rregulla të qarta për ruajtjen e pronës.

**4. Informimi dhe komunikimi:** Informimi është baza e komunikimit që nevojitet për kryerjen me cilësi të detyrave të ngarkuara. Komunikimi me titullarin dhe nëpunësit e tjerë duhet bërë në formën dhe kohën e duhur për ti ndihmuar ata në përmbushjen e detyrave dhe të përgjegjësive.
Konstatohet se raportimet në KB bëhen çdo muaj, çdo 4 muaj, 6 muaj, 8 muaj dhe vjetore. Për raportimet ndiqet si rruga elektrike ashtu edhe manuale.

Struktura që siguron informacionin tek menaxherët është Drejtoria e Financës për realizimin, dhe Drejtoria e Analizës dhe Programimit Buxhetor për planet sipas programeve. Libri i buxhetit, matrica, dhe raportet e realizimit dhe vlerësimit të performancës, publikohen në faqen ŵeb të bashkisë.
Komunikimi i brendshëm dhe i jashtëm rezulton se përdoret nëpërmjet adresës dhe e-mail zyrtar. Të gjitha drejtoritë disponojnë e-mail zyrtar, por stafi i punonjësve nuk është i gjithi i pajisur me adresë zyrtare. Informimet dhe konsultimet me grupet e interesit, njoftimet e ndryshme të bashkisë, bëhen nëpërmjet faqes ŵeb të bashkisë. Rezulton se Bashkia Shkodër siguron rregullisht informacion për buxhetin vjetor të propozuar, buxhetin e miratuar, raportet periodike, planet vjetore të prokurimeve, raportet e auditit të brendshëm etj., nëpërmjet faqes ŵŵŵ.bashkiashkoder.gov.al .

**5. Monitorimi:** Monitorimi është tërësia e proceseve të rishikimit të aktivitetit të njësisë, i cili synon të ofrojë garanci të arsyeshme se aktivitetet e kontrollit funksionojnë, sipas qëllimit për të cilin janë krijuar dhe mbeten efiçente me kalimin e kohës. Monitorimi i sistemit të kontrollit të brendshëm, bëhet për të vlerësuar cilësinë e sistemit dhe të performancës në kohë.
Vlerësimi dhe monitorimi i sistemit të MFK-së bëhet nëpërmjet:
- Monitorimit të vazhdueshëm;
- Vetëvlerësimit;
- Auditimit të brendshëm.

Vlerësimi i vazhdueshëm i sistemit të kontrollit të brendshëm dhe komponentëve të tij duhet të jetë detyrë e titullarit të njësisë, nëpunësit autorizues dhe menaxherëve të tjerë. Ky vlerësim mund të kryhet ose nëpërmjet monitorimit të vazhdueshëm të komponentëve të sistemit të kontrollit ose nëpërmjet mekanizmave individuale të kontrollit dhe zbatimit të tyre gjatë punës së përditshme.
Procedura e shkruar dhe mënyra e raportimit janë përcaktuar në nenin 24 të rregullores së brendshme të Bashkisë Shkodër. Njësia nuk ka një udhëzim për monitorimin e kontrollit të brendshme, për të cilin deklaron se është në proces hartimi. Rekomandimet e auditimit të KLSH në përgjithësi janë zbatuar. Problematike ngelen rekomandimet e Auditit të Brendshëm, pasi nga dokumentacioni i audituar, rezulton se njësitë e audituara nuk kanë hartuar plane veprimi për rekomandimet e lëna, mungojnë shkresat dhe auditimet për të parë ndjekjen e këtyre rekomandimeve. Sa më sipër, nuk kuptohet nëse njësitë e audituara i kanë pranuar rekomandimet, dhe në çfarë faze të zbatimit të tyre janë ato.

**Kriteri:**
Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" neni 20, 21.

**Shkaku:**
Neglizhencë e drejtorive/sektorëve për hartimin e rregulloreve dhe mbajtjen e regjistrit të riskut.

**Ndikimi/Efekti:**
Mungon ndarja e qartë e detyrave sipas drejtorive/sektorëve, mos identifikim i shkallës së riskut, mos trajnim efektiv për rritjet profesionale të stafit.

**Rëndësia:** *E ulët*

**Rekomandimi:**
- Kryetari i Bashkisë Shkodër, në cilësinë e Nëpunësit Autorizues, të marrë masa për njohjen dhe menaxhimin nga stafi të ligjit për MFK dhe manualit përkatës të tij, për hartimin dhe miratimin e një strategjie të risqeve, me qëllim menaxhimin e riskut, ku të bëhet identifikimi, analiza dhe kontrolli i risqeve që mund të kenë impakt në arritjen e objektivave të institucionit.
Të hartohen rregulloret sipas drejtorive/sektorëve përkatës për përcaktimin sa më të qartë të çdo pozicioni pune.
- Drejtoria e Burimeve Njerëzore të hartojë programe të trajnimeve për ngritjen profesionale të stafit. Në bashkëpunim me Kryetarin e Bashkisë Shkodër të krijojë si strukturë me vetë Inspektorati Vendorë i Mbrojtjes së Territorit e pavarur nga Drejtoria e Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit, strukturë e cila të miratohet dhe në Këshillin Bashkiak.

### <u>III/2.1.2. Organizimi i njësisë së Auditit të Brendshëm</u>;

Bashkia Shkodër ka parashikuar në strukturën e saj shërbimin e Sektorin e Auditit të Brendshëm, miratuar me VKB nr. 82, datë 20.12.2018 për vitin 2019 dhe VKB nr. 26, datë 30.12.2019 vitin 2020. Sektori e Auditit të Brendshëm funksionon sipas strukturës organizative të miratuar nga Kryetari i Bashkisë Shkodër, i përbërë nga 2 (dy) specialist dhe 1 (një) përgjegjës, ku përgjegjës i NjAB është emëruar Z. P.Z..
Përbërja e sektorit paraqitet si më poshtë:

| Nr. | Nga data e krijimit deri me 31.12.2020 | Funksioni | Arsimimi | Vjetër sia në pune | Vjetër si në auditi m | Certifiki mi | Trajnimet vijueshme |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1. | P.Z. | Përgj/AB | Univ.Tiranë/Financë. M. Kontabilitet | 24 | 24 | Po/2005 | 40 orë në vit |
| 2. | E.N. | Audituese | Univ.Shkodër/Fakulteti Drejtësisë | 21 | 17 | Po/2008 | 40 orë në vit |
| 3. | B.B. | Audituese | Univ.Shkodër/Fakulteti Ekonomik | 13 | 5 | Po/2013 | 40 orë në vit |

- Karta e Auditimit, është përgatitur dhe miratuar tek titullari i Bashkisë Shkodër me Urdhrin nr. 5, datë 14.01.2016, dhe nr. prot. 357, datë 14.01.2016, në përputhje me nenin 4, pika 12, të Ligjit nr. 114/2015, si dhe në përputhje me pikën 2.5, Kapitulli II të Manualit të Auditimit të Brendshëm.
- Plani Strategjik është përgatitur dhe dërguar në Drejtorinë e Përgjithshme të Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm për vitet 2019 - 2021, me shkresën nr. 3466 prot., datë 15.10.2018, përpiluar në përputhje me standardin e përcaktuar në Manualin e Auditimit të Brendshëm, Kapitulli III, pika 3.1.6. Bashkëlidhur kësaj shkrese është dërguar edhe planifikimi vjetor për vitin 2019, në përputhje me standardin e përcaktuar në Manualin e Auditimit të Brendshëm, Kapitulli III, pika 3.2. Sipas planit strategjik, synohen 14 auditime në vit duke përfshirë edhe zbatimin e rekomandimeve.
- Plani Strategjik është përgatitur dhe dërguar në Drejtorinë e Përgjithshme të Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm për vitet 2020 – 2022, me shkresën nr. 17451 prot., datë 14.10.2019, përpiluar në përputhje me standardin e përcaktuar në Manualin e Auditimit të Brendshëm, Kapitulli III, pika 3.1.6. Bashkëlidhur kësaj shkrese është dërguar edhe plani vjetor për vitin 2020, në përputhje me standardin e përcaktuar në Manualin e Auditimit të Brendshëm, Kapitulli III, pika 3.2. Sipas planifikimit, synohen 10 auditime për vitin, duke bërë një reduktim nga plani strategjik i një viti më parë me 4 auditime më pak të planifikuara.
- Raportimi vjetor në Drejtorinë e Përgjithshme të Harmonizimit të Auditit të Brendshëm për vitin 2019, është dërguar në DHAB me shkresën nr. 2968 prot, date 14.02.2020, dhe për vitin 2020, është dërguar në DHAB me shkresën nr. 2709 prot, datë 15.02.2020, bashkëngjitur dhe pasqyrat shoqëruese. Dokumentacioni është dërguar në afat shoqëruar edhe me pjesën përshkruese të raportit, i përgatitur sipas standardeve që përcakton Manuali i Auditimit të Brendshëm, Kapitulli III, pika 3.6.
- Struktura e projekt raporteve dhe e raporteve përfundimtare të auditimit për vitin 2019 dhe 2020 është hartuar e plotësuar sipas standardit të vendosur nga MAB në Kapitullin IV, pika 4.1.12, Hapi 11.
- Dosjet koherente të auditimit të brendshëm të njësive publike janë mbajtur të plotësuara e administruar në përputhje me kërkesat e Kapitullit VI të MAB, në to është përfshirë gjithë informacioni dhe dokumentet e nevojshme, por në shumicën e tyre <u>mungon Plani i Veprimit të subjekteve të audituara.</u>

### 1.2 *<u>Vlerësim mbi veprimtarinë e njësisë së auditit të brendshëm</u>*

Për çdo mision auditimi, nga audituesit janë hartuar programet e auditimit, të cilat janë miratuar nga Përgjegjësi i NJAB, në bazë të Planit Vjetor. Vlerësojmë se sipas përcaktimeve të bëra në Manualin e AB të miratuar me urdhrin e ministrit të financave nr.100, datë 25.10.2016 (seksioni VI, kreu III,

pika 1), programet kanë përmbledhur orientimet kryesore të veprimit në përputhje me risqet dhe problematikat e subjekteve dhe përmbajnë në mënyrë të qartë emërtimin e subjektit, llojin e auditimit, periudhën dhe afatin e misionit, drejtimet dhe grupin e punës. Referencat ligjore të vëna në programet e auditimit kanë reflektuar dispozitat dhe kuadrin ligjor në fuqi.

**-Nga shqyrtimi i dokumentacionit, për vitin 2019,** sipas planifikimit vjetor, janë planifikuar për tu kryer 12 auditime, nga të cilat janë realizuar 8 auditime (në masën 67%), dhe konkretisht është audituar *Drejtoria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe trajtimit të AMTP-ve, Dega Ekonomike e Kulturës, Drejtoria e Kulturës, Arsimit, Rinisë dhe Sportit, Teatri "Migjeni", Inspektorati Mbrojtjes së Territorit Vendor, Drejtoria e Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit, Drejtoria e Studimeve, Planifikimit dhe Koordinimit të Investimeve, Auditimi i detyrimeve të prapambetura.*

Në lidhje me auditimet e pa realizuara, NJAB sqaron se mos realizimi ka ardhur nga pengesat gjatë proceseve të auditimit, pa përcaktuar se cilat janë këto pengesa.

**-Nga shqyrtimi i dokumentacionit rezulton se për vitin 2020** sipas planifikimit vjetor janë parashikuar për tu kryer 10 auditime gjithsej, prej të cilave janë realizuar 7 angazhime ose 70% e atyre të planifikuara. i janë nënshtruar këtij procesi *Drejtoria e Shërbimeve Publike, Ndjekjes së Investimeve të Infrastrukturës, Drejtoria e Planifikimit Strategjik dhe Përmirësimit të Klimës së Biznesit, Policia Bashkiake, Drejtoria Juridike, Drejtoria e Turizmit, Projekti "Legend – IPA Adriatic" – Administruar nga ish Drejtoria e Koordinimit të Projekteve dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare, Projekti "Europe for citizens programe 2007-2013 No.549435-EFC-1-20013-EFCNTT" ish Komuna Dajç.*

Në lidhje me planet strategjike dhe planifikimet vjetore për vitet objekt auditimi, rezulton se NJAB pavarësisht se ka planifikuar auditimin e disa drejtorive me risk të lartë siç është Drejtoria e Financës, Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore, Njësinë e Prokurimeve, në secilin rast, angazhimi nuk është kryer, ose është shtyrë planifikimi për vitin e ardhshëm.

- *Zbatimi i planeve të auditimit të brendshëm. Hartimi dhe mbajtja e dokumentacionit të auditimit.*

Për veprimtarinë e sektorit të AB për periudhën nga data 01.07.2019 deri në 31.12.2020 është raportuar në mënyrë sistematike Kryetari i Bashkisë Shkodër.

Për veprimtarinë e vitit 2019 janë dërguar evidencat e realizimit të auditimeve, me shkresë përcjellëse nr. 2968, datë 14.02.2019, dhe për veprimtarinë e vitit 2020, janë dërguar me shkresën përcjellëse nr. 2709, datë 15.02.2021, të cilat janë dërguar në Ministrinë e Financave (Drejtorinë Qendrore të Harmonizimit për Auditimin e Brendshëm), bashkë me dokumentacionin shoqërues, sipas Manualit të Auditit të Brendshëm.

*Pasqyra e realizimit të auditimeve të brendshme për 6 mujorin e dytë të vitit 2019 dhe vitin 2020*

***6 mujori i dytë i vitit 2019***

| | Subjekti i Audituar | Nr. Rek. | Rek. Pranuar | Rek. Zbatuar | Në proces | Pa zbatuar |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Inspektorati Mbrojtjes së Territorit | 14 | - | - | - | - |
| 2 | Drejtoria e Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit | 20 | - | - | - | - |
| 3 | Drejtoria e Studimeve, Planifikimit të Investimeve | 23 | - | - | - | - |
| 4 | Drejtoria e Kulturës, Arsimit, Rinisë dhe Sporteve | 15 | 15 | 2 | 5 | 8 |
| 5 | Teatri Migjeni | 16 | - | - | - | - |
| | **Total** | **88** | **15** | **2** | **5** | **8** |

Nga auditimi i 6 mujorit të dytë të vitit 2019, konstatojmë se janë kryer 5 auditime nga të cilat 3 auditime përputhshmërie dhe 2 auditime të kombinuara. Janë dhënë 88 rekomandime. Rekomandimet janë organizative dhe sipas llojit janë ndarë si më poshtë:

a) *Mbi sistemin e prokurimeve 1 rekomandime*
b) *Mbi sistemin e menaxhimit financiar dhe kontrollin 40 rekomandime*
c) *Mbi sistemin e pagave dhe shpërblimeve 3 rekomandime*
d) *Mbi sistemin e tatim taksave 1 rekomandime*
e) *Mbi hartimin e buxhetit 7 rekomandime*
f) *Të tjera rekomandime 36 rekomandime*

Me programin nr. 4000/6 prot., datë 22.10.2019, është kontrolluar zbatimi i rekomandimeve të lëna në auditimet e mëparshme, dhe për auditimet e kryera 6 mujorin e dytë të vitit 2019 është kontrolluar vetëm zbatimi i rekomandimeve në Drejtorinë e Kulturës, Arsimit, Rinisë dhe Sporteve.

***Viti 2020***

| | Subjekti i Audituar | Nr. Rek. | Rek. Pranuar | Rek. Zbatuar | Në proces | Pa zbatuar |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Dr. Shërbimeve Publike, Ndjekjes së Investimeve dhe Infrastrukturës | 15 | - | - | - | - |
| 2 | Dr. Planifikimit Strategjik të Klimës së Biznesit | 8 | - | - | - | - |
| 3 | Policia Bashkiake | 17 | - | - | - | - |
| 4 | Drejtoria Juridike | 10 | - | - | - | - |
| 5 | Drejtoria e Turizmit | 14 | - | - | - | - |
| 6 | Projekti "Legend-IPA Adriatic" | 8 | - | - | - | - |
| 7 | Projekti "Europë for citizens programe 2007-2013" – ish komuna Dajç | 4 | - | - | - | - |
| | **Total** | **76** | **-** | **-** | **-** | **-** |

Nga auditimi i raportimit vjetor 2020, konstatojmë se janë kryer 7 auditime nga të cilat 3 janë auditime përputhshmërie, 3 auditime të kombinuara 1 Shërbim Këshillimi. Janë dhënë 74 rekomandime. Rekomandimet janë organizative dhe sipas llojit janë të ndarë si më poshtë:

a) *Mbi sistemin e prokurimeve 1 rekomandime*
b) *Mbi sistemin Menaxhimin Financiar dhe Kontrollit 34 rekomandime*
c) *Mbi Hartimit të Buxhetit 12 rekomandime*
d) *Mbi Sistemin e administrimit të pronës 2 Rekomandime*
e) *Mbi zbatimin e kontratave 1 rekomandime*
f) *Të tjera 26 rekomandime*

Mungojnë Plan Veprimet e subjekteve të audituara, ndërkohë që NjAB nuk ka kryer angazhime për verifikimin e zbatimit të rekomandimeve. Nuk ka informacion për statusin aktual të rekomandimeve.

***1.*** **Titulli i gjetjes:** *KLSH ka konstatuar mungesë arritje objektivash në realizimin e angazhimeve të planifikuara. Dosjeve kanë mangësi të disa dokumenteve sipas MAB. Sektorët me risk të lartë nuk janë audituar dhe mungojnë planet e veprimit në angazhimet e kryera.*

**Situata:**

- Njësia e auditit të brendshëm paraqet mangësi në përmbushjen e planit vjetor duke mos arritur objektivat sipas planifikimit. Për vitin 2019 janë kryer 8 angazhime nga 12 të planifikuara, dhe për vitin 2020, janë kryer 7 angazhime nga 10 të planifikuara.
- Në dosjet e auditimit, nuk janë mbajtur disa prej dokumenteve të përcaktuara në Manualin e Auditit të Brendshëm, miratuar me Urdhër të Ministrit të Financave me nr. 100, datë 25.10.2016 si më poshtë:

a) *Mungon dokumenti për planifikimin e angazhimit në kundërshtim me Kapitullin IV, pika 4.1.1 "Planifikimi i një angazhimi auditimi".*
b) *Nga audituesit e brendshëm, nuk është dokumentuar takimi i hapur prezantues, në kundërshtim me Kapitullin IV, pika 4.1.4 Hapi 3.*

c) *Në dosjet e audituara, rezulton se nuk janë administruar letrat e punës, në kundërshtim me Kapitullin IV, pika 4.1.8 Hapi 7.*
d) *Nga drejtuesi e NjAB, nuk është kryer sigurimi i cilësisë së punës, veprim ky në kundërshtim me Kapitullin VII, pika 7.1.1 "Vlerësimi i brendshëm i cilësisë që kryhet nga vetë NjAB.*
- Njësia e Auditit të Brendshëm, pavarësisht planifikimit, nuk ka kryer angazhimin për auditim të Drejtorisë Ekonomike, Njësinë e Prokurimi dhe Drejtorinë e Taksave dhe Tarifave Vendore.
- Subjektet e audituara, në shumicën e rasteve nuk kanë paraqitur Planin e Veprimin për zbatimin e rekomandimeve, veprime që bien në kundërshtim me ligjin 114/2015 "Për auditimin e brendshëm në sektorin publik", dhe me Kap. IV, pika 4.1.12, Hapi 11, të MAB.

**<u>Kriteri</u>:**
Ligji nr. 114/2015 "Për auditimin e brendshëm në sektorin publik"," neni 8 germa (c), neni 14 germa; Manuali i Auditit të Brendshëm, urdhër i Ministrit të Financave me nr. 100 datë 25.10.2016, Kapitulli IV, pika 4.1.1, pika 4.1.4 Hapi 3, pika 4.1.8 Hapi 7, Kapitulli VII, pika 7.1.1.

**<u>Shkaku</u>:**
Mungesë e kapaciteteve për kryerjen e gjitha angazhimeve. Neglizhencë e drejtuesit për plotësimin e dosjeve sipas manualit.

**<u>Ndikimi/Efekti</u>:**
Nuk jep garanci për zbatimin e rekomandimeve të lëna. Nuk mbulon fushat me risk të lartë të institucionit.

**<u>Rëndësia</u>: *E Mesme***

**<u>Rekomandimi</u> :**
Sektori i Njësisë së Auditit të Brendshëm (NJAB), të marrë masa të kryej monitorimin e zbatimit të rekomandimeve.
Drejtuesi i Auditimit Brendshëm të vendosë dhe të mirëmbaje një sistem për monitorimin e trajtimit të rezultateve të komunikuara menaxhimit sipas Manualit AB.
Në hartimin e planeve vjetore të planifikohen sektorë me fusha me risk, siç janë zbatimi i procedurave të prokurimit, dhënia e lejeve të ndërtimit/zhvillimit, administrimi i taksave e tarifave vendore, si dhe institucionet e varësisë të Bashkisë Shkodër.

Nga subjekti Bashkia Shkodër me shkresën nr. 4597/55 prot, datë 16.07.2021 (prot KLSH nr. 362/16, datë 21.07.2021), janë përcjellë kundërshtitë në lidhje me mangësitë e konstatuara nga Njësia e Auditit të Brendshëm, si më poshtë vijon:

**<u>Komente dhe sqarime</u>:**
*Në lidhje me Rekomandimin 2.1, NjAB sqaron se nuk ka realizuar planin vjetor, kjo për shkak të numrit të ulët të Audituesve, ndërsa ka rritje të volumit të punës. Në lidhje me letrat e punës në dosjet auditeuse, sqarohet se në përgjithësi janë mbajtur në mënyrë elektronike, dhe për arsye të volumit nuk janë printuar por disponohen elektronikisht. Në lidhje me kontrollin e cilësisë, sqarohet se nuk ka një format të miratuar në manual. Për rekomandimet e lëna, në përfundim të afatit për përpilimin dhe dërgimin e planit të veprimit për zbatimin e rekomandimeve, është njoftuar me shkrim subjekti i audituar dhe njëkohësisht Kryetar i Bashkisë. Për të gjitha misionet e auditimit ka plane veprimi.*
*Në lidhje me Rekomandimin 2.2, sqarohet se në referencë të pikës 2, neni 10 i ligjit nr. 114/2015 "Për auditimin e brendshëm në sektorin publik", raportimi bëhet te titullari i njësisë publike, në këtë rast tek Kryetar i Bashkisë.*

**<u>Sqarim i grupit të KLSH</u>:**
-Në lidhje me rekomandimin 2.1, i cili është konsideruar i pranuar nga Njësia a Auditimit, sqarohet se dokumentet të cilat i mungonin dosjeve, janë kërkesë e Manualit për Auditin e Brendshëm, dhe si të tilla duhen plotësuar dhe të jenë pjesë e dosjeve të çdo auditimi. E njëjta situatë vlen të përmendet edhe për zbatimin e rekomandimeve, pasi nga auditimi ka rezultuar se në shumë raste

subjektet nuk kishin paraqitur plan veprimi, dhe NjAB nuk dispononte informacion për situatën aktuale të këtyre rekomandimeve.
-Në lidhje me pikën 2, pranohet sqarimi juaj, pasi sipas dispozitës të përmendur në observacionin tuaj, Njësia Audituese ka për detyrë raportimin tek titullari i njësisë, detyrë e cila rezulton e kryer për çdo auditim.

*(Më hollësisht problemet janë trajtuar në faqen 14-22, të Projektraport Auditmit)*

### III/2.3. Mbi planifikimin dhe zbatimin e planit të buxhetit, bazuar në ligjin organik të buxhetit të shtetit, nr. 9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH", ligjet vjetore "Për buxhetin e shtetit" të vitit 2019 dhe 2020, si dhe aktet nënligjore mbi planifikimin, monitorimin dhe zbatimin e buxhetit.

***2/2.1.*** *Programimi i PBA për periudhën 2019-2020 dhe programimi i buxhetit vjetor për vitin 2019 dhe 2020;*

Nga auditimi i procedurave për përgatitjen PBA 2019-2021, u konstatua se janë realizuar fazat e përgatitjes, duke filluar që nga ngritja e grupit të punës, Grupi i Menaxhimit Strategjik me urdhër të Titullarit të institucionit, organizimin e mbledhjes së këtij grupi për përcaktimin e tavaneve të shpenzimeve sipas programeve.
Për hartimin e programeve buxhetore afatmesme dhe projektbuxhetet vjetore janë kryer konsultime me komunitetin dhe grupet e interesit në njësinë e vetëqeverisjes vendore, nëpërmjet procesit të "Buxhetit me pjesëmarrje".
Buxhetet janë hartuar mbi bazën e kërkesave shkresore nga njësitë administrative, drejtoritë e shkollave, sektorët e bashkisë (sektori i shërbimeve), U...i, etj., gjë që vërteton se prej tyre janë marrë kërkesat për nevojat reale e mbi bazën e tyre dhe të buxhetit faktit të mundshëm janë përzgjedhur ato më prioritare.

**Buxheti viti 2019 dhe PBA 2020-2021*:***
Me Vendim të KB nr. 82 datë 20.12.2018 "Për miratimin e buxhetit te vitit 2019 dhe programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2019- 2021 te Bashkisë Shkodër", konfirmuar nga Prefekti Qarku Tiranë me shkresën nr. 1462/1, datë 7.01.2019. Nga MFE me shkresën nr. 19369 datë 30.10.2018 dhe nr. 22759 datë 27.12.2018 janë dërguar transferta e pakushtëzuar e përgjithshme dhe sektoriale për vitin 2019. Me shkresën nr. 407 datë 10.01.2019 është dërguar ne Dege te Thesarit –detajimi i buxhetit te vitit 2020 dhe PBA 2021-2022.

**Buxheti viti 2020 dhe PBA 2021-2023***:*
Me Vendim të KB nr. 26 datë 30.12.2019 "Për miratimin e buxhetit te vitit 2020 dhe programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2021- 2022 te Bashkisë Shkodër", konfirmuar nga Prefekti Qarkut Shkodër me shkresën nr. 51/1, datë 16.01.2020. Nga MFE me shkresën nr. 20458 datë 11.11.2019 dhe nr. 24138 datë 26.12.2019 dërgohet transferta e pakushtëzuar e përgjithshme dhe sektoriale për vitin 2020. Me shkresën nr. 1252 datë 21.01.2020 dërgohet ne Dege te thesarit –Detajimi i buxhetit te vitit 2020 dhe PBA 2021-2022.

Me Vendim të KB nr. 19, datë 23.4.2020 "Për miratimin e raportit të monitorimit, zbatimit të buxhetit viti 2019", është miratuar buxheti faktik i **vitit 2019,** konfirmuar nga Prefekti Qarkut Shkodër me shkresën nr. 300/1, datë 6.5.2020. Ndërsa me Vendim të KB nr. 22, datë 25.3.2020 "Për miratimin e raportit të monitorimit, zbatimit të buxhetit viti 2020", është miratuar buxheti faktik i **vitit 2020**, konfirmuar nga Prefekti Qarkut Shkodër me shkresën nr. 312/1, datë 21.4.2021.

Për vitet 2019 dhe 2020, janë përgatitur raporte 4-mujore për procesin e buxhetit realizimit të tij në nivel programesh, duke përfshirë misionin dhe objektivat dhe ndjekjen e realizimit të tyre, konkretisht:
**Për aktivitetin e vitit 2019,** monitorimi është bërë me shkresën nr. 9456, datë 31.5.2019 dhe me shkresën nr. 9455, datë 31.5.2019 është dërguar raporti i monitorimit te zbatimit te Buxhetit për 4 –mujorin e pare te vitit 2019 te Bashkisë Shkodër ne Ministrinë e Financave.
Me shkresën nr. 3993 datë 02.03.2020, është dërguar në Këshillin Bashkiak Shkodër raporti i monitorimit te zbatimit te buxhetit për periudhën e 12 mujorit viti 2019 dhe me shkresën nr. 3949 datë 28.02.2020, po ky raport dërgohet në Ministrinë e Financave me, i cili është miratuar me Vendim të KB nr. 19 datë 23.04.2020 "Për miratimin e raportit te monitorimit ,te zbatimit te buxhetit te vitit 2019".
**Për aktivitetin e vitit 2020,** me shkresën nr. 7386 datë 29.05.2020 është dërguar raporti i monitorimit te zbatimit te Buxhetit për 4 –mujorin e pare te vitit 2020. Me shkresën nr. 6455 datë 08.05.2020 është dërguar realizimi i treguesve kryesore te të ardhurave dhe shpenzimeve sipas planit vjetor dhe planit te periudhës për 4 mujorin e vitit 2020 ne Këshillin Bashkiak. Me shkresën nr. 7380 datë 29.05.2020 datë është dërguar në MFE raporti i monitorimit te zbatimit te Buxhetit për 4 –mujorin e pare te vitit 2020 dhe çdo muaj me shkresa përkatëse është njoftuar KB mbi nivelin e realizimit të të ardhurave dhe zbatimit të buxhetit. Me shkresën nr. 3494 datë 26.02.2021 është dërguar raporti i monitorimit te zbatimit te buxhetit për 12 mujorin e vitit 2020 ne Këshillin Bashkiak Shkodër dhe me shkresën nr. 3496, datë 26.2.2021 është dërguar në MFE raporti i monitorimit te zbatimit te buxhetit për 12 mujorin e vitit 2020.
Raporti i monitorimit te zbatimit te buxhetit për 12 mujorin e vitit 2020 është miratuar me Vendim të KB nr. 22 datë 25.03.2020 "Për miratimin e raportit te monitorimit, te zbatimit te buxhetit te vitit 2020".

Treguesit e realizimit të buxhetit, paraqitet vijon:

*Në 000/lekë*

| Nr. | Emërtimi | Plani fillestar i vitit 2019 | | | | Plani fillestar i vitit 2020 | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | Të Ardhurat | | Shpenzime | | Të Ardhurat | | Shpenzimet | |
| | | Viti | Te trashëguarat | Viti | Te trashëguarat | Viti | Te trashëguarat | Viti | Te trashëguarat |
| A | Të ardhura | 932,579 | 489,851 | | | 856,417 | 455,949 | | |
| B | Transfertës e pakushtëzuar | 630,668 | 222,001 | | | 678,631 | 144,508 | | |
| C | Transferta specifike | 353,768 | 36,808 | | | 373,193 | 46,439 | | |
| D | Transferta e kushtëzuar | 1,069,689 | - | | | 1,055,968 | | | |
| E | Donacionet | 7,443 | 5,472 | | | 5,108 | 9,274 | | |
| 1 | Paga (600) | | | 584,446 | 85,375 | | | 611,794 | 80,516 |
| 2 | Sigurime shoqërore (601) | | | 96,917 | 14,394 | | | 101,293 | 21,185 |
| 3 | Shpenzime operative (602) | | | 629,167 | 227,364 | | | 666,083 | 188,617 |
| 4 | Transferta (604) | | | 96,459 | 15,847 | | | 134,141 | 19,661 |
| 5 | Fondi Rezervë(609) | | | 4,949 | 10,674 | | | 31,649 | 645 |
| 6 | Inv(230 +231) | | | 561,762 | 391,092 | | | 431,662 | 324,500 |
| 7 | Investime FZHR e M. Linjës | | | - | - | | | - | - |
| 8 | Te tjera ( 603, 606) | | | 1,020,446 | 9,386 | | | 992,695 | 21,046 |
| **Totali i buxhetit** | | **2,994,147** | **754,132** | **2,994,147** | **754,132** | **2,969,318** | **656,169** | **2,969,318** | **656,169** |

***Burimi:*** *Nga Drejtoria buxhetit*

**-Krahasimi i planeve buxhetore me PBA respektive**:

PBA 2019-2021 me planin buxhetor 2019, paraqitet në tabelën e mëposhtme:

*Në 000/lekë*

| Nr. | Emërtimi | Plan përfundimtar 2019 | | | Sipas PBA 2019 | | | Ndry-shimi |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | Totali | Viti | Te trashe guarat | Totali | Viti | Te trashe guarat | |
| 1 | Shpenzime për pagat (600+601) *(nga te ardhurat; grant i pakushtëzuar; i pakushtëzuar sektorial dhe donacione)* | 771,728 | 673,366 | 98,363 | 764,992 | 665,223 | 99,769 | 6,736 |
| 2 | Shpenzime (602; 603; 604; 606; 609) *(nga te ardhurat; grant i pakushtëzuar; i pakushtëzuar sektorial dhe donacione)* | 1,010,028 | 805,844 | 204,184 | 994,149 | 730,877 | 263,271 | 15,879 |
| 3 | Investime Bashkia (230-231) *(nga te ardhurat; grant i pakushtëzuar; i pakushtëzuar sektorial dhe donacione)* | 918,001 | 568,415 | 349,586 | 919,449 | 528,357 | 391,092 | (1,448) |
| 4 | Renta Minerare | 40 | 40 | | - | | | 40 |

| Nr. | Emërtimi | Plan përfundimtar 2019 | | | Sipas PBA 2019 | | | Ndry-shimi |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | Totali | Viti | Te trashe guarat | Totali | Viti | Te trashe guarat | |
| ***A*** | ***Total i planit fillestar (nga te ardhurat; grant i pakushtëzuar; i pakushtëzuar sektorial dhe donacione)*** | ***2,699,798*** | ***2,047,665*** | ***652,133*** | ***2,678,590*** | ***1,924,458*** | ***754,132*** | ***21,208*** |
| | | | | | | | | |
| **B** | **Investime nga FZHR** | **26,609** | **26,609** | **-** | | | | **26,609** |
| | | | | | | | | |
| **C** | **Shtesat nga Pushteti Qendror (kapitale)** | **943,741** | **928,299** | **15,443** | **1,069,689** | **1,069,689** | **-** | (125,948) |
| 1 | Shpenzime për pagat (600+601) | 22,391 | 22,391 | | 16,140 | 16,140 | | 6,251 |
| 2 | Shpenzime (602; 603; 604; 606; 609) | 865,255 | 865,255 | | 1,020,144 | 1,020,144 | | (154,889) |
| 3 | Grant i kushtëzuar (230-231) | 56,095 | 40,653 | 15,443 | 33,405 | 33,405 | | 22,690 |
| **A+B+C** | **Gjithsej** | **3,670,148** | **3,002,573** | **667,575** | **3,748,279** | **2,994,147** | **754,132** | **(78,131)** |

***Burimi:*** *Nga Përpunimi i të dhënave sipas planeve të paraqitura nga subjekti.*

**PBA 2020-2022 me planin buxhetor 2020, paraqitet në tabelën e mëposhtme**:

*Në 000/lekë*

| Nr. | Emërtimi | Plan përfundimtar 2020 | | | Sipas PBA 2020 | | | Ndryshimi |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | Totali | Viti | Te trashe guarat | Totali | Viti | Te trashe guarat | |
| 1 | Shpenzime për pagat (600+601) (nga te ardhurat; grant i pakushtëzuar; i pakushtëzuar sektorial dhe donacione) | 796,908 | 695,207 | 101,701 | 798,216 | 696,515 | 101,701 | (1,308) |
| 2 | Shpenzime (602; 603; 604; 606; 609) (nga te ardhurat; grant i pakushtëzuar; i pakushtëzuar sektorial dhe donacione) | 1,053,109 | 877,883 | 175,226 | 1,061,566 | 831,597 | 229,969 | (8,457) |
| 3 | Investime Bashkia (230-231)(nga te ardhurat; grant i pakushtëzuar; i pakushtëzuar sektorial dhe donacione) | 687,414 | 491,196 | 196,219 | 709,737 | 385,237 | 324,500 | (22,322) |
| **A** | **Total i planit fillestar(nga te ardhurat; grant i pakushtëzuar; i pakushtëzuar sektorial dhe donacione)** | **2,537,431** | **2,064,285** | **473,145** | **2,569,518** | **1,913,349** | **656,169** | (32,087) |
| | | | | | | | | |
| **B** | **Investime nga FZHR** | **3,229** | **3,229** | | **-** | | | **3,229** |
| | | | | | | | | |
| **C** | **Shtesat nga Pushteti Qendror** | **1,130,753** | **1,130,753** | **-** | **1,055,968** | **1,055,968** | **-** | 74,784 |
| 1 | Shpenzime për pagat (600+601) | 16,602 | 16,602 | - | 16,572 | 16,572 | - | 30 |
| 2 | Shpenzime (602; 603; 604; 606; 609) | 1,035,609 | 1,035,609 | - | 992,971 | 992,971 | - | 42,638 |
| 3 | Grant i kushtëzuar (230-231) | 78,542 | 78,542 | - | 46,425 | 46,425 | - | 32,117 |
| **A+B+C** | **Gjithsej** | **3,668,184** | **3,195,038** | **473,145** | **3,625,487** | **2,969,318** | **656,169** | **42,697** |

***Burimi:*** *Nga Drejtoria e buxhetit*

***2/2.2.*** *<u>Çelja e fondeve buxhetore të vitit dhe ndryshimet sipas akteve normative. Kontrolli i realizimit të shpenzimeve bazuar në nivelin e fonde të çelura</u>;*

Në programet buxhetore është bërë shpërndarja e fondeve të vënë në dispozicion nga Pushteti Qendror të grandeve nëpërmjet transfertës së pakushtëzuar, transfertës së kushtëzuar dhe fondeve të krijuar nga burimet e veta, për kryerjen e funksioneve të veta, ato të deleguara dhe të përbashkëta si dhe shpërndarjen e fondeve të grandeve.
Ndarja e plan buxhetit dhe detajimi i tyre në nivel titulli, kapitulli, artikulli dhe nën artikulli është kryer në respektim të disiplinës buxhetore sipas strukturës dhe burimeve të financimit. Gjatë vitit si rezultat i çeljeve të reja në llogarinë e njësisë vendore në thesar, vlerat përkatëse të buxhetit vjetor kanë pësuar ndryshime në kuptimin e vlerës totale, pasi janë çelur fondet për funksionet e deleguara, grandeve qeveritare, ndihma ekonomike, gjendja civile, shpërblime lindje, etj., të cilat nuk kanë qenë të pasqyruara në çeljen fillestare të vitit.

**<u>1. Titulli gjetjes:</u>** *Ndryshimet buxhetore gjatë periudhave ushtrimore.*

**<u>Komente dhe sqarime</u>:**
Nga subjekti Bashkia Shkodër me shkresën nr. 4597/55, datë 16.7.2021 (prot KLSH nr. 362/16, datë 21.7.2021), janë përcjellë kundërshtitë në lidhje me mangësitë e konstatuara në zbatimin e buxhet, si më poshtë vijon:
a- *Në lidhje me ndryshimet e buxhetit gjatë viteve 2019 dhe 2020 është zbatuar baza ligjore e mëposhtme:*
*Neni 45 "Rishpërndarja e fondeve buxhetore " të ligjit 68/2017, "Për financat e vetëqeverisjes vendore" parashikon: "Rishpërndarjet e fondeve të buxhetit të njësive të vetëqeverisjes vendore kryhet në përputhje me parashikimet e nenit 44, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar "*
*Neni 44 i ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008, "Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.*
*Të gjitha ndryshimet buxhetore, shoqërohen me relacion të argumentuar, shpjegues, të hollësishëm nga drejtoria përkatëse që menaxhon programin buxhetor, që miratohen më pas me Vendim të Këshillit Bashkiak ose nga Kryetari i Bashkisë.*
*Numri i larte i shkresave të transferimeve të fondeve, është rezultat i përdorimit të fondit të veçantë për shpërblim dalje në pension, ndihmë të menjëhershme në rast fatkeqësie etj. dhe konkretisht:*
*Buxheti i vitit 2019, ka gjithsej 33 shkresa transferime drejtuar Degës së Thesarit, ku përfshihen gjatë gjithë vitit:*
- *Urdhra për dalje në pension, shpërblim në rast vdekjeje - 50*
- *Vendime Kryetari - 4*
- *Vendime Këshilli Bashkiak - 6*
- *Shkresë të Ministrisë - 2*

***Pra 80% të ndryshimeve vijnë si rrjedhojë e përdorimit të fondit të veçantë.***

*Buxheti i vitit 2020, ka gjithsej 32 shkresa transferime drejtuar Degës së Thesarit, ku përfshihen gjate gjithë vitit:*
- *Urdhra për dalje ne pension, shpërblim ne rast vdekjeje - 28*
- *Vendime Kryetari - 11*
- *Vendime Këshilli Bashkiak - 5*

*Pra 63 % të ndryshimeve vijnë si rrjedhoje e përdorimit të fondit të veçante.*

| **Sqarim i grupit të KLSH:** |
|---|
| Referuar analizës së bërë nga Bashkia Shkodër në lidhje me problematiken e buxhetit, ku janë bërë shumë ndryshime gjatë vitit, grupi konkludon se argumentet qëndrojnë dhe merren në konsideratë. |

***2/2.3.*** *Auditimi mbi saktësinë e realizmit të treguesve buxhetor dhe pasqyrimi në raportet e monitorimit.*

Për zbatimin e buxheteve është rakorduar çdo muaj me Degën e Thesarit Shkodër, si për shpenzimet ashtu edhe për të ardhurat, duke mbajtur akt-rakordimet përkatëse. Nga Bashkia Shkodër janë ruajtur kufijtë e miratuar të shpenzimeve në total dhe për çdo artikull e nënartikulli sipas klasifikimit ekonomik. Në të gjithë periudhën e audituar janë respektuar të gjitha procedurat ligjore për çeljen e fondeve me Degën e Thesarit Shkodër, duke pasqyruar rregullisht dhe periodikisht ndryshimet në buxhetin fillestar për vitin respektive të realizuar me Vendim të KB, ose të diktuara nga Transferta e deleguara nga pushteti qendror, si dhe rishikimet e buxhetit e rritjet e limit nga të ardhurat e realizuara, u konstatua se si në planifikim dhe në realizimin është respektuar disiplina buxhetore.
Pasqyra e realizimit të treguesve të buxhetit periudha vitet 2019 dhe 2020, referuar akt-rakordimet me thesarin paraqitet në tabelën e mëposhtme:

*Në 000/lekë*

| Nr. | Llogaria | Emërtimi | 2019 | | | 2020 | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | Plan | Fakt | Real.% | Plan | Fakt | Real.% |
| 1 | 600 | PAGA | 680,579 | 545,372 | 80% | 691,032 | 545,304 | 79% |
| 2 | 601 | SIGURIME SHOQËRORE | 113,540 | 90,155 | 79% | 122,478 | 91,560 | 75% |
| 3 | 602 | SHPENZIME OPERATIVE | 839,032 | 637,403 | 76% | 857,232 | 552,511 | 64% |
| 4 | 603 | SUBVENCION | 40,000 | 25,000 | 63% | 18,439 | 10,000 | 54% |
| 5 | 604 | TRANSFERTA TE BRENDSHME | 139,277 | 119,616 | 86% | 153,041 | 114,963 | 75% |
| 6 | 606 | TRANSFERTA INDIVIDUALE nga e cila (6.a+ 6.b) | 856,369 | 848,077 | 99% | 1,032,495 | 1,014,470 | 98% |
| 6.a | | *Ndihme ekonomike dhe PAK* | *840,868* | *839,571* | 100% | *1,000,812* | *998,768* | 100% |
| 6.b | | *Transferime te tjera* | *15,501* | *8,506* | 55% | *31,683* | *15,702* | 50% |
| 7 | 609 | FOND REZERVE/ FOND KONTIGJENCE | 645 | - | 0% | 27,510 | 0 | 0% |
| 8 | 230 | PROJEKTE | 60,819 | 22,719 | 37% | 37,591 | 19,691 | 52% |
| 8 | 231 | INVESTIME | 939,887 | 609,647 | 65% | 731,594 | 425,959 | 58% |
| | | **SHUMA** | **3,670,148** | **2,897,989** | **79%** | **3,671,412** | **2,774,458** | 76% |

**Burimi**: *Nga Drejtoria e buxhetit*

Referuar të dhënave të pasqyrës mësipërm, niveli i realizmit të treguesve të buxhetit paraqitet 79% për vitin 2019 dhe 76% për vitin 2020, gjë e cila tregon se treguesit e buxhetit planifikohen mbi nevojat që Bashkia Shkodër ka ose realizmi faktik nuk i përgjigjet zbatimit të tij sipas afateve kohorë të përcaktuara.
Për vitin 2019, peshën kryesore të shpenzimeve në buxhet e zënë investimet me 25.6% e pasuar nga ndihma ekonomike/PAK dhe më pas shpenzimet operative. Ndërsa për vitin 2020 peshën kryesore e zënë ndihma ekonomike/ PAK me 28% e ndjekur nga shpenzimet operative me 23.3% dhe ma pas investimet me 19.9%. ndaj totalit, pasqyra:

| EMËRTIMI | Përqindja ndaj totalit | |
|---|---|---|
| | Viti 2019 | Viti 2020 |
| Investime | 25.6 | 19.9 |
| Shpenzime për Nd/ Ekonomike dhe PAK | 23.3 | 28.1 |
| Shpenzime operative | 22.8 | 23.3 |

| **2. Titulli gjetjes:** *Zbatimi i Buxhetit.* |
|---|

**Situata:**
*-Për vitin 2019* buxheti është realizuar në masën 79% ose nga 3,670,148 mijë lekë të planifikuara, janë realizuar 2,897,989 mijë lekë, ndërsa *për vitin 2020* është realizuar në masën 76% ose nga 3,671,412 mijë lekë të planifikuara, janë realizuar 2,774,458 mijë lekë. **Në zërin investime**, buxheti *për vitin 2019* është realizuar në masën 65% ose nga vlera 939,887 mijë lekë të planifikuara, janë realizuar 609,647 mijë lekë, *nga të cilat financim me të ardhurat e veta në vlerën 575,739 mijë lekë ose 94.4%*. Ndërsa *për vitin 2020* është realizuar në masën 58% ose nga 731,594 mijë lekë të planifikuara, janë realizuar 425,959 mijë lekë, *nga të cilat financim me të ardhurat e veta në vlerën 363,043 mijë lekë ose 85.2%*. **Të ardhurat e veta**, për *vitin 2019* është realizuar në masën 92.8% ose nga 692,010 mijë lekë të planifikuara, janë realizuar 640,664 mijë lekë, dhe *për vitin 2020* është realizuar në masën 82% ose nga 796,517 mijë lekë të planifikuara, janë realizuar 653,145 mijë lekë.

**Kriteri:**
-Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010, "Për menaxhimin Financiar dhe Kontrollin", Ligji nr. 9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore" të ndryshuar, Ligji nr. 68-2017, "Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore", Ligji nr. 139/2015, datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore", Udhëzimi nr. 23 datë 22.11.2016, "Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm" dhe Vendimet përkatëse të Këshillit Bashkiak.

**Ndikimi/Efekti:**
Mos realizim i treguesve të zbatimit të buxhetit, në total treguesit e shpenzimeve të buxhetit për vitin 2019 dhe 2020 janë realizuar respektivisht në masën 79% dhe 76%.

**Shkaku:** Mos zbatimi i kërkesave ligjore

**Rëndësia:** I Mesëm

**Rekomandimi :**
Drejtoria e Analizës dhe e Programimit Buxhetor në bashkëpunim me Drejtoritë/ Sektorët e tjerë Bashkia Shkodër, gjatë hartimit dhe miratimit të buxhetit të planifikojë fonde për investime në raport me nivelin e të ardhurave të realizuara për vitin dhe grandeve të planifikuara nga qeveris, në raport me përqindjen e planifikuar për këtë zë.

Planifikimi i të ardhurave të bëhet mbi baza reale dhe shpërndarja e fondeve buxhetore të bazohet në parashikimin e fluksit të hyrjeve të parasë dhe të angazhimeve, ku të sigurohet një përdorim efiçent i burimeve financiare, duke rritur financimet nga të ardhurat e veta.

- **Miratimi dhe përdorimi i fondit rezervë dhe të kontigjencës**

Me miratimin e buxheteve është parashikuar dhe miratuar fondi rezervë/dhe kontigjencës, ku për **vitin 2019** është planifikuar në masën 4,949 mijë lekë dhe të trashëguara në masën 10,674 mijë lekë.

Nga vlera 15,623 mijë lekë është përdorur vlera 14,978 mijë lekë me objekt: *"Rikonstruksion i godinave në pronësi të NJQV për strehim social (ndërtim i ri, godina sociale me kontratë 1+1 dhe 2+1),* duke mbetur papërdorur shuma 645 mijë lekë.

Për **vitin 2020** është planifikuar si fond vlera 31,649 mijë lekë dhe të trashëguara vlera 645 mijë lekë, gjithsej në shumën 32,294 mijë lekë. Me vendim të KB nr. 18, datë 23.4.2020 është bërë shtesë në fondin rezervë në shumën 25,751 mijë lekë, ku në total kap shumën 58,045 mijë lekë për vitin 2020. Me vendim të KB nr. 34, datë 7.8.2020 kemi përdorim të këtij fondi me vlerë 19,035

mijë lekë, kjo në muajin Gusht 2020 dhe në muajin shtator në shumën 11,500 mijë lekë sipas VKB nr. 41, datë 25.9.2020, në mënyrë të detajuar paraqet në pasqyrën:

| Vendime | | Qëllimi përdorimit |
|---|---|---|
| Nr. | Datë | |
| 18 | 23.4.2020 | Për miratimin e raportit te monitorimit te zbatimit te buxhetit te vitit 2019 te Bashkisë Shkodër ( shtese fond rezerve shuma 25,751,000 lekë) |
| 34 | 7.8.2020 | Për zbatimin projektit "Rikonstruksion i godinave ne pronësi te njësive te vetëqeverisjes vendore për strehim social (Rikonstruksion i ish konviktit te shkollës veterinare) ne shumen 19,035,000 lekë |
| 41 | 25.9.2020 | Për zbatimin e aktivitetit shërbimi i ndriçimit te qytetit te njësive administrative ne Bashkinë Shkodër ne shumen 11,500,000 lekë |

- **<u>Subvencionet nga/ dhe për Bashkinë Shkodër</u>**.

Nga dokumentacioni i paraqitur, konstatohet se Bashkia Shkodër ka kryer subvencione për "*Transportin Publik*" dhe "*U...*", në financimin e faturave, si më poshtë vijon, pasqyra:

*Në 000/lekë*

| Nr. Programit | Emërtimi Programit | TOTALI | |
|---|---|---|---|
| | | Plan | Fakti |
| | **Viti 2019** | | |
| 4570 | Transporti Publik | 3,000 | |
| 6330 | Furnizimi me ujë | 37,000 | 25,000 |
| | **TOTALI** | **40,000** | **25,000** |
| | **<u>VITI 2020</u>** | | |
| 4570 | Transporti Publik | 6,000 | |
| 6330 | Furnizimi me ujë | 12,439 | 10,000 |
| | **TOTALI** | **18,439** | **10,000** |

- **<u>Donacione për Bashkinë Shkodër</u>**.

Bashkia Shkodër ka disa projekte me te huajt, ku për **vitin 2019** janë në vlerën 8,147 mijë lekë ose progresivisht nga fillimi i projekteve shkon në vlerën 55,668 mijë lekë. Ndërsa në **vitin 2020** janë për vlerën 1,017 mijë lekë ose nga fillimi i projekteve shkon në vlerën 1,568 mijë lekë. Një pjesë e projekteve kanë përfunduar. *Hollësisht të dhënat janë në pasqyrën Aneks 2.2/7 dhe 8, bashkëlidhur Projekt Raport Auditimit*:

***2/2.4.*** *<u>Vlerësimi i risqeve buxhetore nga niveli i faturave të palikuiduara, vendimet gjyqësore, vendimet e shpronësimeve; (Faturat e palikuiduara të shoqërohen me listë analitike, të detajuara me numër fature dhe datë krijimi etj., sipas raportimit në MF, ku të evidentohen detyrimet nga mungesa e burimeve të veta dhe detyrimet nga mungesa e alokimit të Granteve si FZHR, Ministritë e linjës etj.).</u>*

**<u>3.</u>** **<u>Titulli gjetjes:</u>** ***KLSH-ja,*** *konstaton se nga auditimi i transaksioneve financiare të kryera nëpërmjet bankës për periudhën 01,07,2019 – 31,12,2020, janë kryerjen e pagesave mbi afatit 30 ditë të paraqitjes së faturës për likuidim, si dhe mos kryerjen e pagesave në vlerën e plotë të faturës.*

**Situata:**

Nga auditimi i pagesave të kryera nëpërmjet Bankës dhe testimi i tyre në lidhje me respektimin afatit **30-ditor** të paraqitjes në Degën e Thesarit Shkodër të urdhër-shpenzimit me dokumentacionin shoqërues nga data e faturës së operatorit ekonomik, u konstatua se për periudhën objekt auditimi, janë kryer pagesa mbi afatin **30 ditor** të faturave për shpenzime/ shërbime/investime të mbërritura në institucion në **29** raste në vlerën **55,314 mijë lekë,** nga e cila: *për vitin 2019 janë 15 fatura me vlerë 41,894 mijë lekë dhe për vitin 2019 janë 14 fatura me vlerë 13,420 mijë lekë,* ku si shkak është mos paraqitja në kohë e faturave nga personat përgjegjës, ndajë të cilëve është mbajtur PV ose është bërë tërheqje vëmendje, *ku në mënyrë analitike janë në pasqyrat (tabela 1 dhe 2), bashkëlidhur Projekt raport Auditimit.*

Gjithashtu nga auditimi është konstatuar se sipas subjekti nuk ka fatura të copëzuar, por sipas KLSH evidentohen fatura të copëzuar kjo kryesisht për investimet që Bashkia Shkodër ka realizuar për vitet 2019 dhe 2020, pasi nga subjektet janë paraqitur faturat përfundimtare për likuidim në vlerën e tyre të plotë sipas kontratës, por nga bashkia nuk është mundësuar likuidim i tyre me pretendimin se financimi është planifikuar sipas PBA në periudha 2 dhe 3 vjeçare, por që këto investime nuk janë projekte të reja dhe me kontrata shumëvjeçare. Kështu për vitin 2019 vlera e kontratave të lidhura dhe të mbyllura në afat paraqitet në shumën 821,106 mijë lekë nga e cila likuiduar vlera 469,449 mijë lekë. Ndërsa në vitin 2020 vlera e kontratave të lidhura dhe përfunduar në afat paraqitet 769,705 mijë lekë dhe likuiduar në fat vlera 297,7645 mijë lekë.

**Kriteri:**

UMF nr. 5, datë 27.12.2014 “Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura”, pikat 82-91; Ligjin nr. 68/2017 datë 27.4.2017 “Për financat e Vetëqeverisjes Vendore” neni 40, 48: Ligjin nr. 9936, datë 26/06/2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 52.

**Shkaku:**

Likuidim me vonese i faturave në tejkalim të afatit ligjor prej 30 ditësh dhe mos likuidimi i vlerës së plotë të faturës, ka rezultuar nga vetë institucioni për mungesë likuiditetesh dhe financim të investimeve në periudha 2 – 3 vjeçare.

**Ndikimi/Efekti:**

Mos likuidim në kohë i shpenzimeve sjell akumulim të borxhit të institucionit për fatura të palikuiduara dhe vënien në vështirësi për realizimin e objektivave në vitin vijues, pasi buxheti fillon me planifikimin e faturave kreditorë dhe faturave të planifikuara për likuidim në vitin pasardhës.

**Rëndësia:** ***I mesëm***

**Rekomandimi**

**-** Drejtoria e Financë Bashkia Shkodër, të marrë masa për sigurimin e likuiditeteve në kohë, në mënyrë që të mos krijojë kufizime limiti të arkës *(përjashtuar kufizimet e MFE)*, për likuidimin e faturave, me qëllim që të mos akumulohet borxh për fatura të palikuiduara dhe përfshirjen e institucionit në vështirësi financiare.

Gjithashtu, planifikimi i procedurave të prokurimit të jetë në raport të drejtë me fondet në dispozicion, vlerën e faturave të palikuiduara në fund të periudhës dhe vlerën e kontratave të lidhura me likuidim me këste, veprime të cilat do të ulnin vlerën e faturave të palikuiduara në fund të periudhave ushtrimore.

**-** Kryetari i Bashkinë në cilësinë e Nëpunësit Autorizues, në bashkëpunim me Drejtorin e Financës në cilësinë e Nëpunësit Zbatues dhe Drejtorin e Buxhetit, të marrin masa që në hartimin e buxheteve të viteve në vijim, të planifikojnë procedura prokurimi me fonde publike në raport të

drejtë me fondet në dispozicion, vlerën e faturave të palikuiduara në fund të periudhës dhe vlerën e kontratave të lidhura me likuidim.

- *Gjendja e faturave të palikuiduara në fund të periudhave ushtrimore*

Sipas të dhënave të paraqitura nga Bashkia Shkodër dhe nga auditim i tyre, konstatohet se gjendja e faturave të palikuiduara në fund të periudhave 2019 dhe 2020 dhe të detajuar sipas zërave është si më poshtë:

| Artikulli | Viti 2019/lekë | Viti 2020/lekë |
|---|---|---|
| 231 | 279,354,855 | 153,880,142 |
| 602 | 21,188,136 | 8,406,844 |
| 602 (vendime gjyqësore) | 30,783,253 | 30,783,253 |
| 603 | 10,000,000 | |
| 604 | 12,997,690 | 2,411,503 |
| 606 | 21,185,626 | 1,176,826 |
| **Totali** | **375,509,560** | **196,658,568** |

Nga të dhënat e pasqyrës, rezulton se gjendja e faturave të palikuiduara në fund të ***vitit 2019*** është në shumën 375,509 mijë lekë dhe në fund të ***vitit 2020*** është në shumën 196,658 mijë lekë, pra me një ulje për shumën 178,851 mijë lekë.
Në të dy periudhat peshën kryesore të faturave të palikuiduara e zënë investimet (llog 231), ku për vitin 2019 zënë 74.4% dhe për vitin 2020 zënë 78% të totalit të faturave.
Nga krahasimi i të dhënave midis gjendjes së faturave të palikuiduara në fund të periudhës sipas pasqyra financiare (2019 - 2020) dhe evidencave të dërguara në MFE mbi situatën e kreditorëve në fund të viteve, konstatohet se ka mospërputhje, ku sipas pasqyrave financiare gjendja është më e madhe se ato që i përcillet MFE, konkretisht, pasqyra:

| Nr. | EMËRTIMI | Viti 2019 | Viti 2020 |
|---|---|---|---|
| 1. | Kreditorë sipas bilancit | 375,509,823 | 196,658,568 |
| 2. | Kreditor sipas evidencave MFE | 54,532,823 | 51,304,166 |
| **Diferenca midis dy të dhënave.......** | | **320,970,000** | **145,354,402** |

*Në mënyrë analitike të dhënat paraqiten në pasqyrën Aneks 2.2/4, bashkëlidhur aktit*.

Nga krahasimi i të dhënave të analizës së faturave të palikuiduara me raportet e detyrimeve të prapambetura në MFE dhe me gjendjet e llogarive të klasës 4 në bilanc në fund të periudhave ushtrimore, rezultoi se:
*Për vitin 2019*, detyrimet e raportuara në MFE janë vlerën 54,532 mijë lekë, ndërsa në PF të vitit 2019 gjendjet e llogarive të klasës 4 të detyrimeve (pasiv bilancit) janë në vlerën 375,509 mijë lekë, pra me një diferencë prej 320,970 mijë lekë më pak në të dhënat e dërguara në MFE.
*Për vitin 2020*, detyrimet e raportuara në MFE janë vlerën 51,304 mijë lekë, në PF të vitit 2020 gjendjet e llogarive të klasës 4 të detyrimeve (pasiv bilancit) janë në vlerën 196,658 mijë lekë, pra me një diferencë prej 145,354 mijë lekë më pak në të dhënat e dërguara në MFE**.**

**-** *Mbi vendimet gjyqësore*.

Nga auditimi i dokumentacionit për detyrime për vendime gjyqësore, u konstatua Bashkia Shkodër ka detyrime të formës së prerë të palikuiduara në shumën 30,783,253 lekë të cilat janë kryesisht të ish- komunave të cilat janë në proces gjykimi të pambyllura akoma. Kështu nga vlera e konstatuar prej 68,471,153 lekë është likuiduar, në vitin 2017 në shumën 669,570 lekë, në vitin 2018 në shumën 1,347,738 lekë, në vitin 2019 në shumën 20,515,308 lekë dhe ne vitin 2020 në shumën 15,086,950 lekë. *Në mënyrë analitike të dhënat janë në pasqyrën Aneks 2.2/5, bashkëlidhur aktit.*

- *Shpronësimet për interes publik*:

Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion dhe deklarimeve verbale të kryera gjatë takimeve me strukturat përkatëse, u konstatua se bazuar në ligjin nr. 8561, datë 22/12/1999 *"Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik"*, Bashkia Shkodër, në cilësinë e subjektit në favor të të cilit bëhet shpronësimi për interes publik, për periudhën Janar 2019 deri më 31 Dhjetor 2020, paraqitet si vijon:

| Plan viti | Ministria 0 | | Ministria 6 | |
|---|---|---|---|---|
| | **2019** | **2020** | **2019** | **2020** |
| | 5,000,000 | - | 18,852,893 | 18,852,893 |
| Plan trashëguar | 22,692,235 | 27,377,614 | - | - |
| **Total Plan** | **27,692,235** | **27,377,614** | **18,852,893** | **18,852,893** |
| Fakt viti | - | - | - | 10,115,705 |
| Fakt trashëguar | 314,621 | 4,255,500 | - | - |
| **Total Fakt** | **314,621** | **4,255,500** | **-** | **10,115,705** |
| **Gjendje papërdorur** | **27,377,614** | **23,122,114** | | **8,737,188** |

Në mënyrë më të zgjeruar të dhënat paraqiten në pasqyrën Aneks 2.2/9, bashkëlidhur aktit.

***2/2.5.*** *Çelja dhe ekzekutimi i fondeve të përfituara përmes FZHR, saktësia e raportimit buxhetor të tyre;*

Nga auditimi i dokumentacioni të paraqitur nga subjekti Bashkia Shkodër, konstatohet se për periudhën 01.01.2019 – 31.12.2020, niveli i financimit të investimeve nga grande specifike dhe të kushtëzuara është shumë i ulët për vlerën 74,199 mijë lekë, *respektivisht*:

**Për vitin 2019** është financuar një objekti me vlerë 14,510,321 lekë me objekt "*Kanali ujitjes KU-21"*, me fonde nga Ministria e Bujqësisë. Ndërsa për **vitin 2020** janë financuar **2** investime, në objektin "*Rikonstruksion i godinave ne pronësi te njësive te vetëqeverisjes vendore për strehim social (ndërtim i ri ,godina sociale, me kontejner 1+1 dhe 2+1"*" me vlerë 35,571,215 lekë dhe objekti "*Rikonstruksion i godinave ne pronësi te NJVV për strehim social*" me vlerë 72,079,645 lekë, të dhëna të cilat paraqiten në pasqyrën si vijon:

**Tabela 1, viti 2019**

| Nr. | Emërtimi i objektit | Fondi i akorduar lek me TVSh | Burimi i financimit | Planifikuar për periudhën (lek me TVSh) | Vlera e prokurua r(vlera e kontratës ) | Realizimi progresiv Vlere | % | Shënime |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Rikonstruksion Blloku pallateve Xhabije | 46,519,616 | FZHR | 11,907,996 | 46,519,616 | 46,508,532 | 100 | Vijon nga 2016Likuiduar |
| 2 | Projekti" Jeto me Sportin "Rikualifikim i terreneve sportive ne shkollat Oso Kuka,B.Shkoder Ana e Malit Oblike dhe "At Gjon Kama " Gur i Zi | 14,712,175 | FZHR | 14,712,175 | 17,940,832 | 14,712,175 | 82 | Vijon nga 2018. Likuiduar pjesërisht nga Ministria |
| 3 | Projekte për përmirësimin e kushteve te banimit për komunitete te pa favorizuara | 15,222,683 | Transferta e kushtëzuar | 7,289,393 | 15,220,683 | 15,220,549 | 100 | Vijon nga 2018. Likuiduar |
| 7 | Kanali ujitës KU-21 | 14,510,321 | Transferta e kushtëzuar | 14,510,321 | 14,067,444 | 7,059,662 | 49 | Financim 2019. Likuiduar pjesërisht |
| 8 | Shpronësime | 18,852,893 | Transferta e kushtëzuar | 18,852,893 | | | | Akorduar fondi ne sistem te Thesarit me date 27.12.2019 . Nuk |

| Nr. | Emërtimi i objektit | Fondi i akorduar lek me TVSh | Burimi i financimit | Planifikuar për periudhën (lek me TVSh) | Vlera e prokuruar(vlera e kontratës) | Realizimi progresiv Vlere | % | Shënime |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | | | Disponojmë shkrese zyrtare. |

**Tabela 2, viti 2020**

| Nr. | Emërtimi i objektit | Fondi i akorduar lek me TVSh | Burimi i financimit | Planifikuar për periudhën (lek me TVSh) | Vlera e prokuruar (vlera e kontratës) | Realizimi progresiv/ Vlere | % | Shënime |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Projekti" Jeto me Sportin "Rikualifikim i terreneve sportive ne shkollat Oso Kuka,B.Shkoder Ana e Malit Oblike dhe "At Gjon Kama " Gur i Zi | 3,228,657 | FZHR | 3,228,657 | 17,940,832 | 17,940,832 | 100 | Vijon nga 2019. Likuiduar |
| 2 | Shpronësime | 18,852,893 | Min. Linjës | 18,852,893 | | 10,115,705 | 54 | Likuiduar pjesërisht |
| 3 | Rikonstruksion i godinave ne pronësi te njësive te vetëqeverisjes vendore për strehim social(ndërtim i ri ,godina sociale, me kontejner 1+1 dhe 2+1 | 35,571,215 | Min. Linjës | 35,571,215 | 35,571,215 | 35,571,215 | 100 | Likuiduar |
| 4 | Rikonstruksion i godinave ne pronësi te NJVV për strehim social | 24,117,524 | Min. Linjës | 24,117,524 | 72,079,645 | 24,117,516 | 33 | Likuiduar pjesërisht |

**Burimi:** *Nga të dhënat e Drejtorisë së Financës*

Kontratat nuk janë likuiduar sipas afateve të përcaktuara por financimi është kryer në disa fazë, kjo si rezultat i mos alokimi të fondeve nga FZHSH/ Ministritë e linjës.

- **Analizë për investimet**

Nga auditimi në lidhje me planifikimin dhe realizimin e investimeve në Bashkinë Shkodër u konstatua se:

*Për vitin 2019, me financim nga buxheti i Bashkisë dhe nga FZHR/Ministritë e linjës, janë planifikuar investime në vlerën 655,000 mijë lekë dhe realizuar në vlerën 469,449 mijë lekë ose 71.6%. Investimet me burim financimi transferta e pakushtëzuar, transferta specifike, të ardhura dhe donator janë 621,092 mijë lekë dhe janë realizuar 435,541 mijë lekë me rreth 70.1 %. Investimet me burim financimi FZHR/Ministritë e linjës (transferta e kushtëzuar) janë 33,908 mijë lekë dhe janë realizuar 33,908 lekë me rreth 100 %.

*Për vitin 2020, me financim nga buxheti i Bashkisë dhe nga FZHR/ dhe Ministritë e linjës, janë planifikuar investime në vlerën 521,058 mijë lekë dhe realizuar në vlerën 287,211 mijë lekë ose 55%. Investimet me burim financimi transferta e pakushtëzuar, transferta specifike, të ardhura dhe donator janë 458,142 mijë lekë dhe janë realizuar 224,295 lekë ose 48.9 %. Investimet me burim financimi FZHR/Ministritë e linjës (transferta e kushtëzuar), janë 62,916 mijë lekë dhe janë realizuar 62,916 lekë ose 100 %.

- *<u>Fondet e shpenzuara nga njësia vendore për shkak të situatës së "COVID-19', miratimi i tyre sipas kuadrit ligjore në fuqi</u>***.**

Mbështetur në nenin 65, të ligjit nr. 45/2019 "Për mbrojtjen civile", Bashkitë, për zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë dhe mbrojtjen civile, si dhe kryerjen e detyrave në zbatim të këtij ligji, mbështeten në parashikimin minimal prej 4 % të totalit të buxhetit vjetor të tyre, të cilat sigurohen nga fondet e kushtëzuara të buxhetit të shtetit.

Me shkresën nr. 23198/1 prot., datë 24.12.2019 të Ministrit të Financave me lëndë "Mbi parashikimin e fondeve buxhetore të emergjencave civile nga njësitë e vetëqeverisjes vendore", është kërkuar prej bashkive: "Në vijim të procesit të miratimit të buxhetit 2020 nga njësitë e vetëqeverisjes vendore, lidhur me parashikimet e fondeve për rastet e emergjencave civile në buxhetin vendor 2020, ju bëjmë me dije se: Në përputhje me nenin 65 të ligjit nr. 45/2019 "Për mbrojtjen civile", njësitë e vetëqeverisjes vendore duhet të parashikojnë nga burimet e veta të financimit për emergjencat civile, jo më pak se 1.7% të të totalit të buxhetit. Pjesa tjetër e financimit për mbrojtjen civile do të mbulohet në formën e transfertës së kushtëzuar nga buxheti qendror në vitin buxhetor 2020".
Me shkresën nr. 1650 prot., datë 24.03.2020, të Ministrit të Mbrojtjes me lëndë "Kërkesë për marrjen e masave urgjente për përdorimin e fondeve për mbrojtjen civile" (tepër urgjente), drejtuar të gjitha bashkive të vendit, thuhet " Në mbështetje të nenin 65 të ligjit nr. 45/2019 "Për mbrojtjen civile", ...bashkitë për zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë dhe mbrojtjen civile, mbështeten në parashikimin minimal prej 4% të totalit të buxhetit vjetor të tyre, të cilat sigurohen nga fondet e kushtëzuara të buxhetit të shtetit. Në këtë shkresë është kërkuar që bashkitë të raportojnë për vlerën e fondeve që kanë në dispozicion për mbrojtjen civile dhe sa për qind të buxhetit përbëjnë.
Në zbatim sa më sipër, Bashkia Shkodër duke qenë se buxhetit i vitit 2020 ishte miratuar, me Vendim të KB nr. 18, datë 23.04.2020 ka miratuar shumën prej 35,927,823, si dhe shtese me Vendim Kryetari nr. 87, date 25.03.2020 ne shumën prej 4,915,000 lekë, Vendim kryetari nr. 83, date 11.03.2020 ne shumën prej 200,000 lekë, dhe nr. 84 datë 12.03.2020 "Për miratimin e rishpërndarjes së fondeve të zërave të shpenzimeve korente, brenda të njëjtit program për vitin 2020".
Gjithashtu, ka përfunduar procesi i dy dhurimeve financiare nga UNICEF me vlerë 2,333,600 lekë i shpërndarë 553 familjeve në nevojë sipas numrit të anëtarëve.

Të dhënat e mësipërme paraqiten në pasqyrën si vijon:

| Emërtimi i shpenzimit | Plani | Realizimi |
|---|---|---|
| Blerje produkte ushqimore dhe jo ushqimore për shtresat ne nevoje | 4,915,000 | 4,915,000 |
| FV tunel dezinfektues për tregun e merkates Rus dhe Zdrale | 35,927,823 | 672,000 |
| Dezinfektues për tunel dezinfektimi | | 96,000 |
| Blerje produkte ushqimore dhe detergjente për situate emergjente | | 5,219,313 |
| Blerje tubacione dhe rekorderi për lidhjen me ujë te pijshëm te banoreve ne lagjen Mark Lula (Blloku nr.1 dhe Blloku nr.2 )për rritjen e higjienës nga rreziku i infektimit nga COVID- 19 | | 2,672,808 |
| Mbështetje financiare për familjet ne vështirësi ne kushtet e pandemisë se shkaktuar nga COVID-19 (UNICEF) | 2,333,600 | 2,333,600 |
| FV Mbrojtëse plexiglass për zyrën me një ndalës për situatën e COVID -19 | 200,000 | 95,000 |
| FV Mbrojtëse plexiglass për zyrën me një ndalës te njësive administrative dhe zyrave te ndihmës ekonomike dhe PAK për situatën e COVID -19 | | 100,800 |
| Blerje materiale dezinfektuese | 754,800 | 547,433 |
| Blerje materiale dezinfektuese | | 202,536 |
| **Totali** | **44,131,223** | **16,854,490** |

Pra, Bashkia Shkodër ka pasur në dispozicion për të shpenzuar nga fondi i emergjencave për situatën "COVID- 19", vlerën 44,131 mijë lekë, prej të cilit është shpenzuar vlera 16,854,490 lekë, sipas objekteve të mësipërme.

Nga grupi i KLSH, u auditua dokumentacioni mbi përdorimin e këtij fondi dhe rezultojë se është në përputhje me kuadrin ligjorë në fuqi. Nga pushteti qendror, **nuk ka pasur** asnjë fond mbi përballimin e situatës së pandemisë "COVID-19".

- Në lidhje me detyrimet e lindura dhe të krijuara, konstatohet se *për vitin 2019* paraqiten në shumën 375,509 mijë lekë dhe për *vitin 2020* paraqiten në shumën 196,658 mijë lekë. Këto detyrime nuk përputhem me detyrimet kreditore ndërmjet evidencave që dërgohen në MFE dhe detyrimeve sipas pasqyrave financiare 2019 dhe 2020, ku për vitin 2019 ka një mospërputhje për vlerën 320,977 mijë lekë *(sipas evidencave të MFE në shumën 54,532 mijë lekë)* dhe për vitin 2020 ka një mospërputhje në vlerën 145,354 mijë lekë *(sipas evidencave të MFE në shumën 51,304 mijë lekë)*, kjo më e lartë në pasqyrat financiare. Mos përputhje sipas Bashkisë Shkodër vjen për faktin se në të dhënat që dërgohen në MF janë vetëm kreditorët e ish- komunave të cilat janë pa shkresë pagese pasi nuk kanë dokumentacion të rregullit dhe vendimet gjyqësore në proces për të cilat nuk dihet vendimmarrja deri në përfundim të gjykimit.
Gjendja e lartë e faturave të palikuiduara në fund të periudhave, nuk shpjegon faktin e gjendjes monetare në fund të periudhave në llog. 520. Kështu në fund të periudhës së vitit 2019 në llog. 502, kemi gjendje vlerën 629,207 mijë lekë dhe në fund të periudhës së vitit 2020 gjendje në llog. 520 paraqitet në vlerën 662,041 mijë lekë (sipas pasqyrave financiare).
- Nga auditimi është konstatuar se, janë kryer procedura pas datës 15 tetor, ku për vitin 2019 janë kryer **16** procedura dhe për vitin 2020 janë kryer **35** procedura, të cilat dhe këto kanë qenë të miratuara me VKB nr. 26, datë 30.12.2019 dhe PBA 2020-2022 dhe nuk ka procedura të tjera të zhvilluara në këtë periudhë, të cilat nuk janë të miratuara në VKB ose PBA.

- **<u>Mbi zbatimin e strukturës dhe organikës së miratuar</u>**

Për periudhën objekti auditimi (01.07.2019 – 31.12.2020), struktura dhe orgaN... e Bashkisë Shkodër, janë miratuar me Vendim të Këshillit Bashkiak dhe të konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Shkodër, *respektivisht*:
**a-** Vendimi i KB nr. 82, datë 20.12.2018 "Për miratimin e buxhetit të vitit 2019 dhe programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2019-2021 të Bashkisë Shkodër *(pika 1 germa (d) për miratimin e numrit të punonjësve për **vitin 2019**),* konfirmuar nga Prefekti Qarkut Shkodër datë 07.01.2019 administruar me nr.230 prot. datë 08.01.2019
**b-** Vendimi i KB nr. 26 datë 30.12.2019 "Për miratimin e buxhetit te vitit 2020 dhe programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2020-2022 të Bashkisë Shkodër *(pika 1 germa (d) për miratimin e numrit të punonjësve për **vitin 2020** ),* konfirmuar nga Prefekti Qarkut Shkodër me shkresën nr.51/1 prot, datë 16.01.2020.
Sipas të dhënave të paraqitura Bashkia Shkodër ka gjithsej 15 drejtori dhe 31 sektorë, ku në për[bërë te të cilit për vitin 2019 janë të punësuar 327 punonjës dhe për vitin 2020 janë të punësuar 310 punonjës.
Struktura e Bashkisë Shkodër është miratuar me Vendim të Kryetarit të Bashkisë nr. 7, datë 20.01.2020 "Për miratimin e strukturës së nëpunësve dhe punonjësve të administratës dhe Institucioneve të varësisë", tabela si vijon:
**Tabelë 1.** Të dhëna për institucionet e varësisë

| Institucioni | 2019 | | 2020 | |
|---|---|---|---|---|
| | Nr. punonjësish | Me kontrate | Nr. punonjësish | Me kontrate |
| Bashkia Shkodër | 297 | 30 | 276 | 34 |
| Sport klub "Vllaznia" | 21 | | 21 | 37 |
| Teatrit 'Migjeni' | 41 | | 41 | |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| Dega Ekonomike te Kultures | 31 | | 31 | |
| Drejtoria e Kopshte - Çerdhe | 239 | | 239 | |
| Drejtoria ekonomike arsimit | 197 | | 249 | |
| Drejtoria e MZSH | 36 | | 36 | |
| Drejtoria e shërbimeve bujqësore dhe pyjore | 34 | | 34 | 10 |

Punonjës me status dhe me kontratë, paraqitet si vijon

**Tabelë 2**. Të dhëna për numrin e punonjësve për vitin 2019 -2020

| Viti | Numri total administrata | Numri i nëpunësve me status nëpunësi civil | Numri i pozicioneve të plotësuara me status NC | Numri i NC në periudhë prove | Numri i pozicioneve vakante me status NC | Numri i punonjësve me kontratë ( punonjës mbështetës) | Nr. Të zgjedhur , te emëruar |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 2019 | 310 | 191 | 170 | 5 | 16 | 104 | 15 |
| 2020 | 327 | 191 | 170 | 5 | 16 | 121 | 15 |

Konstatohet se për periudhën objekt auditimi, nuk u konstatua tejkalimi i numrit të punonjësve të miratuar me VKB, referuar listëpagesat përkatëse të audituara, të përcaktuara nga grupi i auditmit dhe vënë në dispozicion, respektivisht periudhat; Mars – Qershor 2019, Tetor – Dhjetor 2019 dhe Janar – Prill 2020.
Nga Bashkia Shkodër, janë zbaruar kërkesat e VKM nr. 117, datë 5.3.2014 "Për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrit qendror të personelit". Janë hapur librat e pagave, si dhe janë plotësuar me te gjithë elementet, page bruto dhe ndalesat përkatëse për secilin punonjës.
Listëpagesat janë plotësuar nga punonjësi i caktuar për pagat, duke u mbështetur në të dhënat e dokumentacionit bazë *(Listëprezencat të cilat janë të firmosura nga përgjegjësit e zyrave),* specialisti i pagave, përgjegjësi i financës, nga punonjësi i burimeve njerëzore dhe nga Kryetari i Bashkisë.
Referuar të dhënave të Drejtorisë së Burimeve Njerëzore Bashkia Shkodër, në lidhje me numrin e pozicioneve me status të Nëpunësit Civil, *u konstatua se*:
Në Bashkinë Shkodër janë vlerësuar me status të Nëpunësit Civil, gjithsej **201** pozicione, *nga të cilat*:
*a-* Pozicion i kategorisë së lartë *asnjë,*
*b-* Pozicione të kategorisë së mesme drejtues *15 pozicione*;
*c-* Pozicione të kategorisë së ulët drejtues, *31 pozicione*;
*d-* Pozicione të kategorisë ekzistuese, *155 pozicione*.
Pozicione të lira, gjithsej 15 pozicione, *konkretisht*:
*e-* Pozicione të kategorisë së mesme drejtues, *0 pozicione*;
*f-* Pozicione të kategorisë së ulët drejtues, *2 pozicione*;
*g-* Pozicione të kategorisë ekzistuese, *0 pozicione*
*h-* Janë në periudhë prove, gjithsej *13 punonjës.*

*- Lëvizjet e punonjësve të Bashkisë Shkodër, periudha 01.01.2019 -31.12.2020*
Nga auditimi i dokumentacionit të paraqitur mbi lëvizjet e punonjësve të Bashkisë Shkodër, të dhënat janë paraqitur në pasqyrën si vijon:

| Periudha | Largimet | Arsyeja | Emërimet | Procedura e ndjekur |
|---|---|---|---|---|
| Viti 2019 | 14 | -Lirim me dëshirë/-Dalje në pension/-Me masë disiplinore | 17 | Komision disiplinor |
| Viti 2020 | 6 | -Lirim me dëshirë/-Dalje ne pension | 11 | |

***Burimi**: Pasqyra hartuar nga grupi KLSH sipas të dhënave të Drejt/Burimeve Njerëzore*

Nga auditimi i procedurave të marrjes në punë të punonjës me status dhe kontratë, ku nga **28** praktika u audituan **8** praktika ose 30% e tyre, u konstatua se aktet e emërimit/largimit dhe lëvizjeve brenda institucioni, në pozicione pune të punonjësve me status të Nëpunësit civil, janë në zbatim të nenit 22, të ligjit nr. 152/2013, datë 30/05/2013 "Për Statusin e Nëpunësit Civil' i ndryshuar dhe Kreut II, IV dhe VI të VKM nr. 243, datë 18.3.2015.

*- Auditim mbi zbatimin e dispozitave ligjore në kryerjen e pagesave për pagat e punonjësve, shtesat mbi to , shpërblimeve.*

Nga Bashkia Shkodër, është mbajtur dhe përditësuar libri dhe ditari i pagave. Ato hartoheshin sipas standardeve të kontabilitetit, ku plotësoheshin pagat me të gjithë elementet dhe shtesa të ndryshme të përfituara deri tek shuma bruto. Po kështu pasqyroheshin llojet e ndalesave deri tek paga neto. Përmbledhëset janë të kundruar me listë pagesat dhe me urdhër pagesat respektive, të nënshkruara nga punonjësi i financës dhe titullari.

Për të gjithë periudhën e kontrolluar, janë përllogaritur, ndaluar dhe xhiruar detyrimet për kontributin e sigurimeve shoqërore dhe tatimin mbi të ardhurat. Janë respektuar strukturat organike të miratuara përsa i përket numrit të punonjësve si dhe janë respektuar dispozitat ligjore për kohëzgjatjen e punës.

*- Auditim mbi zbatimin e dispozitave ligjore në kryerjen e ndalesave për tatimin mbi të ardhurat personale , për detyrimin ndaj sigurimeve shoqërore e shëndetësore , xhirimi ne favor të buxhetit të shtetit***.**

Nga auditimi në tërësi i listpagesave për periudhën e audituar *(Janar – Prill 2018, Nëntor – Dhjetor 2018; Mars – Qershor 2019, Tetor – Dhjetor 2019 dhe Janar – Prill 2020)*, u konstatua se llogaritja dhe ndalesat për kontributin e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore dhe tatimin mbi të ardhurat personale janë në zbatim të ligjit nr. 7703,datë 11/05/1993"Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar , ligjit nr. 7870, datë 13/10/1994 "Për sigurimet shëndetësore në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar si dhe ligjit nr.8438,datë 28.12.1998"Për tatimin mbi të ardhurat" i ndryshuar.

*- Mbulimi me fonde i pagave të punonjësve sipas periudhave***.**

Sipas të dhënave mbi mbulimin me fondet e planifikuara për paga, të dhënat paraqiten në pasqyrën si vijon:

| Periudha ushtrimore | Fonde gjithsej *Në 000/lekë* | E ndarë | | % që zë Bashkia | % që zë Grandeve |
|---|---|---|---|---|---|
| | | *Me të ardhurat e Bashkisë në 000/lekë* | *Me fondet e buxhetit shtetit (grande), në 000/lekë* | | |
| Viti 2019 | 635,527 | 95,216 | 540,310 | 15 | 85 |
| Viti 2020 | 636,864 | 67,301 | 569,562 | 11 | 89 |

Nga të dhënat e pasqyrës, konstatohet se me fondet e veta Bashkia Shkodër mbulon nga 11 - 15% të fondit të pagave, ndërsa diferenca mbulohet me grandet e ardhura nga Pushteti Qendror.

- **<u>Opinion mbi performancës e reformës territoriale në fondin e pagave</u>**.

Nga përpunimi i të dhënave mbi numrin e punonjësve dhe fondin e pagave para dhe pas reformës territoriale, për të parë efektivitetin e kësaj reforme, konstatohet se referoma territoriale nuk ka dhënë efektin e duhur për të cilën ajo u bë, pasi si numri i punonjësve dhe fondi i pagave është në rritje duke krahasuar dy periudhat, konkretisht kemi një rritje prej 18 punonjës dhe një fond për 4,438 mijë lekë, pasqyra:
Pasqyra e punonjësve para dhe pas reformës territoriale.

**Të dhënat para reformës (15.8.2015**

| Njësia Administrative | 31 Gusht 2015 | |
|---|---|---|
| | Nr. | Paga Bruto mujore |
| Bashkia Shkodër | 162 | 7,582,086 |
| Komuna Ana Malit | 10 | 347,442 |
| Komuna Dajç | 16 | 549,417 |
| Komuna Velipoje | 28 | 1,015,366 |
| Komuna Postribe | 15 | 645,117 |
| Komuna Shale | 18 | 560,686 |
| Komuna PULT | 20 | 487,588 |
| Komuna Shosh | 10 | 284,921 |
| Komuna Guri i Zi | 22 | 782,494 |
| Komuna Rrethina | 51 | 1,483,914 |
| Komuna Berdice | 14 | 539,194 |
| Gjendje Civile | 10 | 504,160 |
| **SHUMA** | **376** | **14,782,385** |

**Të dhënat pas reformës (31.03.2021)**

| Nr. | Emërtimi | Nr. punojnë | Paga Bruto mujore |
|---|---|---|---|
| 1 | Administrata | 271 | 14,240,513 |
| 2 | Policia Bashkiake | 24 | 1,050,542 |
| 3 | Shërbime publike | 28 | 1,012,120 |
| 4 | Shërbimi i Ndriçimit | 9 | 300,900 |
| 5 | Qendra Komunitare | 10 | 518,493 |
| 8 | Shërbime publike | 30 | 899,400 |
| 9 | Gjendje Civile | 20 | 1,094,900 |
| 10 | QKR | 2 | 103,600 |
| | **SHUMA** | **394** | **19,220,468** |

*(Më hollësisht problemet janë trajtuar në faqen 22-44, të Projektraport Auditimit)*

***III/2.2.6.*** **Burimi i krijimit të të ardhurave bazuar në kuadrin rregullator ligjor/nënligjor në fuqi. Vlerësimi i mbledhjes së të ardhurave në përputhje me dispozitat ligjore dhe borxhi tatimor***;*

- *<u>Përdorimi i të ardhurave vjetore sipas klasave</u>*.

| Emërtimi | Fakt 2019 | | | |
|---|---|---|---|---|
| | Gjithsej | Tr.Pakushtezuar dhe Specifike | Te ardhurat e Veta | Transferta e Kushtëzuar |
| 600-Paga | 545,372 | 444,410 | 81,915 | 19,047 |
| 601-Sigurime Shoqërore | 90,155 | 74,481 | 13,301 | 2,372 |
| 602-Shpenzime Operative | 637,403 | 270,615 | 356,801 | 9,986 |
| 603-Subvencion | 25,000 | | 25,000 | |
| 604-Transferta Brendshme | 119,616 | 88,561 | 24,191 | 6,864 |
| 606-Transferta Buxh.Fam.Ind | 848,077 | 1,366 | 2,546 | 844,166 |
| 230-Projekte | 22,719 | 900 | 21,269 | 550 |
| 231-Investime | 609,647 | 143,969 | 417,715 | 47,964 |
| **SHUMA……** | **2,897,989** | **1,024,303** | **942,738** | **930,949** |
| | | | | |
| **Emërtimi** | **Fakt 2020** | | | |

| | Gjithsej | Tr.Pakushtezuar dhe Specifike | Te ardhurat e Veta | Transferta e Kushtëzuar |
|---|---|---|---|---|
| 600-Paga | 545,304 | 470,810 | 59,890 | 14,604 |
| 601-Sigurime Shoqërore | 91,560 | 81,717 | 7,411 | 2,431 |
| 602-Shpenzime Operative | 552,511 | 242,866 | 305,667 | 3,978 |
| 603-Subvencion | 10,000 | | 10,000 | |
| 604-Transferta Brendshme | 114,963 | 55,492 | 52,439 | 7,033 |
| 606-Transferta Buxh.Fam.Ind | 1,014,470 | 1,252 | 790 | 1,012,428 |
| 230-Projekte | 19,691 | 86 | 19,103 | 502 |
| 231-Investime | 425,959 | 122,044 | 229,522 | 74,392 |
| **SHUMA……** | **2,774,458** | **974,268** | **684,821** | **1,115,369** |

Nga të dhënat e tabelës, konstatohet se për vitin 2019 me të ardhurat e veta Bashkia Shkodër ka mbuluar 32.5% të shpenzimeve, kurse për vitin 2020 ka mbuluar 24.6% të shpenzimeve totale. Zërin investime për vitin 2019, nga 609,647 mijë lekë janë mbuluar me të ardhurat e veta 417,715 mijë lekë ose 68.4%. Ndërsa për vitin 2020 nga vlera 425,959 mijë lekë ka mbuluar 229,522 mijë lekë ose 53.8%. Pra shikohet se mbulimi i investimeve me të ardhurat e veta është në ulje dhe kjo nga niveli i realizmit të të ardhurave. *Më e detajuar në pasqyrën Aneks 2.2/6, bashkëlidhur akt-konstatimit.*

*- Strukturat për administrimin dhe mbledhjen e taksave dhe tarifave vendore*
Për vitin 2019 me Vendim të KB nr. 82, datë 20.12.2018 “Për miratimin e buxhetit të vitit 2019 dhe programin buxhetor afatmesëm përfundimtarë 2019 – 2021”, në pikën 1/d të këtij vendimi është miratuar numri i punonjësve, konfirmuar nga Prefekti Qarkut Shkodër me shkresën nr. 230, datë 08.01.2019. Me vendim të Kryetarit të Bashkisë nr. 6, datë 03.01.2019 është miratuar struktura organizative sipas drejtorive/sektorëve.
Me vendim të KB nr. 26, datë 30.12.2019 “Për miratimin e buxhetit të vitit 2020 dhe programin buxhetor afatmesëm përfundimtarë 2020 - 2022”, në pikën 1/d të këtij vendimi është miratuar numri i punonjësve, konfirmuar nga Prefekti Qarkut Shkodër me shkresën nr. 51/1, datë 16.01.2020.
Me vendim të Kryetarit të Bashkisë Shkodër nr. 7, datë 20.01.2020 dhe në referencë të numrit total të punonjësve të miratuar në VKB është miratuar struktura organizative sipas drejtorive/sektorëve, ku janë të detajuar dhe punonjësit për secilën nga drejtoritë, ku bën pjesë dhe Drejtoria e të Ardhurave Vendore, si më poshtë vijon:
- Drejtoria e të Ardhurave Vendore (*këtu e vijim DAV Bashkia Shkodër)*, ka në strukturën e saj **30 punonjës** dhe është e ndarë në katër sektorë: Sektori i Regjistrimit dhe Vlerësimit të Biznesit, Sektori i Regjistrimit dhe Vlerësimit të Taksave dhe Tarifave për Individin, Sektori i Kontabilizimit dhe Rakordimit të të Ardhurave dhe Njësia e Inspektimit Tatimor dhe Kundërvajtjeve Administrative, respektivisht pasqyra:

| Nr. | Emri Mbiemri | Funksioni Sipas Strukturës | Lloji i shkollës | Larte ose i mesëm | Urdhri i emërimit Nr., datë | Urdhri largimit Nr., datë |
|---|---|---|---|---|---|---|
| a | b | 1 | 2 | 3 | 4 | 5 |
| 1 | GJ.K. | Drejtor | Juridik | I lartë | 22.09.2020 e vijim | |
| | D.K. | Ish-drejtor | ekonomist | I larte | Deri 22.9.2020 | Këshill kabinet |
| **Sektori i Regjistrimit dhe Vlerësimit të Biznesit** | | | | | | |
| 2 | E.K. | Përgjegjës | Ekonomik | I larte | 43; 04.07.2007 | |
| 3 | L.B. | Specialist | Ekonomik | I lartë | 79; 03.08.2009 | |

| Nr. | Emri Mbiemri | Funksioni Sipas Strukturës | Lloji i shkollës | Larte ose i mesëm | Urdhri i emërimit Nr., datë | Urdhri largimit Nr., datë |
|---|---|---|---|---|---|---|
| a | b | 1 | 2 | 3 | 4 | 5 |
| 4 | F.M. | Specialist | Juridik | I lartë | 72; 23.08.2007 | |
| 5 | P.P. | Specialist | Financë Kontabilitet | I lartë | 491; 01.08.2016 | |
| **Sektori i Taksave dhe Tarifave Familjare** | | | | | | |
| 6 | F.K. | Përgjegjës | Financë | I lartë | 243; 10.05.2016 | |
| 7 | E.B. | Specialist | Financë Kontabilitet | I lartë | 497; 01.08.2016 | |
| 8 | G.S. | Specialist | Administrim Biznes | I lartë | 316; 22.08.2017 | |
| **Sektori i Kontabilitetit dhe rakordimit të të ardhurave** | | | | | | |
| 9 | F.D. | Përgjegjës | Administrim Biznes | I lartë | 245; 10.05.2016 | |
| 10 | G.S. | Specialist | Financë Kontabilitet | I lartë | 40; 27.04.2015 | |
| 11 | E.P. | Specialist | Administrim Biznes | I lartë | 496; 01.08.2016 | |
| **Sektori i Kontrollit, Verifikimit dhe Masave Shtrënguese** | | | | | | |
| 12 | A.B. | Inspektor | Marketing Turizëm | I lartë | 55; 16.07.2007 | |
| 13 | B.G. | Inspektor | Financë | I lartë | 61; 16.07.2007 | |
| 14 | E.Z. | Inspektor | Ekonomik Turizëm | I lartë | 6; 24.01.2008 | |
| 15 | F.B. | Inspektor | Financë Kontabilitet | I lartë | 17; 27.01.2020 | |
| 16 | A.O. | Inspektor | Administrim Biznes | I lartë | 19; 27.01.2020 | |
| 17 | K.M. | Inspektor | Ekonomik Turizëm | I lartë | 607/5; 01.09.2016 | |
| 18 | I.M. | Inspektor | Ekonomi Agrare | I lartë | 607/6; 01.09.2016 | 5/ 01.03.2021 |
| 19 | G.N. | Inspektor | Ekonomi Agrare | I lartë | 492; 01.08.2016 | |
| 20 | G.B. | Inspektor | Administrim Biznes | I lartë | 72; 11.02.2016 | |
| 21 | S.D. | Inspektor | Administrim Biznes | I lartë | 493; 01.08.2016 | |
| 22 | F.B. | Inspektor | Financë Kontabilitet | I lartë | 490; 01.08.2016 | |
| 23 | E.L. | Inspektor | Juridik | I lartë | 680; 15.09.2016 | |
| 24 | I.RR. | Inspektor | Juridik | I lartë | 18; 27.01.2020 | |
| 25 | E.D. | Inspektor | Administrim Biznes | I lartë | 489; 01.08.2016 | |
| 26 | E.P. | Inspektor | Juridik | I lartë | 817; 28.12.2016 | |
| 27 | F.K. | Inspektor | Ekonomi Agrare | I lartë | 533; 01.08.2016 | |
| 28 | I.D. | Inspektor | Ekonomik | I lartë | 12; 10.02.2005 | |
| 29 | Z.L. | Inspektor | Juridik | I lartë | 169; 01.06.2017 | |
| 30 | F.M. | Specialist | Finance Bankë | I lartë | 16; 27.01.2020 | |

**1. Titulli gjetjes:** *Struktura organizative e Drejtorisë së Taksave Vendore.*

**Situata:**

**-** Nga të dhënat, konstatojmë se struktura e DAV Bashkia Shkodër ka probleme dhe nuk është në funksion të realizmit e të ardhurave, pasi evidentohet mos krijimi i Sektorit të Masave Shtrënguese si një nga sektorët më të rëndësishëm në DAV Bashkia Shkodër, pasi evidentohet se një numër i lartë i detyrimeve të paarkëtuara (debitor), gjithsej **20478** subjekte/abonentë familjarë për vlerën **1,174,117** mijë lekë, *nga e cila:* subjekte fizik/juridik dhe institucioni shtetërore për 13886 subjekte me vlerë 596,442 mijë lekë dhe abonentë familjarë për 6592 familje me vlerë 596,442 mijë lekë. Alternim i këtij sektori në përbërje të Sektorit të Kontrollit Terren është i papërshtatshëm, kjo nisur nga fakti se kanë natyra të ndryshme pune dhe se arkëtimi i debitorëve është procedurë më vete dhe afate të përcaktuara.

- Gjithashtu në strukturën organizative të DAV Bashkia Shkodër, konstatohet se ka mungesë Përgjegjësit të Sektorit të Kontrollit në Terren dhe në përbërë të tij të jetë i punësuar 2 specialist me profil ing. Urbanist për evidentimin e sipërfaqeve të hapësirave publike të lokaleve, plazheve

si dhe të ndërtesave gjatë punës kontrollues në terren, pasi evidentohet raste të shfrytëzimit ose mos deklarimit të sipërfaqeve dhe nuk llogaritet detyrimet fiskale për këto mos deklarime, kjo për mungesë stafi.

**Kriteri:**

Në përputhje me pikën (ç) të nenit 5 të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore" i ndryshuar dhe në Kreun XI- "*Mbledhja me forcë e detyrimit tatimor të papaguar",* nenet 88 – 104, të ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008 "Për Procedurat Tatimore në RSH" me ndryshime.

**Ndikimi/Efekti:**

Mungesa e stafit dhe mos përshtatja e strukturës më natyrën e menaxhimit të të ardhurave, çojnë në mos realizim të të ardhurave dhe mungesë të tyre në buxheti e Bashkisë Shkodër.

**Shkaku:**

Mos njohja e kuadrit ligjorë për ,menaxhimit e të ardhurave nga instancat drejtues Bashkia Shkodër.

**Rëndësia: i lartë**

**Rekomandimi:**

Kryetari i Bashkisë Shkodër në bashkëpunim me Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse, të marrë masa për plotësimin e stafit të DAV Bashkia Shkodër me specialit të fushës dhe përshtatja e strukturës sipas natyrës së menaxhimit të të ardhurave, duke krijuar Sektorin e Menaxhimit të Borxhit.

- *Parashikimi dhe realizimi i taksave dhe tarifave vendore sipas llojeve për periudhën 01.01.2019 – 31.12.2020*

Nga auditimi i dokumentacionit të paraqitur, u konstatua se:

**Për vitin 2019**, niveli i të ardhurave është miratuar me Vendim të KB nr. 79, datë 04.12.2018 dhe **për vitin 2020** është miratuar me Vendim të KB nr. 25, datë 20.12.2019, vendime këto të konfirmuara dhe nga Prefektura e Qarkut Shkodër.

Gjithashtu gjatë vitit 2020, si rezultat i situatës së pandemisë "COVID-19", që përfshiu gjithë botën, Bashkia Shkodër ka marrë vendim për uljen nivelit të të ardhura sipas Vendimit të KB nr. 25, datë 26.06.2020.

**Ndikimi në të ardhurat e Bashkisë Shkodër nga zbatimi i këtij vendimi kap vlerën prej 20,119 mijë lekë, e cila është minus nga planifikimi dhe mungesë në realizmin e të ardhurave të kësaj njësie për vitin 2020.**

Parashikimi për të ardhurat vendore është pjesë e parashikimeve buxhetore, duke u përgatitur fillimisht në formë relacioni nga Drejtoria e të Ardhurave Vendore. Niveli i realizimit të të ardhurave për periudhën 2019 – 2020, paraqitet në pasqyrën Aneks 2.6/1, bashkëlidhur Projektraport Auditmit..

Nga të dhënat e pasqyrës konstatohet se si plani dhe fakti (arkëtimi) kanë një rritje nga njëra periudhë në tjetër, **por jo në nivelet dhe mundësitë** që ka kjo bashki, të cilat grupi i auditimit është shprehur më poshtë.

**Për vitin 2019**, të ardhurat paraqiten me një realizim në masë 92.5%, ku nga 692,100 mijë lekë të planifikuar është arkëtuar vlera prej 640,6646 mijë lekë. **Për vitin 2020**, të ardhurat paraqiten me një realizim në masë 82%, ku nga vlera e rekomanduar prej 796,517 mijë lekë është arkëtuar vlera prej 653,145 mijë lekë. Për vitin 2020 ndikim në mos realizim ka dhe situata e pandemisë "COVID-19".

Nga të dhënat e pasqyrës, konstatohet se me mos realizim në vitin 2020 paraqiten zërat taksa e pasurisë (ndërtesa) në masën 86%, taksa e tabelë/reklamë në masën 44.9%, si dhe taksa nga ndërtimet e reja (legalizimi) në masën 37.6%.
Gjatë auditimit është konstatuar se taksa e banesave të reja dhe taksa e reklamë/tabelë, paraqitet me ulje nga njëra periudhë në tjetër (2019/2020), për vlerën 27,522 mijë lekë, ulje kjo e paargumentuar nga DAV Bashkia Shkodër, pasi nisur dhe nga të dhënat numri i subjekteve me mbyllje është më ulët se subjekteve të hapura, si dhe mungesa e PV që subjektet kanë hequr/shembur sipërfaqet e banesave dhe reklamave, **vlerë kjo e cila konsiderohet e ardhur e munguar në buxhetin e Bashkisë Shkodër,** konkretisht tabela:

*Në 000/lekë*

| Emërtimi | Fakti 2019 | Fakti 2020 | Diferenca |
|---|---|---|---|
| Ndërtesa banimi dhe tjera | 142,136 | 117,505 | 24,631 |
| Taksa tabela dhe reklame | 10,022 | 7,131 | 2,891 |
| **TOTALI** | **152,158** | **124,636** | **27,522** |

- <u>*Administrimi i taksave:*</u>

Administrimi i taksave vendore bëhet me program, ku janë të pasqyruara regjistrat, sipas aktiviteteve, njoftim detyrimet dhe pagesat, kjo si për subjektet fizik/juridik dhe abonentët familjarë. Nga të dhënat që kërkohen për auditim, konstatohet që programi është i saktë, pasi në informacionet që kërkohen të dhënat dalin të analizuara për çdo zë tatimor që DAV Bashkia Shkodër aplikon. Pasqyrimi i të dhënave fillon me çelje si debitor. Kamatëvonesat rigjenerohen nga sistemi në fund të çdo periudhe**.**
Referuar të dhënave të marra nga DAV Bashkia Shkodër, situata e lëvizjes së subjekteve paraqitet si më poshtë:

| Nr. | Lloji Biznesit | Viti | Gjendja ne fillim vit | Regjistrime te reja | Mbyllje aktiviteti | Gjendja në fund te vitit |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Biznesi Vogël | *2018* | 3826 | 1330 | 1512 | 3644 |
| | | *2019* | 3644 | 1123 | 1116 | 3651 |
| | | *2020* | 3651 | 911 | 880 | 3682 |
| 2 | Biznesi Madh | *2018* | 937 | 325 | 334 | 928 |
| | | *2019* | 928 | 246 | 235 | 939 |
| | | *2020* | 939 | 216 | 189 | 966 |
| 3 | Ambulant | *2018* | 101 | 16 | 25 | 92 |
| | | *2019* | 92 | 71 | 17 | 146 |
| | | *2020* | 146 | 5 | 14 | 137 |
| 4 | OJF | *2018* | 138 | 14 | 16 | 136 |
| | | *2019* | 136 | 12 | 29 | 119 |
| | | *2020* | 119 | 14 | 10 | 123 |
| 5 | Institucione | *2018* | 53 | 3 | 4 | 52 |
| | | *2019* | 52 | 2 | 0 | 54 |
| | | *2020* | 54 | 0 | 3 | 51 |
| **Gjithsej** | | **2018** | **5055** | **1688** | **1891** | **4852** |
| | | **2019** | **4852** | **1454** | **1397** | **4909** |
| | | **2020** | **4909** | **1146** | **1096** | **4959** |

**Konstatimi:** Nga të dhënat e pasqyrës, konstatohet se në periudhën 2019 – 2020 numri i subjekteve të reja është më i lartë se subjekteve të mbyllura. Kjo tregon se të dhënat e mëposhtme që do trajtojnë në lidhje me planifikimin e taksave e tarifave vendore nuk ka ndikim nga lëvizja e subjekteve, pasi numri i subjekteve të reja është më i lartë se ato të mbyllura, pavarësisht faktit se situata në terren mund të jetë ndryshe ku ka dhe subjekte të cilat nuk janë të regjistruara dhe ushtrojnë aktivitet pa ju nënshtruar detyrimeve fiskale dhe bërë konkurrencë të pandershme me subjektet të cilat janë të regjistruar dhe paguajnë detyrime fiskale. Kështu në fund të vitit 2020 ushtrojnë aktivitet në Bashkinë Shkodër, gjithsej 4959 subjekte, *nga të cilat:* subjekte të biznesit të vogël janë 3682 subjekte, subjekte juridik janë 966 subjekte, ambulant 137 subjekte, OJF janë 123 subjekte dhe Institucioni Shtetërorë janë 51 subjekte.

Nga të dhënat në lidhje me detyrimet dhe arkëtimet e vitit të subjekteve fizik dhe juridik, kemi këtë situatë, pasqyra:

*Në 000/lekë*

| EMERTIMI | Detyrimet e aplikuara viti 2019 | | Arkëtuar për vitin 2019 | | Mbetja me 31.12.2019 | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | Nr. | Vlere | Nr. | Vlere | Nr. | Vlere |
| Subjekte juridik | 1061 | 149,896 | 825 | 115,359 | 236 | 34,537 |
| Subjekte fizik | 4894 | 217,368 | 3819 | 182692 | 1075 | 34,676 |
| Institucioni Shtetërore | 63 | 274,843 | 52 | 263893 | 11 | 10,950 |
| Abonentë familjare | 39545 | 250,654 | | 120,829 | 39945 | 129,824 |
| | **45563** | **892,761** | **4696** | **682,773** | **41267** | **209,987** |

| EMERTIMI | Detyrimet e aplikuara viti 2020 | | Arkëtuar për vitin 2020 | | Mbetja me 31.12.2020 | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | Nr. | Vlere | Nr. | Vlere | Nr. | Vlere |
| Subjekte juridik | 1069 | 171,656 | 783 | 134,633 | 286 | 37,023 |
| Subjekte fizik | 4691 | 169,643 | 3205 | 135,200 | 1486 | 34,443 |
| Institucioni Shtetërore | 67 | 309,622 | 57 | 284,950 | 10 | 24,672 |
| Abonentë familjare | 41308 | 254,460 | | 119,283 | 41308 | 135,177 |
| | **47135** | **905,381** | **4045** | **674,066** | **43090** | **231,315** |

**Burimi**: *Të dhëna nga DAV Bashkia Shkodër*

Nga të dhënat e pasqyrës, konstatohet se numri i subjekteve dhe vlera debitorë në fund të periudhës 2020 vjen në rritje në krahasim me vitin 2019, kjo për 1823 subjekte me vlerë 21,328 mijë lekë, **veprime të cilat tregojnë për një punë jo sistematike të DAV Bashkia Shkodër.**

- **Analiza e disa nga zërave fiskal të ndjekur nga DAV Bashkia Shkodër**

**- Tatimi i thjeshtuar mbi fitimin**. Sipas të dhënave të pasqyrës, kjo taksë *për vitin 2019* është realizuar në masën 129%, ose nga 5,400 mijë lekë të planifikuar është arkëtuar vlera 6,991 mijë lekë. *Për vitin 2019,* është realizuar në masën 123.%, ku nga 7,500 mijë lekë është arkëtuar vlera 9,280 mijë lekë. Menaxhimi i kësaj takse behet me agjent tatimor (Drejtoria Rajonale Tatimore Shkodër).
Nga të dhënat konstatohet se rakordimet bëheshin çdo muaj dhe vetëm për arkëtimet dhe nuk kishin rakordime sa është vlera që pritet të merret dhe sa është marrë nga kjo vlerë. DAV Bashkia Shkodër nuk kishte asnjë të dhënë se sa është numri i subjekteve që duhet të paguajnë tatim fitim të thjeshtuar (si vjetor), sa nga këto subjekte kanë paguar dhe sa nuk kanë paguar, sa është numër i subjekteve që hyjnë dhe dalin nga kjo zë tatimor, **veprime këto të cilat kanë çuar në mos**

**planifikimin e saktë të kësaj takse, për të cilën ngarkohen me përgjegjësi strukturat e DAV Bashkia Shkodër.**

**-Taksa mbi ndërtesat.** Nga të dhënave të pasqyrës, rezulton se **për vitin 2019** është realizuar në masën 104.16%, ose nga 153,912 mijë lekë të planifikuar është arkëtuar vlera 160,312 mijë lekë. Ndërsa **për vitin 2020**, është realizuar në masën 78.9%, ku nga vlera 171,666 mijë lekë të planifikuara është arkëtuar vlera 135,535 mijë lekë, pra më pak për shumën 36,131 mijë lekë.

**2. Titulli gjetjes:** *Mos aplikim i saktë i taksës së ndërtesës.*

**Situata:**

Referuar Vendimit të KB për paketën fiskale, u konstatua se taksa e ndërtesës për familjarët në mungesë të dokumentacionit ligjorë (genplani për sipërfaqet ose të dhënave nga ASHK) është lënë 100 $m^2$, mbi të cilën janë aplikuar tarifat sipas ligjit (çmim/$m^2$). Kjo mënyrë e aplikimit të taksës së ndërtesës për familjarët, favorizon disa dhe penalizon disa të tjerë, pasi pas viteve 90 ka shumë ndërtime me sipërfaqe mbi 100 $m^2$ *(2 dhe 3 kate)*, të cilat nuk janë identifikuar, duke bërë që ndajë tyre të mos aplikohet saktë taksa e ndërtesës, veprime të cilat çojnë në mungesë të ardhurave nga kjo takes.

Referuar të dhënave të marra nga Drejtoria e Planifikim Zhvillim Territorit (PZHT) Bashkia Shkodër, u konstatua të jenë dhënë këto leje ndërtimi/ zhvillimi, pasqyra:

| HOTELE LEJE 2016-2021 | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| **Emërtimi objekti** | **Lloj** | **Nr. Leje./ndërtimi** | **Investitori** | **Sip ndërti-more** | **Certifikuar** |
| Rikonstruksion + Shtesë horizontale+parkim | Hotel | 120, dt. 23.06.2017 | “S...” | 4259 | jo |
| Hotel 3 kt + Nënçati+Parkim | Hotel | 218, dt. 03.10.2017 | "C..." (B.Ç.) | 1562 | po |
| Hotel 3 kt + Nënçati + Podrum | Hotel | 60, dt. 24.10.2016 | A... | 908 | po |
| Hotel 3 kt + Nënçati + Podrum | Hotel | 190, dt. 12.09.2017 | P... L.A. | 430 | po |
| Hotel 6 kt + Podrum | Hotel | 398, dt. 23.10.2018 | V... “A...” | 3431 | jo |
| Hotel 4 kt | Hotel | 52, dt. 03.03.2020 | D.../“N...” | 595.5 | po |

Referuar të dhënave të DAV Bashkia Shkodër, për një pjesë nuk ishte llogaritur saktë taksa e ndërtesës me pretendimin që nuk ushtronin aktivitet, **por që nuk u paraqitën dokumentacion argumentues të këtij fakti.**

Ndërsa për një pjesë taksa e ndërtesës nuk ishte llogaritur për gjithë sipërfaqen që ato kanë në administrim, për të cilën grupi i KLSH sipas të dhënave mbi llogaritjen e taksës së ndërtesës të aplikuar në Bashkinë Shkodër, bëri rillogaritje si për rastet kua ato nuk janë aplikuar fare dhe për rastet kur aplikimi është bërë për një sipërfaqe më të vogël, si më poshtë vijon:

| Emërtimi | Investitori | Sip/m2 | Çmimi sipas Bashkisë | Vlera e taksa për pagës viti 2020 |
|---|---|---|---|---|
| Rikonstruksion + Shtesë / horizontale+parkim | “S...” shpk | 4259 | 5.22 | 22,232 |
| Hotel 3 kt + Nënçati+Parkim | "C..." ShPK | 1562 | 174 | 271,788 |
| Hotel 3 kt + Nënçati + Podrum | A... | 908 | 174 | 157,992 |

| Emërtimi | Investitori | Sip/m2 | Çmimi sipas Bashkisë | Vlera e taksa për pagës viti 2020 |
|---|---|---|---|---|
| Hotel 3 kt + Nënçati + Podrum | P... | 430 | 174 | 74,820 |
| Hotel 6 kt + Podrum | V... | 3431 | 5.22 | 17,910 |
| Hotel 4 kt | D... | 595.5 | 174 | 103,617 |
| **SHUMA** | | | | **648,359** |

**Burimi:** *Nga DPZH, DAV dhe çmimet sipas paketës fiskale.*

Nga DAV Bashkia Shkodër nuk është llogaritur saktë taksa e ndërtesës për objektet me leje ndërtimi/ dhe ose shfrytëzimi, kjo sipas të dhënave të marra në DPZHT për **6** subjekte, **duke krijuar të ardhura të munguara në buxhetin e Bashkisë Shkodër në shumën 648,359 lekë për vitin 2020.**

**Kriteri:**,

Në kundërshtim me nenet 20, 21 dhe 22, të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 "Për Taksat vendore" i ndryshuar dhe pikës 4[13] të VKM nr. 132, datë 7.3.2018 "Për metodologjinë për përcaktimin e vlerës së taksueshme të pasurisë së paluajtshme "ndërtesa", e bazës së taksës për kategori specifike, natyrën dhe prioritetin e informacionit dhe të dhënave për përcaktimin e bazës së taksës, si dhe të kritereve dhe rregullave për vlerësimin alternativ të detyrimit të taksës".

**Ndikimi/Efekti:**

Mos aplikimi i saktë i taksës së ndërtesës, çon në mungesë të ardhurash për Bashkinë Shkodër, minimalisht për vlerën 1,296 mijë lekë.

**Shkaku:** Mungesa e zbatimit të kuadrit ligjorë në fuqi.

**Rëndësia: i lartë**

**Rekomandimi:**

- Drejtoria e të Ardhurave Vendore Bashkia Shkodër në bashkëpunim me strukturat e tjera të Bashkisë Shkodër, të marrë masa për evidentimin e objekteve me sipërfaqe mbi 100 m$^2$, duke aplikuar saktë taksës e ndërtesës.
- Drejtoria e të Ardhurave Vendore, të ndjekë të gjitha proçedurat administrative e ligjore për arkëtimin e taksës së ndërtesë ndaj **6** subjekteve për vlerën **648,359 lekë**, të pataksuar si më poshtë:

**vlera 271,788 lekë**, ndajë subjektit "C...".
**vlera 157,992 lekë**, ndajë subjektit "A...".
**vlera 74,820 lekë**, ndajë subjektit "P...".
**vlera 17,910 lekë**, ndajë subjektit "V...".
**vlera 103,617 lekë**, ndajë subjektit "D....

**-Taksa mbi tokën bujqësore.** Nga të dhënave të pasqyrës, rezulton se **për vitin 2019** është realizuar në masën 20.4%, ose nga 21,736 mijë lekë të planifikuar është arkëtuar vlera 4,446 mijë lekë më pak për shumën 17,290 mijë lekë. Ndërsa **për vitin 2020**, është realizuar në masën 21.6%,

[13] 4. Vlera e pasurisë së paluajtshme për ndërtesat e papërfunduara në shkelje të afatit të lejes së ndërtimit Për ndërtesat e pajisura me leje ndërtimi, por që nuk kanë arritur të përfundojnë sipas afatit të përcaktuar në aktin e miratimit të kërkesës për leje ndërtimi, përcaktimi i bazës së taksueshme bazohet mbi koston e parashikuar të ndërtimit, sipas lejes së ndërtimit të miratuar nga njësia përkatëse e vetëqeverisjes vendore apo KKT-ja. Në këtë rast, vlera e bazës së taksës së ndërtesës llogaritet për të gjithë ndërtesën, kur është një njësi e vetme dhe e destinuar për një qëllim të vetëm përdorimi, pavarësisht fazës në të cilën gjendet ndërtesa e papërfunduar. Baza e taksës së ndërtesës llogaritet në masën 30 (tridhjetë) për qind të shkallës së taksës të përcaktuar me ligj, shumëzuar me koston e ndërtimit të parashikuar në lejen e miratuar të ndërtimit. Në rast kur ndërtesa përbëhet nga më shumë se një njësi pronësore,..........

ku nga vlera 21,736 mijë lekë të planifikuara është arkëtuar vlera 4,698 mijë lekë, pra më pak për shumën 17,038 mijë lekë.
Konstatohet se si planifikimi dhe arkëtimet janë në të njëjtat nivele nga viti 2019 dhe vitin 2020, gjë e cila tregon se nga DAV Bashkia Shkodër nuk është përqendruar puna në evidentimi dhe vjeljen e detyrimeve të personave të cilët nuk paguajnë.

| **3.** **<u>Titulli i gjatjes:</u>** *Mos planifikim i saktë i taksës së tokës bujqësore.* |
|---|

**<u>Situata</u>:**
Nga auditimi i dokumentacionit mbi planifikimin e taksës së tokës bujqësore për vitet 2019 – 2020, u konstatua se kishte rezerva në planifikim, pasi sipas të dhënave të marra nga Drejtoria e Bujqësisë, Zhvillimit rural dhe trajtimit te AMTP, mbi ndarjen e tokës bujqësore për familje dhe boniteti, evidentohet mos planifikim në vlerën 7,170 mijë lekë, konkretisht:

**Tabela 1.** Pritshmëria e taksës së tokës bujqësore për vitet 2019 – 2020

| Nr. | Emri fshatit | Tok bujq gjithsej për tu ndarë | Familje që kanë marrë tapi | | Boniteti tokës | Çmimi sipas paketës fiskale | Detyrim vjetor/lekë |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | Nr. | Ha | | | |
| 1 | Ana e Mali | 1775 | 801 | 1775 | III-IV | 1960 | 3,479,000 |
| 2 | Bërdicë | 2151 | 1609 | 2151 | IV | 1610 | 3,463,110 |
| 3 | Dajç | 2135 | 1403 | 2135 | III | 1960 | 4,184,600 |
| 4 | Guri i Zi | 1965.1 | 1790 | 1965.1 | IV | 1610 | 3,163,811 |
| 5 | Rrethina | 2481 | 3121 | 2481 | V | 1330 | 3,299,730 |
| 6 | Postribë | 1030.15 | 2799 | 1030.15 | VI | 1120 | 1,153,768 |
| 7 | Velipojë | 2949 | 1537 | 2949 | IV | 1610 | 4,747,890 |
| 8 | Pult | 409 | 727 | 409 | V | 1330 | 543,970 |
| 9 | Shale | 834 | 1138 | 834 | V-VI | 1120 | 934,080 |
| 10 | Shosh | 314 | 345 | 314 | VI | 1120 | 351,680 |
| | **SHUMA** | **16043.25** | **15270** | **16043.25** | | | **25,321,639** |

**<u>Burimi</u>**: *Të dhënat janë marrë nga Drejtoria e Bujqësisë dhe paketa fiskale*

Kështu sipas të dhënave të pasqyrës sipërfaqja gjithsej e tokës së ndarë sipas fshatrave dhe familjeve është 16043.25 ha. Për këtë sasi toke të ndarë, referuar boniteti të tokës sipas fshatrave dhe çmimit për bonitet të miratuara në paketat fiskale me VKB, planifikim i kësaj takse për një vit ushtrimorë duhej të ishte në vlerën 25,321 mijë lekë, por në fakt nga DAV Bashkia Shkodër është planifikuar një vlerë prej 21,736 mijë lekë ose më pak për shumën 3,585 mijë lekë dhe për dy vite objekt auditivi në **shumën 7,170 mijë lekë,** një e ardhur munguar në buxhetin e Bashkisë Shkodër**.**
**<u>Kriteri:</u>**
Në kundërshtim me nenin 20, 21 dhe 22 të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar.
**<u>Ndikimi/Efekti:</u>**
Mos evidentimi i saktë i familjeve me tokë bujqësore, çon në mos planifikimin e saktë të kësaj takes dhe mungesë të ardhurash në Bashkinë Shkodër.
**<u>Shkaku:</u>** Mungesa e bashkëpunimit midis drejtorie/sektorëve Bashkia Shkodër.
**<u>Rëndësia:</u> i lartë**
**<u>Rekomandimi:</u>**
Drejtoria e të Ardhurave Vendore Bashkia Shkodër në bashkëpunim me Drejtorinë e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Trajtimit te AMTP, të marrë masa për evidentimi e të gjithë familjeve me

tokë bujqësore sipas të dhënave të Drejtorisë së Bujqësisë, duke evidentuar familjet me tokë bujqësor dhe të pataksuar, si dhe të ndiqen të gjitha rrugët administrative e ligjore për planifikimin dhe arkëtimin e detyrimeve të pataksuara dhe paarkëtuara gjatë periudhave ushtrimore në vlerën **7,170 mijë lekë**.

**<u>-Tarifa e pastrimit/gjelbërimi dhe ndriçimi.</u>** Sipas të dhënave të pasqyrës, **për vitin 2019** është realizuar në masën 99.9%, ose nga vlera e planifikuar prej 222,671 mijë lekë është arkëtuar vlera 222,491 mijë lekë. Ndërsa **për vitin 2020**,  është realizuar në masën 97%, ku nga vlera e planifikuar prej 205,762 mijë lekë është arkëtuar vlera 199,837 mijë lekë. Këto tarifa janë parashikuar nisur nga numri i bizneseve sipas llojit të aktiviteteve dhe abonentëve familjarëve të cilët duhet të shlyejnë detyrimet në territorin e Bashkisë Shkodër.
Nga auditimi i procedura në lidhje me arkëtimin e taksës së tokës dhe tarifave për abonentët familjarë, konstatohet se ajo realizohet nëpërmjet agjentit "U..." sh.a. Nga të dhënat niveli i detyrimeve (mos arkëtim), nga njëra periudhë në tjetër paraqitet në rritje. Kështu në fund të vitit 2020, nga 6037 abonentë familjarë me vlerë 527,465 mijë lekë në fund të vitit 2019, kanë mbetur parketuar deri më 31.12.2020, gjithsej **6055** abonentë familjarë me vlerë **577,914** mijë lekë, pra kemi një rritje për 18 familje me vlerë  50,449 mijë lekë.
Mënyra e arkëtimit nga "U..." sh.a, realizohet sipas faturës së detyrimit të përcjellë nga DAV Bashkia Shkodër e cila faturohet në faturën  ujit të pijshëm, por ka dhe një numër familjesh të cilët nuk kanë kontratë me U... për ujë dhe faturimi ju bëhet vetëm për taksa/ tarifa vendore. Këto familje janë paraqitur në Bashkinë Shkodër për arsye nga më të ndryshmet dhe nga administrata e bashkisë nuk iu është kryer veprim pa planifikuar dhe arkëtuar taksat/ tarifat vendore të dhëna të cilat më pas u janë përcjellë sh.a "U...", i cili ka bërë faturimet për vitet në vazhdim, ku familje me kontratë me U... janë 41948 familje dhe familje të cilëve ju faturohet vetëm taks/ tarifa vendore, pasi nuk kanë kontratë me ujin janë 12526 familje.
Gjithashtu, ka dhe një numër jo të vogël familjesh (trajtuar më sipër), të cilëve **nuk iu është faturuar** taksa/tarifa vendore, pasi nuk janë paraqitur në Bashki për kryerjen e veprimeve të ndryshme dhe nga vetë administrata e DAV Bashkia Shkodër nuk është mundësuar shpërndarja e fletë detyrimit *(faturë pagesë)*, me inspektorët e sajë, kjo për të bërë të mundur evidentimin, planifikimin dhe arkëtimin e të ardhurave në favor të Bashkisë Shkodër (*Të dhënat për efekt volumi, janë paraqitur në CD, pjesë e aktit).*

**<u>4.</u>** **<u>Titulli i gjetjes:</u>** *Mos planifikim i tarifës së pastrim/gjelbërim dhe ndriçim të familjeve në Bashkinë Shkodër.*

**<u>Situata:</u>**
Nga të dhënat konstatohet se, si në planifikim dhe në realizim këto tarifa vijnë në ulje ku nga 222 milion lekë të planifikuara në vitin 2019 në vitin 2020 është planifikuar vlera 205 milionë lekë, pra më pak për shumën **17 milionë lekë, si mungesë të ardhurash në buxhetin e Bashkisë Shkodër**, për të cilën DAV Bashkia Shkodër nuk paraqet argument, pasqyra si vijon:

*Në 000/lekë*

| Lloj tarifës | Viti 2019 | | Viti 2020 | |
|---|---|---|---|---|
| | Plani | Fakti | Plani | Fakti |
| Tarifë pastrimi | 166,891 | 166,913 | 150,952 | 149,117 |
| Tarifë ndriçim | 34,270 | 33,306 | 35,763 | 30,901 |

| Lloj tarifës | Viti 2019 | | Viti 2020 | |
|---|---|---|---|---|
| | Plani | Fakti | Plani | Fakti |
| Tarifë gjelbërimi | 21,510 | 22,272 | 19,047 | 19,837 |
| **Shuma** | **222,671** | **222,491** | **205,762** | **199,837** |

Në lidhje me pagesën e tarifës së pastrim/gjelbërim/ndriçim nga abonentët familjarë, këto tarifa administrohen nga agjenti tatimorë "Nd. U..." sha Shkodër, ku referuar të dhënave që përcillen nga DAV Bashkia Shkodër bëhej faturimi tek abonentët që janë me kontratë me U... dhe pas pagesës bëhej xhirimi për llogarit të Bashkisë Shkodër. Por ka dhe një kategori tjetër familjesh të cilat nuk kanë kontratë me U... dhe faturohen vetëm për tarifat vendore.
Kështu sipas të dhënave familje me kontratë me U... janë 41948 familje, ndërsa familje të cilat paguajnë vetëm tarifat vendore janë 12526 familje, pra gjithsej janë taksuar **54474 familje.**
Referuar të dhënave të marra nga Gjendja Civile mbi numrin e familjeje, rezulton se është më i lartë se numër i familje të taksuar, pasqyra:

| Nr. | Njësia Administrative | Nr. Banorëve | Nr. Familje |
|---|---|---|---|
| 1 | Bashkia Shkodër | 115,401 | 38,093 |
| 2 | Ana e Malit | 6,119 | 1,732 |
| 3 | Bërdicë | 9,917 | 2,725 |
| 4 | Dajç | 9,085 | 2,285 |
| 5 | Guri i Zi | 12,172 | 3,522 |
| 6 | Postribë | 11,691 | 3,328 |
| 7 | Pult | 2,941 | 902 |
| 8 | Rrethina | 27,927 | 8,036 |
| 9 | Shalë | 5,072 | 1,727 |
| 10 | Shosh | | |
| 11 | Velipojë | 9,857 | 2,767 |
| **Popullsia Totale** | | **210,182** | **65,117** |

**Burimi**: *Nga Gjendja Civile Shkodër*

Nga të dhënat, evidentohet një numër i lartë familjesh, gjithsej **10643** familje të pataksuara për taksa/ tarifa vendore, për të cilat DAV Bashkia Shkodër nuk ka ndërmarrë asnjë veprime ligjore për identifikimin dhe taksimin e tyre, ku mos taksimi çon në mungesë të ardhurash në buxhetin e Bashkisë Shkodër.
Referuar paketës fiskale të miratuara në Bashkinë Shkodër, ku çdo familje paguan taks ndërtese (100 m$^2$ x 29 lekë), taksa tokë, taks trualli (100 m$^2$ x 0.42 lekë, tarifë pastrim/gjelbërim/ndriçim (3450 + 600 + 1200), detyrimi i munguar nga mos identifikimi, llogaritja dhe arkëtimi i detyrimeve për abonentët familjarë të pataksuar, përllogaritët në vlerën **118,320,360 lekë për periudhën objekt çuditmi (2019 – 2020), si e ardhur e munguar në buxhetin e Bashkisë Shkodër,** të dhëna të cilat paraqiten në pasqyrën si vijon:

| EMËRTIMI | Abonentë familjarë të pataksuar qytet/fshat | | | | | | Për vitet 2019-2020 |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | 30% e familjeve qytet | 70% familje fshat | Çmimet sipas VKB | | Vlera pataksuar, sipas KLSH | | |
| | | | Qytet | Fshat | Qytet | Fshat | |
| Tarifë pastrimi | 3,193 | 7,450 | 3,450 | 1,950 | 11,015,505 | 14,527,695 | 51,086,400 |
| Tarifë gjelbërimi | 3,193 | 7,450 | 600 | | 1,915,740 | 0 | 3,831,480 |
| Tarifë ndriçimi | 3,193 | 7,450 | 1,200 | 480 | 3,831,480 | 3,576,048 | 14,815,056 |
| Taks ndërtese | 3,193 | 7,450 | 2,900 | 2,000 | 9,259,410 | 14,900,200 | 48,319,220 |
| Taks trualli | 3,193 | 7,450 | 42.00 | 0 | 134,102 | 0 | 268,204 |
| Taks Toke | 3,193 | 7,450 | | | 0 | 0 | 0 |

| EMËRTIMI | Abonentë familjarë të pataksuar qytet/fshat | | | | | | Për vitet 2019-2020 |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | 30% e familjeve qytet | 70% familje fshat | Çmimet sipas VKB | | Vlera pataksuar, sipas KLSH | | |
| | | | Qytet | Fshat | Qytet | Fshat | |
| SHUMA | | | | | 26,156,237 | 33,003,943 | 118,320,360 |

**Burimi**: *Nga të dhënat e gjendjes civile, paketa fiskale. Ndërsa ndarja e familjeve në % dhe llogaritja është bërë nga grupi i KLSH, nisur nga fakti se pjesa më e madhe e familjeve të pataksuara mund të jenë në zona urale (NJA).*

**Kriteri:**
Në kundërshtim me ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 "Për Sistemin e Taksave Vendore" i ndryshuar dhe paketat fiskale të viteve respektive 2019 – 2020.
**Ndikimi/Efekti:**
Mos evidentimi i saktë i familjeve, çon në mos planifikimin dhe mungesë të ardhurash në Bashkinë Shkodër.
**Shkaku:** Mungesa e bashkëpunimit.
**Rëndësia: i lartë**
**Rekomandimi:**
Drejtoria e të Ardhurave Vendore Bashkia Shkodër, të marrë masa për evidentimi e të gjithë familjeve të pataksuara me taksa/tarifa vendore, si dhe të ndiqen të gjitha rrugët administrative e ligjore për planifikimin dhe arkëtimin e detyrimeve të pataksuara dhe paarkëtuara gjatë periudhave ushtrimore 2019 -2020 dhe jo vetëm, për vlerën **118,320,360 lekë**.

Nga specialistët e DAV Bashkia Shkodër me shkresën nr. 4597/55, datë 16.7.2021 (*port KLSH* nr. 362/16, datë 21.7.2021), janë paraqitur kundërshti në lidhje me mangësitë e evidentuar për mos planifikim të tarifës së pastrim/gjelbërim dhe ndriçim, ku kundërshton se:
**Komente dhe sqarime:**
*Bazuar në ligjin nr.10129, datë 1.05.2009 "Për gjendjen civile", të ndryshuar si dhe në ligjin nr.9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", të ndryshuar, të dhënat e regjistrit të gjendjes civile, janë të dhëna personale, në të cilat ne nuk kemi akses. Regjistrimi i abonentëve në sistemin e taksave dhe tarifave vendore, bëhet mbi bazën e numrit ID, të sjellë nga vetë personi.*
*Parashikimi i të ardhurave nga familjet është bërë duke iu referuar kapaciteteve reale të familjeve rezidente sipas Censusit, si dhe lehtësive fiskale të parashikuara. Numri i familjeve që përfshihen në skemën e detyrimeve fiskale te bashkisë Shkodër është 35,425. Në paketën fiskale të Bashkisë Shkodër janë parashikuar lehtësi fiskale dhe numri i familjeve me lehtësi fiskale, arrin në 10,988 familje si pensionistë, invalid, familje me ndihmë ekonomike, familje njëprindërore, familje me probleme sociale etj. Ato zënë 31% të numrit të përgjithshëm të familjeve në Bashkinë Shkodër.*
**Sqarim i grupit të KLSH:**
Për sa sqaroni në lidhje me mangësitë e konstatuara për mos taksimin e një pjesë të abonentëve familjarë dhe mos kryerjen e kontrolle në vend për abonentëve me banesa me vila, nuk është bindës për grupin e KLSH dhe nuk merret në konsideratë, kjo për faktin se taksa/tarifa familjarë kë një periudhë të gjatë kohore që aplikohet dhe nisur nga numri i inspektorëve të dispozicion dhe nëse nuk do kishit mundësi marrje informacioni duhet të ishin bërë verifikime në terren.

**-Taksa mbi ndikimin në infrastrukturë**. Sipas të dhënave të pasqyrës, **për vitin 2019** është realizuar në masën 31%, ose nga 125,201 mijë lekë të planifikuar është arkëtuar vlera 39,239 mijë

lekë, *nga e cila:* nga ndërtimet e reja nga vlera 100,160 mijë lekë të planifikuar është arkëtuar vlera 19,637 mijë lekë dhe objektet në proces legalizimi nga vlera e planifikuar prej 25,041 mijë lekë është arkëtuar vlera 19,602 mijë lekë. **Për vitin 2020**, është realizuar në masën 37.6%, ku nga vlera e planifikuar prej 185,000 mijë lekë është arkëtuar vlera 69,673 mijë lekë, *nga e cila:* nga ndërtimet e reja nga vlera 148,000 mijë lekë të planifikuar është arkëtuar vlera 41,514 mijë lekë dhe objektet në proces legalizimi nga vlera e planifikuar prej 37,000 mijë lekë është arkëtuar vlera 28,159 mijë lekë.

Nga të dhënat konstatohet se në asnjërin nga vitet objekt auditimi kjo taksë nuk është realizuar, fakt ky i cili varet nga niveli i lejeve zhvillimit/ ndërtimit që jepen nga Drejtoria e PZHT sipas periudhave, ku nuk mundësohet dhënia e lejeve të parashikuara për mungesë kërkesash nga personat e interesuar.

Ky planifikim i lartë nga njëra periudhë në tjetrën, ku niveli i realizmit nuk kalon 30% është i pabazuar dhe që ndikon në hartimin e buxhetit të viteve, pasi referuar këtyre shifrave të larta *(por të parealizuara)*, AK planifikon procedura prokurimi për investime etj., me pretendimin se do realizohen të ardhurat nga taksa e ndikimit në infrastrukturë, ku në totalin e planit të të ardhurave, vetëm kjo taksa zë 16% të planit.

**5. Titulli gjetjes:** *KLSH konstatoj se Drejtoria e të Ardhurave, Bashkia Shkodër në lidhje me legalizimet e ndërtimeve pa leje dhe listave që disponon për pagesën e taksës së ndikimit në infrastrukturë, nuk ka bërë të mundur arkëtimin e detyrimeve në vlerën* ***220,380,615 lekë****, shumë e cila përben të ardhur të munguar për bashkinë***.**

**Situata:**

Nga auditimi i dokumentacionit që disponon Drejtoria e të Ardhurave, Bashkia Shkodër në lidhje me legalizimet e ndërtimeve pa leje dhe listave që disponon për pagesën e taksës së ndikimit në infrastrukturë, konstatohet se nga Drejtoria Rajonale e ALUIZNIT Shkodër janë dërguar zyrtarisht me shkresë lista e qytetarëve shoqëruar me leje legalizimi dhe destinuara për regjistrim në ZVRPP Shkodër.

Konkretisht për periudhën nga 01.01.2016 deri më 31.12.2020, sipas listave të vëna në dispozicion me leje legalizimi dhe kryqëzimi i tyre me personat që kanë bërë të mundur likuidimin e taksës së ndikimit në infrastrukturës, rezulton se detyrimi për këtë taksë është në vlerën 250,613,179 lekë për 2016 persona, kanë paguar detyrimet 115 persona me vlerë 30,232,524 lekë dhe kanë mbetur për likuidim deri datë 31.12.2020 gjithsej **1901** persona me vlerë **220,380,615 lekë,** e ardhur e munguar në buxhetin e Bashkisë Shkodër *(sipas listës të administruar në CD)*.

Nga dokumentacioni i paraqitur, nuk u evidentuan raste që Bashkia Shkodër ti jetë drejtuar ASHK Dega Shkodër, për bllokimin e pasurisë dhe mos kryerjen veprimeve hipotekore ose bllokimin e marrjes së lejes së legalizimit dhe certifikatës pa bërë më parë pagesën taksës së ndikimit në infrastrukturë, **veprime të cilat ngarkohen me përgjegjësi Drejtorinë e PZhT dhe DAV Bashkia Shkodër**.

| Natyra e debitorëve | Detyrime gjithsej 2016-2020 | | Arkëtuar deri 31.12.2020 | | Debitorë me 31.12.2020 | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | Person | Lekë | Person | Lekë | Person | Lekë |
| Taksa infrastrukture (legalizim) | 2016 | 250,613,179 | 115 | 30,232,524 | 1901 | **220,380,615** |

**<u>Kriteri:</u>**
Me nenin 27 pika (d), të ligjit nr. 9482, datë 03.04.2006 "Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje„,"; VKM nr. 860, datë 10.12.2014 "Për përcaktimin e mënyrës së mbledhjes dhe administrimit të të ardhurave për ndërtimet pa leje dhe vlerave të zbatueshme për legalizim" i ndryshuar, pika 5 dhe ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 "Për Sistemin e Taksave vendore", i ndryshuar, neni 27- *Taksa e ndikimit në infrastrukturë,* pika 2/1.
**<u>Ndikimi/Efekti:</u>**
Mos arkëtimi i detyrimeve taksës së ndikimit në infrastrukturës nga ndërtimet pa leje, ka çuar në mungesë të ardhurash në vlerën **220,380,615 lekë,** për buxhetin e Bashkisë
**<u>Shkaku:</u>**
Mos kryerja e akt-rakordimeve midis ADV Bashkia Shkodër dhe ASHK Rajonale Shkodër, për ndjekjen e procedurave ligjore për arkëtimin e detyrimeve.
**<u>Rëndësia:</u>** i **lartë**
**<u>Rekomandimi:</u>**
- Drejtoria e të Ardhurave Vendore Bashkia Shkodër, të marrë masa duke ndjekur të gjitha procedurat administrative dhe ligjore për arkëtimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë për ndërtimet pa leje në vlerën **220,380,615 lekë** ndaj **1901** personave.
- Drejtoria e Planifikim Zhvillim Territorit në bashkëpunim me Drejtorinë e të Ardhurave Vendore Bashkia Shkodër, për personat të cilat nuk kanë kryer pagesën e taksës së ndikimit në infrastrukturë për ndërtimet pa leja, t'i kërkojnë Drejtorisë Rajonale Vendore ASHK Shkodër vendosjen e urdhër kufizimit mbi pasurinë, deri në pagesës e taksës së ndikimit në infrastrukturë.
- Drejtoria e Planifikim Zhvillim Territorit, në planifikimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë të bazohet në kërkesat e personave për leje dhe faktin e vitit që mbyllet dhe të mos aplikojë apriori vlera të cilat nuk kanë bazë.

**<u>-Tarifa e zënies së hapësirës publike</u>**. Sipas të dhënave të pasqyrës, **për vitin 2019** kjo tarifë është realizuar në masën 110.8%, ose nga 32,000 mijë lekë të planifikuar është arkëtuar vlera 35,469 mijë lekë. Ndërsa **për vitin 2020**, është realizuar në masën 123.2%, ku nga 36,800 mijë lekë është arkëtuar vlera 45,350 mijë lekë.
Nga të dhënat konstatohet se kjo tarifë është realizuar në të dy periudhat objekt auditimi, por planifikimi i kësaj tarife nuk është bërë me dokumentacion të rregullt, pasi mungojnë genplani për saktësimin e sipërfaqeve që subjektet administrojnë dhe procesverbalet e verifikimit në teren të subjekteve. Në realitet dhe sipas të dhënave të kontrolleve të kryera nga Sektori i Kontrollit Terren, sipërfaqet që subjektet disponojnë për biznes është e madhe se sa ato kanë vetëdeklaruar, gjë e cila bën që planifikimi të mos jetë në baza reale dhe me dokumentacion argumentues, evidentuar kjo dhe nga fakti që çdo vit paraqitet me realizim.

**6. <u>Titulli gjetjes:</u>** *KLSH konstatoj raste të mos aplikimit të tarifës së zënies së hapësirave publike nga subjektet private, evidentuar kjo nga Sektori i Kontrollit në Terren.*

**<u>Situata:</u>**
Sipas dokumentacionit të paraqitur nga DAV Bashkia Shkodër mbi aktivitetin e Sektorit të Kontrollit në Terren, konstatohet se për vitet 2019 dhe 2020 nga ana e këtij sektori janë evidentuar një numër subjektesh të regjistruar në Bashkinë Shkodër që shfrytëzojnë hapësira publike pa lidhur kontratë dhe papaguar detyrimet përkatëse sipas tarifës së përcaktuar në VKB. Në këto akt-kontroll

nuk është evidentuar sipërfaqja që ato shfrytëzojnë, kjo për mungesë specialisti sipas Sektorit të Kontrollit.
Me shkresë përcjellëse, akt-konstatimet i janë dërguar Policisë Bashkiake për penalizim dhe bllokim të aktivitetit deri në fazën e lidhjes së kontratës, **por nga Policia Bashkiake nuk është kryer asnjë veprim.**
Kështu, referuar të dhënave të paraqitura nga ADV Bashkia Shkodër dhe kundërshtive paraqitur me shkresën nr. 4597/39, datë 11.06.2019 *(port KLSH nr. 362/8, datë 14.06.2021)*, të cilat janë marrë në konsideratë nga grupi i KLSH, rezulton se për periudhën 2019- 2020, mbeten subjekte që shfrytëzojnë hapësira publike, por që nuk i nënshtrohen pagesës, gjithsej për **45** subjekte me një vlerë mesatare detyrimi prej **1,823,223 lekë**, **e ardhur e munguar në buxhetin e Bashkisë Shkodër**, *nga e cila:* për aktivitetin e vitit 2019 në vlerën 523,333 lekë dhe për aktivitetin e vitit 2020 në vlerën 1,294,890 lekë, *të dhëna sipas Tabelave 1 dhe 2, si vijon.*

**Tabela 1. Subjekte debitorë viti 2019**

| Nr. | Emri i subjektit | Detyrimi/lek |
|---|---|---|
| 1 | B... | 40,635 |
| 2 | D... | 35,280 |
| 3 | M... | 29,232 |
| 4 | D... | 8,400 |
| 5 | L... | 7,840 |
| 6 | S... | 19,600 |
| 7 | G... | 7,840 |
| 8 | S... | 11,740 |
| 9 | E... | 15,680 |
| 10 | A... | 7,560 |
| 11 | R... | 6,300 |
| 12 | F... | 6,300 |
| 13 | S... | 34,020 |
| 14 | I... | 45,360 |
| 15 | G... | 45,360 |
| 16 | R... | 33,600 |
| 17 | E... | 5,712 |
| 18 | E... | 3,780 |
| 19 | A... | 11,760 |
| 20 | A... | 27,440 |
| 21 | D... | 16,800 |
| 22 | S... | 11,424 |
| 23 | K... | 7,560 |
| 24 | E... | 5,040 |
| 26 | P... | 3,780 |
| 27 | A... | 5,880 |
| 28 | V... | 57,120 |
| | **Shuma** | **528,333** |

**Tabela 2. Subjekte debitorë, viti 2020**

| Nr. | Emri i subjektit | Detyrimi/lek |
|---|---|---|
| 1 | A... | 110,880 |
| 2 | D... | 415,800 |
| 3 | A... | 33,075 |
| 4 | J... | 29,400 |
| 5 | A... | 58,800 |
| 6 | E... | 15,750 |
| 7 | A... | 48,510 |
| 8 | F... | 27,000 |
| 9 | G... | 16,905 |
| 10 | M... | 20,475 |
| 11 | A... | 113,400 |
| 12 | B... | 55,125 |
| 13 | E... | 90,720 |
| 14 | G... | 66,150 |
| 15 | B... | 77,400 |
| 16 | I... | 56,700 |
| 17 | S... | 58,800 |
| | **Shuma** | **1,294,890** |

Nga DAV Bashkia Shkodër (Sektori i Kontabilitetit), nuk është ndërmarrë asnjë masë për llogaritjen dhe arkëtimin e tarifës së zënies së hapësirës publike nga subjektet dhe të konstatuar nga kontrolli në terren, por është mjaftuar vetëm në njoftimin e Policisë Bashkiake, duke lënë të lirë subjektet të shfrytëzojnë ato dhe mos paguajnë detyrime, si dhe duke krijuar pabarazi fiskale në subjektet që e pengojnë këtë lloj tarifë dhe krijuar evazion fiskal, veprime të cilat nuk janë kryer dhe nga Policia Bashkiake për penalizmin dhe bllokimin e aktivitetit deri në llogaritjen dhe pagesën e taksës së hapësirës publike.

**<u>Kriteri:</u>**
Në kundërshtim me nenin 35, të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 "Për Sistemin e Taksave vendore" i ndryshuar dhe kapitulli III.4.11 – *Tarifa për zënie hapësirë publike,* **veprime të cilat ngarkohen me përgjegjësi Drejtorët e Drejtorive të të Ardhurave Vendore, Drejtoria e Studimeve, Planifikimit dhe Koordinimit të Investimeve dhe Policinë Bashkiake**.
**<u>Ndikimi/Efekti:</u>**
Mos kryerja e veprimeve për taksimin e subjekteve të cilat shfrytëzojnë hapësira publike, janë veprime në mungesë të ardhurash në shumën 14,364 mijë lekë.
**<u>Shkaku:</u>**
Mungesa e bashkëpunimit midis drejtorive/sektorëve Bashkia Shkodër dhe mungesa e organizmit të Strukturës së Sektorit të Kontrollit me specialit të fushës.
**<u>Rëndësia:</u> i lartë**
**<u>Rekomandimi:</u>**
Drejtoria e të Ardhurave Vendore në bashkëpunim me Drejtorinë e Studimeve, Planifikimit dhe Koordinimit të Investimeve, të ngrejë një grup pune me specialit të fushës për saktësimin e sipërfaqes së hapësirës publike të zënë **45** subjekte, sipas të dhënave të Sektorit të Kontrollit në Terren, si dhe të ndjek të gjitha rrugët administrative e ligjore për arkëtimin e vlerës së përcaktuar nga grupi i KLSH-së prej **1,823,223 lekë**, e ardhur e munguar në buxhetin e Bashkisë Shkodër.

**<u>-Taksa e fjetjes në hotel:</u>** Për ***vitin 2019*** kjo taksa paraqet me një realizim në masën 149.6%, ku nga 13,200 mijë lekë të parashikuara është arkëtuar i vlerën 19,756 mijë lekë dhe ***për vitin 2020*** paraqitet në masën 43.4%, ku nga vlera e planifikuar prej 17,000 lekë është arkëtuar vlera 7,380 mijë lekë. Ky mos realizim lidhet me faktin se gjatë vitit 2020, vendi është përfshirë nga pandemia globale (CIVID-19), dhe vështirësia e lëvizjes së qytetarë në drejtim të zonave të plazhit.

**7. <u>Titulli gjetjes:</u>** *KLSH konstatoj mangësi të aplikimin e taksës së fjetjes në hotel.*

**<u>Situata:</u>**
Nga auditimi u konstatua se, ndjekja e kësaj taksë aplikohej bazuar në akt-konstatimet të Sektorit të Kontrollit Terren çdo datë 5 fillim muaj me tarifën e përcaktuar në Vendimin e KB është 70 lekë/natë/personi. Në këto akt-konstatime nuk evidentohet se sa netë kanë fjetur këto persona, por është evidentuar thjeshtë numër i tyre.
Ky dokument (akt-konstatimi), nuk është i saktë, pasi në të nuk paraqitej panorama e plotë e lëvizjes (akomodimit) të personave në hotel, por thjeshtë bëhej një konfirmim i deklaratës së subjektit (vetëdeklarim). Pra nuk evidentohej, sa dhoma ka hoteli diponibël për aktivitet, sa shterët janë për dhomë dhe gjithsej, sa dhoma janë aktive dhe sa jo. Të gjitha këto mangësi bëjnë që kjo taksë të mos jetë planifikuar sakë për numrin e personave që akomodohen në Bashkinë Shkodër, kryesisht kjo në sezonin verorë ku numër i personave që akomodohen në hotele është edhe më i lartë, <u>veprime të cilat çojnë në mungesë të ardhurash në buxhetin e Bashkisë Shkodër nga mos planifikimin i saktë të të ardhurave nga kjo taksa.</u>
Mungesa e dokumentacionit ose mos evidentimi i saktë i personave që akomodohen në hotel dhe lëvizjet e shpeshta të personave, duke mos i regjistruar ato në regjistrat e hotelit, lind si e nevojshme që nga ana e Bashkisë Shkodër në miratimin e paketës fiskale të vitit 2022 të bëjë ndryshimin e mënyrës së llogaritjes, **duke aplikuar tarifë fikse për shtretër/nata,** gjithmonë duke ruajtur nivelin ligjorë +/- 30%.

Nga auditimi, u konstatua se nga DAV Bashkia Shkodër nuk është marrë informacion dhe nuk është bërë ndarja e hotele në "Yje", të dhëna këto të cilat kërkohen nga Ministria e Turizmit. Kështu nga kërkimi në inerten konstatohet se 2 nga hotele të Bashkisë Shkodër janë me "5 yje" dhe sipas VKB tarifa për person është 175 lekë/personi/nata.

**Kriteri:**

Dispozitat ligjore të nenit 26, të ligjit nr. 9632 "Për Sistemin e Taksave Vendore", pasi nga auditimi është konstatuar se aplikimi i taksë së hotelit

**Ndikimi/Efekti:**

Mos evidentimi i saktë i fjetjes në hotel të personave, çon në mos taksim të taksës së fjetjes në hotel dhe mungesë të ardhurash në Bashkinë Shkodër.

**Shkaku:** Mos njohje dhe mos zbatim i kuadrit ligjorë në fuqi.

**Rëndësia: i lartë**

**Rekomandimi:**

- Drejtoria e të Ardhurave Vendore Bashkia Shkodër në bashkëpunim me Policinë Bashkiake, të ngrejë një grup pune me specialit të fushës për të evidentuar numrin e hoteleve që operojnë në territorin e Bashkisë Shkodër, duke evidentuar numrin e dhomave dhe shtretërve aktiv, si dhe të shikohet mënyra e taksimit të fjetjes në hotel të personave (lekë/shtretër/nata), duke ruajtur nivelet ligjore +/- 30%.
- Drejtoria e të Ardhurave Vendore në bashkëpunim me Drejtorinë e Turizmit dhe Policinë Bashkiake, të evidentojnë hotelet me 4-5 yje me miratim të Ministrisë së Turizmit për një aplikim të saktë të taksës sipas VKB. Të mos lejojnë përdorimin e simboleve (yjeve) nga subjektet hoteliere pa leje përkatëse të Ministrisë së Turizmit dhe në rast kundërshtimi të aplikohet tarifa e miratuar me VKB për 175 lekë/natë/personi.

**- Tarifë parkimi**. Sipas të dhënave të pasqyrës mbi realizimin e të ardhurave, ***për vitin 2019***, kjo tarifë paraqitet në nivelin 126.3%, ku nga 3,789 mijë lekë të planifikuara është arkëtuar vlera 4,787 mijë lekë. Ndërsa ***për vitin 2020*** paraqitet në nivelet 83.45%, ku nga 4,133 mijë lekë të planifikuar është arkëtuar vlera 3,499 mijë lekë.

Nga të dhënat konstatohet se fakti i vitit 2020 është më i vogël se fakti i vitit 2019 për vlerën 1,338 mijë lekë, për të cilën DAV Bashkia Shkodër nuk paraqiti asnjë informacion.

- **Zbatimi i Akt- Marrëveshjeve**

Në zbatim të nenit 77, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 "Për Procedurat Tatimore në RSH", i ndryshuar, nga DAV Bashkia Shkodër janë lidhur marrëveshje për pagesën me këste të detyrimeve të prapambetura.

Referuar të dhënave të nxjerra nga DAV Bashkia Shkodër, janë lidhur gjithsej 16 akt-marrëveshje me subjekte private me vlerë 9,477 mijë klekë dhe 19 individë me vlerë 13,434 mijë lekë.

Nga vlera 22,911 mijë lekë për pagesë me këste, deri në fund të vitit 2020, është likuiduar sipas afateve vlera 10,395 mijë lekë, duke mbetur për likuidim vlera 12,516 mijë lekë.

**8. <u>Titulli gjetjes</u>:** *Mangësitë e konstatuara në dokumentacionin mbi aktivitetin e Agjentëve Tatimorë.*

**<u>Situata:</u>**
Nga të dhënat e paraqitura nga DAV Bashkia Shkodër, konstatohet se për periudhën objekt auditimi janë mbajtur akt-rakordimet çdo muaj dhe vjetorë, por që janë të paplota, pasi nuk evidentohet se sa është numri i personave që duhet të paguajnë detyrimin, sa nga këto persona plotësojnë kriteret për pagesa, sa kanë paguar, sa nuk paguajnë dhe nëse vlera e arkëtuar nga agjentët tatimorë janë likuiduar në afat apo jo, kjo për agjentët tatimorë si: Drejtoria Rajonale Vendore ASHK Shkodër (*nga shitja e pasurisë)*, Drejtoria e Transportit (*për mjetet qarkullues),* Drejtoria Rajonale Tatimore Shkodër (*tatim fitim thjeshtuar)* dhe Ndërmarrjen e U... sh.a *(abonentët familjarë).*
Bashkia Shkodër nuk ka krijuar baza të plota të dhënash për detyrimet që vilen nëpërmjet agjentëve tatimorë, në bazë të të cilave të bëjë akt-rakordimet. N.q.s. krijohen baza të plota dhe gjithëpërfshirëse për të dhënat, do të jetë e mundur të bëhet një planifikim i saktë, real dhe i realizueshëm. Për sa më sipër, Bashkia Shkodër nuk ka bërë asnjë lloj analize për mosrealizimin e këtyre taksave dhe jo vetëm këtyre.
Në lidhje me mosrealizimet e taksave nga agjentët tatimorë, Bashkia Shkodër, duhet të marrë masa për evidentimin e diferencave të pa mbledhura sipas llojit të taksës/tarifës, të cilat përbëjnë mungesë të ardhurash për buxhetin e saj dhe të fillojë procedurat për gjobitjen e këtyre agjentëve tatimorë me 50% të shumës së plotë të taksave/tarifave të pa arkëtuara apo të shmangura,
Pjesa më e rëndësishme e të ardhurave që vilen me agjentët tatimorë është U.... Është shumë e rëndësishme të theksohet se vjelja e këtyre të ardhurave ka pasur përmirësime pas kontraktimit me Agjentin Tatimor, por ka një shumë të madhe debitorësh, e cila së pari duhet të përcaktohet nëse është mangësi e planifikimit apo problem në vjelje dhe më pas të vazhdohet me procedurat përkatëse.
Konstatojmë se sipas DAV Bashkia Shkodër, mos arkëtimet nga ana e Drejtoria Rajonale Vendore ASHK Shkodër, janë për shkak të anashkalimit të arkëtimit të këtyre detyrimeve për taksën e infrastrukturës, për të cilat nga Bashkia Shkodër është kërkuar vazhdimisht në rrugë zyrtare që të mos i kryejnë veprimet e regjistrimit të pronës nga këto lloj subjektesh, pa paraqitur dokumentin e pagesës së kësaj takse. Për sa më sipër, Bashkia Shkodër duhet të fillojë procedurat për të gjobitur Agjentin Tatimor ASHK në zbatim të dispozitës së mësipërme.
**<u>Kriteri:</u>**
Në nenin 117[14] të ligjit nr. 9920, dt. 19.5.2008, "*Për Procedurat Tatimore*", ku parashikohet se "*Dënimet për agjentët e mbajtjes së tatimit në burim, agjentët e taksave dhe agjentët e tarifave*".
**<u>Ndikimi/Efekti:</u>** Mos njohja e situatës, çon në mungesë të ardhura për Bashkinë Shkodër
**<u>Shkaku:</u>** Mungesa e bashkëpunimin dhe mos zbatimit të kuadrit ligjorë.
**<u>Rëndësia:</u> i mesëm**

---

[14] *"Agjenti i mbajtjes së tatimit në burim, agjenti i taksave apo tarifave, që nuk arrin të mbajë, të llogarisë, të raportojë dhe të transferojë në Buxhetin e Shtetit tatimin në burim apo tatimet, taksat dhe tarifat e mbledhura, apo i shmanget mbledhjes së tyre, detyrohet të paguajë gjobë të barabartë me 50 për qind të shumës së plotë të tatimit, taksës apo tarifës së pambledhura apo të shmangur."*

**Rekomandimi;**
Drejtoria e të Ardhurave Vendore, Bashkia Shkodër, të marrë masa për evidentimin e diferencave të pa mbledhura nga Agjentët Tatimore, sipas llojit të taksës/tarifës, të cilat përbëjnë mungesë të ardhurash për buxhetin e saj dhe të fillojë procedurat për penalizmin e Agjentëve Tatimore me 50% të shumës së plotë të taksave/tarifave të pa mbledhura apo të shmangura.
Të krijojë bazën të dhënave për subjektet, tarifat apo taksat të cilat mblidhen nga Agjentët Tatimore, të kryqëzojë informacionet me institucioni e tjera përkatëse dhe rakordimet të bëhen në fund të çdo muaj sipas formularit përkatës të miratuar nga Ministria e Financave.

**9. Titulli gjetjes:** *Lejimi i subjekteve që tregtojnë hidrokarbure me Licencë të bashkisë dhe papaguar tarifën në zbatim të VKM nr. 344, datë 19.04.2017.*

**Situata:**
Nga auditimi i dokumentacionit mbi pasjen me Liçensë tregtimi për subjektet që tregtojnë hidrokarbure dhe derivatet e tyre, u konstatua se ka mangësi në plotësimin e të dhënave të këtyre subjekteve në përgjithësi dhe debitorëve në veçanti, si mos aplikimin e tarifës së licencës dhe lejimin e subjekteve të ushtrojnë aktivitet pa paguar këtë taksë dhe mos ndjekjen e detyrimeve për subjektet të cilat janë pajisur dhe nuk e kanë paguar tarifën.
Sipas të dhënave të paraqitura nga DAV Bashkia Shkodër dhe Drejtoria e Shërbimeve për vitin 2019 ushtrojnë aktivitet në këtë fushë **43** subjekte, ku vetëm 1 subjekt është licencuar për vlerën 1,000,000 lekë (e paguar). Ndërsa për vitin 2020 ushtrojnë këtë aktivitet **45** subjekte, ku vetëm 13 prej tyre janë licencuar. Nga vlera e tarifës prej 10,069,966 lekë është paguar vlera 9,769,966 lekë, duke mbetur pa arkëtuar vlera 300,000 lekë, kjo për 13 subjektet e liçensuar, pasi pagesa është ndarë me këste mujore.
Nga të dhënat e mësipërme, konstatohet se nuk janë licencuar me leje tregtim karburanti, gjithsej **40** subjekte të cilët ushtrojnë aktivitet dhe papaguar detyrimin fiskal në **vlerën 40,000,000 lekë,** e ardhur e munguar në buxhetin e Bashkisë Shkodër, *të dhëna të cilat paraqiten në pasqyrën Aneks 2.6/3, bashkëlidhur Projektraport Auditimit*.
Sipas Drejtorisë së Shërbimeve Bashkia Shkodër, arsyeja e mos pajisjes me licencë të pikave të karburantit është fakti se ato nuk paraqesin dokument nga ARSH-ja për hyrje-dalje në rrugë, pasi këto pika janë në anë të rrugëve kryesore dhe pajisja me këtë vërtetim është një nga kriteret për të dhënë licencën e tregtimit me afat 5 vjeçar, por nga Drejtoria e Shërbimeve për asnjë moment nuk është kërkuar informacion nga ARSH nëse këto subjekte janë paraqitur ose jo**,** dhe cila është rruga që ato të pajisjen me leje për të mundësuar marrjen e licencës së tregtimit, kjo pasi aktualisht ato po ushtrojnë aktivitet lirshëm dhe pa asnjë pengesë, duke mos derdhur taksat në favor të Bashkisë Shkodër, shprehur si më sipër.
Drejtoria e Shërbimeve nga ana e saj i është drejtuar Inspektoratit Shtetërore Teknik mbi mos pajisjen e këtyre subjekteve me liçencë tregtim hidrokarbure, konkretisht me shkresën nr. 19424, datë 12.11.2019, nr. 89, datë 6.01.2020, nr. 12486, datë 04.09.2020, nr. 13539/1, datë 01.10.2020, nr. 19755, datë 29.12.2020, nr. 2209, datë 05.02.2021, bazuar në VKM nr. 344, datë 19.04.2017, paragrafi 15.1, por që nga kjo e fundit nuk ka asnjë përgjigje.
Gjithashtu, Drejtoria e Shërbimeve Publike, ndjekjes së Investimeve të infrastrukturës në bashkëpunim me DAV Bashkia Shkodër, Inspektorët e lagjeve dhe Administratorët e NJA është bërë njoftimi i subjekteve pa liçencë me shkresën nr. 1907, datë 30.01.2020 dhe nr. 11715, datë 18.08.2020.

Me shkresën nr. 2672/b, datë 04.09.2020, nr. 3620/b, datë 12.11.2020, nr. 360, datë 02.02.2021 i është dërguar informacion Policisë Bashkiake për mos pajise me Liçensë tregtimi, por që nga kjo e fundit nuk është marrë asnjë masë, duke lejuar këto subjekte të ushtrojnë aktivitet lirshëm.
Konstatohet se ndajë këtyre subjekteve nga instancat përgjegjëse (DAV Bashkia Shkodër, Drejtoria e Shërbimeve Publike, ndjekjes së Investimeve të infrastrukturës dhe Policia Bashkiake), nuk është ndërmarrë asnjë masë për bllokimin dhe penalizmin e veprimtarisë në zbatim të nenit 25 të ligjin nr. 8450, datë 24.2.1999, "Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre", të ndryshuar, veprime të cilat ngarkojnë me përgjegjësi strukturat përkatëse**: z. B.GJ.** me funksion ish- Drejtor të Ardhurave periudha 01.01.2019 – 06.10.2019, **z. GJ.K.** me funksion Drejtor aktual i të ardhurave periudha 22.9.2020 e vijim dhe **z. A.H.** me funksion ish- Kryeinspektor i Policisë Bashkiake periudha 01.01.2019 – 31.12.2020.

**Kriteri:**

Në kundërshtim me ligji nr. 8450, datë 24.2.1999 "Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre", i ndryshuar me ligjin nr. 71/2014 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8450, datë 24.2.1999, "Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre", të ndryshuar, neni 4, neni 20, pika 2 dhe VKM-së nr. 344, datë 19.04.2017, kreu II, pika 9 dhe 10[15]**.**

**Ndikimi/Efekti:**

Mos ndjekja e procedurës për dhënien e Liçensë së tregtimit të karburanteve, çon në mungesë të ardhura për Bashkinë Shkodër me vlerë 66,000 mijë lekë.

**Shkaku:**

Mungesa e bashkëpunimin dhe mos ndjekja e të gjitha rrugëve administrative e ligjore për mos lejimin e ushtrimit të aktivitet pa dokumentacion të rregullt.

**Rëndësia: i lartë**

**Rekomandimi:**

Drejtoria e Shërbimeve Publike, ndjekjes së Investimeve të Infrastrukturës në bashkëpunim me Drejtorinë e të Ardhurave Vendore dhe Policinë Bashkiake, Bashkia Shkodër, të ndjekë të gjitha rrugët administrative e ligjore për pajisen me liçensa të subjekteve që tregtojnë hidrokarbure dhe derivatet e tyre dhe arkëtimin e tarifës së pataksuar prej **40,000,000 lekë** ndajë **40** subjekteve, sipas pasqyrës Aneks 2.6/3 bashkëlidhur Projektraport Auditmit.

**10. Titulli gjetjes:** *Mos arkëtimi i gjobave të Policisë Bashkiake dhe mangësitë e punën e saj.*

**Situata:**

Nga të dhënat e marra nga Policia Bashkiake, konstatohet se për periudhën 01.01.2019 – 31.12.2020 janë aplikuar gjithsej 550 gjoba me vlerë 1,196,500 lekë, *nga e cila:* janë arkëtuar deri me datë 31.12.2020, gjithsej 170 gjoba me vlerë 243,000 lekë dhe mbetet për arkëtim 380 gjoba

[15] "*9. Pagesa për dhënien dhe përsëritjen e liçencave për stacionet e shitjes së karburanteve, gazit të lëngshëm, të naftës për automjetet dhe vajrat lubrifikante, është 3,000,000 (tre milionë) lekë për Bashkinë e Tiranës dhe 1,000,000 (një milion) lekë për bashkitë e tjera."... "10. Pagesa për dhënien dhe përsëritjen e liçencave për njësitë e shitjes së lëndëve djegëse, që ushtrojnë veprimtarinë e tregtimit të tyre për përdorim nga konsumatorët fundorë, është 500,000 (pesëqind mijë) lekë për Bashkinë e Tiranës dhe 100,000 (njëqind mijë) lekë për bashkitë e tjera*".

me vlerë **953,500 lekë**, e ardhur e munguar në buxhetin e Bashkisë Shkodër. *Sipas llojit të gjobës të dhënat bashkëlidhur Aneksi 2.6/4, bashkëlidhur Projektraport Auditimit*.
Referuar të dhënave të gjobave të Policisë Bashkiake, konstatohet se aktiviteti i tyre nuk është përqendruar në punën kryesore, ndjekjen e shkresave të DAR Bashkia Shkodër dhe Drejtorisë Shërbimeve, të cilat lidhen me të ardhurat munguara në buxhetin e kësaj njësie vendore, pasi nuk evidentojmë të jenë paralizuar subjekte për hapësira publike, subjekte që shfrytëzojnë parkime të rezervuara pa kontratë, subjektet e pikave të karburantit të cilat ushtrojnë aktivitet pa u pajisur me leje bashkie, subjekte debitorë, etj., veprime të cilat ngarkojnë me përgjegjësi **z. A.H.** me funksion ish- Kryeinspektor i Policisë Bashkiake periudha 01.01.2019 – 31.12.2020.
**Kriteri:** Në zbatim të rregullores së Bashkisë Shkodër dhe urdhrave të brendshëm.
**Ndikimi/Efekti:**
Mos kryerja e veprimeve në zbatimin e shkresave çon në mungesë të ardhurash për Bashkinë Shkodër.
**Shkaku:** Mos zbatim i kuadrit ligjorë dhe rregullores së brendshme
**Rëndësia: i mesëm**
**Rekomandimi:**
Policinë Bashkiake në bashkëpunim me Drejtoria e të Ardhurave Vendore, të marrë masat administrative e ligjore në të gjitha shkallët e gjykimit për arkëtimin e vlerës së gjobave të paarkëtuara prej **953,500 lekë**
Të ndjek me korrektësi zbatimin e shkresave të dërguara nga Drejtoritë/Sektorët e tjerë që kërkojnë mbështetje për të mundësuar realizmin e të ardhurave të munguara nga parregullsitë ligjore të evidentuara.

- **Kontratat e qirave të Aseteve dhe pyje/kullota**

Nga auditimi i kryer për monitorimin e arkëtimit të detyrimeve nga dhënia e objekteve të ndryshme me qira, kontratat e qirave të përpiluara midis Bashkisë Shkodër dhe personave fizik dhe juridik, datat e lidhjes së kontratave, vendndodhjen e objektit të dhënë me qira, afatin e kontratës, detyrimet, arkëtimet dhe diferencat e pa arkëtuara për periudhën objekt auditimi, paraqiten në vijim:
**Për vitin 2019,** janë lidhur 4 kontrata qiraje për vlerën e detyrimit vjetor 1,689,991 lekë, nga e cila likuiduar për vitin 2019 vlera 1,358,991 lekë, duke mbetur për likuidi vlera 331,000 lekë, vlerë e cila i takon subjekti "B..." për kontratën nr. 2946, datë 23.05.2014 me afat 5 vjeçar dhe objekt "Thertore".
**Për vitin 2020,** janë lidhur 3 kontrata qiraje për vlerën e detyrimit vjetor 227,867 lekë, nga e cila likuiduar për vitin 2020 vlera 227,867 lekë. Të dhënat për çdo kontratë janë në pasqyrën aneks 2.6/4,5 bashkëlidhur akt-konstatimit.
Për mos pagim të kësaj vlera nga Bashkia Shkodër është bërë kërkesë padi nr. 18511, datë 13.12.2017 me palë paditëse "Bashkia Shkodër" dhe paditur subjekti "B...", me objekt: *"Zgjidhja e kontratës së qirasë nr. 2946, datë 23.5.2014, lirimin dhe dorëzimin e objektet për mos përmbushje të kushteve të kontratës (mos pagesë)",* ku vlera e detyrimi të papaguar ndër vite paraqitet në shumën 1,400,000 lekë.
<u>Statusi i çështjes</u> : Gjykata Rrethit Gjyqësor Shkodër me vendimin nr. 235(845) datë 26.02.2018 vendosi: Pushimin e gjykimit te çështjes, me arsyetimin se çështja është zgjidhur me marrëveshje mes palëve sipas marrëveshjes nr. 2996 prot, datë 26.02.2018.

Sipas të dhënave të DAV Bashkia Shkodër, subjekti ka shlyer vlerën 1,350,000 lekë pjesë e detyrimit të prapambetur për vitin 2017, duke mbetur debitor përsëri ne vleftën 200,000 lekë për vitin 2017.
Bashkia Shkodër ka depozituar kërkesë padinë nr. 745 prot, datë 17.01.2019, me pale ndërgjyqësi: Paditës : Bashkia Shkodër i Paditur : B..., person fizik
Objekti :Detyrimin e subjektit "B..." p.f, t'i paguaj paditësit B.SH masën e detyrimit kontraktor (qira mujore) të pashlyer :
> në vlerën 200,000 lekë, për vitin 2017
> në vlerën 1,800,000 lekë, për vitin 2018.
> në vlerën 331,000 lekë, për vitin 2019.
Statusi i çështjes : Gjykata Rrethit Gjyqësor Shkodër me vendimin nr. 1445, datë 11.11.2019 vendosi: -Rrëzimin e kërkesë padisë.
-Veçimin e çështjes përsa i përket gjykimit te kundërpadisë se paraqitur nga personi fizik B....
Bashkia Shkodër ka ushtruar ankim brenda afateve ligjore te njoftimit, me shkresën nr.1424 prot, datë 23.01.2020 pranë Gjykatës së Apelit Shkodër, vazhdon gjykimi.
Personi fizik "B.B", ka depozituar kërkesë padinë datë 14.05.2019, me pale ndërgjyqësi: Kundërpaditë : B..., person fizik, i Paditur : Bashkia Shkodër.
Objekti: Përmbushjen e detyrimeve kontraktore te shprehura ne kontratën e qirasë nr.2946 prot, dt.23.05.2014, neni 4, duke me përjashtuar nga detyrimi i pagimit te vlerës se qirasë për muajt nëntor dhe dhjetor 2017.
Pagimin e shpenzimeve për restaurimin e objektit te marre me qira, ne masën 800,000 lekë te realizuara gjate muajve nëntor dhe dhjetor 2017, ne zbatim të vendimit nr.2161 datë 04.11.2017 te Drejtorisë Rajonale te Autoritetit Kombëtare te Ushqimit Shkodër.
Pagimin e detyrimeve qe kam ndaj bashkisë Shkodër me këste
Statusi i çështjes : Gjykata Rrethit Gjyqësor Shkodër me vendimin nr. 1477, datë 17.12.2019 vendosi:- Pranimin e pjesshëm te kundërpadisë ne pjesën e konvertimit të shumes te detyrimeve kontraktore mes kundër paditësit "B..." dhe të kundërpaditurit Bashkia Shkodër.
Detyrimin e kundërpaditësit B... të dëmshpërbleje të kundërpaditurën bashkia Shkodër ne shumen e mbetur nga konvertimi, detyrim qiraje në shumen prej 1,736,976 lekë, shumë e cila do të paguhet me këste me nga 50,000 lekë/muaj duke filluar nga data 01.02.2020.
-Bashkia Shkodër ka ushtruar ankim brenda afateve ligjore të njoftimit me shkresën nr.1326 prot, datë 22.01.2020 pranë Gjykatës se Apelit Shkodër, vazhdon gjykimi.

- **Sipërfaqet pyjore/kullosore të dhëna me qira.**

Në përmbushje të detyrimeve ligjore për Administrimin/menaxhimin e fondit pyjor kullosor, Bashkia Shkodër ka lidhur kontrata për dhënie me qira për shfrytëzimin e fondit pyjor kullosor për antena të Telefonisë Celularë BST, gjithsej 5 kontratat me të dhëna si më poshtë :

| Nr. | Vendimi i KB | Kontrata | Afati i Lidhjes | Sipërfaqe | Vlera lek/vit |
|---|---|---|---|---|---|
| 1 | nr. 57/ 30.09.2017 | Antene e telefonisë " Lugina e Kirit" | 01.10.2017-30.09.2022 | 205 m2 | 232,445 |
| 2 | nr. 57/ 30.09.2017 | Antene e telefonisë " Pruemos-Sheldi" | 01.10.2017-30.09.2022 | 205 m2 | 179,325 |
| 3 | nr. 57/ 30.09.2017 | Antene e telefonisë " Rosek-Rrjoll" | 01.10.2017-30.09.2022 | 205 m2 | 186,500 |
| 4 | nr. 52/ 19.07.2018 | Antene Telefonisë " Lugina e Kirit" | 28.09.2018-27.09.2023 | 250 m2 | 281,250 |

| Nr. | Vendimi i KB | Kontrata | Afati i Lidhjes | Sipërfaqe | Vlera lek/vit |
|---|---|---|---|---|---|
| 5 | nr. 52/. 19.07.2018 | Antene Telefonisë " Lugina e Shales 2" | 19.08.2018-18.08.2023 | 250 m2 | 281,250 |
| | **TOTAL** | | | | **1,160,770** |

Për vitin 2019 është realizuar një e ardhur prej qirave ne vlerën 2,392,378 lekë dhe për vitin 2020 një e ardhur prej 1,490,890 lekë. Po ashtu Bashkia Shkodër ka dhënë për përdorim nëpërmjet Kontratës një sipërfaqe kullosore të dhënat e të cilës paraqiten më poshtë :

| Nr. | Vendimi i KB | Kontrata | Afati i Lidhjes | Sipërfaqe | Vlera lek/vit |
|---|---|---|---|---|---|
| 1 | VKB nr. 23 dt. 30.04.2018 | Dhënie me qira sipërfaqe kullosore verore , EP Rosek Rrjoll Parcela nr. 3 , fermer Zamir Milani NIPT H70116033E | 01.05.2018-30.04.2027 | 1 HA | 3750 |

**Vlera prej 3750 lek/vit është arkëtuar për vitin 2019 dhe 2020**.
Bashkia Shkodër për vitin 2019 dhe 2020 nuk ka lidhur asnjë kontratë me subjekte të ndryshme për shfrytëzimin për prodhimet e dyta të pyllit.
Për vitin 2019, nga ana e Bashkisë Shkodër u realizua procesi i ankandit për prodhimet e dyta pyjore dhe nuk pati asnjë ofertues. Për vitin 2020 hyrja me hyrjen në fuqi të ligjit nr. 57/2020 "Përfitimet nga shfrytëzimi i produkteve jo drusore nga pylli", Bashkitë duhet të pajisnin subjektet me certifikatë origjine / dokument. i cili duhet të miratohej nga Ministri i Turizmit e Mjedisit me udhëzim të veçantë, dokument i cili ende nuk është miratuar, si rrjedhim në mungesë të tij Bashkia nuk mund të realizoje akoma procedurën e Ankandit.

- *Auditimi i procedurave të kryera për menaxhimin e të ardhurave nga qiradhënia e hapësirave të plazhit nga Bashkia Shkodër*

Në auditimin e ushtruar në dokumentacionin bashkëshoqërues të kontratave të dhënies me qira të hapësirave të plazhit, u konstatua se për vitin 2019 janë lidhur 65 kontrata me vlerë 32,675,216 lekë për sipërfaqen 63300 m$^2$, nga e cila likuiduar vlera 31,496,576 lekë, duke mbetur për arkëtim vlera **1,178,640 lekë, e ardhur e munguar në buxhetin e Bashkisë Shkodër,** konkretisht subjektet:

1- XH.B. për vlerën 576,000 lekë.
2- F.N. për vlerën 156,240 lekë.
3- V.N. për vlerën 223,200 lekë, ku ky subjekt ka lidhur kontratë dhe për vitin 2020 dhe nuk i janë kërkuar detyrimet e vitit 2019.

Ndërsa për **vitin 2020,** janë 67 subjekte që u është dhënë e drejta për shfrytëzimin e hapësirave publike në zonën e plazhit prej 59746 m$^2$ kundrejt pagesës së tarifës së qirasë të miratuar në paketën fiskale.
Detyrimi i evidentuar është në vlerën 39,378,050 lekë dhe pagesat e kryera janë në vlerën prej 39,378,050 lekë.

**11. <u>Titulli gjetjes:</u>** *KLSH-ja konstatoj se nga DAV Bashkia Shkodër, nuk janë ndjekur të gjitha rrugët ligjore për arkëtimin e detyrimeve të pa arkëtuara (borxhi), dhe për të gjithë subjektet.*

**<u>Situata:</u>**
Sipas të dhënave për strukturën organike të DAV Bashkia Shkodër, konstatohet se nuk ka një të ngritur një strukturë përgjegjëse për menaxhimin e borxhit (debitorëve nga taksat/ tarifat vendore). Referuar të dhënave të paraqitura nga kjo drejtori, detyrimet për taksat e tarifat vendore për subjektet fizik/juridik dhe abonentë familjare paraqitet si vijon:

*Në 000/lekë*

| Lëvizja e Debitorëve | Subjekte juridik/Institucioni Shtetërore | | Subjekte fizik | | Abonentë familjare | | Totali | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | Nr. | Vlerë | Nr. | Vlerë | Nr. | Vlerë | Nr. | Vlere |
| Gjendje 31.12.2018 | 749 | 67,528 | 3472 | 116,002 | 10861 | 819,474 | **15082** | **1,003,004** |
| Shtuar Viti 2019 | | 378,660 | | 331,346 | | 169,846 | **0** | **879,852** |
| Pakësuar Viti 2019 | | 252,587 | | 186,062 | | 362,169 | **0** | **800,818** |
| Gjendje me 31.12.2019 | 788 | 193,601 | 3889 | 261,286 | 6380 | 627,151 | **11057** | **1,082,038** |
| Shtuar Viti 2020 | | 305,382 | | 227,995 | | 145,899 | **0** | **679,276** |
| Pakësuar viti 2020 | | 275,996 | | 115,826 | | 195,375 | **0** | **587,197** |
| Gjendje me 31.12.2020 | 1647 | 222,987 | 12239 | 373,455 | 6592 | 577,675 | **20478** | **1,174,117** |

Nga të dhënat konstatohet se detyrimet debitorë paraqiten në rritje nga njëra periudhë në tjetrën, ku nga 8614 subjekte me vlerë 788,835 mijë lekë në fund të vitit 2019, në fund të vitit 2020 kjo gjendje paraqitet për 20478 subjekte me vlerë 1,174,117 mijë lekë, **pra shtuar për 9421 subjekte me vlerë 92,079 mijë lekë ose shtuar për 8.5%.**
Peshën kryesorëve të detyrimeve për taksat e tarifat vendore e zënë abonentët familjarë, ku në fund të vitit 2020 paraqiten me një vlerë prej 577,675 mijë lekë ose 49.1%, detyrime të cilat mblidhen nga agjenti tatimorë "U..." sh.a.
Konstatohet se çdo vit gjendja e detyrimeve të paarkëtuara është më e lartë se arkëtimet e vitit, kjo për vlerën e detyrimeve të mbetura.

Nga të dhënat, konstatohet se me gjithë masat e marra nga DAV Bashkia Shkodër, niveli i detyrimeve nga një periudhë në tjetrën vjen në rritje si në numri dhe vlerë.

*<u>Pamja grafike</u>*



Referuar dokumentacionit të paraqitur nga DTTV mbi masat e marra në lidhje me punën e kësaj drejtorie ne arkëtimin e debitorëve, në zbatim të ligji nr. 9920, datë 19.05.2008 **"**Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë**"**, me ndryshime, Udhëzimit nr. 24, datë 02.09.2008 **"**Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë**"**, me ndryshime, rezulton se në shkresat përcjellëse (trajtuar në akt-konstatim), nuk janë përcaktuar vlerat për të cilën është kërkuar bllokim dhe sa rezultat ka pasur ky veprim. Nuk i janë dërguar shkresa adresuar Drejtorisë së Transportit për marrjen e masave në arkëtimin e vlera të subjekteve që disponojmë mjete.

- Në raport me numrin e subjekteve debitorë në fund të periudhave ushtrimore dhe subjekteve për të cilat është kërkuar në zbatim të ligjit masa shtrënguese, konstatohet se është shumë i vogël, kështu nga 11697 subjekte fizik/ juridik me vlerë 300,632 mijë lekë është zbatuar marrje masa vetëm për 984 subjekte ose 8.4% e totalit të subjekteve. Nuk konstatohet të jenë dërguar njoftim detyrimi për vlerën e borxhit, bllokim të aktivitet për mos likuidim të detyrimeve, vendosja sekuestro dhe deri në kallëzim penal për mos pagës taksa në zbatim të kodi penal, nisur dhe nga fakti se një pjesë e subjekteve janë debitorë në vite dhe për çdo vit ju planifikohen detyrime fiskale të vitit ne vijim.

- Në lidhje me detyrimet për abonentëve familjarë, sipas të dhënave të paraqitura nga DAV Bashkia Shkodër, menaxhimi i kësaj tarife bëhej me dy mënyra, nëpërmjet U... sh.a (abonentët me kontratë) dhe nga vetë bashkia për personat që vijnë në bashki për kryerjen e punëve të ndryshme (abonentë me TF), por që ka dhe një pjesë të konsiderueshme të abonentëve familjarë, të cilat nuk paraqiten në Bashkinë Shkodër për veprime të ndryshme dhe nuk u është ngarkuar njoftim detyrimi.
- Në plotësimin e regjistrave, nuk ka një standard të unifikuar të mbajtjes së tyre dhe informacioni në më të shumtën e rasteve nuk pasqyron hapat e ndjekur për secilin subjekt, në lidhje me likuidimet e kryera në vazhdimësi, gjë që e bën të vështirë analizën në kohë reale të debitorëve, mënyrën e ndjekjes apo kohën e arkëtimit të detyrimit.
- Për një pjesë të subjekteve nuk janë nxjerre njoftim detyrimet për vlerën e borxhit, por është kaluar direkt në zbatimin e hapave të mëvonshme.
- Në momentin e nxjerrjes së urdhër bllokimi të llogarive bankare, në shumicën e rasteve, nuk ka konfirmim nga banka për gjendjen e llogarive të subjektit. Nga ana e DAV Bashkia Shkodër disa herë bankave të nivelit të dytë i është kërkuar zbatimi i urdhër bllokimeve të subjekteve debitorë mbi vlerën e detyrimeve të paarkëtuara, por këto të fundit nuk kanë vepruar.
- Për Institucionet shtetërore, të identifikuar si debitorë nga DAV Bashkia Shkodër është ndjekur vetëm procedura e nxjerrjes së njoftimit për pagesë të detyrimeve tatimore dhe nuk është vazhduar me asnjë procedurë tjetër.
- Nuk janë respektuar afatet ligjore nga një procedurë në një tjetër, duke çuar kështu në mos mbledhjen në kohën e duhur të detyrimit.
- Nuk u konstatuan raste për vendosje barrë siguruese dhe hipotekore, apo Njoftim për bllokim të dokumentacionit të mjeteve në pronësi, nga institucionet përkatëse, pothuajse në shumicën e rasteve nuk ka konfirmim të pronës apo mjeteve që subjekti ka në pronësi, dhe mbi të gjitha nuk është vepruar.
- Mos zbatimi i plotë i masave shtrënguese, ku për subjektet me vlera të konsiderueshme dhe që janë me status aktiv, janë lejuar të ushtrojë aktivitet ndërkohë që vlera e borxhit vjen në rritje nga njëra periudhë në tjetër, duke pritur nga ndonjë amisti fiskale ose parashkrim të gjobave.

- Nga DAV Bashkia Shkodër nuk është ndërhyrë në zbatimin e dispozitave ligjore, deri në padi gjyqësore për arkëtimin e borxhit në zbatim të nenit 15, të Kodit Civil në Republikën e Shqipërisë dhe nenit 203 të Kodit të Punës në Republikën e Shqipërisë, apo të parashikimit të vendimeve (vlerave) të gjobave të përcaktuara në nenin 46 të ligjit "Për Kundërvajtjet Administrative" (brenda 2 viteve), duke u bërë përgjegjës për rritjen e nivelit të borxhit.

- **Dinamika e debitorëve**

Referuar të dhënave të paraqitura nga DAV Bashkia Shkodër, konstatohet se dinamike e debitorëve paraqitet si vijon:

*Në 000/lekë*

| Dinamika e debitorëve | Nr. | Vlerë | Ne % |
|---|---|---|---|
| Debitor nga 0 deri ne 1 vit | | 189,824 | 16.16738 |
| Debitor nga 1 deri në 3 vite( < 1 dhe >=3) | | 546,479 | 46.54383 |
| Debitor për 4 vite | | 277,167 | 23.60642 |
| Debitor pa shprese arkëtimi | | 160,647 | 13.68237 |
| **SHUMA** | | **1,174,117** | |

Nga pasqyra konstatohet se, vlerën më të lartë e zënë debitor nga 1 deri 3 vite, në një nivel 46.5% e ndjekur nga debitorë mbi 4 vite me 23.6%, të dhëna këto të cilat flasin për punën e pamjaftueshme të DAV Bashkia Shkodër në zbatimin e procedurave për arkëtimin e detyrimeve debitorë, **ku në vlerë totale (1,174 milionë lekë) kap afërsisht 2 plane vjetore të të ardhurave të vitit të planifikuar**. **Kjo tregon punën e pamjaftueshme të Sektorit të MB në mos zbatimin e masave shtrënguese dhe lënien në harrese të subjekteve me detyrime.**

- **Statusi i detyrimeve të paarkëtuara**.

Referuar të dhënave të paraqitura nga DAV Bashkia Shkodër, konstatohet se statusi i detyrimeve të paarkëtuara paraqitet si vijon:

| Nr. | STATUSI | Nr. | Vlera e borxhit |
|---|---|---|---|
| 1 | Apl. Çregjistrim | | ska info |
| 2 | Fshirje | | ska info |
| 3 | Mbyllje aktiviteti | 1377 | 118,502 |
| 4 | Subjekte pasiv | 2172 | 237,786 |
| | **SHUMA** | **3549** | **356,288** |

Nga të dhënat evidentohet se një numër i konsiderueshëm subjektet me status pasiv/mbyllur paraqiten me situatë debitorë me vlerë 356,288 mijë lekë, ku përgjegjësia është si Administratës së QKB po ashtu dhe DAV Bashkia Shkodër, e cila ka lejuar mbylljen e tyre subjekteve pa likuiduar detyrimet fiskale, duke u bërë premisë për kalimin e tyre në borxh të paarkëtueshëm. Në këto kushte DAV Bashkia Shkodër duhet të ketë një bashkëpunim me të madh me Administratën e QKB dhe mos lejoje fenomene të tilla, si dhe për subjektet të cilat janë me status pasiv/mbyllur të ndiqen procedura ligjore për kallëzim penal nëse ato nuk paraqiten me dëshirë për kryerjen e pagesave, pasi në raport me vlerën totale të detyrimeve të paarkëtuara zënë 30.3% të totalit.

**Kriteri:**

Pikat 3,4, 5 dhe 5, të nenin 45 – *"Çregjistrimi i subjekteve tatimore"* dhe Kreun XI-*Mbledhja me forcë e detyrimit tatimor të papaguar,* të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 "Për procedurat tatimore

në Republikën e Shqipërisë", me ndryshimet dhe Udhëzimit nr. 24, datë 02.09.2008 **"**Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë**"**, me ndryshime; ligjin nr. 7895, datë 27.01.1995, me ndryshimet e mëvonshme, neni 181 -*Mospagimi i taksave dhe tatimeve*[16].

**<u>Ndikimi/Efekti:</u>**

Mos ndjekja e plotë e procedura për arkëtimin e detyrimeve, rrit nivelin e detyrimeve të paarkëtuara në fund të periudhave ushtrimore, si një e ardhur e munguar në buxhetin e bashkisë, ku në fund të vitit 2020 ka një vlerë afërsisht sa 2 plane vjetore të të ardhurave të Bashkisë Shkodër.

**<u>Shkaku:</u>**

Mos njohja dhe mos zbatimi i kuadrit ligjorë në fuqi, si dhe mungesa e një strukturë organizative të përshtatshme.

**<u>Rëndësia:</u> i lartë**

**<u>Rekomandimi:</u>**

Drejtoria e të Ardhurave Vendore Bashkia Shkodër, bazuar në nenin 70 pika 3 "*E drejta për të nxjerrë njoftimin e vlerësimit tatimor*", të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 "Për Procedurat tatimore në R.SH", i ndryshuar, të marrë masa për nxjerrjen e njoftim vlerësimet tatimore për debitorët duke ndjekur të gjitha rrugët për arkëtimin e detyrimeve për taksat dhe tarifat vendore në vlerën **1,174,117 lekë**, duke ndjekur procedurat si më poshtë vijon**:**

f- Tu dërgohen bankave të nivelit të dytë urdhrat e bllokimit të llogarive bankare.

g- Të dërgohet në Drejtorinë Rajonale të Transportit, kërkesa për vendosjen e barrës siguruese (për mjetet) dhe në AKSH (për pasuritë e paluajtshme).

h- Për subjektet të cilët nuk kanë paguar detyrimet tatimore në afat, ndaj tyre të aplikohet llogaritja e gjobës në masën 0.06% të shumës së detyrimit të papaguar për çdo dit gjatë së cilës pagesa nuk është kryer, por jo më shumë se 365 ditë (gjobë).

i- Në rast se bizneset private edhe pas njoftimeve zyrtare dhe dërgimit të urdhër bllokimeve në bankë nuk kryejnë pagesën e detyrimeve, pasi të merren masat administrative apo sekuestro, të bëhet kallëzim penal, bazuar në Kodin Penal të RSH, miratuar me ligjin nr. 7895, datë 27.1.1995 me ndryshimet e mëvonshme, neni 181 "Mospagimi i taksave dhe tatimeve".

j- Drejtoria e të Ardhurave Vendore Bashkia Shkodër, në bashkëpunim me Njësitë Administrative, të evidentojë listat emërore të debitorëve familjarë në mënyrë elektronike, duke të njoftojë nëpërmjet postës (dhe jo vetëm) familjet të cilët nuk kanë paguar detyrimet për taksën e tokës/ tarifën e pastrimit, ndriçimit, banesave dhe gjelbërimit.

- Të bashkëpunimet me QKB për mos lejimin e mbylljes së aktivitetit ose kalimi në pasiv të subjekteve me detyrime të paarkëtuara, të cilat kanë premisë për kalimin në debitorë pa shpresë arkëtimi, si dhe të kryhen kontrolle të vazhdueshme në bashkëpunim dhe me Policinë Bashkiake për evidentimin dhe vjeljen e detyrimeve debitorë.
- Kryetari i Bashkisë Shkodër në bashkëpunim me Drejtorinë e të Ardhurave vendore, të marrin masa që brenda strukturës së DAV Bashkia Shkodër, të krijojnë "Sektorin e Menaxhimit të Borxhit", si një sektor i rëndësishëm në punën për arkëtimin e debitorëve, nisu kjo dhe nga vlera e lartë e detyrimeve të paarkëtuara dhe që vijnë në rritje nga njëra periudhë në tjetrën.

**Për mangësitë e mësipërme me personat përgjegjës: z. GJ.K.** me funksion Drejtor i të Ardhurave vendore periudha 22.09.2020 e vijim, **z. D.K.**, me funksion ish- Drejtor komanduar i të Ardhurave vendore, periudha 06.10.2019 – 22.09.2020, **z. B.GJ.** me funksion ish- Drejtor të Ardhurave periudha 01.01.2019 – 06.10.2019, **zj. E.K.,** me funksion Përgjegjëse e Sektorit të Regjistrimit dhe

[16] Mospagimi i taksave dhe tatimeve brenda afatit të caktuar, megjithëse mundësinë e pagimit të tyre, nga personi ndaj të cilit janë marrë më parë masa administrative për këtë qëllim, dënohet me gjobë ose me burgim gjer në tre vjet.

Vlerësimit të Biznesit, **z. F.K.,** me funksion Përgjegjës i Sektorit të Taksave e Tarifave Vendore për familjarët, **zj. F.D.** me funksion Përgjegjës i Sektorit të Kontabilitetit dhe rakordimit të të Ardhurave, **z. S.Z.,** me funksion Drejtor Drejtoria e Kontrollit të Zhvillimit të Territorit, **z. A.H.** me funksion ish- Kryeinspektor i Policisë Bashkiake periudha 01.01.2019 – 31.12.2020 është mbajtur akt-konstatimi nr. 13, datë 04.06.2021, prot Bashkia Shkodër nr. 4597/31, datë 04.06.2021.

Nga specialistët e DAV Bashkia Shkodër me shkresën nr. 4597/55, datë 16.7.2021 *(port KLSH nr. 362/16, datë 21.7.2021)*, janë paraqitur kundërshti në lidhje me mangësitë e konstatuara në menaxhimin e të ardhurave nga taksat e tarifat vendore.
Grupi i KLSH, pasi i analizojnë me kujdes dhe paanshmëri si dhe sqarimeve që mori në takimin përmbyllës të datës 30.7.2021 arrin në konkluzionin se disa prej tyre qëndrojnë dhe janë marrë në konsideratë dhe disa nuk qëndrojnë duke i reflektuar në këtë raport përfundimtar auditimi, si më poshtë vijon:
*- Pretendimi i subjektit Bashkia Shkodër në lidhje me rillogaritje e detyrimeve për subjektet "C...", "P..." dhe "D...", të cilat nuk kanë paguar taksë ndërtesë, nuk qëndron, pasi nga KLSH rillogaritja është marrë në konsideratë nga momenti i lejes së përdorimit të dhëna këto të marra në Drejtorinë e PZHT Bashkia Shkodër.*
*- Në lidhje me pretendimet mbi mos aplikimin e taksës së tokës bujqësore, sqarojmë se nga KLSH është konstatuar vetëm fakti i mos taksimit të një pjese të sipërfaqes së ndarë dhe ku si tarifa janë aplikuar ato të miratuara me VKM. Në këto kushte argumenti juaj nuk qëndron dhe gjetja mbetet.*
*- Në lidhje me problematikën e konstatuara në subjektet që tregtojnë hidrokarbure dhe derivatet e tyre, nga KLSH-ja është marrë në konsideratë vetëm fakti i dublimit të subjekteve, megjithëse lista është serviru nga vetë bashkia. Ndërsa argumentet e tjera nuk qëndrojnë.*
*- Merret në konsideratë problematika e subjekteve që shfrytëzojnë parkime të rezervuara, ku sipas dokumentacionit rezulton se ato janë taksuar dhe likuiduar detyrimin.*

- **Mbi organizimin dhe funksionimin e IVMT. Realizimi i të ardhurave nga sektori i IMTV, Bashkia Shkodër.**

Inspektorati Vendor i Mbrojtjes të Territorit, për periudhën 01.07.2019 - 31.12.2020, është ngritur dhe funksionon në bazë të nenit 4, të ligjit nr. 9780, datë 16.07.2007, "*Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme",* me 13 punonjës në strukturë, nga të cilët 1 Kryeinspektor, 3 specialist, 3 inspektor dhe 6 ndihmës inspektorë.
Arsimimi i Kryeinspektorit dhe 3 inspektorëve është në përputhje me nenin 11 të ligjit nr. 9780, datë 16.7.2007, "*Për inspektimin dhe* mbrojtjen *e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme*", i ndryshuar, por vihet re që në përbërje janë vetëm 2 inxhinierë dhe pjesa tjetër janë juristë, ndërsa 6 ndihmës inspektorët janë me arsim të mesëm, në kundërshtim me nenin 11 i ligjit të mësipërm.

**12. <u>Titulli i gjetjes</u>:** *Inspektorati Vendor i Mbrojtjes së Territorit, Bashkia Shkodër, ka mungesa të punonjësve të kualifikuar për kryerjen e inspektimit në fushën e ndërtimit dhe mos arkëtim të gjobave të aplikuara.*

**<u>Situata</u>:**
Në lidhje me auditimin e kryer të dokumenteve të vëna në dispozicion nga zyra e IVMT Bashkia Shkodër, për ushtrimin e kontrollit në terren të kontrollit mbi territorin e Bashkisë, nga IVMT, rezultoi se janë mbajtur gjithsej 197 procesverbale konstatimi për ndërtime pa leje.
Janë nxjerrë 197 vendime gjobash për ndërtime të kundërligjshme nga persona të ndryshëm fizik dhe juridik, sipas aneksit bashkëlidhur këtij akti, *nga e cila:* për gjashtë mujorin e dytë të vitit 2019, janë nxjerrë 59 vendime për gjobë për shkelje të legjislacionit në fushën e ndërtimit me vlerë 23,660,000 lekë, janë likuiduar **10** gjoba me vlerë **1,250,000 lekë**.
Për pjesën e gjobave të mbetur, 49 gjobat me vlerë 22,410,000 lekë, nga IVMT Bashkia Shkodër janë bërë kërkesë paditë drejtuar Gjykatës për kthimin e gjobave në titull ekzekutiv si dhe i janë përcjellë zyrës përmbarimore për ekzekutimin e vendimeve të gjykatës.
Ndërsa **për vitin 2020**, janë nxjerrë 138 vendime me vlerë 51,480,000 lekë, janë likuiduar **25** gjoba me vlerë **2,020,000**. Gjobat e nxjerra për 5 mujorin e parë të vitit 2020, i janë përcjellë gjykatës për kthimin e tyre në titull ekzekutiv, ndërkohë që nuk ka vendimmarrje për asnjë nga kërkesat e vitit 2020. Pjesa tjetër e gjobave rezultojnë në proces hartimi të kërkesë padisë.
Nga ana tjetër, IMT ka përcjellë gjithashtu pranë Drejtorisë së të Ardhurave të gjitha gjobat nëpërmjet sistemit. Është bërë kontabilizimi i tyre.
Nga sa trajtuam më sipër, për periudhën objekti auditimi nga IVMT janë penalizuar për shkelje të aktive ligjore e nënligjore të ndërtimit, gjithsej 197 vendime me gjobë për vlerën 75,140,000 lekë, ku arkëtuar për këtë periudhë janë 35 gjoba me vlerë 3,270,000 lekë, duke mbetur për arkëtim vlera **71,870,000 lekë,** si mungesë të ardhurash në buxhetin e Bashkisë Shkodër**.**
Nga 162 gjoba me vlerë 71,870,000 lekë, për mos pagim të vlerës, IVMT i është drejtuar me kërkesë paditë drejtuar Gjykatës për kthimin e gjobave në titull ekzekutiv për 81 gjoba me vlerë 36,200,00 lekë, si dhe i janë përcjellë zyrës përmbarimore për ekzekutimin e vendimeve të gjykatës.
Në strukturën organizative të IVMT, konstatohet se ka të punësuar vetëm 2 inxhinierë të cilët përmbushin kriteret ligjore për kryerjen e inspektimit, ndërkohë që pjesa tjetër janë ndihmës inspektorë. Duke qenë se territori i Bashkisë Shkodër ka një shtrirje të madhe dhe në përbërje të saj janë dhe zona me rëndësi kombëtare si Plazhi i Velipojës, Parku Kombëtar i Thethit, Liqeni i Shkodrës etj., inspektimi me juristë dhe ndihmës inspektorë mund të jetë jo cilësor. Gjithashtu, rritja e kapaciteteve me inxhinierë është e nevojshme edhe për mbajtjen e akteve të kontrollit për objektet e pajisura me leje ndërtimi sipas fazave të përcaktuara.
**<u>Kriteri</u>:**
Ligji nr. 9780, datë 16.07.2007 "Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme" i ndryshuar, nenet 11, 12 13 .
**<u>Ndikimi/Efekti:</u>**
Ndikon në cilësinë e inspektimit, dhe në kontrollin e zbatimit të lejeve të ndërtimit të dhëna dhe mungesë të ardhurash në vlerën 71,870 mijë lekë në buxhetin e Bashkisë Shkodër
**<u>Shkaku</u>:** Mos rekrutimi i punonjësve të kualifikuar.
**<u>Rëndësia</u>: E Lartë**

**Rekomandimi:**

- Inspektorati Vendor i Mbrojtjes së Territorit në bashkëpunim me Sektorin Juridik në Bashkinë Shkodër, të marrë masa duke ndjekur të gjitha rrugët administrative e ligjore për arkëtimin e vlerës **71,870,000 lekë ndajë 162 personave** për ndërtime të paligjshme, si dhe mos lejimin e parashkrimit të tyre.
- Kryetari i Bashkisë Shkodër në bashkëpunim me Drejtorinë e Burimeve Njësore, të vlerësojë mundësinë e strukturimit të IVMT Bashkia Shkodër me specialist me kualifikim në fushën e inxhinierisë (mundësisht të ndërtimit), për të rritur cilësinë e inspektimit dhe kontrollin e lejeve të ndërtimit.

*(Më hollësisht trajtuar në faqen 44-78, të Projektraport Auditmit)*

**III/2.3. Vlerësimi Raportimit Financiar, për të arritur në opinionin në se pasqyrat financiare për vitet 2019-2020, japin një paraqitje të vërtetë e të drejtë të pozicionit financiar, performancës financiare dhe fluksit të parasë, bazuar në kuadrin rregullator në fuqi dhe konkretisht, ligjin nr. 24/2018, datë 10.05.2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare" si dhe udhëzimi MFE nr.08, datë 09.03.2018 "Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme".**

1. **Titulli gjetjes:** *Mbi kontabilizimin e llogarisë 466 "Kreditorë për mjete në ruajtje".*

**Situata:**
Llogaria 466 "*Kreditore për mjete nën ruajtje*", sipas Pasqyrës së Pozicionit Financiar, në fund të vitit 2019 paraqitet në vlerën 92,179,959 lekë dhe në fund të vitit 2020 paraqitet në vlerën 93,508,882 lekë, e cila përfaqëson vlerën e garancisë së kontratave në masën 5%.
Nga analiza e këkaj llogarie rezultoi se, vlera në fund të vitit 2019 dhe 2020, ka pasur në përbërje të llogarisë detyrime për garanci punimesh të bashkisë ndaj subjekteve privatë, garanci këto të cilave u ka kaluar afati i përcaktuar në kontratat përkatëse të investimit dhe përsëri janë akoma gjendje në llogarinë 466. Sistemimi i vlerës totale të llogarisë 466 "*Kreditore për mjete nën ruajtje*", duhet të bëhet duke njoftuar subjektet për paraqitjen e dokumentacionit të nevojshëm për të sistemuar dhe pastruar garancitë të cilat tashmë u ka kaluar afati i përcaktuar në kontratën e investimit përkatës.
Përfundimisht për vitin 2019 dhe 2020, llogaria 466 "*Kreditore për mjete nën ruajtje*" është mbivlerësuar për 3,670,249 lekë për vitin 2020 dhe 690,238 lekë për vitin 2019, për të cilat duhet të bëhet sistemimi i llogarisë.

**Kriteri:**
Baza ligjore mbi të cilën është vlerësuar situata e cila paraqet parregullsi janë; ligji 28/2018 datë 10.05.2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare" neni 5, 6, 7, 9 dhe 10" ; ligjin 10296 datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" neni 6, udhëzimin nr.8 datë 09.03.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme" seksioni "Funksionimi kontabël i llogarive të tjera të klasës 4., Llogaria 466 " Kreditorë për mjete në ruajtje"

**Ndikimi/Efekti:**

Mos regjistrimi në kontabilitet dhe deformim i informacionit financiar për sa i përket gjendjes kontabël të paraqitur në Pasqyrat e Pozicionit Financiar për vitin 2020 të llogarisë 466 "Kreditorë për mjete në ruajtje"

**Shkaku:**

Mos njohja dhe mos zbatim i udhëzimit nr.8 datë 09.03.2018 *"Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme"*.

**Rëndësia: E lartë**

**Rekomandimi:**

Drejtoria e Financës në bashkëpunim me Drejtorinë e Shërbimeve Publike, të marrë masa për të bërë sistemimin e llogarisë 466 "*Kreditore për mjete nën ruajtje*", duke rakorduar drejtoritë njëra me tjetrën çdo muaj mbi balancat e llogarisë 466, si dhe duke njoftuar subjektet për paraqitjen e dokumentacionit të nevojshëm për të sistemuar dhe pastruar garancitë të cilat tashmë u ka kaluar afati i përcaktuar në kontratën e investimit përkatës.

**2. Titulli gjetjes:** *Mbi kontabilizimin e llogarisë 401- 408 "Furnitorë e llogari te lidhura me to" si dhe 467 "Kreditorë të ndryshëm".*

**Situata:**

Llogaria 401- 408 "*Furnitorë e llogari te lidhura me to*" si dhe 467 "*Kreditorë të ndryshëm*", përfaqësojnë detyrimet e vitit si dhe detyrimet e prapambetura ndaj të tretëve, për shpenzime, shërbime apo investime të kryera. Është vënë re fenomeni i likuidimit pjesor të faturave që janë pranuar nga Drejtoria e Financës. Kjo ka ardhur si shkak i lidhjes së kontratave të investimeve, zbatimi i të cilave nuk përputhet në kohë me kohën e financimit të tyre. Praktikisht zbatimi i kontratave arrin nga 3 deri në 6 muaj, ndërsa financimi i pikërisht këtyre kontratave shkon deri në 3 vjet, sipas planit të pagesave dhe PBA 3vjecare. Duke analizuar faturat e investimeve të regjistruara për vitet 2019, u vu re se regjistrimi i disa prej tyre nuk ishte bërë për vlerën e plotë të faturës. Më poshtë paraqiten vlerat e faturave të regjistruara dhe diferenca për tu regjistruar si detyrim për vitin 2019;

| | | | | | | | *Viti 2019* | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Nr. | Objekti i Kontrates | Shuma e Fatures | Date | Serial | Rregjistruar ne 401-404 | Rregjistruar ne 467 | Detyrimi i parregjistruar 401-408 | Detyrimi i parregjistruar 467 |
| 1 | Sistemim asfaltim i rruges Muriqan-Gorice, Situacion nr. 2 perfundimtar | 12,104,756 | 02.12.2019 | 63644460 | 7,836,756 | | 4,268,000 | |
| 2 | Rikonstruksion degezime rruga e Shirokes, Situacion nr. 2 perfundimtar | 6,965,000 | 13.12.2019 | 68337709 | 3,152,167 | | 3,812,833 | |
| 3 | Rikonstruksion rruga Shasi Situacion Nr. 1 perfundimtar | 12,126,492 | 22.12.2019 | 38259513 | 3,841,492 | | 8,285,000 | |
| 4 | Rikonstruksion rruga Brioti Situacion Nr. 1 perfundimtar | 17,974,764 | 23.12.2019 | 38259514 | 11,753,764 | | 6,221,000 | |
| 5 | Rikonstruksion rruga Oblike-Velinaj-Alimetaj Loti 3, Situacion nr. 2 perfundimtar Likuidim pjesor | 6,099,781 | 01.11.2019 | 79556453 | | 2,000,000 | | 4,099,781 |
| | Totali | 55,270,793 | | | 26,584,179 | 2,000,000 | ***22,586,833*** | ***4,099,781*** |

Pra në përfundim, për vitin 2019, llogaria 401-408 "*Furnitorë e llogari të lidhura me to*" është nënvlerësuar për 22,586,833 lekë dhe llogaria 467 "*Kreditorë të ndryshëm*" është nënvlerësuar me 4,099,781 lekë.

**Kriteri:**

Baza ligjore mbi të cilën është vlerësuar situata e cila paraqet parregullsi janë; ligji 28/2018 datë 10.05.2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare" neni 5, 6, 7, 9 dhe 10, ligjin 10296 datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", urdhrit nr.64 datë 22.07.2014 " Për shpallje të Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit të Përmirësuara" dhe Standardet Kombëtar të Kontabilitetit nr.1 "Kuadri i përgjithshëm për përgatitjen e pasqyrave financiare".

**<u>Ndikimi/Efekti:</u>**

Mos regjistrimi në kontabilitet dhe deformim i informacionit financiar për sa i përket gjendjes kontabël të paraqitur në Pasqyrat e Pozicionit Financiar për vitin 2019 të llogarisë 401-408 "Furnitorë e llogari të lidhura me to" dhe 467 "Kreditorë të ndryshëm".

**<u>Shkaku:</u>**

Mos njohja dhe mos zbatim i kuadrit të përgjithshëm të përgatitjes së pasqyrave financiare

**<u>Rëndësia:</u> E lartë**

**<u>Rekomandimi:</u>**

Nga Drejtoria e Financës, të merren masa për të bërë sistemimin e llogarisë 401-408 "*Furnitorë e llogari të lidhura me to*" dhe 467 "*Kreditorë të ndryshëm*", të cilat janë nënvlerësuar përkatësisht me 22,586,833 lekë dhe 4,099,781 lekë për vitin 2019. Gjithashtu, pas saktësimit të detyrimeve të prapambetura, duhet të merren masa për raportimin e tyre në Ministrinë e Financave, raportim i cili aktualisht nuk është real.

3. **<u>Titulli gjetjes:</u>** *Mbi kontabilizimin e llogarisë 486 "Shpenzime të periudhave të ardhshme" dhe llogarisë 481 "Shpenzime për tu shpërndarë".*

**<u>Situata:</u>**

**Për vitin 2019**

*481 Shpenzime për tu shpërndarë* 180,430,320 lekë te *401- 404- Furnitorë e llogari të lidhura me to* 180,430,320 lekë

*486 Shpenzime të periudhave të ardhshme* 10,931,136 lekë te *467- Kreditorë të ndryshëm*. 10,931,136 lekë

**Për vitin 2020**

*481 Shpenzime për tu shpërndarë* 80,414,087 lekë

*486 Shpenzime të periudhave të ardhshme* 3,199,930 lekë te *401- 404 Furnitorë e llogari të lidhura me to* 83,614,017 lekë

Duke analizuar faturat e investimeve të cilat janë klasifikuar si 401-408, por që në fakt kontrata e investimit të të cilave ka filluar në vitin 2019 dhe likuidim i tyre kalon në vitet 2020 dhe 2021, duhet riklasifikuar në 467 si detyrime të prapambetura, si dhe duhen debituar në kundërparti në llogarinë 486- Shpenzime te periudhave te ardhshme. Sistemimi kontabël në nivel fature paraqitet ne **aneksin 2,** për vitet 2019 dhe 2020

**<u>Kriteri:</u>**

Baza ligjore mbi të cilën është vlerësuar situata e cila paraqet parregullsi janë; *ligjin 28/2018 datë 10.05.2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare*" neni 5, 6, 7, 9 dhe 10, *ligjin 10296 datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", urdhrit nr.64 datë 22.07.2014 " Për shpallje të Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit të Përmirësuara*" dhe *Standardet Kombëtar të Kontabilitetit nr.1 "Kuadri i përgjithshëm për përgatitjen e pasqyrave financiare*" ku përcaktohet qartë së detyrimet njihen në momentin që lindin dhe jo në momentin kur kemi nxjerrje të likuiditeteve. si **dhe udhëzimin nr. 8 , datë 09.03.2018, pika 42 ku citohet;**

**<u>Ndikimi/Efekti:</u>**

Mos regjistrimi në kontabilitet dhe deformim i informacionit financiar për sa i përket gjendjes kontabël të paraqitur në Pasqyrat e Pozicionit Financiar për vitin 2019 dhe 2020 të llogarisë 486 “Shpenzime të periudhave të ardhshme” dhe llogarisë 481 “Shpenzime për tu shpërndarë”.

**Shkaku:**

Mos njohja dhe mos zbatim i kuadrit të përgjithshëm të përgatitjes së pasqyrave financiare

**Rëndësia: E lartë**

**Rekomandimi:**

Nga Drejtoria e Financës, të merren masa për të bërë sistemimin llogarive, përkatësisht; Llogaria 481- *Shpenzime për tu shpërndarë*, duhet të sistemohet në vlerë, duke kaluar në llogarinë 486- *Shpenzime të periudhave të ardhshme*, si dhe llogaria 401-404- *Furnitorë e llogari të lidhura me to* për të gjitha faturat e aneksit 2 të cilat duhet të sistemohet në llogarinë 467- *Kreditorë të ndryshëm,* duke qenë se këto fatura për investime përbëjnë detyrime të prapambetura.

4. **Titulli gjetjes:** *Mbi kontabilizimin e llogarisë 468 "Debitorë të ndryshëm" dhe llogaria 475 "Të ardhura për t'u regjistruar vitet pasardhëse".*

**Situata:**

Regjistrim në kontabilitet i debitorëve, të cilët në analitiken e tyre përbëhen nga debitorët nga taksat dhe tarifat e bizneseve, familjet, gjobat e IMTV aktuale dhe ndër vite debitorët e trashëguar ndër vite nga ish komunat, sot njësit administrative, si dhe nga kamatëvonesa të cilat përbëjnë të ardhura të paarkëtuara, për vitet 2019 dhe 2020 është bërë si më poshtë;

**Për vitin 2019**

*468 “Debitorë të ndryshëm”* 1,083,319,116 lekë, te *4341 “Operacione me shtetin (detyrime)”* 35,763,928 lekë

*475 “Te ardhura për t'u regjistruar vitet pasardhëse”* 1,048,001,223 lekë

**Për vitin 2020**

*468 “Debitorë të ndryshëm*” 1,174,224,674 lekë te *475 Te ardhura për t'u regjistruar vitet pasardhëse* 1,174,224,674 lekë

Në nivel llogarie, regjistrimi i të ardhurës sipas dhe udhëzimit nr.8 datë 09.03.2018, “*Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme*”, në momentin e njohjes apo konstatimit të të ardhurës, në varësi të llojit të të ardhurës, bëhet regjistrimi kontabël dhe debitohet 468“Debitorë të ndryshëm” e vitit përkatës dhe do të kreditohet klasa 70 e Të ardhurave të vitit përkatës në të cilën është njohur debitori. Pra debitorët, në rastin konkret si kundërparti kanë pasur llogarinë 475 “*Te ardhura për t'u regjistruar vitet pasardhëse*” kur në fakt duhej të kreditohej klasa 7, pra e ardhura përkatëse e çdo viti në të cilin është njohur debitori.

Përfundimisht për vitin 2019 dhe 2020, duhet të bëhet sistemimi i llogarisë 475 “*Te ardhura për t'u regjistruar vitet pasardhëse”* për vlerën 1,083,319,116 lekë në 2019 dhe 1,174,224,674 lekë në 2020, duke transferuar njohjen e të ardhurave përkatëse në secilin vit.

**Kriteri:**

Baza ligjore mbi të cilën është vlerësuar situata e cila paraqet parregullsi janë; me ligjin nr. *28/2018 datë 10.05.2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare*” neni 5, 6, 7, 9 dhe 10” ; ligjin 10296 datë 08.07.2010 “*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*” neni 6, udhëzimin nr.8 datë 09.03.2018 “*Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare*

*vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme*” seksioni 4.2. Të ardhurat në NJQP dhe operacionet që lidhen me to.

**Ndikimi/Efekti:**

Mos regjistrimi në kontabilitet dhe deformim i informacionit financiar për sa i përket gjendjes kontabël të paraqitur në Pasqyrat e Pozicionit Financiar për vitin 2019 dhe 2020 të llogarisë *475 Te ardhura për t'u regjistruar vitet pasardhëse si dhe llogarive vjetore të të ardhurave të klasës 70 ”Tatime dhe taksat dhe tatimet”*

**Shkaku:**

Mos njohja dhe mos zbatim i kuadrit të përgjithshëm të përgatitjes së pasqyrave financiare

**Rëndësia: E lartë**

**Rekomandimi:**

Nga Drejtoria e Financës, të merren masa për të bërë sistemimin në kontabilitet të llogarive kontabël 475- *Te ardhura për t'u regjistruar vitet pasardhëse si dhe llogarive vjetore të të ardhurave të klasës 70 ”Tatime dhe taksat dhe tatimet”*. Gjithashtu të sistemohet e ardhura e akumuluar ndër vite nga taksat dhe tarifat vendore për secilin vit përkatës në llogarinë *1210 “Rezultat i mbartur i seksionit të funksionimit”* të vitit në vazhdim.

Mbi Vlerësimin e Raportimit Financiar, për të arritur në opinionin në se pasqyrat financiare për vitin 2019, japin një paraqitje të vërtetë e të drejtë të pozicionit financiar, performancës financiare dhe fluksit të parasë, bazuar në kuadrin rregullator në fuqi.

5. **Titulli gjetjes:** *Mbi kontabilizimin e llogarisë 150 “Shuma të parashikuara për rreziqe e shpenzime" dhe llogarisë 683 “Shuma të parashikuara të shfrytëzimit”.*

**Situata:**

Për të dyja vitet fiskale 2019 dhe 2020, këto llogari paraqiten në vlerat zero lekë.

Sipas udhëzimit nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, pika 34 citohet;

*“Provizionet për shpenzime janë ngjarje të ndodhura, të cilat sjellin një probabilitet që do të ketë një detyrim për t’u paguar nga ana e njësisë. Raste të tilla do të konsiderohen të gjitha vendimet gjyqësore, të cilat kanë kaluar shkallën e dytë të procesit të apelimit. Këto provizione duhet të njihen në kontabilitet dhe të pasqyrohen në pasqyrat financiare vjetore të njësisë nëse:*

- *Njësia ka një detyrim aktual (ligjor ose konstruktiv), si rezultat i një ngjarje të ndodhur;*
- *Është e mundur që një dalje e burimeve ekonomike të jetë e nevojshme për të përmbushur detyrimin; si dhe*
- *Mund të bëhet një parashikim i besueshëm mbi vlerën e detyrimit.*

Nga pikëpamja e kontabilitetit, regjistrimet për provizionet të bëhen si më poshtë:

a) Në momentin e njohjes së provizionit kryhen këto regjistrime:

*Debitohet llogaria 683 “Shuma të parashikuara të shfrytëzimit”; dhe Kreditohet llogaria 150 “Shuma të parashikuara për rreziqe e shpenzime”.*

*b) Në momentin e përdorimit apo pakësimit të provizionit kryhen këto regjistrime:*

*Debitohet llogaria 150 “Shuma të parashikuara për rreziqe e shpenzime”; dhe Kreditohet llogaria 785 “Përdorim i shumave të parashikuara për shpenzime të viteve të ardhshme”.*

Në **aneksin 3** paraqitet tabela me vendimet gjyqësore si dhe vlerat përkatëse për vitin 2019 dhe 2020 të cilat nuk janë kontabilizuar për vitet përkatëse.

**Kriteri:**

Baza ligjore mbi të cilën është vlerësuar situata e cila paraqet parregullsi janë; ligji 9228 datë 29.04.2004 "*Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare*" neni 6, 7, 9 dhe 10; ligji 10296 datë 08.07.2010 "*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*" neni 6, udhëzimin nr.8 datë 09.03.2018 "*Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme*" pika 34 , *urdhrit nr.64 datë 22.07.2014 " Për shpallje të Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit të Përmirësuara*" dhe. Standardet Kombëtar të Kontabilitetit nr.6 "Provizionet, detyrimet dhe aktivet e kushtëzuara"

**Ndikimi/Efekti:**

Mos regjistrimi në kontabilitet dhe deformim i informacionit financiar për sa i përket gjendjes kontabël të paraqitur në Pasqyrat e Pozicionit Financiar të llogarisë *150 "Shuma të parashikuara për rreziqe e shpenzime"* për vitet 2019 dhe 2020. dhe llogarisë së Pasqyrës së Performancës Financiare *683 "Shuma të parashikuara të shfrytëzimit"* për vitet 2019 dhe 2020

**Shkaku:**

Mos njohja dhe mos zbatim i ligjit nr. 9228 datë 29.04.2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare" neni 6, 7, 9 dhe 10; ligji 10296 datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" neni 6, udhëzimin nr.8 datë 09.03.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme" dhe urdhrit nr.64 datë 22.07.2014 " Për shpallje të Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit të Përmirësuara" dhe. Standardet Kombëtar të Kontabilitetit nr.6 "Provizionet, detyrimet dhe aktivet e kushtëzuara".

**Rëndësia: E lartë**

**Rekomandimi**

Nga Drejtoria e Financës, të merren masa për të bërë sistemimet në kontabilitet të llogarisë 150 *"Shuma të parashikuara për rreziqe e shpenzime"* dhe llogarisë 683 *"Shuma të parashikuara të shfrytëzimit"*, për vitet 2019 dhe 2020.

**Për sa mësipërm me personat përgjegjës: *znj. M.D. me funksion Përgjegjëse e Sektorit të Kontabilitetit dhe znj. B.M.*.**

6. **Titulli gjetjes:** *Llogaritja e çmimit të karburanteve nuk është mbështetur në buletinet e APP në çmimet referuar bursës REUTERS për datën e furniturës lëvruar sipas kushtit CIF-Shqipëri në këtë moment."*

**Situata:**

Kontratat për blerjen e karburantit janë hartuar në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", Neni 31 "Kriteret për vlerësimin e ofertës"; 3. Kriter vlerësimi për furnizimin me karburant, gazoil, benzol dhe karburant për ngrohje do të jetë çmimi më i ulët, bazuar në:

a) çmimin e bursës, sipas Reuters, lëvruar sipas kushtit CIF-Shqipëri, i cili dërgohet për publikim, çdo javë, në Buletinin e Njoftimeve Publike nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave;

b) elementet fiskale, përfshi akcizën, taksë karboni si dhe çdo taksë tjetër sipas legjislacionit në fuqi;

c) marzhin e fitimit, të shprehur në përqindje.

- Gjithashtu, Autoriteti Kontraktor për llogaritjen e çmimit të karburanteve nuk është mbështetur në buletinet e APP në çmimet referuar bursës REUTERS për datën e furniturës lëvruar sipas kushtit CIF-Shqipëri në këtë moment, sipas raporteve të analizave nga Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial për sasinë e importuar, gjithashtu janë shtuar elementë fiskalë si "taksa e markimit" jo në përputhje me ligjin nr. 9975, datë 28.07.2008, "Për taksat Kombëtare", të ndryshuar, pasi është shtuar dhe taksa e shënjimit të naftës bruto dhe nënprodukteve të naftës sipas VKM nr. 498, datë 30.05.2013 dhe në kundërshtime me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", neni 77, pika 5. Nga auditimi i zbatimit të kontratave të blerjes së karburantit rezultoi se në likuidimin e sasisë së karburantit gazoil dhe benzol nga Bashkia Shkodër, nuk është respektuar çmimi i miratuar sipas kontratës për furniturën bazuar çmimit referuar bursës REUTERS për datën e furniturës lëvruar sipas kushtit CIF-Shqipëri në këtë moment, gjithashtu si element i çmimit është llogaritur edhe markimi i karburantit, si rrjedhojë janë kryer pagesa të tepërta për gazoilin dhe benzolin e likuiduar në vlerën **239,068** lekë me TVSh e cila duhet ti kthehet bashkisë nga subjekti "K..." shpk. pasi është përfituar në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", neni 77, pika 5

**Kriteri:**

VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*", dhe Dokumentet Standarde të Tenderit, VKM nr. 970, datë 02.12.2015 "*Për përcaktimin e procedurave dhe kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto*" ligjin nr. 9975, datë 28.07.2008, "*Për taksat Kombëtare*", të ndryshuar, pasi është shtuar dhe taksa e shënjimit të naftës bruto dhe nënprodukteve të naftës sipas VKM nr. 498, datë 30.05.2013

**Ndikimi/Efekti:**

Si rezultat i mos respektimit të çmimi të miratuar sipas kontratës për furniturën bazuar çmimit referuar bursës REUTERS për datën e furniturës lëvruar sipas kushtit CIF-Shqipëri në këtë moment, dhe përfshirja si element i çmimit markimi i karburantit kanë sjellë kryerjen e pagesave të tepërta për gazoilin dhe benzolin e likuiduar në vlerën **239,068 lekë me TVSh**

**Shkaku:**

Mos respektimi i çmimit të miratuar sipas kontratës për furniturën bazuar çmimit referuar bursës REUTERS për datën e furniturës lëvruar sipas kushtit CIF-Shqipëri në këtë moment, dhe përfshirja si element i çmimit markimi i karburantit

**Rëndësia: E lartë**

**Rekomandimi:**

Autoriteti Kontraktor Bashkia Shkodër, në hartimin e kontratave të furnizimit me karburant (gazoil, benzol dhe karburant për ngrohje), të marrin parasysh kriteret për vlerësimin e furniturës, si çmimin e bursës sipas Reuters, lëvruar sipas kushtit CIF Shqipëri, elementeve fiskalë, etje, referuar rregullave të prokurimit publik dhe Dokumenteve Standarde të Tenderit.

Urdhër shpenzimet për vlerat e likuiduara nga Autoriteti Kontraktor për karburante, të shoqërohen me faturat tatimore, raportin e analizave nga Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial për sasinë e produktit të importuar, kjo për të vërtetuar cilësinë dhe standardet e furniturës lëvruar sipas kushtit CIF-Shqipëri dhe kushteve të kontratës.

Nga ana e Bashkisë Shkodër, në llogaritjen e çmimit të karburanteve, duhet të mbështetet në buletinet e APP, me çmimet referuar bursës REUTERS për datën e furniturës, sipas *kushtit CIF-Shqipëri*, raporteve të analizave sipas datës respektive të lëshuara nga Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial për sasinë e produktit të importuar, referuar elementëve fiskalë të përcaktuara me ligj.

Nga ana Drejtorisë së Financës në bashkëpunim me njësitë vartëse, të ndiqen të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, për arkëtimin e vlerës prej **239,068 lekë me TVSh,** vlerë e cila duhet ti kthehet bashkisë nga subjekti **"K... "** SHPK me NIUS

Për mangësitë e konstatuara mësipërm me personat përgjegjës: *zj. F.SH., z. P.GJ. dhe z. G.P., si pjesë nënshkruese e proces verbalit të marrjes në dorëzim të me nr. prot 163/1 datë 11.04.2019, z. E.N., zj. Z.C. dhe z. G.H., si pjesë nënshkruese e proces verbalit të marrjes në dorëzim të me nr. prot 79/1 datë 28.03.2019, z. V.M., z. H.M. dhe z. A.SH., si pjesë nënshkruese e proces verbalit të marrjes në dorëzim të me nr. prot 4956 datë 28.03.2019 si dhe z. M.V., z. GJ.GJ. dhe z. N.SH., si pjesë nënshkruese e proces verbalit të marrjes në dorëzim të me nr. prot 125/1 datë 11.04.2019.*

*(Më hollësisht trajtuar në faqen 78-87, të Projektraport Auditimit)*

Nga subjekti Bashkia Shkodër me shkresën nr. 4597/55 prot, datë 16.07.2021 (prot KLSH nr. 362/16, datë 21.07.2021), janë përcjellë kundërshtitë në lidhje me mangësitë e konstatuara nga Njësia e Auditit të Brendshëm, si më poshtë vijon:

**Komente dhe sqarime:**

*Nga subjektet K... shpk dhe K... sha, specifikisht janë paraqitur observimet me nr. Prot 15/1 datë 12.07.2021 për gjetjet në aktin nr.5 në lidhje me shpenzimet e karburantit të Bashkisë Shkodër ku, ndër të tjera, thuhet se:*

*"Taksa e markimit është vendosur me anë të VKM nr.498 datë 30.05.2013 "për përcaktimin e procedurave të shënjimit të naftës bruto dhe nënprodukteve të naftës" dhe është tarifë kombëtare..*

**Sqarim i grupit të auditimit**:

Nga ana e grupit të auditimit theksohet se ligji nr. 9975, datë 28.07.2008, "Për taksat Kombëtare", të ndryshuar, nuk e përfshin tarifën e markimit si dhe bazuar në nenin 77 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", çmimi CIF përcakton të gjitha kostot deri në momentin e mbërritjes së mallit në pikën doganore, që do të thotë nuk përfshin më asnjë kosto pas zhdoganimit të tij Tarifa e markimit është një tarifë që aplikohet pasi malli është zhdoganuar dhe nuk bënë pjesë tek kostot që përbëjnë çmimin CIF. Argumentet e paraqitura nga ana Juaj nuk merren në konsideratë.

### III/2.4. Mbi planifikimin dhe zhvillimin e procedurave të prokurimit publik, me vlera të larta dhe të vogla, si dhe zbatimin e kontratave të punimeve, bazuar në kërkesat e ligjit nr. 9643, datë 20.11.2016 "Për Prokurimin Publik" i ndryshuar, VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar, Manualeve përkatëse të punimeve, udhëzimeve të Agjencisë së Prokurimit Publik etj.

**Programimi i nevojave, përgatitja e regjistrit të prokurimeve.**

Nga auditimi ka rezultuar se, janë hartuar regjistrat e parashikimeve dhe realizimeve për periudhën 01.07.2019 – 31.12.2020. Mbas miratimit në sistem të regjistrit nga APP, me shkresa përcjellëse janë dërguar në Degën e Thesarit, regjistri i parashikimit të prokurimeve për vitet objekt auditimi mbështetur në VKB përkatëse "Mbi miratimin e buxhetit vjetor të Bashkisë Shkodër". Gjithashtu në të gjitha rastet e shtesave dhe pakësimeve është dërguar regjistri përkatës. Në këto regjistra janë pasqyruar shtesat dhe ndryshimet e bëra sipas VKB –ve përkatëse.

NJP dhe NZ, kanë vepruar në përputhje me VKM, nenin 4 "*Regjistri i parashikimeve të procedurave të prokurimit publik*", pika 1. Dërgimi i regjistrit të parashikimeve në APP, është bërë brenda afateve të përcaktuara në VKM nr. 914, neni 4, pika 3.
Nga auditimi ka rezultuar se gjatë periudhave ka patur ndryshim të regjistrit të parashikimeve, për të cilat është bërë buxhetimit i tyre. Të gjitha ndryshimet janë hedhur në SPE, referuar VKM nr. 914, datë 29.12.2014, me ndryshime, neni 4, pika 4 .

*4.1. Verifikimi i shpenzimeve të programuara me nivelin e fondeve të buxhetuara*:

Për kryerjen e auditimit mbi disponimin e fondeve dhe angazhimin e tyre për kryerjen e procedurave të prokurimit publike për periudhën objekt auditimi, nga Grupi i auditimit u shqyrtua dokumentacioni i mëposhtëm:

- Buxheti i viteve 2019 -2020, miratuar me Vendimeve të KB nr. 82, datë 20.12.2018 (për vitin 2019) dhe nr. 26, datë 30.12.2019 (për vitin 2020);
- Plani përfundimtar (fillestar me ndryshime);
- Realizimi i Buxhetit të periudhës 2019 -2020;
- Regjistri i parashikimeve të prokurimeve publike, periudha 01.07.2019 – 31.12.2020;
- Regjistri i realizimeve të prokurimeve publike, periudha 01.07.2019 – 31.12.2020.

Burimet e financimit të buxhetit të Bashkisë për periudhën 01.07.2019 – 31.12.2020, janë dy burime:

a- *Nga burimet e veta vendore, ku përfshihen të ardhurat nga taksat vendore dhe taksat e ndara, te ardhurat nga tarifat vendore, te ardhura te tjera, donacione dhe te ardhura qe trashëgohen.*

b- *Nga burimet qendrore, ku përfshihen transferta e pakushtëzuar, transferta specifike për funksionet e reja, që i janë transferuar Bashkisë dhe transferta e kushtëzuar.*

Nga të dhënat, konstatohet se për periudhën objekti auditimi 01.07.2019 – 31.12.2020, nga vlera totale e fondit limit të prokuruar 94 % e tyre është me burim financimi nga buxheti i Bashkisë Shkodër + Grande pakushtëzuara, ndërsa pjesa tjetër nga FZHR dhe Ministritë e linjës, në mënyrë të përmbledhur sipas tabelës:

**"Projektet dhe burimi i financimit", në 000/lekë**

| Fondi limit i prokuruar | Fondi limit i detajuar nga buxheti: | |
|---|---|---|
| | Bashkisë/grande | FZHR/Min. linje |
| 1,633,987 | 1,537,163 | 96,824 |

*Burimi i të dhënave: Bashkia Shkodër*

Në mënyrë tabelore të dhënat mbi procedurat e prokurimeve për periudhën 01.07.2019 - 31.12.2020, paraqitet si më poshtë vijon:

**Tabela nr. "Mbi realizimin e prokurimeve periudha 01.07.2019 – 31.12.2020"**

| Lloji i procedurës | Nr. Proc | Fondi limit pa TVSh | Kontrata pa TVSh | Fondi total i kursyer pa TVSh | % që zë fondi i kursyer ndaj fondit limit |
|---|---|---|---|---|---|
| Hapura | 47 | 729,627,793 | 579,602,912 | 150,024,881 | 21 |
| Kërkesë me propozim | 185 | 594,896,277 | 562,751,069 | 32,145,208 | 5 |
| Negocim pa shpallje | 22 | 281,328,187 | 253,839,340 | 27,488,847 | 10 |
| Negocim pa botim | 5 | 24,182,779 | 22,783,961 | 1,398,818 | 6 |
| Negocim pa njoftim | 1 | 3,952,500 | 3,721,250 | 231,250 | 6 |

| Lloji i procedurës | Nr. Proc | Fondi limit pa TVSh | Kontrata pa TVSh | Fondi total i kursyer pa TVSh | % që zë fondi i kursyer ndaj fondit limit |
|---|---|---|---|---|---|
| **Shuma procedura sipas llojit** | **260** | **1,633,987,536** | **1,422,698,532** | **211,289,004** | **13** |
| **Procedura sipas objektit** | **Nr.** | **Fondi limit pa TVSh** | **Kontrata pa TVSh** | **% ndaje total lloje** | |
| | | | | **Fond limit** | **Kontratës** |
| Ne fushën e ndërtimeve | 116 | 1,096,986,372 | 906,390,268 | 67 | 64 |
| Në shërbime/ blerje, etj. | 144 | 537,001,163 | 516,308,264 | 33 | 34.5 |
| **Procedura te vlerësuara për auditim** | **Nr.** | **Fondi limit pa TVSh** | **Kontrata pa TVSh** | **% ndaje total lloje** | |
| | | | | **Fond limit** | **Kontratës** |
| Hapura | 35 | 699,916,326 | 653,368,673 | 100 | 100 |
| Kërkesë me propozim | 54 | 402,280,944 | 326,632,429 | 67.6 | 51.4 |
| **Shuma vlerësuar për auditim** | **89** | **1,102,197,270** | **980,001,102** | **67.5** | **67.4** |

Burimi i të dhënave: Bashkia Shkodër
Punoi: KLSH

Nga Bashkia Shkodër, për periudhën 01.07.2019 – 31.12.2020, parashikimi dhe realizimi i prokurimeve publike është kryer vetëm pasi janë vënë në dispozicion fondet buxhetore. Nuk kanë rezultuar tejkalime të planit të buxhetit të miratuar, veprime në përputhje me LPP, VKM nr. 807, datë 16.11.2016 “Për disiplinimin e angazhimeve buxhetore”, me UMF nr. 2 “Për proçedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, Kapitulli III. “Procedurat për kryerjen e shpenzimeve publike”; “Marrja e angazhimit dhe kryerja e shpenzimeve publike”, pika nr. 140, dhe ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 40 “Shpenzimet”, pika 3. Sipas të dhënave të pasqyrës mësipërm, konstatohet se 67% e fondeve janë adresuar për investime, kryesisht riparim rrugësh dhe 33% e fondit janë adresuar për shërbime të tjera.

2. **Titulli gjetjes:** *Në zbatimin e procedurave të prokurimit, u konstatuan shkelje të akteve ligjore e nënligjore të LPP, si në aplikimin e kritereve dhe shpalljen fitues të OE.*

**Situata:**

Referuar të dhënave të regjistrit të procedurave, të dhëna të cilat paraqiten në pasqyrën sipër, për periudhën 01.07.2019 – 31.12.2020, janë realizuar gjithsej 260 procedura me fond limit 1,633,987 mijë lekë dhe vlerë kontrate 1,422,698 mijë lekë.

Grupi i KLSH-së, referuar vlerësimit të dhënave të materialitetit dhe riskut nga 260 procedura me fond limit 1,633,987 mijë lekë ka vlerësuar për auditim 89 procedura ose 34.2% me fond limit 1,102,197 mijë lekë ose 67.4% të fondit të prokuruar.

Nga auditimi i 89 procedura me fond limit 1,102,197 mijë lekë, janë konstatuara në shkelje të akteve ligjore e nënligjore të LPP, gjithsej 25 procedura me fond limit 370,298 mijë lekw ose 33.5% e fondit limit, *nga të cilat*:

a- Në 24 procedura, kriteret nuk janë në përputhje me llojin e procedurës dhe dispozitat ligjore tw LPP;

b- Në 11 procedura, OE të shpallur fitues nuk janë në kushtet e plotësimit të kritereve të DST të miratuara nga AK, ku procedurat duheshin anuluar dhe zhvilluar procedura të tjera me kushte më të favorshme për të siguruar përdorim me efektiv të fondeve publike në vlerën **135,672 mijë** lekë pa TVSH.

**Kriteri:**

**a- Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar:**

- **Neni 2,** *"Parimet e përzgjedhjeje",* ku thuhet se:

*Përzgjedhja e fituesve të kontratave publike realizohet në përputhje me këto parime të përgjithshme:*
*a) mos diskriminim dhe trajtim i barabartë i ofertuesve ose kandidatëve;*
*b) transparencë në procedurat e prokurimit;*
*c) barazi në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve, që u ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve.*

- **Neni 24,** *"Anulimi i një procedure",* ku theksohet se:

1. *Autoriteti kontraktor anulon procedurën e prokurimit vetëm:*
*a) për shkaqe që dalin jashtë kontrollit të autoritetit kontraktor dhe të paparashikueshme në kohën e fillimit të procedurës së prokurimit, duke respektuar parimet e barazisë dhe të transparencës, sipas përcaktimit në rregullat e prokurimit publik;*
*b) nëse nuk është paraqitur asnjë ofertë brenda afateve kohore;*
*c) kur në fazën e parë të procedurës së kufizuar dhe me negocim me shpallje paraprake të njoftimit kualifikohen më pak se 2 kandidatë;*
*ç) nëse asnjë nga ofertat e paraqitura nuk përputhet me kriteret e përcaktuara në dokumentet e tenderit;*
*d) nëse të gjitha ofertat e paraqitura përmbajnë çmime që e tejkalojnë buxhetin e autoritetit kontraktor, të parashikuar për një kontratë të caktuar;*
*dh) kur Komisioni i Prokurimit Publik vendos anulimin, sipas parashikimit të shkronjave "b" dhe "ç" të pikës 3 të nenit 64 të këtij ligji*

- **Neni 46,** *"Kualifikimi i ofertuesve"*, pika 1, ku është përcaktuar se**:**

*"Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret e mëposhtme, që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe jo diskriminuese:…".*

- **Neni 47**, "*S`kualifikimi i ofertuesve*", ku është përcaktuar se:

*"Autoriteti kontraktor s`kualifikon çdo kandidat ose ofertues, që paraqet të dhëna të rreme, për qëllime kualifikimi, në çdo kohë, deri në fazën e shpalljes së kontratës fituese. Autoriteti kontraktor për çdo s`kualifikim raporton në Agjencinë e Prokurimit Publik për qëllimet e parashikuara në nenin 13 pika 3 të këtij ligji.*

- **Neni 53,** *"Shqyrtimi i ofertave",* ku është përcaktuar se:

*"1. Autoriteti kontraktor, kur e shikon të arsyeshme, u kërkon ofertuesve sqarime për ofertat e tyre, për shqyrtimin, vlerësimin dhe krahasimin sa më të drejtë të këtyre ofertave. Pa cenuar dispozitat e parashikuara në nenet 32 dhe 33 të këtij ligji, nuk duhet të kërkohet, ofrohet apo lejohet asnjë ndryshim në përmbajtjen e ofertës, përfshirë ndryshimet në çmim apo ndryshime që synojnë të kthejnë një ofertë të pavlefshme në të vlefshme".*

- **Neni 55,** *"Kriteret e përcaktimit të ofertës",* ku thuhet se:

*2. Autoriteti kontraktor vlerëson dhe krahason ofertat e vlefshme, për të përcaktuar ofertën fituese, në përputhje me procedurat dhe kriteret e përcaktuara në dokumentet e tenderit. Nuk duhet të përdoret asnjë kriter, që nuk është përfshirë në dokumentet e tenderit.*
*3. Vlerësimi i ofertave bëhet vetëm në baza teknike dhe ekonomike.*

- **Neni 58,** *"Njoftimi i fituesit dhe nënshkrimi i kontratës"***,** pika 1, ku është përcaktuar se:

*"1. Njoftimi i fituesit i jepet menjëherë ofertuesit, që ka paraqitur ofertën më të mirë, në përputhje me nenin 55 të këtij ligji".*

**b- VKM nr. 914, datë 29.12.2014,** "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, nenet:

**- Neni 26**, "*Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave*", pika 5, ku është përcaktuar se:

*"Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike në përputhje me nenin 46 të LPP. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kritereve.*

**- Neni 66**, "*Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave*", ku është përcaktuar se:

*"1. Pas mbylljes së seancës publike, komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kriteret për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit.*
*Nëse është e nevojshme, komisioni i vlerësimit të ofertave kërkon sqarime nga ofertuesit, të cilat duhet të jenë me shkrim ose të reflektuara në procesverbal.*

**- Neni 67**, *"Klasifikimi i ofertave"*, ku është përcaktuar se:

*"Në bazë të ofertave të pranuara, komisioni i vlerësimit të ofertave harton klasifikimin përfundimtar, i cili u komunikohet ofertuesve në kohën e përcaktuar në këto rregulla".*

**- Neni 69**, *"Njoftimi i fituesit"*, ku është përcaktuar se:

**"***Pas miratimit të raportit përmbledhës, autoriteti kontraktor dërgon për publikim në faqen e internetit të APP-së dhe Buletinin e Njoftimeve Publike njoftimin e fituesit në përputhje me nenin 58 të LPP***".**

**- Neni 70** *"Lidhja e kontratës"*, ku është përcaktuar se:

*"Zhvillimi i procedurës së prokurimit do të bëhet deri në momentin e shpalljes së njoftimit të fituesit, ndërsa lidhja e kontratës do të bëhet në përputhje me afatet e përcaktuara në pikën 3, të nenit 21, të këtyre rregullave, dhe vetëm pasi fondi do të jetë në dispozicion (në llogarinë përkatëse) të autoritetit kontraktor*".

**- Neni 78 "***Ankesat në autoritetin kontraktor*, ku është përcaktuar se:

*3. Për shqyrtimin e ankesave, autoriteti kontraktor ndjek hapat e mëposhtëm:*
*a- Titullari i autoritetit kontraktor ia ngarkon çështjen një komisioni të përbërë nga 3 (tre) persona, ku të paktën njëri është ekspert i fushës[17] për të shqyrtuar ankesën dhe për të dhënë një vendim. Përjashtimisht, në rast të mungesës së personelit, titullari i autoritetit kontraktor ia ngarkon çështjen për shqyrtim 1 (një) zyrtari të vetëm, i cili duhet të jetë ekspert fushe. Komisioni/zyrtari i ngarkuar është përgjegjës për vendimin e dhënë në përfundim të shqyrtimit të ankesës.*

**c- Vendimi i KM nr. 514, datë 20.9.2017** "Për miratimin e listës kombëtare të profesioneve (LKP)",të rishikuar.

<u>**Shkaku:**</u>

[17] *Shtuar me vendimin Nr. 797, datë 29.12.2017 "Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.914, datë 29.12.2014, të këshillit të ministrave, "për miratimin e rregullave të prokurimit publik", të ndryshuar.*

Mos njohja e kuadrit ligjorë zbatues në fuqi, në aplikimin e kritereve dhe shpalljen fitues të OE me mangësi.

**Ndikimi/Efekti:**

Aplikimi i kritereve jo në mënyrë të argumentuar dhe në përputhje me procedurën, si dhe shpallja fitues e OE me mangësi në plotësimin e kritereve të DST, janë veprime në paligjshmëri të përdorimit të fondeve publike për vlerën **154,381 mijë lekë** pa TVSH, për të cilën ngarkohen me përgjegjësi anëtarët e NJHDT dhe KCO sipas procedurave trajtuar në vijim.

**Rëndësia:** ***E lartë***

**Rekomandimi** :

Kryetari i Bashkisë Shkodër, në cilësinë e Titullarit të AK, të marrë masa që në komisionet e NHDT dhe KVO, të emërojë persona me profil sipas llojit të procedurës, të cilët në hartimin e kritereve të aplikojnë kritere në përputhje me procedurën e zhvilluar dhe në shpalljen fitues të OE të vlerësohen në maksimum kriteret e DST të miratuara nga AK, duke mos lejuar veprime me dy standarte në klasifikimin e tyre dhe të udhëhiqen nga kriteri kryesor "*Çmimi më i leverdishëm*", midis OE pjesëmarrës, kjo për të bërë të mundur përdorimin më me efektivitet të fondeve të prokura për vlerën 154,381 mijë lekë pa TVSH.

3. **Titulli gjetjes:** *Mos kryerja e pagesave të kontratave të lidhura sipas afateve të caktuara në buxhetet respektive të viteve 2019 – 2020.*

**Situata:**

Nga përpunimi i të dhënave në lidhje me pagesën e kontratave të lidhura për mbi procedurat e prokurimit me vlera të larta, u konstatua se likuidimi i tyre nuk është bërë sipas afateve të caktuara në buxhetet respektive, të dhëna të cilat paraqiten në tabelat 1 dhe 2, më poshtë:

**Tabela 1.** *Për aktivitetin e vitit 2019*

| EMERTIMI | Viti 2019 | Viti 2020 | Viti 2021 |
|---|---|---|---|
| Vlerë kontrate me TVSh gjithsej | 821,106,113 | | |
| Planifikuar për pagese sipas periudhave | 655,000,039 | 126,765,113 | 39,340,962 |
| Pagesa sipas periudhave | 469,449,741 | 269,253,533 | 42,751,742 |
| Diferenca papaguar sipas periudhave | 185,550,298 | -142,488,420 | -3,410,780 |
| **Diferenca papaguar deri 31.03.2021** | **39,651,097** | | |

**Tabela 2.** *Për aktivitetin e vitit 2020*

| EMERTIMI | Viti 2020 | Viti 2021 | Viti 2022 |
|---|---|---|---|
| **Vlerë kontrate me TVSh gjithsej** | **769,705,604** | | |
| Planifikuar për pagese sipas periudhave | 521,058,966 | 188,802,142 | 59,844,495 |
| Pagesa sipas periudhave | 287,211,456 | 111,113,288 | 0 |
| **Diferenca papaguar deri 31.03.2021** | **233,847,510** | **77,688,854** | **59,844,495** |

Nga të dhënat e mësipërme, në asnjë nga vitet objekt auditimi nuk janë zbatuar afatet e likuidimit sipas kësteve të miratuara në buxhet. kështu për vitin 2019 nga vlera e kontraktuar prej 821 milionë lekë është likuiduar vlera 655 milionë lekë me një diferencë të pazbatuar për vlerën 469 milionë lekë. Ndërsa në vitin 2020 nga vlera e kontraktuar prej 769 milionë lekë është likuiduar vlera prej 521 milionë lekë, duke mbetur pa likuiduar vlera 287 milionë lekë.

Për të dy periudhat, mos pagesa lidhet me faktin me faktin se nga Bashkia Shkodër, nuk janë realizuar të ardhurat e planifikuara dhe të destinuara për likuidimin e fondeve të prokuruar. Pra nga sa mësipërm nuk janë respektuar dhe këstet e parashikuara në PBA.

**Kriteri:**

Nenin 40 të ligjit 139/2015, datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore", në të cilin është përcaktuar shprehimisht:

"1. *Njësitë e vetëqeverisjes vendore kryejnë shpenzime, sipas akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi, në përputhje me parimet e disiplinës fiskale, menaxhimit financiar dhe kontrollit, si dhe përdorimin me efiçencë, efektivitet dhe ekonomi të burimeve të tyre financiare. Të ardhurat e veta të njësive të vetëqeverisjes vendore, që nuk janë shpenzuar brenda vitit fiskal, trashëgohen në vitin tjetër fiskal.....*"

Nenin 41 po të këtij ligji është përcaktuar shprehimisht se:

*"1. Njësitë e vetëqeverisjes vendore hartojnë dhe miratojnë buxhetin vjetor e programin buxhetor afatmesëm, sipas legjislacionit në fuqi që rregullon sistemin buxhetor dhe financat vendore".*

Paragrafin e parë të nenit 40 të ligjit nr.9936, datë 26.06.2008, "Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, në të cilin është përcaktuar shprehimisht:

*"Si rregull, e drejta për të kryer shpenzime, brenda kufirit të fondeve të miratuara, skadon ditën e fundit të vitit buxhetor, pavarësisht nëse kontrata njëvjeçare ose shumëvjeçare mund të vazhdojë edhe në vitin buxhetor pasardhës. Për fondet e njësive vendore, nga transferta e pakushtëzuar apo të ardhurat vendore, e drejta për të kryer shpenzime është në përputhje me përcaktimet e ligjit përkatës për vetëqeverisjen vendore."*

Nenin 47, pika 3 të ligjit 68/2017, "Për financat e vetëqeverisjes vendore", në të cilin është përcaktuar shprehimisht:

*"3. Njësitë e vetëqeverisjes vendore janë të detyruara të zbatojnë angazhimet sipas renditjes së regjistrimit të tyre në sistemin Informatik financiar të qeverisjes qendrore.* ***Në rast se njësitë e vetëqeverisjes vendore marrin angazhime buxhetore disavjeçare, ato regjistrojnë angazhimet kundrejt planit vjetor për tre vite në vijim*** *dhe, nëse angazhimi buxhetor është më i gjatë, mbetja regjistrohet në janar të vitit të katërt në sistemin Informatik financiar të Qeverisë.*

**Ndikimi/Efekti:**

Mos likuidimi i kontratave sipas afateve të caktuar, çojnë në krijimin e gjendjes kreditorë ne fund të periudhave për faturat e palikuiduara, duke vënë kushte ne vështirësi financiare bashkinë për periudhat në vijim.

**Shkaku:**

Mungesa e realizmit të të ardhurave dhe planifikimit të procedurave pa një mirëmenaxhimi të fondeve publike, duke planifikuar procedurat jo në përputhje me fondet në dispozicion

**Rëndësia: E lartë**

**Rekomandimi:**

Kryetari i Bashkinë në cilësinë e Nëpunësit Autorizues, në bashkëpunim me Drejtorin e Financës në cilësinë e Nëpunësit Zbatues dhe Drejtorin e Buxhetit, të marrin masa që në hartimin e buxheteve të viteve në vijim, të planifikojnë procedura prokurimi në raport më nivelin e të ardhurave të realizuara dhe fondeve në dispozicion, kjo për të shmangur në maksimum rritjen e nivelit të faturave të palikuiduara (kreditorët), në fund të periudhave ushtrimore.

Nga Bashkia Shkodër me shkresën nr. 4597/55, datë 16.7.2021 (prot KLSH nr. 362/16 datë 21.7.2021), janë kundërshtuar mangësitë në lidhje me planifikimin e procedurave me fonde në dispozicion ku sqarojnë se:

**<u>Komente dhe sqarime:</u>**

*Realizimi i planit të të ardhurave të veta për vitin 2019 në total është në masën 99%.*

*Diferenca 1% është e papërfillshme dhe mbulohet nga diferenca e prokurimeve Publike.*

*Gjatë vitit 2019 përveç administrimit dhe dhënies së shërbimit ndaj qytetarëve në gjithë territorin e saj, bashkia menaxhoi burimet e veta dhe siguroi plotësisht të ardhurat buxhetore të parashikuara, të nevojshme për kryerjen e gjithë funksioneve të larmishme që bashkia ka.*

*Rritja e vazhdueshme e të ardhurave si nga biznesi, ashtu edhe nga taksapaguesi familjar, kundrejt fokusimit për uljen e barrës fiskale nga ana tjetër, vërteton efikasitetin e këtyre politikave, kundrejt rezultatit pozitiv që bashkia ka arritur në rritjen e bazës së taksapaguesve, si familjar, ashtu edhe atij biznes.*

*Sipas pasqyrave financiare të vitit 2019 kemi gjendje në llogarinë 520 në vlerën 629 207 mijë lekë ndërkohë që llogaritë kreditore janë në shumën 381 726 mije lekë (duke zbritur detyrimet e pagave të muajit dhjetor ) .*

*Pra kemi gjendje kesh 247 481 mijë lekë me tepër se detyrimet.*

*Prandaj Bashkia Shkodër nuk është në kushtet e problemeve financiare të përcaktuar në pikën 1 nenin 55 të ligjit nr 68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore ", sepse gjendja e llogarisë 520 -Disponibilitete ne Thesar tejkalon detyrimet sipas pasqyrave financiare për Bilancin e vitit 2019.*

*Për vitin 2020.*

*Realizimi i planit të të ardhurave të veta për vitin 2020, në total është në masën 83%.*

*Në ndryshim nga vitet e mëparshme, viti 2020 ishte një vit i cili për shkak të pandemisë COVID-19 që përfshiu të gjithë globin, krijoi problematika të mëdha në financa, në zhvillim ekonomik por dhe në jetët e humbura. Bashkia Shkodër, si çdo njësi tjetër vendore dhe institucion publik i Republikës së Shqipërisë, u gjend në këtë situatë të jashtëzakonshme të pa ndodhur më parë, që në muajt e parë të vitit 2020.*

*Pavarësisht situatës së vështirë të krijuar nga pandemia COVID-19, Bashkia Shkodër me burimet e veta arriti të menaxhojë situatën dhe të ofrojë shërbimet e duhura ndaj qytetarëve në gjithë territorin e saj.10*

*Megjithëse ka qenë në realizimin 83%, Bashkia Shkodër me VKB Nr. 22, Dt. 25.03.2021, ka miratuar buxhetin faktit për vitin 2020 dhe me VKB Nr 26, datë 20.04.2021 ka kryer pakësimet sipas realizimit të të ardhurave të veta dhe ka patur fonde diponibël. Si rrjedhojë e mos realizimit të të ardhurave ka pakësuar 136,231,077 lekë , dhe njëkohësisht ka patur fonde diponibël për rialokimit në shumën prej 96,702,305 lekë.*

*Sipas pasqyrave financiare të vitit 2020 gjendja e llogarisë 520 - Disponibilitete ne Thesar sipas pasqyrave financiare është në vlerën 662 041 mijë lekë ndërsa llogaritë kreditore duke zbritur detyrimet e pagave të muajit dhjetor janë në vlerën 202 651 mijë lekë.*

*Pra kemi gjendje kesh 459,390 mijë lekë me tepër se detyrimet.*

*Prandaj Bashkia Shkodër nuk është në kushtet e problemeve financiare të përcaktuar ne pikën 1 nenin 55 të ligjit nr 68/2017 " Për financat e vetëqeverisjes vendore ", sepse gjendja e llogarisë 520 -Disponibilitete ne Thesar tejkalon detyrimet sipas pasqyrave financiare për Bilancin e vitit 2020.*

**<u>Sqarim i grupit të KLSH;</u>**

Argumentet dhe faktet që paraqisni në lidhje me konstatimin e bërë nga KLSH, që në planifikimin e fondeve të kihet parasysh niveli i realizmit të të ardhurave, gjendje e faturave të palikuiduara dhe vlera kontratave shumëvjeçare, nuk është bindës për grupin e KLSH, pasi mos marrja në konsideratë e këtyre fakte çon në rritjen nga viti në vit të faturave kreditore në këtë Bashki.

- **Mbi procedurat e prokurimit të zhvilluara në periudhën 01.07.2019- 31.12.2019.**

Për periudhën 01/7/2019 – 31/12/2019, nga Bashkia Shkodër referuar të dhënave të regjistrit të prokurimeve, paraqitet si vijon:

| Lloji i procedurës | Nr. Proc | Fondi limit pa TVSh | Kontrata pa TVSh | Fondi total i kursyer pa TVSh | % që zë fondi i kursyer ndaj fondit limit |
|---|---|---|---|---|---|
| Hapura | 25 | 489,091,515 | 377,102,755 | 111,988,760 | 23 |
| Kërkesë me propozim | 108 | 214,485,220 | 186,142,760 | 28,342,460 | 13 |
| Negocim pa shpallje | 11 | 144,948,684 | 138,359,374 | 6,589,310 | 5 |
| **Shuma procedura sipas llojit** | **144** | **848,525,418** | **701,604,889** | **146,920,530** | **17** |
| **Procedura sipas objektit** | **Nr.** | **Fondi limit pa TVSh** | **Kontrata pa TVSh** | **% ndaje total lloje** | |
| | | | | **Fond limit** | **Kontratës** |
| Ne fushën e ndërtimeve | 50 | 584,698,350 | 459,184,616 | 69 | 65 |
| Në shërbime/ blerje, etj. | 94 | 263,827,068 | 242,420,273 | 31 | 34.5 |
| **Vlerësuara për auditim** | **Nr.** | **Fondi limit pa TVSh** | **Kontrata pa TVSh** | **% ndaje total lloje** | |
| | | | | **Fond limit** | **Kontratës** |
| Hapura | 25 | 489,091,515 | 450,868,516 | 100 | 100 |
| Kërkesë me propozim | 22 | 137,115,652 | 141,127,662 | 63.9 | 51.4 |
| ***Shuma vlerësuar për auditim*** | ***47*** | ***626,207,167*** | ***591,996,178*** | ***73.8*** | ***67.4*** |

**Burimi**: *Nga Bashkia Shkodër. përpunuar nga grupi i KLSH*

Sipas të dhënave të pasqyrës për periudhën 01.07.2019 – 31.12.2019, janë zhvilluar gjithsej **144** procedura me vlerë të fondit limit 848,525 mijë lekë dhe vlerë kontrate të lidhur 701,604 mijë lekë, me një kursim në vlerën 146,604 mijë lekë ose 17%, *e analizuar për çdo procedurë paraqiten në pasqyrën Aneks III/4.1, bashkëlidhur Raport Auditmit*.

Sipas llojit të procedurës, në fushën e investimeve janë zhvilluar gjithsej 50 procedura me fond limit 584,698 mijë lekë ose 69% e totalit dhe në fusha të tjera *(shërbime/ blerje mallrash)*, janë zhvilluar 94 procedura me fond limit 263,827 mijë lekë ose 31% e totalit. Pra pjesën më të madhe të procedurave e zënë investimet, ku investimet në rrugët e brendshme të Bashkisë Shkodër janë 55.7% e totalit të investimeve me vlerë 473,532 mijë lekë.

Sipas informacionit të marrë nga sektori i procedurave, konstatohet se procedurat me objekt: "*Shërbimi i pastrimit Bashkia Shkodër*", si ato të llojit "*të hapur*" dhe "*Negocim pa shpallje paraprake*", dosjet janë tërhequr nga SKAP, sipas shkresës nr. 1548, datë 192.2021, për procedurat e zhvilluara për periudhën 01.01.2017 – 33.03.2021. Në këto kushte grupi nuk mund ti auditoi këto procedura. Gjithsej janë 12 procedura me vlerë të fondit limit 148,608 mijë lekë.

Grupi i auditmit të KLSH-së, mbi e vlerësimit të riskut, nga **144** procedura me fond limit 848,525 mijë lekë, vlerësojë për auditim **47** procedura ose 32.6% e totalit me fond limit 626,207 mijë lekë ose 73.8%.

Në përfundim të punës audituse në terren dhe pas shqyrtimit të kundërshtive të subjekti, nga 47 procedura me fond limit 626,207 mijë lekë, kanë rezultuar në shkelje të akteve ligjore e nënligjore të LPP, gjithsej 12 procedura me fondi limit 157,772 mijë lekë ose 25.1% e fondit të prokuruar, *nga e cila*: a- **Në 11 procedura**, kriteret nuk janë vendosur në pëputhje me kuadrin ligjorë të LPP dhe objektin e prokurimit;

b- **Në 7 procedura**, OE të shpallur fitues nuk plotësojnë të gjitha kriteret e DST të miratuara nga AK, veprime në paligjshmëri të përdormit të fondeve me vlerë 96,315 mijë lekë, *të dhëna të cilat në mënyrë tabelore paraqiten në pasqyrën Aneks III/4.2, bashkëlidhur Raport Auditimit*.

- <u>**Konkretisht për vitin 2019, procedurat me shkelje paraqiten sa më poshtë vijon**</u>:

| **1. Procedura me objekt "Sistemin asfaltim rruga Ura e Mesit – Drisht Loti I"** | | |
|---|---|---|
| **1. Urdhër Prokurimi** nr. 489, datë 29.5.2019<br>**2. Lloji i Procedurës** "Hapur" | **3. Hartuesit e Dokumenteve nr.** 489, datë 29.5.2019<br>E.D.,<br>D.K.,<br>I.T., (spec. Ndërtimi) | ***4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave** Urdhër nr. 492, datë 29.5.2019*<br>A.SH.,<br>N.D., - anëtar (ing)<br>J.G., - anëtar (financiare) |
| **5. Fondi Limit (pa TVSH)**<br>14,712,991 lekë<br><br>**REF-24436-05-29-2019** | **6. Oferta fituese (pa TVSH)**<br>EO "S..." ShPK për vlerën 9,482,996 lekë pa TVSh me kontratë nr. 9267/15, datë 19.8.2019, me afat 60 ditë. | **7. Diferenca me fondin limit (pa TVSH)**<br>5,230 mijë lekë ose 35.5 % |
| **8. Data e hapjes së tenderit**<br>Datë 01.7.2019 | **9. Burimi Financimit**<br>Bashkia + Grande, sipas periudhave<br>Viti 2019 në shumën 8,046,666 lekë.<br>Viti 2020 në shumën 3,333,333 lekë<br>Viti 2021 në shumën 3.332.92 lekë | **10. Operatoret Ekonomike**<br>**a)**Pjesëmarrës në tender **10**OE/BOE<br>b) S'kualifikuar 6 OE/BOE,<br>c) Kualifikuar **4** OE/BOE<br>• |
| **11. Ankimime**<br>**AK**- nr. ---, dt. ---; **KPP--/ APP**–s'ka/ka; | **12. Përgjigje Ankesës** nga AK<br>Shkresa nr. ---, dt. -- | **13. Përgjigje** Ankesës nga APP apo AKKP ; Shkresa nr. ----, dt. ---- |

<u>**Hartimi i fondit limit**</u>***:*** Fondi për kryerjen e këtij financim është me të ardhurat e Bashkisë Shkodër dhe i miratuar me VKB nr. 82, datë 20.12.2018 në shumën 14,712,991 lekë, e cila do paguhet me dy fazë, ku për vitin 2019 do paguhet vlefta 8,046,666 lekë, për vitin 2020 do paguhet vlefta 3,333,333 lekë pa TVSH dhe për vitin 2021 në vlerën 3,332,992 lekë pa TVSh, bazuar kjo në udhëzimin plotësues nr. 1 datë 171.2019 "Për buxhetin e vitit 2019" dhe miratuar në PBA periudhës 2019 – 2021.
Nga të dhënat e dosjes, konstatohet se preventivi/preventivi është hartuar nga specialistët e Bashkisë Shkodër ing. V.B., XH.R. dhe E.D., bazuar në VKM nr. 629, datë 15.7.2015 për çmimet sipas manualit.

<u>**Situata**</u>:
Në hartimin e DST rezulton se, nuk ka gjetur zbatim VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, sa vijon:
**Në DT është kërkuar***:* Për kapacitetin teknik: Operatori ekonomik ofertues, me anë të një deklaratë (nga Administratori i shoqërisë) duhet të përcaktoje Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt, i cili duhet të jetë i përfshirë në licencën e shoqërisë dhe të deklaroje se ai nuk është i angazhuar në kontratat të tjera Bashkëlidhur deklaratës për Drejtuesin Teknik duhet të paraqitet; a) Kontrata e punës e vlefshme dhe Diploma.
Nisur nga fakti se vlera e përllogaritur e kontratës është në shumën 14,712,991 lekë, kjo kërkesë e përcaktuar është në kundërshtim me kreun I, pika 2.1 të UKM nr. 2, datë 135.2005, "Për zbatimin e punimeve të ndërtimit, ku parashikohet se për punime deri në 30 milion lekë nuk është e detyrueshme qëndrimi i drejtuesit teknik në kantier gjatë gjithë periudhës së punimeve".

**<u>Vlerësimi i procedurës</u>:**
- Nuk plotëson kriterin që në stafin e tije të jenë të punësuar punonjës me profesion dhe dëshmi kualifikimi, pasi referuar të dhënave të listpagesave *(kodet e profesioneve)*, nuk përputhet me profesionin që kërkohet në DST, *konkretisht*:
Tekniku i ndërtimi z. F.H. paraqitet me kod 93126, ku sipas listës së profesioneve është "*punëtorë krahu*".
F.K. i deklaruar si "manovrator", sipas listpagesave paraqet kod 43211 me profil "*magazinier*".
N.H. dhe Z.E. i deklaruar si "manovrator", sipas listpagesave paraqet kod 83221 me "*profil shofer*".
SH.T. i deklaruar si "murator", sipas listpagesave paraqet kod 83221 me *"profil shofer".*
R.K. i deklaruar si "murator", sipas listpagesave paraqet kod 72129 me profil "*saldator*".
A.K. i deklaruar si "karpentier", sipas listpagesave paraqet kod 43211 me profil "*punëtor krahu*".
**<u>Kriteri:</u>** Në shkelje të akteve ligjore e nënligjore të LPP, trajtuar në fillim të Kapitullit III/2.4.

**<u>Konkluzioni:</u>** Nga sa kemi trajtuar më sipër procedura paraqitet me probleme si në aplikimin e kritereve dhe shpallje fitues të OE, veprime të cilat çojnë në paligjshmëri të përdorimit të fondeve të prokuruar, *për të cilën ngarkohen me përgjegjësi anëtarët e NJHDT,* ***E.D.,*** *me funksion specialist në Njësinë e Prokurimeve,* ***D.K.,*** *me funksion specialist në Njësinë e Prokurimeve* ***I.T.,*** *me funksion specialist në DPZHT (spec. Ndërtimi) dhe anëtarët e KVO, i përbërë:* ***A.SH.,*** *me funksion Administrator NJA Postribe,* ***N.D.,*** *me funksion specialist në DPZHT - anëtar (ing) dhe* ***J.G.,*** *me funksion specialistë në Drejt. Buxhetit - anëtar*

| **2. Procedura me objekt "Sistemin asfaltim rruga Qendër Mes - Kullaj"** | | |
|---|---|---|
| **1. Urdhër Prokurimi** nr. 510, datë 30.5.2019<br>**2. Lloji i Procedurës** **"**Kërkesë propozim" | **3. Hartuesit e Dokumenteve nr.** 510, datë 30.5.2019<br>E.D.,<br>D.K.,<br>N.D., (spec. Ndërtimi) | ***4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave***<br>*Urdhër nr. 518, datë 30.5.2019*<br>A.SH.,<br>J.V., - anëtar (ing)<br>J.G., - anëtar (financiare) |
| **5. Fondi Limit (pa TVSH)**<br>8,685,571 lekë<br><br>**REF-24866-05-30-2019** | **6. Oferta fituese (pa TVSH)**<br>EO "K... ShPK. me vlere 8,376,121 lekë pa TVSH me kontratë nr. 9362/12, datë 15.8.2019, me afat 60 ditë. | **7. Diferenca me fondin limit (pa TVSH)** 309 mijë lekë ose 3.5 % |
| **8. Data e hapjes së tenderit**<br>Datë 146.2019 | **9. Burimi Financimit**<br>Bashkia + Grande, sipas periudhave<br>Viti 2019 në shumën 253,833 lekë.<br>Viti 2020 në shumën 4,556,667 lekë<br>Viti 2021 në shumën 3,875,071 lekë | **10. Operatoret Ekonomike**<br>**a)**Pjesëmarrës në tender **6** OE/BOE<br>b) S'kualifikuar 4 OE/BOE,<br>c) Kualifikuar **2** OE/BOE |
| **11. Ankimime**<br>**AK**- nr. ---, dt. ---; **KPP--/ APP**–s'ka/ka; | **12. Përgjigje Ankesës** nga AK<br>Shkresa nr. ---, dt. -- | **13. Përgjigje** Ankesës nga APP apo AKKP ; Shkresa nr. ----, dt. ---- |

- **<u>Hartimi i fondit limit</u>:** Fondi për kryerjen e këtij financim është me të ardhurat e Bashkisë Shkodër dhe i miratuar me VKB nr. 82, datë 20.12.2018 në shumën 8,685,571 lekë, e cila do paguhet me dy fazë, ku për vitin 2019 do paguhet vlefta 253,833 lekë, për vitin 2020 do paguhet vlefta 4,556,667 lekë pa TVSH dhe për vitin 2021 në vlerën 3,875,071 lekë pa TVSh, bazuar kjo në udhëzimin plotësues nr. 1 datë 171.2019 "Për buxhetin e vitit 2019" dhe miratuar në PBA periudhës 2019 – 2021.

Nga të dhënat e dosjes, konstatohet se preventivi/preventivi është hartuar nga studio e projektimit "GJ...", bazuar në VKM nr. 629, datë 15.7.2015 për çmimet sipas manualit.

**Situata**:
Në hartimin e DST rezulton se, nuk ka gjetur zbatim VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, sa vijon:
**Në DT është kërkuar:** Sipas pikës 2.2 "Për kapacitetin teknik ekonomik" është kërkuar që OE pjesëmarrës të paraqesin një xhiro mesatare vjetore për vitet 2016, 2017 dhe 2018 jo më të vogël se 8,685,571 lekë, ku sipas akteve ligjore kërkohet deri në 50%.
**Në DT është kërkuar**: Për kapacitetin teknik: "Operatori ekonomik ofertues, me anë të një deklaratë (nga Administratori i shoqërisë) duhet të përcaktoje Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt, i cili duhet të jetë i përfshirë në licencën e shoqërisë dhe të deklaroje se ai nuk është i angazhuar në kontratat të tjera Bashkëlidhur deklaratës për Drejtuesin Teknik duhet të paraqitet; a) Kontrata e punës e vlefshme dhe Diploma.
Nisur nga fakti se vlera e përllogaritur e kontratës është në shumën 8,685,571 lekë, kjo kërkesë e përcaktuar është në kundërshtim me kreun I, pika 2.1 të UKM nr. 2, datë 135.2005, "Për zbatimin e punimeve të ndërtimit, ku parashikohet se për punime deri në 30 milion lekë nuk është e detyrueshme qëndrimi i drejtuesit teknik në kantier gjatë gjithë periudhës së punimeve".
**Kriteri:** Në shkelje të akteve ligjore e nënligjore të LPP, trajtuar në fillim të Kapitullit III/2.4.

**Konkluzioni:** Nga sa kemi trajtuar më sipër procedura paraqitet me probleme si në aplikimin e kritereve dhe shpallje fitues të OE, duke e bërë procedurën të parregullt, *për të cilën ngarkohen me përgjegjësi anëtarët e NJHDT,* ***E.D.,*** *me funksion specialist në Njësinë e Prokurimeve,* ***D.K.,*** *me funksion specialist në Njësinë e Prokurimeve****, N.D.,*** *me funksion specialist në DPZHT (spec. Ndërtimi).*

| **3. Procedura me objekt "Rikonstruksion i rrugës Oblik – Velinaj – Alimetaj, loti 3""** | | |
|---|---|---|
| **1. Urdhër Prokurimi** nr. 504/30.5.2019<br>**2. Lloji i Procedurës** "HAPUR" | **3. Hartuesit e Dokumenteve nr.** 504/30.5.2019<br>E.D.,<br>D.K.,<br>A.K., (spec. Ndërtimi) | ***4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave***<br>*Urdhër nr. 495/30.5.2019*<br>A.C.,<br>J.V., - anëtar (ing)<br>I.M., - anëtar (financiare) |
| **5. Fondi Limit (pa TVSH)**<br>15,740,387 lekë<br><br>**REF-24570-05-30-2019** | **6. Oferta fituese (pa TVSH)**<br>BEO "S... .." ShPK. me vlere 13,428,718 lekë pa TVSH me kontratë nr. 9359/12, datë 19.8.2019, me afat 60 ditë. | **7. Diferenca me fondin limit (pa TVSH)** 2.312 mijë lekë ose 14.6 % |
| **8. Data e hapjes së tenderit**<br>Datë 01.7.2019 | **9. Burimi Financimit**<br>Bashkia + Grande, sipas periudhave<br>Viti 2019 në shumën 4,220,714 lekë.<br>Viti 2020 në shumën 5,714,005lekë<br>Viti 2021 në shumën 5,805,668 lekë | **10. Operatoret Ekonomike**<br>**a)**Pjesëmarrës në tender **7** OE/BOE<br>b) S'kualifikuar **5** OE/BOE,<br>c) Kualifikuar **2** OE/BOE<br>• |
| **11. Ankimime**<br>**AK**- nr. ---, dt. ---; **KPP--/ APP**–s'ka/ka; | **12. Përgjigje Ankesës** nga AK<br>Shkresa nr. ---, dt. -- | **13. Përgjigje** Ankesës nga APP apo AKKP ; Shkresa nr. ----, dt. ---- |

- **Hartimi i fondit limit:** Fondi për kryerjen e këtij financim është me të ardhurat e Bashkisë Shkodër dhe i miratuar me VKB nr. 82, datë 20.12.2018 në shumën 15,740,387 lekë, e cila do

paguhet me dy fazë, ku për vitin 2019 do paguhet vlefta 4,220,714 lekë, për vitin 2020 do paguhet vlefta 5,714,005 lekë pa TVSH dhe për vitin 2021 në vlerën 5,805,668 lekë pa TVSh, bazuar kjo në udhëzimin plotësues nr. 1 datë 171.2019 "Për buxhetin e vitit 2019" dhe miratuar në PBA periudhës 2019 – 2021.
Nga të dhënat e dosjes, konstatohet se preventivi/preventivi është hartuar nga studio e projektimit "I...", bazuar në VKM nr. 629, datë 15.7.2015 për çmimet sipas manualit.

**Situata**:
- Nga auditimi i dokumentacionit në dosjen e subjekti dhe sistemin SEP, konstatohet se:
**Në DT është kërkuar***:* Për kapacitetin teknik: "Operatori ekonomik ofertues, me anë të një deklaratë (nga Administratori i shoqërisë) duhet të përcaktoje Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt, i cili duhet të jetë i përfshirë në licencën e shoqërisë dhe të deklaroje se ai nuk është i angazhuar në kontratat të tjera Bashkëlidhur deklaratës për Drejtuesin Teknik duhet të paraqitet; a) Kontrata e punës e vlefshme dhe Diploma.
Nisur nga fakti se vlera e përllogaritur e kontratës është në shumën 13,428,718 lekë, kjo kërkesë e përcaktuar është në kundërshtim me kreun I, pika 2.1 të UKM nr. 2, datë 135.2005, "Për zbatimin e punimeve të ndërtimit, ku parashikohet se për punime deri në 30 milion lekë nuk është e detyrueshme qëndrimi i drejtuesit teknik në kantier gjatë gjithë periudhës së punimeve".
**Në vlerësimin e procedurës:**
Nga shoqëria "S..." është paraqitur vetëm për një punonjës me profil "*murator*", konkretisht H.P., por sipas kodit në listpagesave (71134) nuk është murator, por është "*gurgdhendës monumentesh*".
Është paraqitur një punonjës me profil "karpentier", konkretisht N. B., por sipas kodit më listpagesave (93126) është "*punëtor krahu'*.
Për profilin manovrator, nga shoqëria "S...", janë paraqitur 5 punonjës, por asnjë prej tyre nuk e plotësojnë, kjo referuar kodit në listpagesave. Konkretisht:
O.H. dhe P.L. me kod 8332.14 me profil "*shofer kamioni*". GJ.B., sipas Listëpagesat ka kod 31128 me profil "*tek/ndërtimi'*.
I.V., sipas Listëpagesat ka kodin 21511 me "*profil ing. Elektrik*".
S.SH., sipas Listëpagesat ka kodin 93129 me profil "*punëtorë krahu*".

**Kriteri:** Në shkelje të akteve ligjore e nënligjore të LPP, trajtuar në fillim të Kapitullit III/2.4.

**Konkluzioni:** Nga sa kemi trajtuar më sipër procedura paraqitet me probleme si në aplikimin e kritereve po ashtu dhe në shpallje fitues të OE, veprime në paligjshmëri të përdorimit të fondeve publike, *për të cilën ngarkohen me përgjegjësi anëtarët e NJHDT* ***E.D.,*** *me funksion specialist në Njësinë e Prokurimeve,* ***D.K.,*** *me funksion specialist në Njësinë e Prokurimeve,* ***A.K.,*** *me funksion Drejtor i Drejtorisë së PZHT (spec. Ndërtimi) dhe anëtarët e KVO, i përbërë:* ***A.C.,*** *me funksion Administrator NJA Ana e Mali,* ***J.V.,*** *me funksion specialist në Drejtorinë e PZHT - anëtar (ing) dhe* ***I. M.,*** *me funksion- anëtar*

| **4. Procedura me objekt "Sistemim asfaltim rruga Hamidije, Shtoj i Vjetër"** | | |
|---|---|---|
| **1. Urdhër Prokurimi** nr. 213/20.3.2019<br>**2. Lloji i Procedurës** "HAPUR" | **3. Hartuesit e Dokumenteve nr.** 213/20.3.2019<br>E.D.,<br>D.K.,<br>I.T., (spec. Ndërtimi) | ***4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave*** *Urdhër nr. 214/20.3.2019*<br>V.P.,<br>J.V., - anëtar (ing)<br>J.G., - anëtar (financiare) |
| **5. Fondi Limit (pa TVSH)**<br>20,381,399 lekë | **6. Oferta fituese (pa TVSH)** | **7. Diferenca me fondin limit (pa TVSH)**<br>596 mijë lekë ose 25 % |

| 4. Procedura me objekt "Sistemim asfaltim rruga Hamidije, Shtoj i Vjetër" | | |
|---|---|---|
| **REF-24570-05-30-2019** | BEO "S... ..." ShPK. me vlere 15,285,000 lekë pa TVSH me kontratë nr. 4514/12, datë 17.6.2019, me afat 60 ditë. | |
| **8. Data e hapjes së tenderit** Datë 22.4.2019 | **9. Burimi Financimit** Bashkia + Grande, sipas periudhave Viti 2019 në shumën 7,993,333 lekë. Viti 2020 në shumën 9,086,667 lekë Viti 2021 në shumën 3,301,399 lekë | **10. Operatoret Ekonomike** **a)**Pjesëmarrës në tender **9** OE/BOE b) S'kualifikuar 2 OE/BOE, c) Kualifikuar **7** OE/BOE • |
| **11. Ankimime** **AK**- nr. ---, dt. ---; **KPP**--/ **APP**–s'ka/ka; | **12. Përgjigje Ankesës** nga AK Shkresa nr. ---, dt. -- | **13. Përgjigje** Ankesës nga APP apo AKKP ; Shkresa nr. ----, dt. ---- |

- **Hartimi i fondit limit***:* Fondi për kryerjen e këtij financim është me të ardhurat e Bashkisë Shkodër dhe i miratuar me VKB nr. 82, datë 20.12.2018 në shumën 20,381,399 lekë, e cila do paguhet me dy fazë, ku për vitin 2019 do paguhet vlefta 7,993,333 lekë, për vitin 2020 do paguhet vlefta 9,086,667 lekë pa TVSH dhe për vitin 2021 në vlerën 3,301,399 lekë pa TVSh, bazuar kjo në udhëzimin plotësues nr. 1 datë 171.2019 "Për buxhetin e vitit 2019" dhe miratuar në PBA periudhës 2019 – 2021.
Nga të dhënat e dosjes, konstatohet se preventivi/preventivi është hartuar nga specialistët e Bashkisë Shkodër ing. V.B, XH.R. dhe E.D., bazuar në VKM nr. 629, datë 15.7.2015 për çmimet sipas manualit.

| 5. Procedura me objekt "Sistemin - Asfaltim i rrugës së varrezave të fshatit Mali - Hebaj" | | |
|---|---|---|
| **1. Urdhër Prokurimi** nr. 184/15.3.2019<br>**2. Lloji i Procedurës** "HAPUR" | **3. Hartuesit e Dokumenteve nr.** 184/15.3.2019 E.D., D.K., XH.R., (spec. Ndërtimi) | ***4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave*** *Urdhër nr. 185/15.3.2019* P.M. - kryetar J.V., - anëtar (ing) J.G., - anëtar (financiare) |
| **5. Fondi Limit (pa TVSH)** 13,080,570 lekë **REF-13818-03-15-2019** | **6. Oferta fituese (pa TVSH)** EO "RR..." ShPK. me vlere 10,286,842 lekë pa TVSH me kontratë nr. 4216/12, datë 26.6.2019, me afat 45 ditë. | **7. Diferenca me fondin limit (pa TVSH)** 2,794mijë lekë ose 21% |
| **8. Data e hapjes së tenderit** Datë 17.4.2019 | **9. Burimi Financimit** Bashkia + Grande, sipas periudhave Viti 2019 në shumën 5,330,000 lekë. Viti 2020 në shumën 7,750,570 lekë | **10. Operatoret Ekonomike** **a)**Pjesëmarrës në tender **4** OE/BOE b) S'kualifikuar 3 OE/BOE, c) Kualifikuar **1** OE/BOE |
| **11. Ankimime PO** **AK**- nr. ---, dt. ---; **KPP**--/ **APP**–s'ka/ka; | **12. Përgjigje Ankesës** nga AK Shkresa nr. ---, dt. -- | **13. Përgjigje** Ankesës nga APP apo AKKP ; Shkresa nr. ----, dt. ---- |

- **Hartimi i fondit limit:** Fondi për kryerjen e këtij financim është me të ardhurat e Bashkisë Shkodër dhe i miratuar me VKB nr. 82, datë 20.12.2018 në shumën 13,080,570 lekë, e cila do paguhet me dy fazë, ku për vitin 2019 do paguhet vlefta 5,330,000 lekë, për vitin 2020 do paguhet vlefta 7,750,570 lekë pa TVSH, bazuar kjo në udhëzimin plotësues nr. 1 datë 171.2019 "Për buxhetin e vitit 2019" dhe miratuar në PBA periudhës 2019 – 2021.
Nga të dhënat e dosjes, konstatohet se preventivi/preventivi është hartuar nga studio e projektimit "F.H.", bazuar në VKM nr. 629, datë 15.7.2015 për çmimet sipas manualit.

__Situata__:
**Në DT është kërkuar***:* Për kapacitetin teknik: "Operatori ekonomik ofertues, me anë të një deklaratë (nga Administratori i shoqërisë) duhet të përcaktoje Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt, i cili duhet të jetë i përfshirë në licencën e shoqërisë dhe të deklaroje se ai nuk është i angazhuar në kontratat të tjera Bashkëlidhur deklaratës për Drejtuesin Teknik duhet të paraqitet; a) Kontrata e punës e vlefshme dhe Diploma.
Nisur nga fakti se vlera e përllogaritur e kontratës është në shumën 13,080,570 lekë, kjo kërkesë e përcaktuar është në kundërshtim me kreun I, pika 2.1 të UKM nr. 2, datë 135.2005, "Për zbatimin e punimeve të ndërtimit, ku parashikohet se për punime deri në 30 milion lekë nuk është e detyrueshme qëndrimi i drejtuesit teknik në kantier gjatë gjithë periudhës së punimeve".

__**Në vlerësimin e procedurës:**__
Nga auditimi, konstatohet se OE "RR...", nuk plotëson kriteret e DST, sipas pikës 2.3.8, *konkretisht*:
a- Për punonjësit me profesion "karpentier" dhe "murator", nga shoqëria është paraqitur i njëjti person **L.M.**, ku dhe për këtë profesioni që kërkohet në DST, nuk përputhet me kodin e profesionit sipas listpagesave. Kusht sipas listpagesave është 96221 ku sipas VKM nr. 514, datë 20.9.2017, i takon profesioni "punëtor krahu"
b- Për plotësimin e 2 manovratorë, shoqëria ka paraqitur E.M. dhe GJ.V.. Sipas Listëpagesat kodi i tyre është 83321 dhe i takon të jetë "drejtues makinash bankave" dhe jo "makinerish" ose "manovrator".
c- "Hekurkthyesi", i cili është LL.M.. Sipas Listëpagesat paraqitet me kod 93129, i cili i korrespondon "punëtor krahu".
__**Kriteri:**__ Në shkelje të akteve ligjore e nënligjore të LPP, trajtuar në fillim të Kapitullit III/2.4.

__**Konkluzioni:**__ Nga sa kemi trajtuar më sipër procedura paraqitet me probleme si në aplikimin e kritereve po ashtu dhe në shpallje fitues të OE, veprime në paligjshmëri të përdorimit të fondeve publike. Procedura duhej anuluar dhe zhvilluar procedurë tjetër duke analizuar shkaqet, *për të cilën ngarkohen me përgjegjësi anëtarët e NJHDT* ***E.D.,*** *me funksion specialist në Njësinë e Prokurimeve,* ***D.K.,*** *me funksion specialist në Njësinë e Prokurimeve,* ***XH.R.,*** *me funksion Specialiste në Drejtorinë e PZHT (spec. Ndërtimi) dhe anëtarët e KVO, i përbërë:* ***A.SH.*** *- kryetar,* ***J.V.,*** *me funksion specialist në Drejtorinë e PZHT - anëtar (ing) dhe* ***J.G.,*** *me funksion specialistë në Drejt. Buxhetit - anëtar*

| **6. Procedura me objekt "Rikonstruksion rruga Zabelaj"** | | |
|---|---|---|
| **1. Urdhër Prokurimi** nr. 435/23.5.2019<br>**2. Lloji i Procedurës** **"**HAPUR" | **3. Hartuesit e Dokumenteve nr.** 435/23.5.2019<br>E.D.,<br>D.K.,<br>I.T., (spec. Ndërtimi) | ***4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave*** *Urdhër nr. 436/23.5.2019*<br>P.M. - kryetar<br>J.V., - anëtar (ing)<br>J.G., - anëtar (financiare) |
| **5. Fondi Limit (pa TVSH)** 12,314,310 lekë<br>**REF-23565-05-23-2019** | **6. Oferta fituese (pa TVSH)** EO "**S...**" ShPK. me vlere 9,118,586 lekë pa TVSH me kontratë nr. 8891/15, datë 4.9.2019, me afat 70 ditë. | **7. Diferenca me fondin limit (pa TVSH)** 3,196 mijë lekë ose 26% |
| **8. Data e hapjes së tenderit** Datë 24.6.2019 | **9. Burimi Financimit** Bashkia + Grande, sipas periudhave<br>Viti 2019 në shumën 6,237,500 lekë.<br>Viti 2020 në shumën 6,076,810 lekë | **10. Operatoret Ekonomike**<br>**a)** Pjesëmarrës në tender **9** OE/BOE<br>b) S'kualifikuar 5 OE/BOE,<br>c) Kualifikuar **4** OE/BOE |

| **6. Procedura me objekt “Rikonstruksion rruga Zabelaj”** | | |
|---|---|---|
| | | • |
| **11. Ankimime PO**<br>**AK**- nr. ---, dt. ---; **KPP--/ APP**–s’ka/ka; | **12. Përgjigje Ankesës** nga AK<br>Shkresa nr. ---, dt. -- | **13. Përgjigje** Ankesës nga APP apo AKKP ; Shkresa nr. ----, dt. ---- |

- **<u>Hartimi i fondit limit</u>:** Fondi për kryerjen e këtij financim është me të ardhurat e Bashkisë Shkodër dhe i miratuar me VKB nr. 82, datë 20.12.2018 në shumën 12,314,310 lekë, e cila do paguhet me dy fazë, ku për vitin 2019 do paguhet vlefta 6,237,500 lekë, për vitin 2020 do paguhet vlefta 6,076,810 lekë pa TVSH, bazuar kjo në udhëzimin plotësues nr. 1 datë 171.2019 “Për buxhetin e vitit 2019” dhe miratuar në PBA periudhës 2019 – 2021.
Nga të dhënat e dosjes, konstatohet se preventivi/preventivi është hartuar nga studio e projektimit “C...”, bazuar në VKM nr. 629, datë 15.7.2015 për çmimet sipas manualit.

**<u>Situata</u>**:
- Nuk plotëson kriterin që në stafin e tije të jenë të punësuar punonjës me profesion dhe dëshmi kualifikimi, pasi referuar të dhënave të listpagesave (kodet e profesioneve), nuk përputhet me profesionin që kërkohet në DST, konkretisht:
Tekniku i ndërtimi F.H. paraqitet me kod 93126, ku sipas listës së profesioneve është “punëtorë krahu”. Ky person është deklaruar dhe në procedurën me objekt “Sistemim asfaltim rruga Ura e Mesit – Drisht”, gjë e cila bie ndesh me kërkesat e DST.
F.C. i deklaruar si manovrator, sipas listpagesave paraqet kod 9333 me profil “Punëtor ngarkim shkarkimi”.
N.H. i deklaruar si manovrator, sipas listpagesave paraqet kod 83221 me profil shofer dhe jo manovrator. Ky person është deklaruar dhe në procedurën me objekt “Sistemim asfaltim rruga Ura e Mesit – Drisht”, gjë e cila bie ndesh me kërkesat e DST.
S.T. i deklaruar si murator, sipas listpagesave paraqet kod 83221 me profil “Shofer”. Ky person është deklaruar dhe në procedurën me objekt “Sistemim asfaltim rruga Ura e Mesit – Drisht”, gjë e cila bie ndesh me kërkesat e DST
M.M. i deklaruar si “manovrator”, sipas listpagesave paraqet kod 31133 me profil “Inspektorati i sigurimit në punë”.
Z.H. i deklaruar si hidraulik, sipas listpagesave paraqet kod 71125 me profil “Murator murrë tulle”.
A.P. i deklaruar si karpentier, sipas listpagesave paraqet kod 93126 me profil “Punëtor krahu”.
Gjithashtu nga auditimi konstatohet se si makineritë, numri i punonjësve, drejtuesi teknik, e deklaruar në këtë procedurë janë të deklaruara dhe në **2 procedura** të tjera të zhvilluara në Bashkinë Shkodër, konkretisht rastet:

| Nr. | Objekti | Urdhër Prokurimi | | Kontrata bazë me TVSH | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | Nr. | Datë | Vlera |
| 1 | Rikonstruksion Rruga "Zabelej" | 435 | 23.5.2019 | 8891/15 | 4.9.2019 | 10,942,303.2 |
| 2 | Sistemim asfaltim rruga "Ura e Mesit-Drisht" | 489 | 29.5.2019 | 9267/15 | 19.8.2019 | 11,379,595.2 |

**<u>Kriteri:</u>** Në shkelje të akteve ligjore e nënligjore të LPP, trajtuar në fillim të Kapitullit III/2.4.

**<u>Konkluzioni:</u>** Nga sa kemi trajtuar më sipër procedura paraqitet me probleme në shpallje fitues të OE, pasi janë aplikuar kritere jo në përputhje me kushtet e zbatimit të projekti dhe se OE i shpallur fitues nuk plotëson të gjitha kriteret e DST, veprime të cilat çojnë në paligjshmëri të përdorimit të

fondeve të prokuruar, *për të cilën ngarkohen me përgjegjësi anëtarët e KVO, i përbërë:* ***P.M.,*** *me funksion Administrator NJA Guri i Zi - kryetar,* ***J.V.,*** *me funksion specialist në Drejtorinë e PZHT - anëtar (ing) dhe* ***J.G.,*** *me funksion specialistë në Drejt. Buxhetit - anëtar*

<table>
<tr><th colspan="3">7. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt : “Rikualifikim urban rruga “Daut Boriçi”.</th></tr>
<tr><td>1. Urdhër Prokurimi<br>Nr. 746, datë 208.2019</td><td rowspan="2">3. Hartuesit e Dokumenteve Tenderit<br>Urdhër nr. 746, datë 208.2019<br>1. E.D.<br>2. D.K.<br>3. R.T.,</td><td rowspan="2">4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave<br>Urdhër nr. 747, datë 208.2019<br>1. P.M.<br>2. N.D.,<br>3. J.G.</td></tr>
<tr><td>2. Lloji i Procedurës –<br>“Kërkesë për propozim”</td></tr>
<tr><td>5. Fondi Limit (pa TVSh)<br>10,010,912 lekë.</td><td>6. Oferta fituese (pa TVSh)<br>OE/BOE “N... “ me ofertë 6,705,120 lekë pa TVSh, sipas kontratës nr. 14386/14, dt. 22.10.2019 me afat 70 ditë kalendarike.</td><td>7. Diferenca me fondin limit (pa TVSh)<br>3,305 mijë lekë ose 33- %</td></tr>
<tr><td>8. Data e hapjes së tenderit<br>Datë 029.2019<br><br>REF-34056-08-21-2019</td><td>9. Burimi Financimit<br>Buxheti i Bashkisë Shkodër<br>Vitin 2019 vlefta 899,999 lekë,<br>Vitin 2020 do paguhet vlefta 4,166,667 lekë Vitin 2021 në shumën 5,712,500 lekë</td><td>10. Operatoret Ekonomike<br>a)Pjesëmarrës në tender 4 OE/BOE<br>b) S’kualifikuar 2 OE/BOE,<br>c) Kualifikuar 2 OE/BOE<br>•</td></tr>
<tr><td>11. Ankimime; Ka ankesë – Nuk ka patur<br>AK- nr. --------APP-------;<br>KPP-------</td><td>12. Përgjigje Ankesës nga AK<br>Shkresa nr. --------</td><td>13. Përgjigje Ankesës nga<br>APP apo AKKP ---------------<br>Shkresa nr. ----</td></tr>
</table>

- **<u>Hartimi i fondit limit</u>:** Fondi për kryerjen e këtij financim është me të ardhurat e Bashkisë Shkodër dhe i miratuar me VKB nr. 82, datë 20.12.2018 në shumën 10,779,166 lekë, e cila do paguhet me tre fazë, ku për vitin 2019 do paguhet vlefta 899,999 lekë, për vitin 2020 do paguhet vlefta 4,166,667 lekë pa TVSH dhe për vitin 2021 në shumën 5,712,500 lekë pa TVSh, bazuar kjo në udhëzimin plotësues nr. 1 datë 171.2019 “Për buxhetin e vitit 2019” dhe miratuar në PBA periudhës 2019 – 2021.
Nga të dhënat e dosjes, konstatohet se preventivi/preventivi është hartuar nga studio e projektimit “C...”, bazuar në VKM nr. 629, datë 15.7.2015 për çmimet sipas manualit.

**<u>Situata</u>**:
Në hartimin e DST rezulton se, nuk ka gjetur zbatim VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, sa vijon:
**Në DT është kërkuar:** Sipas pikës 2.2 “Për kapacitetin teknik ekonomik” është kërkuar që OE pjesëmarrës të paraqesin një xhiro mesatare vjetore për vitet 2016, 2017 dhe 2018 jo më të vogël se 10,010,912 lekë, ku sipas akteve ligjore kërkohet deri në 50%.
**Në DT është kërkuar**: Për kapacitetin teknik: “Operatori ekonomik ofertues, me anë të një deklaratë (nga Administratori i shoqërisë) duhet të përcaktoje Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt, i cili duhet të jetë i përfshirë në licencën e shoqërisë dhe të deklaroje se ai nuk është i angazhuar në kontratat të tjera Bashkëlidhur deklaratës për Drejtuesin Teknik duhet të paraqitet; a) Kontrata e punës e vlefshme dhe Diploma.
Nisur nga fakti se vlera e përllogaritur e kontratës është në shumën 6,705,120 lekë, kjo kërkesë e përcaktuar është në kundërshtim me kreun I, pika 2.1 të UKM nr. 2, datë 135.2005, “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit, ku parashikohet se për punime deri në 30 milion lekë nuk është e detyrueshme qëndrimi i drejtuesit teknik në kantier gjatë gjithë periudhës së punimeve”.

**<u>Kriteri:</u>** Në shkelje të akteve ligjore e nënligjore të LPP, trajtuar në fillim të Kapitullit III/2.4.

**Konkluzioni:** Nga sa kemi trajtuar më sipër procedura paraqitet me probleme si në aplikimin e kritereve dhe shpallje fitues të OE, pasi janë aplikuar kritere jo në përputhje me kushtet e zbatimit të projekti dhe se OE i shpallur fitues nuk plotëson të gjitha kriteret e DST, veprime të cilat çojnë në paligjshmëri të përdorimit të fondeve të prokuruar, *për të cilën ngarkohen me përgjegjësi anëtarët e NJHDT,* ***E.D.,*** *me funksion specialist në Njësinë e Prokurimeve,* ***D.K.,*** *me funksion specialist në Njësinë e Prokurimeve,* ***R.T.,*** *me funksion specialist në DPZHT (spec. Ndërtimi)* .

| 8. Procedura e Prokurimit me objekt : "*Rikonstruksion i rrugës Rragam – Sheldi (loti 2)*". | | |
|---|---|---|
| **1. Urdhër Prokurimi**<br>441/20.5.2019<br><br>**2. Lloji i Procedurës –**<br>"*Hapur*" | **3. Hartuesit e Dokumenteve Tenderit**<br>Urdhër 441/20.5.2019.<br>E.D.<br>2. D.K.<br>3. N.D. | **4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave**<br>Urdhër 442/23.5.2019<br>1. P.M.<br>2. J.V., me funksion specialiste në DPZHT<br>3. J.G. |
| **5. Fondi Limit (pa TVSh)**<br>16,716,140 *lekë (loti 2).*<br>**REF-23431-05-23-2019** | **6. Oferta fituese (pa TVSh)**<br>Loti II: BOE **"**S..." & "S... **"** me ofertë 14,503,719 lekë pa TVSh, sipas kontratës nr. 8894/12, dt. 19.8.2019 me afat 2 muaj | **7. Diferenca me fondin limit (pa TVSh)**<br>Loti II në shumën 2,213 mijë lekë ose 13.2- % |
| **8. Data e hapjes së tenderit**<br>Datë 24.6.2019 | **9. Burimi Financimit**<br>Buxhet i Bashkisë Shkodër, sipas periudhave<br>Viti 2019 në shumën 3,746,666 lekë.<br>Viti 2020 në shumën 6,303,333 lekë<br>Viti 2021 në shumën 6,666,141 lekë | **10. Operatoret Ekonomike**<br>**<u>Loti II</u>**<br>a)Pjesëmarrës në tender 7 OE/BOE<br>b) S'kualifikuar **5** OE/BOE<br>c) Kualifikuar **2** OE/BOE |
| **11. Ankimime; Ka ankesë -** Nuk ka patur ankesa<br>**AK**- nr. ----; **APP**-------;<br>**KPP**------- | **12. Përgjigjie Ankesës** nga AK<br>Shkresa nr. -------- | **13. Përgjigje** Ankesës nga APP apo AKKP ---------------<br>Shkresa nr. ---- |

- **<u>Hartimi i fondit limit</u>:** Fondi për kryerjen e këtij financim është me të ardhurat e Bashkisë Shkodër dhe i miratuar me VKB nr. 82, datë 20.12.2018 në shumën 16,716,140 lekë, e cila do paguhet me tre fazë, ku për vitin 2019 do paguhet vlefta 3,746,666 lekë, për vitin 2020 do paguhet vlefta 6,303,333 lekë pa TVSH dhe për vitin 2021 në shumën 6,666,141 lekë pa TVSh, bazuar kjo në udhëzimin plotësues nr. 1 datë 171.2019 "Për buxhetin e vitit 2019" dhe miratuar në PBA periudhës 2019 – 2021.

Nga të dhënat e dosjes, konstatohet se preventivi/preventivi është hartuar nga studio e projektimit "I...", bazuar në VKM nr. 629, datë 15.7.2015 për çmimet sipas manualit.

**<u>Situata</u>**:

Në hartimin e DST rezulton se, nuk ka gjetur zbatim VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, sa vijon:

**<u>Në DT është kërkuar</u>:** Për kapacitetin teknik: "Operatori ekonomik ofertues, me anë të një deklaratë (nga Administratori i shoqërisë) duhet të përcaktoje Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt, i cili duhet të jetë i përfshirë në licencën e shoqërisë dhe të deklaroje se ai nuk është i angazhuar në kontratat të tjera Bashkëlidhur deklaratës për Drejtuesin Teknik duhet të paraqitet; a) Kontrata e punës e vlefshme dhe Diploma.

Nisur nga fakti se vlera e përllogaritur e kontratës është në shumën 14,503,719 lekë, kjo kërkesë e përcaktuar është në kundërshtim me kreun I, pika 2.1 të UKM nr. 2, datë 135.2005, "Për zbatimin

e punimeve të ndërtimit, ku parashikohet se për punime deri në 30 milion lekë nuk është e detyrueshme qëndrimi i drejtuesit teknik në kantier gjatë gjithë periudhës së punimeve".

**Vlerësimi i OE fitues:**

Nga vlerësimi i dokumentacionit në dosjen e subjekti dhe sistemin SEP të APP, u konstatua se BOE nuk plotëson të gjitha kriteret e DST, konkretisht:

a- Nuk plotëson pikën 2.3.11 të DST, për mjetet në dispozicion. Kështu nuk paraqet mjet me kapacitet 3.5 – 7 ton. Sipas dokumenteve në sistem nga shoqëria "S..." është paraqitur mjeti me targë A...K me kontratë qiraje 3783/811 datë 01.6.2019 dhe pronar z. M.B.. Sipas lejes se qarkullimit dhe certifikatës se transportit janë për përdorim vetjak dhe jo për te trete, mangësi për të cilën janë skualifikuar dhe OE me ofertë më të leverdishme**.** Për këtë mjet nuk paraqitet leje bashkime**.**

Nga shoqëria "S..." është paraqitur mjeti me targë S...E me kapacitet mbajtës 23 ton.

b- Nga shoqëria "S..." janë paraqitur mjetet me targë A...O dhe kapacitet 11 ton, dhe mjeti me targë A...N me kapacitet 9.8 ton.

Pra nga të dy shoqëritë nuk është paraqitur mjetin me kapacitet mbajtës 3.55 – 7 ton**.**

- Nuk plotëson kriterin që në stafin e tije të jenë të punësuar punonjës me profesion dhe dëshmi kualifikimi, pasi referuar të dhënave të listpagesave (kodet e profesioneve), nuk përputhet me profesionin që kërkohet në DST, konkretisht:

*Për shoqërinë "S..."*

Tekniku i ndërtimi F.H. paraqitet me kod 93126, ku sipas listës së profesioneve është punëtorë krahu. Ky person është deklaruar dhe në procedurën me objekt "Sistemim asfaltim rruga Ura e Mesit – Drisht", gjë e cila bie ndesh me kërkesat e DST.

SH.B. i deklaruar si murator, sipas listpagesave paraqet kod 83221 me profil "Shofer".

S.T. i deklaruar si murator, sipas listpagesave paraqet kod 83221 me profil "Shofer".

*Për shoqërinë "S..."*

A.P. i deklaruar si hidraulik, sipas listpagesave paraqet kod 93129 me profil "Punëtorë krahu".

L.K. i deklaruar si hidraulik, sipas listpagesave paraqet kod 93129 me profil "Punëtorë krahu".

GJ.B. i deklaruar si manovrator, sipas listpagesave paraqet kod 31128 me profil "ekspert zjarri"

I.V. i deklaruar si murator, sipas listpagesave paraqet kod 21421 me profil "ing/supervizor".

S.SH. i deklaruar si manovrator, sipas listpagesave paraqet kod 93129 me profil "Punëtorë krahu".

z. H.P. i deklaruar si murator, sipas listpagesave paraqet kod 71134 me profil "gdhendës monumentesh".

**Kriteri:** Në shkelje të akteve ligjore e nënligjore të LPP, trajtuar në fillim të Kapitullit III/2.4

**Konkluzioni:** Nga sa kemi trajtuar më sipër procedura paraqitet me probleme si në aplikimin e kritereve dhe shpallje fitues të OE, pasi janë aplikuar kritere jo në përputhje me kushtet e zbatimit të projekti dhe se OE i shpallur fitues nuk plotëson të gjitha kriteret e DST, veprime të cilat çojnë në paligjshmëri të përdorimit të fondeve të prokuruar, *për të cilën ngarkohen me përgjegjësi anëtarët e NJHDT,* ***E.D.,*** *me funksion specialist në Njësinë e Prokurimeve,* ***D.K.,*** *me funksion specialist në Njësinë e Prokurimeve,* ***N.D.,*** *me funksion specialist në DPZHT (spec. Ndërtimi) dhe anëtarët e KVO, i përbërë:* ***P.M.,*** *me funksion Administrator NJA Guri i Zi - kryetar,* ***J.V.,*** *me funksion specialist në Drejtorinë e PZHT - anëtar (ing) dhe* ***J.G.,*** *me funksion specialistë në Drejt. Buxhetit - anëtar*

| 9. Procedura e Prokurimit me objekt : "*Sistemim asfaltim i rrugëve të brendshme, fshati Gur i Zi*". | | |
|---|---|---|
| **1. Urdhër Prokurimi**<br>437/23.5.2019<br><br>**2. Lloji i Procedurës –**<br>**"***Kërkesë propozim*" | **3. Hartuesit e Dokumenteve Tenderit**<br>Urdhër 437/23.5.2019.<br>1. E.D.<br>2. D.K.<br>3. I.T. | **4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave**<br>Urdhër 438/23.5.2019<br>1. P.M.<br>2. J.V.,<br>3. J.G. |
| **5. Fondi Limit (pa TVSh)**<br>11,661,818 lekë<br><br>**REF-23441-05-23-2019** | **6. Oferta fituese (pa TVSh)**<br>Loti II: BOE **"**S..." & "S... **"** me ofertë 14,503,719 lekë pa TVSh, sipas kontratës nr. 8895/12, dt. 19.8.2019 me afat 4 muaj | **7. Diferenca me fondin limit (pa TVSh)**<br>Loti II në shumën 2,213 mijë lekë ose 13.2-% |
| **8. Data e hapjes së tenderit**<br>Datë 03.6.2019 | **9. Burimi Financimit**<br>Buxhet i Bashkisë Shkodër, sipas periudhave<br>Viti 2019 në shumën 4,479,167 lekë.<br>Viti 2020 në shumën 3,610,000 lekë<br>Viti 2021 në shumën 3,572,651 lekë | **10. Operatoret Ekonomike**<br>**<u>Loti II</u>**<br>a)Pjesëmarrës në tender 8 OE/BOE<br>***b) S'kualifikuar 4 OE/BOE***<br>***c) Kualifikuar 4 OE/BOE*** |
| **11. Ankimime; Ka ankesë -** Nuk ka patur ankesa<br>**AK**- nr. ----; **APP**–------;<br>**KPP**------- | **12. Përgjigje Ankesës** nga AK<br>Shkresa nr. -------- | **13. Përgjigje** Ankesës nga<br>APP apo AKKP ---------------<br>Shkresa nr. ---- |

- **<u>Hartimi i fondit limit</u>:** Fondi për kryerjen e këtij financim është me të ardhurat e Bashkisë Shkodër dhe i miratuar me VKB nr. 82, datë 20.12.2018 në shumën 11,661,818 lekë, e cila do paguhet me tre fazë, ku për vitin 2019 do paguhet vlefta 4,479,167 lekë, për vitin 2020 do paguhet vlefta 3,610,000 lekë pa TVSH dhe për vitin 2021 në shumën 3,572,651 lekë pa TVSh, bazuar kjo në udhëzimin plotësues nr. 1 datë 171.2019 "Për buxhetin e vitit 2019" dhe miratuar në PBA periudhës 2019 – 2021.

Nga të dhënat e dosjes, konstatohet se preventivi/preventivi është hartuar nga studio e projektimit "I...", bazuar në VKM nr. 629, datë 15.7.2015 për çmimet sipas manualit.

**<u>Situata</u>**:

Në hartimin e DST rezulton se, nuk ka gjetur zbatim VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, sa vijon:

**Në DT është kërkuar**: Për kapacitetin teknik: "Operatori ekonomik ofertues, me anë të një deklaratë (nga Administratori i shoqërisë) duhet të përcaktoje Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt, i cili duhet të jetë i përfshirë në licencën e shoqërisë dhe të deklaroje se ai nuk është i angazhuar në kontratat të tjera Bashkëlidhur deklaratës për Drejtuesin Teknik duhet të paraqitet; a) Kontrata e punës e vlefshme dhe Diploma**.**

Nisur nga fakti se vlera e përllogaritur e kontratës është në shumën 9,646,852 lekë, kjo kërkesë e përcaktuar është në kundërshtim me kreun I, pika 2.1 të UKM nr. 2, datë 135.2005, "Për zbatimin e punimeve të ndërtimit, ku parashikohet se për punime deri në 30 milion lekë nuk është e detyrueshme qëndrimi i drejtuesit teknik në kantier gjatë gjithë periudhës së punimeve".

**<u>Vlerësimi i OE fitues</u>:**

Nga vlerësimi i dokumentacionit në dosjen e subjekti dhe sistemin SEP të APP, u konstatua se BOE nuk plotëson të gjitha kriteret e DST, konkretisht:

- Nuk plotëson pikën 2.3.11 të DST, për mjetet në dispozicion. Kështu nuk paraqet mjet me kapacitet 3.5 – 7 ton. Sipas dokumenteve në sistem nga shoqëria "S..." është paraqitur mjeti me targë A...K me kontratë qiraje 3783/811 datë 01.6.2019 dhe pronar M.B.. Sipas lejes se qarkullimit dhe certifikatës se transportit janë për përdorim vetjak dhe jo për te trete, <u>mangësi për të cilën janë skualifikuar dhe OE me ofertë më të leverdishme.</u>

Për këtë mjet nuk paraqitet leje bashkime.
Gjithashtu nga shoqëria "S..." është paraqitur mjeti me targë S...E me kapacitet mbajtës 23 ton.
- Nga shoqëria "S..." janë paraqitur mjetet me targë A...O dhe kapacitet 11 ton, dhe mjeti me targë A...N me kapacitet 9.8 ton.
Pra nga të dy shoqëritë nuk është paraqitur mjetin me kapacitet mbajtës 3.55 – 7 ton.
- Nuk plotëson kriterin që në stafin e tije të jenë të punësuar punonjës me profesion dhe dëshmi kualifikimi, pasi referuar të dhënave të listpagesave (kodet e profesioneve), nuk përputhet me profesionin që kërkohet në DST, konkretisht:
*Për shoqërinë "S..."*
Tekniku i ndërtimi z. F.H. paraqitet me kod 93126, ku sipas listës së profesioneve është punëtorë krahu. Ky person është deklaruar dhe në procedurën me objekt "Sistemim asfaltim rruga Ura e Mesit – Drisht", gjë e cila bie ndesh me kërkesat e DST.
SH.B. i deklaruar si murator, sipas listpagesave paraqet kod 83221 me profil "Shofer".
S.T. i deklaruar si murator, sipas listpagesave paraqet kod 83221 me profil "Shofer".
*Për shoqërinë "S..."*
A.P. i deklaruar si hidraulik, sipas listpagesave paraqet kod 93129 me profil "Punëtorë krahu".
L.K. i deklaruar si hidraulik, sipas listpagesave paraqet kod 93129 me profil "Punëtorë krahu".
GJ.B. i deklaruar si manovrator, sipas listpagesave paraqet kod 31128 me profil "ekspert zjarri"
I.V. i deklaruar si murator, sipas listpagesave paraqet kod 21421 me profil "ing/supervizor".
S.SH. i deklaruar si manovrator, sipas listpagesave paraqet kod 93129 me profil "Punëtorë krahu".
H.P. i deklaruar si murator, sipas listpagesave paraqet kod 71134 me profil "gdhendës monumentesh".

Gjithashtu nga auditimi konstatohet se si makineritë, numri i punonjësve, drejtuesi teknik, e deklaruar në këtë procedurë janë të deklaruara dhe në **6 procedura** të tjera të zhvilluara në Bashkinë Shkodër, konkretisht rastet:

| Nr. | Objekti | Kontrata bazë me TVSH | | |
|---|---|---|---|---|
| | | Nr. | Datë | Vlera |
| 1 | Rikonstruksion i rrugës Oblike – Velinaj – Alimetaj, Loti 3 | 9359/12 | 19.8.2019 | 16,114,461.6 |
| 2 | Rikonstruksion Rruga "Zabelej" | 8891/15 | 4.9.2019 | 10,942,303.2 |
| 3 | Rikonstruksioni rrugës Rragam – Sheld (Loti 2). | 8895/12 | 19.8.2019 | 17,404,462.8 |
| 4 | Sistemim - Asfaltim i rrugës Muriqan-Goricë | 9361/15 | 4.9.2019 | 15,477,013.2 |
| 5 | Sistemim - Asfaltim i rrugëve te brendshme, fshati Guri i Zi, (Rruga e Xhamise, Loti 1). | 8895/12 | 5.8.2019 | 11,576,222.4 |
| 6 | Sistemim asfaltim rruga "Ura e mesit-Drisht" | 9267/15 | 19.8.2019 | 11,379,595.2 |

**Kriteri:** Në shkelje të akteve ligjore e nënligjore të LPP, trajtuar në fillim të Kapitullit III/2.4

**Konkluzioni:** Nga sa kemi trajtuar më sipër procedura paraqitet me probleme si në aplikimin e kritereve dhe shpallje fitues të OE, pasi janë aplikuar kritere jo në përputhje me kushtet e zbatimit të projekti dhe se OE i shpallur fitues nuk plotëson të gjitha kriteret e DST, veprime të cilat çojnë në paligjshmëri të përdorimit të fondeve të prokuruar, *për të cilën ngarkohen me përgjegjësi*

*anëtarët e NJHDT,* ***E.D.,*** *me funksion specialist në Njësinë e Prokurimeve,* ***D.K.,*** *me funksion specialist në Njësinë e Prokurimeve,* ***I.T.,*** *me funksion specialist në DPZHT (spec. Ndërtimi) dhe anëtarët e KVO, i përbërë:* ***P.M.,*** *me funksion Administrator NJA Guri i Zi - kryetar,* ***J.V.,*** *me*

| funksion specialist në Drejtorinë e PZHT - anëtar (ing) dhe **J.G.,** me funksion specialistë në Drejt. Buxhetit - anëtar |
|---|

| **10. Procedura e Prokurimit me objekt : "*Rikonstruksion rruga Brioti"*.** | | |
|---|---|---|
| **1. Urdhër Prokurimi**<br>Nr. 469/28.5.2019<br><br>**2. Lloji i Procedurës – "***HAPUR*" | **3. Hartuesit e Dokumenteve Tenderit**<br>Urdhër nr. 469/28.5.2019<br>1. E.D.<br>2. D.K.<br>3. XH.R., | **4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave**<br>Urdhër nr. 518/30.5.2019<br>1. P.M.,<br>2. J.V.<br>3. J.G. |
| **5. Fondi Limit (pa TVSh)**<br>19,258,655 lekë.<br>**REF-24194-05-28-2019** | **6. Oferta fituese (pa TVSh)**<br>OE/BOE **"A..."** ShPK me vlere te përgjithshme prej **14,829,163** lekë pa TVSh, sipas kontratës nr. 9206/15, dt. 4.9.2019 me afat 2 muaj. | **7. Diferenca me fondin limit (pa TVSh)** 4,429 mijë lekë ose 22.9- % |
| **8. Data e hapjes së tenderit**<br>Datë 28.6.2019 | **9. Burimi Financimit**<br>Buxhet i Bashkisë Shkodër, sipas periudhave<br>Viti 2019 në shumën 5,034,166 lekë.<br>Viti 2020 në shumën 5,034,166lekë<br>Viti 2021 në shumën 7,263,656lekë | **10. Operatoret Ekonomike**<br>a)Pjesëmarrës në tender 11 OE/BOE<br>**b) S'kualifikuar 4 OE/BOE**<br>**c) Kualifikuar 7OE/BOE** |
| **11. Ankimime; Ka ankesë PO**<br>**AK-** nr.14082, dt. 14.8.2019-;<br>**APP**-------;<br>**KPP**------- | **12. Përgjigje Ankesës** nga AK<br>Shkresa nr. 14082/1, dt. 19.8.2019 | **13. Përgjigje** Ankesës nga<br>APP apo AKKP --------------<br>Shkresa nr. ---- |

**- <u>Hartimi i fondit limit</u>:** Fondi për kryerjen e këtij financim është me të ardhurat e Bashkisë Shkodër dhe i miratuar me VKB nr. 82, datë 20.12.2018 në shumën 19,258,655 lekë, e cila do paguhet me dy fazë, ku për vitin 2019 do paguhet vlefta 5,034,166 lekë, për vitin 2020 do paguhet vlefta 5,034,166lekë pa TVSH dhe për vitin 2021 në shumën 7,263,656 lekë pa TVSh, bazuar kjo në udhëzimin plotësues nr. 1 datë 171.2019 "Për buxhetin e vitit 2019" dhe miratuar në PBA periudhës 2019 – 2021.
Nga të dhënat e dosjes, konstatohet se preventivi/preventivi është hartuar nga studio e projektimit "C...", bazuar në VKM nr. 629, datë 15.7.2015 për çmimet sipas manualit.

**<u>Situata</u>**:
Në hartimin e DST rezulton se, nuk ka gjetur zbatim VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, sa vijon:
**Në DT është kërkuar**: Për kapacitetin teknik: "Operatori ekonomik ofertues, me anë të një deklaratë (nga Administratori i shoqërisë) duhet të përcaktoje Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt, i cili duhet të jetë i përfshirë në licencën e shoqërisë dhe të deklaroje se ai nuk është i angazhuar në kontratat të tjera Bashkëlidhur deklaratës për Drejtuesin Teknik duhet të paraqitet; a) Kontrata e punës e vlefshme dhe Diploma.
Nisur nga fakti se vlera e përllogaritur e kontratës është në shumën 14,829,163 lekë, kjo kërkesë e përcaktuar është në kundërshtim me kreun I, pika 2.1 të UKM nr. 2, datë 135.2005, "Për zbatimin e punimeve të ndërtimit, ku parashikohet se për punime deri në 30 milion lekë nuk është e detyrueshme qëndrimi i drejtuesit teknik në kantier gjatë gjithë periudhës së punimeve".
**Në DT është kërkuar:** Të paraqiten mjete dhe pajisje të mbrojtjes në punë të punëtorëve, personelit si më poshtë:
- *Kokore minimumi 15 (pesëmbëdhjetë) copë*
- *Fikse zjarri të lëvizshme me kapacitet 5-7 litra secila minimumi 2 (dy) copë*
- *Prozhektorë ndriçimi natën minimumi 2 (dy) copë*

- *Komplet i ndihmës së shpejtë minimumi 3 copë*
- *Tabela paralajmëruese për sigurinë në objekt minimumi 5 (pese) copë*

Kjo kërkesë është e tejkaluar pasi NJHDT në hartimin e preventivave, të cilat janë bërë pjesë e DT, duhej të gjente zbatim VKM nr. 664, datë 269.2012, "Për disa ndryshime dhe shtesa në VKM nr. 514, datë 15.87, "Për informatizimin e llogaritjes së kostos dhe hartimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit", pika 10, pasi nuk është parashikuar zbatimi i VKM nr. 312, datë 055.10, "Për miratimin e rregullores për sigurinë në kantier", aneksi VI, "Mbi sigurinë në kantier", në vlerën jo më pak se 3% të vlerës së projektit. Pjesë përbërëse e këtij 3% janë materialet e kërkuara krahas makinerive e mjeteve.

**Kriteri:** Në shkelje të akteve ligjore e nënligjore të LPP, trajtuar në fillim të Kapitullit III/2.4

**Konkluzioni:** Nga sa kemi trajtuar më sipër procedura paraqitet me probleme në aplikimin e kritereve, *për të cilën ngarkohen me përgjegjësi anëtarët e NJHDT,* ***E.D.,*** *me funksion specialist në Njësinë e Prokurimeve,* ***D.K.,*** *me funksion specialist në Njësinë e Prokurimeve,* ***XH.R.,*** *me funksion specialist në DPZHT (spec. Ndërtimi).*

Në lidhje me shpalljen fitues të OE , nga auditim nuk u konstatuan mangësi sipas dispozitave të LPP dhe plotësimit të kritereve të DST.

| **11. Procedura e Prokurimit me objekt : "*Rikonstruksion rruga SHASI*".** | | |
|---|---|---|
| **1. Urdhër Prokurimi**<br>Nr. 439/23.5.2019<br>**2. Lloji i Procedurës – "***HAPUR***"** | **3. Hartuesit e Dokumenteve Tenderit**<br>Urdhër nr. 439/23.5.2019<br>1. E.D.<br>2. D.K.<br>3. I.T., | **4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave**<br>Urdhër nr. 440/23.5.2019<br>1. P.M.,<br>2. J.V.<br>3. J.G. |
| **5. Fondi Limit (pa TVSh)**<br>12,800,370 lekë.<br>**REF-23563-05-23-2019** | **6. Oferta fituese (pa TVSh)**<br>OE/BOE **"A..."** ShPK me vlere te përgjithshme prej 10,105,670 lekë pa TVSh, sipas kontratës nr. 9206/15, dt. 4.9.2019 me afat 2 muaj. | **7. Diferenca me fondin limit (pa TVSh)**<br>2,695 mijë lekë ose 21- % |
| **8. Data e hapjes së tenderit**<br>Datë 27.5.2019 | **9. Burimi Financimit**<br>Buxhet i Bashkisë Shkodër, sipas periudhave<br>Viti 2019 në shumën 3,585,000 lekë.<br>Viti 2020 në shumën 3,585,000lekë<br>Viti 2021 në shumën 2,038,203lekë | **10. Operatoret Ekonomike**<br>a)Pjesëmarrës në tender 7 OE/BOE<br>**b) S'kualifikuar 5 OE/BOE**<br>**c) Kualifikuar 2 OE/BOE** |
| **11. Ankimime; Ka ankesë**<br>**AK**- nr. ----; **APP**-------;<br>**KPP**------- | **12. Përgjigje Ankesës** nga AK<br>Shkresa nr. -------- | **13. Përgjigje** Ankesës nga<br>APP apo AKKP ---------------<br>Shkresa nr. ---- |

- **<u>Hartimi i fondit limit</u>:** Fondi për kryerjen e këtij financim është me të ardhurat e Bashkisë Shkodër dhe i miratuar me VKB nr. 82, datë 20.12.2018 në shumën 12,800,370 lekë, e cila do paguhet me dy fazë, ku për vitin 2019 do paguhet vlefta 3,585,000 lekë, për vitin 2020 do paguhet vlefta 3,585,000 lekë pa TVSH dhe për vitin 2021 në shumën 2,038,203 lekë pa TVSh, bazuar kjo në udhëzimin plotësues nr. 1 datë 171.2019 "Për buxhetin e vitit 2019" dhe miratuar në PBA periudhës 2019 – 2021.

Nga të dhënat e dosjes, konstatohet se preventivi/preventivi është hartuar nga studio e projektimit "C...", bazuar në VKM nr. 629, datë 15.7.2015 për çmimet sipas manualit.

**Situata**:
Në hartimin e DST rezulton se, nuk ka gjetur zbatim VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, sa vijon:
**Në DT është kërkuar**: Për kapacitetin teknik: "Operatori ekonomik ofertues, me anë të një deklaratë (nga Administratori i shoqërisë) duhet të përcaktoje Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt, i cili duhet të jetë i përfshirë në licencën e shoqërisë dhe të deklaroje se ai nuk është i angazhuar në kontratat të tjera Bashkëlidhur deklaratës për Drejtuesin Teknik duhet të paraqitet; a) Kontrata e punës e vlefshme dhe Diploma.
Nisur nga fakti se vlera e përllogaritur e kontratës është në shumën 10,105,670 lekë, kjo kërkesë e përcaktuar është në kundërshtim me kreun I, pika 2.1 të UKM nr. 2, datë 135.2005, "Për zbatimin e punimeve të ndërtimit, ku parashikohet se për punime deri në 30 milion lekë nuk është e detyrueshme qëndrimi i drejtuesit teknik në kantier gjatë gjithë periudhës së punimeve".
**Në DT është kërkuar:** Të paraqiten mjete dhe pajisje të mbrojtjes në punë të punëtorëve, personelit si më poshtë: *Kokore minimumi 15 (pesëmbëdhjetë) copë; Fikse zjarri të lëvizshme me kapacitet 5-7 litra secila minimumi 2 (dy) copë; Prozhektorë ndriçimi natën minimumi 2 (dy) copë ; Komplet i ndihmës së shpejtë minimumi 3 copë; Tabela paralajmëruese për sigurinë në objekt minimumi 5 (pese) copë.*
Kjo kërkesë është e tejkaluar pasi NJHDT në hartimin e preventivave, të cilat janë bërë pjesë e DT, duhej të gjente zbatim VKM nr. 664, datë 269.2012, "Për disa ndryshime dhe shtesa në VKM nr. 514, datë 15.87, "Për informatizimin e llogaritjes së kostos dhe hartimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit", pika 10, pasi nuk është parashikuar zbatimi i VKM nr. 312, datë 055.10, "Për miratimin e rregullores për sigurinë në kantier", aneksi VI, "Mbi sigurinë në kantier", në vlerën jo më pak se 3% të vlerës së projektit. Pjesë përbërëse e këtij 3% janë materialet e kërkuara krahas makinerive e mjeteve.
**Kriteri:** Në shkelje të akteve ligjore e nënligjore të LPP, trajtuar në fillim të Kapitullit III/2.4.

**Konkluzioni:** Nga sa kemi trajtuar më sipër procedura paraqitet me probleme në aplikimin e kritereve, pasi janë aplikuar kritere jo në përputhje me kushtet e zbatimit të projekti, *për të cilën ngarkohen me përgjegjësi anëtarët e NJHDT,* ***E.D.,*** *me funksion specialist në Njësinë e Prokurimeve,* ***D.K.,*** *me funksion specialist në Njësinë e Prokurimeve,* ***I.T.,*** *me funksion specialist në DPZHT (spec. Ndërtimi).*

| **12. Procedura e Prokurimit me objekt : "*Rikualifikim Urban Blloqe Banimi "Henrik Laca"*".** | | |
|---|---|---|
| **1. Urdhër Prokurimi**<br>Nr. 491/29.5.2019<br><br>**2. Lloji i Procedurës –**<br>"*Kërkesë me propozim*" | **3. Hartuesit e Dokumenteve Tenderit**<br>Urdhër nr. 491/29.5.2019<br>1. E.D.<br>2. D.K.<br>3. J.V., | **4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave**<br>Urdhër nr. 509/29.5.2019<br>1. A.L.,<br>2. V.SH.<br>3. J.G. |
| **5. Fondi Limit (pa TVSh)**<br>10,704,401 lekë.<br>**REF-24389-05-29-2019** | **6. Oferta fituese (pa TVSh)**<br>OE/BOE **"G..."** ShPK me vlere te përgjithshme prej 8,887,203 lekë pa TVSh, sipas kontratës nr. 9206/14, dt. 19.8.2019 me afat 2 muaj. | **7. Diferenca me fondin limit (pa TVSh)**<br>1,817 mijë lekë ose 16.9 % |
| **8. Data e hapjes së tenderit**<br>Datë 12.6.2019 | **9. Burimi Financimit**<br>Buxhet i Bashkisë Shkodër, sipas periudhave<br>Viti 2019 në shumën 3,495,833 lekë.<br>Viti 2020 në shumën 3,495,833 lekë<br>Viti 2021 në shumën 3,232,735 lekë | **10. Operatoret Ekonomike**<br>**a)**Pjesëmarrës në tender **3** OE/BOE<br>b) S'kualifikuar 1 OE/BOE,<br>c) Kualifikuar **3** OE/BOE |
| **11. Ankimime; jo**<br>**AK**- nr. ----; **APP**–------;<br>**KPP**------- | **12. Përgjigje Ankesës** nga AK<br>Shkresa nr. -------- | **13. Përgjigje** Ankesës nga<br>APP apo AKKP ---------------<br>Shkresa nr. ---- |

- **<u>Hartimi i fondit limit</u>:** Fondi për kryerjen e këtij financim është me të ardhurat e Bashkisë Shkodër dhe i miratuar me VKB nr. 82, datë 20.12.2018 në shumën 10,704,401 lekë, e cila do paguhet me dy fazë, ku për vitin 2019 do paguhet vlefta 3,495,833 lekë, për vitin 2020 do paguhet vlefta 3,495,833 lekë pa TVSH dhe për vitin 2021 në shumën 3,232,735 lekë pa TVSh, bazuar kjo në udhëzimin plotësues nr. 1 datë 171.2019 "Për buxhetin e vitit 2019" dhe miratuar në PBA periudhës 2019 – 2021.
Nga të dhënat e dosjes, konstatohet se preventivi/preventivi është hartuar nga studio e projektimit "C...", bazuar në VKM nr. 629, datë 15.7.2015 për çmimet sipas manualit.

**<u>Situata</u>**:
Në hartimin e DST rezulton se, nuk ka gjetur zbatim VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, sa vijon:
**Në DT është kërkuar:** Sipas pikës 2.2 "Për kapacitetin teknik ekonomik" është kërkuar që OE pjesëmarrës të paraqesin një xhiro mesatare vjetore për vitet 2016, 2017 dhe 2018 jo më të vogël se 10,704,404 lekë, ku sipas akteve ligjore kërkohet deri në 50%.
**Në DT është kërkuar**: Për kapacitetin teknik: "Operatori ekonomik ofertues, me anë të një deklaratë (nga Administratori i shoqërisë) duhet të përcaktoje Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt, i cili duhet të jetë i përfshirë në licencën e shoqërisë dhe të deklaroje se ai nuk është i angazhuar në kontratat të tjera Bashkëlidhur deklaratës për Drejtuesin Teknik duhet të paraqitet; a) Kontrata e punës e vlefshme dhe Diploma.
Nisur nga fakti se vlera e përllogaritur e kontratës është në shumën 8,887,203 lekë, kjo kërkesë e përcaktuar është në kundërshtim me kreun I, pika 2.1 të UKM nr. 2, datë 135.2005, "Për zbatimin e punimeve të ndërtimit, ku parashikohet se për punime deri në 30 milion lekë nuk është e detyrueshme qëndrimi i drejtuesit teknik në kantier gjatë gjithë periudhës së punimeve".
**Në DT është kërkuar:** Të paraqiten mjete dhe pajisje të mbrojtjes në punë të punëtorëve, personelit si më poshtë: *Kokore minimumi 10 (Dhjete) copë; Fikse zjarri të lëvizshme me kapacitet 5-7 litra secila minimumi 2 (dy) copë; Prozhektorë ndriçimi natën minimumi 2 (dy) copë ; Komplet i ndihmës së shpejtë minimumi 3 copë dhe Tabela paralajmëruese për sigurinë në objekt minimumi 5 (pese) copë.*

Kjo kërkesë është e tejkaluar pasi NJHDT në hartimin e preventivave, të cilat janë bërë pjesë e DT, duhej të gjente zbatim VKM nr. 664, datë 269.2012, "Për disa ndryshime dhe shtesa në VKM nr. 514, datë 15.87, "Për informatizimin e llogaritjes së kostos dhe hartimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit", pika 10, pasi nuk është parashikuar zbatimi i VKM nr. 312, datë 055.10, "Për miratimin e rregullores për sigurinë në kantier", aneksi VI, "Mbi sigurinë në kantier", në vlerën jo më pak se 3% të vlerës së projektit. Pjesë përbërëse e këtij 3% janë materialet e kërkuara krahas makinerive e mjeteve

**<u>Kriteri:</u>** Në shkelje të akteve ligjore e nënligjore të LPP, trajtuar në fillim të Kapitullit III/2.4.

**<u>Konkluzioni:</u>** Nga sa kemi trajtuar më sipër procedura paraqitet me probleme si në aplikimin e kritereve, pasi janë aplikuar kritere jo në përputhje me kushtet e zbatimit të projekti, *për të cilën ngarkohen me përgjegjësi anëtarët e NJHDT,* ***E.D.,*** *me funksion specialist në Njësinë e Prokurimeve,* ***D.K.,*** *me funksion specialist në Njësinë e Prokurimeve,* ***J.V.,*** *me funksion specialist në Drejtorinë e PZHT - anëtar.*

| 13. Procedura e Prokurimit me objekt : “*Kanali ujitës KU- 21”.* | | |
|---|---|---|
| **1. Urdhër Prokurimi**<br>Nr. 477/28.5.2019<br><br>**2. Lloji i Procedurës –**<br>**“***Hapur*” | **3. Hartuesit e Dokumenteve Tenderit**<br>Urdhër nr. 477/28.5.2019<br>1. E.D.<br>2. D.K.<br>3. XH.R., | **4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave**<br>Urdhër nr. 478/28.5.2019<br>1. A.S.,<br>2. M.M.<br>3. J.G. |
| **5. Fondi Limit (pa TVSh)**<br>12,091,934 lekë.<br>**REF-23998-05-28-2019** | **6. Oferta fituese (pa TVSh)**<br>OE/BOE **“K.....**” ShPK me vlere te përgjithshme prej 11,722,870 lekë pa TVSh, sipas kontratës nr. 9126/12, dt. 2.8.2019 me afat 70 ditë. | **7. Diferenca me fondin limit (pa TVSh)**<br>369 mijë lekë ose 35 % |
| **8. Data e hapjes së tenderit**<br>Datë 11.7.2019 | **9. Burimi Financimit**<br>Buxhet i Bashkisë Shkodër, | **10. Operatoret Ekonomike**<br>a)Pjesëmarrës në tender 7 OE/BOE<br>**b) S'kualifikuar 7 OE/BOE**<br>**c) Kualifikuar 1 OE/BOE** |
| **11. Ankimime; jo**<br>**AK**- nr. ----; **APP**–------;<br>**KPP**------- | **12. Përgjigje Ankesës** nga AK<br>Shkresa nr. -------- | **13. Përgjigje** Ankesës nga<br>APP apo AKKP --------------<br>Shkresa nr. ---- |

- **<u>Hartimi i fondit limit</u>:** Fondi për kryerjen e këtij financim është me të ardhurat e Bashkisë Shkodër dhe i miratuar me VKB nr. 82, datë 20.12.2018 në shumën 12,091,934 lekë, bazuar kjo në udhëzimin plotësues nr. 1 datë 171.2019 “Për buxhetin e vitit 2019” dhe miratuar në PBA periudhës 2019 – 2021.

Nga të dhënat e dosjes, konstatohet se preventivi/preventivi është hartuar nga studio e projektimit “C...”, bazuar në VKM nr. 629, datë 15.7.2015 për çmimet sipas manualit. Me shkresën nr. 3780, datë 9.5.2019 është dërguar VKM nr. 170, datë 27.3.2019 “Për shpërndarjen dhe detajimin e fondit prej 1,000,000,000 lekë në programin “Menaxhim i Infrastrukturës së Ujitjes dhe Kullimit”, ku Bashkia Shkodër është për vlerën 14,510,321 lekë me objekt “Kanali Ujitës KU-21”

**<u>Situata</u>**:

Në hartimin e DST rezulton se, nuk ka gjetur zbatim VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, sa vijon:

**Në DT është kërkuar:** Sipas pikës 2.3.4 Për kapacitetin teknik, është kërkuar një numër punonjësish prej 30 veta, numër ky i paargumentuar me volumet e punës, nisur kjo dhe nga fakti se tek makineritë është kërkuar mjet “Trencher për hapjen e kanalit”.

**Në DT është kërkuar:** Të paraqiten mjete dhe pajisje të mbrojtjes në punë të punëtorëve, personelit si më poshtë: *Kokore minimumi 20 (njëzet) copë; Fikse zjarri të lëvizshme me kapacitet 5-7 litra secila minimumi 2 (dy) copë; Prozhektorë ndriçimi natën minimumi 2 (dy) copë ; Komplet i ndihmës së shpejtë minimumi 3 copë; Tabela paralajmëruese për sigurinë në objekt minimumi 5 (pese) copë*

Kjo kërkesë është e tejkaluar pasi NJHDT në hartimin e preventivave, të cilat janë bërë pjesë e DT, duhej të gjente zbatim VKM nr. 664, datë 269.2012, “Për disa ndryshime dhe shtesa në VKM nr. 514, datë 15.87, “Për informatizimin e llogaritjes së kostos dhe hartimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit”, pika 10, pasi nuk është parashikuar zbatimi i VKM nr. 312, datë 055.10, “Për miratimin e rregullores për sigurinë në kantier”, aneksi VI, “Mbi sigurinë në kantier”, në vlerën jo më pak se 3% të vlerës së projektit. Pjesë përbërëse e këtij 3% janë materialet e kërkuara krahas makinerive e mjeteve.

**Në DT është kërkuar:** Në kritere për mjetet me qira është kërkuar që në kontratë duhet të specifikohet afati dhe objekti i kontratës, një kriter ky i paargumentuar, pasi kontrata nuk lidhet për çdo objekt por me afat dhe vleftë.

**Vlerësimi i procedurës:**

Nga auditimi i dokumentacionin në sistem dhe SEP, konstatohet se JV "K... & H..." ShPK, nuk plotëson të gjitha kriteret e DST të miratuara nga AK, konkretisht:

a- Mjetet me qira që paraqet shoqëria "K...", në kontratat qirasë nuk kanë të specifikuar objektin e kontratës, sipas pikës 2.3.4/IV të DST, kjo për mjetet me targa A...T; A...G; A...R; Minieskavator; A...L dhe A...Z.

b- Ndërsa nga shoqëria 'H..." është paraqitur kontratë qiraje për mjetin "Autobitumatrice" me targë A...S dhe kontratë nr. 1705/477 me subjektin "D&A" dhe për mjetin eskalator me targë A...F me nr. 2164/611 me subjektin "H.D.F", ku në kontratë nuk është shënuar objekti i kontratës.

c- Gjithashtu në këto kontrata sipas lejes së qarkullimit janë për përdorim vetjak dhe jo të lëshohen me qira, kriter për të cilat janë skualifikuar OE me ofertë me të leverdishme.

d- Shoqëria "H...", vërtetimi mbi pagesën e energjisë elektrike nuk është i saktë, pasi nuk përfshihet muaj Maj 2019, ku dihet se procedura është zhvilluar me datë 11.7.2019. pra duhej përfshirë dhe muaj maj 2019.

**Kriteri:** Në shkelje të akteve ligjore e nënligjore të LPP, trajtuar në fillim të Kapitullit III/2.4.

**Konkluzioni:** Nga sa kemi trajtuar më sipër procedura paraqitet me probleme si në aplikimin e kritereve dhe shpallje fitues të OE, pasi janë aplikuar kritere jo në përputhje me kushtet e zbatimit të projekti dhe se OE i shpallur fitues nuk plotëson të gjitha kriteret e DST, veprime të cilat çojnë në paligjshmëri të përdorimit të fondeve të prokuruar, *për të cilën ngarkohen me përgjegjësi anëtarët e NJHDT,* ***E.D.,*** *me funksion specialist në Njësinë e Prokurimeve,* ***D.K.,*** *me funksion specialist në Njësinë e Prokurimeve,* ***XH.R.,*** *me funksion specialist në DPZHT (spec. Ndërtimi) dhe anëtarët e KVO, i përbërë:* ***A.S.,*** *me funksion Drejtor në Drejtoria e Bujqësisë, Zhvillimit rural dhe trajtimit te AMTP - kryetar,* ***M.M.,*** *me funksion -------- - anëtar (ing)* ***dhe J.G.*** *me funksion specialist në Drejtorinë e PZHT - anëtar*

- **Mbi procedurat e prokurimit të zhvilluara në periudhën 01.01.2020 - 31.12.2020.**

Për periudhën 01.01.2020 – 31.12.2020, nga Bashkia Shkodër, janë zhvilluar gjithsej **116** procedura me vlerë të fondit limit 785,462 mijë lekë dhe vlerë kontrate të lidhur 721,093 mijë lekë, me një kursim në vlerën 64,368 mijë lekë ose 8.19%, ku për çdo procedurë të dhënat paraqiten në pasqyrën **Aneks IV/4.3,** bashkëlidhur Projektraport auditmit.

| Lloji i procedurës | Nr. Proc | Fondi limit pa TVSh | Kontrata pa TVSh | Fondi total i kursyer pa TVSh | % që zë fondi i kursyer ndaj fondit limit |
|---|---|---|---|---|---|
| Hapura | 22 | 240,536,278 | 202,500,157 | 38,036,121 | 15.81 |
| Kërkesë me propozim | 77 | 380,411,057 | 376,608,309 | 3,802,748 | 1.00 |
| Negocim pa shpallje | 11 | 136,379,503 | 115,479,966 | 20,899,537 | 15.32 |
| Marrëveshje kuadër | 5 | 24,182,779 | 22,783,961 | 1,398,818 | 5.78 |
| Shërbim konsulence | 1 | 3,952,500 | 3,721,250 | 231,250 | 5.85 |

| Lloji i procedurës | Nr. Proc | Fondi limit pa TVSh | Kontrata pa TVSh | Fondi total i kursyer pa TVSh | % që zë fondi i kursyer ndaj fondit limit |
|---|---|---|---|---|---|
| **Totali** | **116** | **785,462,117** | **721,093,642** | **64,368,475** | **8.19** |
| **Procedura sipas objektit** | **Nr.** | **Fondi limit pa TVSh** | **Kontrata pa TVSh** | **% ndaj totalit kontratës** | |
| Ne fushën e ndërtimeve | 66 | 512,288,022 | 447,205,652 | 65 | 62 |
| Në shërbime/ blerje, etj. | 50 | 273,174,095 | 273,887,991 | 35 | 38 |
| **Procedura te vlerësuara për auditim** | **Nr.** | **Fondi limit pa TVSh** | **Kontrata pa TVSh** | **% ndaj totalit kontratës** | |
| Hapura | 10 | 210,824,811 | 202,500,157 | 87.64782292 | 100 |
| Kërkesë me propozim | 32 | 265,165,292 | 182,176,975 | 69.7 | 48.3 |
| *Shuma proced vlerësuar për auditim* | *42* | *475,990,103* | *384,677,132* | 60.6 | 53.3 |

**Burimi:** *Nga Bashkia Shkodër, përpunuar nga grupi i KLSH*

Sipas llojit të procedurës, në fushën e investimeve janë zhvilluar gjithsej 66 procedura me fond limit 512,288 mijë lekë ose 65% e totalit dhe në fusha të tjera *(shërbime/ blerje mallrash)*, janë zhvilluar 50 procedura me fond limit 273,174 mijë lekë ose 35% e totalit. Pra pjesën më të madhe të procedurave e zënë investimet, ku investimet në rrugët e brendshme të Bashkisë Shkodër kapin vlerën 411,386 mijë lekë ose 80% të fondit të prokuruar në fushën e investimeve.

Grupi i auditmit të KLSH-së, mbi bazën e të dhënave të riskut, nga **116** procedura me fond limit 785,462 mijë lekë, vlerësojë për auditim **42** procedura ose 36% e totalit me fond limit 475,990 mijë lekë ose 60.6%.
Nga auditimi i 42 procedurave me fond limit 475,990 mijë lekë, kanë rezultuar në shkelje të akteve ligjore e nënligjore të LPP, gjithsej **13** procedura me vlerë të fondit limit 212,526 mijë lekë ose 44.6%, *nga të cilat*:
**a- Në 13 procedura**, kriteret nuk janë në përputhje me llojin e procedurës, veprime të cilat direkt ose indirekt kanë çuar në mospjesëmarrjen e OE në procedura;
**b- Në 3 procedura**, OE të shpallur fitues nuk janë në kushtet e plotësimit të kritereve të DST të miratuara nga AK, veprime në paligjshmëri të përdorimit të fondeve publike në vlerën **39,357 mijë lekë** pa TVSH.
Pasqyra me të dhëna të procedurave të audituara me/ dhe pa probleme paraqitet në pasqyrën **Aneks IV/4.4**, bashkëlidhur Projektraport auditimit.

- **Konkretisht për vitin 2020, procedurat me shkelje paraqiten si më poshtë vijon**:

| 1. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt : "*Rikonstruksion rruga "Mehmet Shpendi"*" | | |
|---|---|---|
| **1. Urdhër Prokurimi**<br>Nr. 898, datë 23.10.2020<br>**2. Lloji i Procedurës –**<br>**"***E Hapur*" | **3. Hartuesit e Dokumenteve Tenderit**<br>Urdhër nr. 898, datë 23.10.2020<br>1. E.D.<br>2. D.K.<br>3. S.L. | **4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave**<br>Urdhër nr. 899, datë 23.10.2020<br>1. T.M.<br>2. A.C.<br>3. P.M. |
| **5. Fondi Limit (pa TVSh)**<br>15,714,819 lekë. | **6. Oferta fituese (pa TVSh)**<br>OE/BOE *"A..."& "A..."* me ofertë 14,867,392.58 lekë pa TVSh, sipas kontratës nr. 15032/12 prot., dt. 30.12.2020 me afat 5 muaj. | **7. Diferenca me fondin limit (pa TVSh)**<br>**847 mijë** lekë ose 5.3 % |
| **8. Data e hapjes së tenderit** | **9. Burimi Financimit** | **10. Operatoret Ekonomike** |

| 1. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt : "*Rikonstruksion rruga "Mehmet Shpendi"* | | |
|---|---|---|
| Datë 02.12.2020 | Buxheti i Bashkisë Shkodër | **a)**Pjesëmarrës në tender **5** OE/BOE<br>b) S'kualifikuar 3 OE/BOE,<br>c) Kualifikuar **2** OE/BOE<br>• |
| **11. Ankimime; Ka ankesë – Nuk ka patur**<br>**AK**- nr. ----------<br>**APP**–------;<br>**KPP**------- | **12. Përgjigje Ankesës** nga AK<br>Shkresa nr. -------- | **13. Përgjigje** Ankesës nga<br>APP apo AKKP ---------------<br>Shkresa nr. ---- |

**Burimi i Financimit:** Buxheti i Bashkisë sipas VKB nr.26 datë 30.12.2019 "Për miratimin e Buxhetit te vitit 2020 dhe programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2020-2022 te Bashkisë Shkodër" për investime i detajuar si me poshtë:
Financimi për vitin 2020 është 1,549,166 lekë pa TVSh
Financimi për vitin 2021 është 8,333,333 lekë pa TVSh
Financim për vitin 2022 është 5,832,320 lekë pa TVSh

**Situata:**
**Hartimi i dokumenteve të tenderit:**
Procesverbali i hartimit të DT mban datën 23.10.2020. Në hartimin e DT rezulton se nuk ka gjetur zbatim VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, sa vijon:
**Në DT është kërkuar:** Për kapacitetin teknik: "Operatori ekonomik ofertues, me anë të një deklaratë (nga Administratori i shoqërisë) duhet të përcaktoje Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt, i cili duhet të jetë i përfshirë në licencën e shoqërisë dhe të deklaroje se ai nuk është i angazhuar në kontratat të tjera Bashkëlidhur deklaratës për Drejtuesin Teknik duhet të paraqitet; a) Kontrata e punës e vlefshme dhe Diploma.
Nisur nga fakti se vlera e përllogaritur e kontratës është në shumën 15,714,819 lekë, kjo kërkesë e përcaktuar është në kundërshtim me kreun I, pika 2.1 të UKM nr.2, datë 13.05.2005, "Për zbatimin e punimeve të ndërtimit, ku parashikohet se për punime deri në 30 milion lekë nuk është e detyrueshme qëndrimi i drejtuesit teknik në kantier gjatë gjithë periudhës së punimeve", **duke ngarkuar me përgjegjësi anëtarët e NJHDT.**

**Situata:**
**Zhvillimi i procedurës së prokurimit:** Procedura e prokurimit është hapur më datë 02.12.2020 dhe është vlerësuar më datë 15.123.2020., sa më poshtë vijon:
Nga vlerësimi i dokumentacionit teknik/ligjorë të OE pjesëmarrës nga 5 OE/BOE pjesëmarrës, KVO ka skualifikuar 3 OE/BOE dhe ka kualifikuar 2 OE/BOE, ku arsyet e skualifikimit janë trajtuar gjerësisht në akt-konstatimin nr. 12, datë 04.06.2021.

**Auditimi i ofertave:**
Nga auditimi i ofertës së shpallur fituese "Alko-Impex General Construcion" &"A..." ShPK, me vlerë më të lartë rezultoi se, nuk ka paraqitur punime të ngjashme për anëtarin e BOE "A..." ShPK, konkretisht ka paraqitur 2 kontrata të ngjashme sa vijon:
Sa më sipër ky BOE nuk plotëson kriterin e punëve të ngjashme.

**Konkluzioni:** Nga sa kemi trajtuar më sipër procedura paraqitet me probleme si në aplikimin e kritereve dhe në shpallje fitues të OE, veprime të cilat çojnë në paligjshmëri të përdorimit të

| |
|---|
| fondeve të prokuruar, *për të cilën ngarkohen me përgjegjësi: Anëtarët e NJHDT* ***E.D.,*** *me funksion specialist në Njësinë e Prokurimeve,* ***D.K.,*** *me funksion specialist në Njësinë e Prokurimeve z.* ***S.L.,*** *me funksion specialist në Sektori i Koordinimit të Investimeve Bashkiake dhe anëtarët e KVO, i përbërë nga* ***T.M.,*** *me funksion Administratorë në NJA Pult,* ***A.C.,*** *me funksion Administratorë në NJA Ana e Malit dhe* ***P.M.*** *me funksion Administratorë në NJA Guri i Zi* |

| **2. Zhvillimi i Procedurës me objekt : "*Rikonstruksion Rruga "1 Qershori"*.** | | |
|---|---|---|
| **1. Urdhër Prokurimi**<br>Nr. 896, datë 23.10.2020<br><br>**2. Lloji i Procedurës –**<br>**"***E hapur*" | **3. Hartuesit e Dokumenteve Tenderit**<br>Urdhër nr. 896, datë 23.10.2020<br>1. E.D.<br>2. D.K.<br>3.N.D. | **4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave**<br>Urdhër nr. 897, datë23.10.2020<br>1. T.M.<br>2. T.D.<br>3. P.M. |
| **5. Fondi Limit (pa TVSh)**<br>13,495,723 lekë. | **6. Oferta fituese (pa TVSh)**<br>OE/BOE **"A..."** me ofertë 12,439,979.5 lekë pa TVSh, sipas kontratës nr. 15031/13 prot., dt. 30.12.2020 me afat 4 muaj. | **7. Diferenca me fondin limit (pa TVSh)**<br>1,056 mijë lekë ose 7.8 % |
| **8. Data e hapjes së tenderit**<br>Datë 30.11.2020 ndryshuar me datë 02.12.2020 | **9. Burimi Financimit**<br>Buxheti i Bashkisë Shkodër | **10. Operatoret Ekonomike**<br>**a)**Pjesëmarrës në tender 5 OE/BOE<br>b) S'kualifikuar 4 OE/BOE,<br>c) Kualifikuar **1** OE/BOE |
| **11. Ankimime; Ka ankesë – Jo nuk ka patur**<br>**AK**- nr. ----------<br>**APP**-------;<br>**KPP**------- | **12. Përgjigje Ankesës** nga AK<br>Shkresa nr. -------- | **13. Përgjigje** Ankesës nga<br>APP apo AKKP ---------------<br>Shkresa nr. ---- |

**Burimi i Financimit**: Buxheti i Bashkisë sipas VKB nr.26 datë 30.12.2019 "Për miratimin e Buxhetit te vitit 2020 dhe programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2020-2022 te Bashkisë Shkodër" për investime i detajuar si me poshtë:
Financimi për vitin 2020 është 5,162,500 lekë pa TVSh
Financimi për vitin 2021 është 4,166,666 lekë pa TVSh
Financimi për vitin 2022 është 4,166,557 lekë pa TVSh
Projekt/ Preventivi në vlerën 13,495,723 lekë pa TVSh është hartuar nga shoqëria "C...", bazuar në VKM nr. 629, datë 15.7.2015 për çmimet sipas manualit.

**<u>Situata:</u>**

**Hartimi i dokumenteve të tenderit:**

Procesverbali i hartimit të DT mban datën 23.10.2020 *(prot 15031/2)*. Në hartimin e DT rezulton se nuk ka gjetur zbatim VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, sa vijon:
**Në DT është kërkuar:** Operatori ekonomik ofertues, me anë të një deklaratë (nga Administratori i shoqërisë) duhet të përcaktoje *Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt,* i cili duhet të jetë i përfshirë në licencën e shoqërisë dhe të deklaroje se ai nuk është i angazhuar në kontratat të tjera Bashkëlidhur deklaratës për Drejtuesin Teknik duhet të paraqitet; a) Kontrata e punës e vlefshme dhe Diploma.
Vet deklarim nga Drejtuesi Teknik se ai është i disponueshëm për realizimin e kësaj kontrate dhe nuk është i angazhuar në kontratat të tjera .

Nisur nga fakti se vlera e përllogaritur e kontratës është në shumën **13,495,723** lekë, kjo kërkesë e përcaktuar është në kundërshtim me kreun I, pika 2.1 të UKM nr.2, datë 13.05.2005, "Për zbatimin e punimeve të ndërtimit, ku parashikohet se për punime deri në 30 milion lekë nuk është e detyrueshme qëndrimi i drejtuesit teknik në kantier gjatë gjithë periudhës së punimeve.

**Kriteri:** Në shkelje të akteve ligjore e nënligjore të LPP, trajtuar në fillim të Kapitullit III/2.4.

**Konkluzioni:** Nga sa kemi trajtuar më sipër procedura paraqitet me probleme në aplikimin e kritereve, *për të cilën ngarkohen me përgjegjësi: Anëtarët e NJHDT* ***E.D.,*** *me funksion specialist në Njësinë e Prokurimeve,* ***D.K.,*** *me funksion specialist në Njësinë e Prokurimeve* ***N.D.,*** *me funksion specialist në Drejtoria e Studimeve, Planifikimit dhe Koordinimit të Investimeve.*

**Situata:**

Nga auditim i dokumentacionit në dosjen e subjekti dhe sistemin SEP, konstatohet se ky OE është shpallur fitues dhe ne procedurën me objekt: "*Rikonstruksion Rruga "Besa Shqiptare" dhe Rruga "Paqes"*, sipas kontratës nr. 11534/15, datë 26.10.2020, afati për zbatimin e punimeve (pa shtyrje) është 4 muaj, pra nga data 26.10.2020 deri me datë 26.2.2021. Ndërsa procedura me objekt "Rikonstruksion Rruga "1 Qershori" e cila është zhvilluar me datë 02.12.2020 ose brenda afatit të zbatimit të kontratë së parë. Në këto kushte nga shoqëria "A..." si mjetet, drejtuesit teknik, punonjësit sipas profesioneve dhe punonjësit janë të njëjtë me ato të deklaruara nga procedurën me objekt: "*Rikonstruksion Rruga "Besa Shqiptare" dhe Rruga "Paqes"*, pra kemi të bëjmë me deklarim të rremë dhe duhej skualifikuar.

**Kriteri:** Në shkelje të akteve ligjore e nënligjore të LPP, trajtuar në fillim të Kapitullit III/2.4.

**Konkluzioni:** Nga sa trajtuam procedura paraqitet me probleme në shpalljen fitues të OE, i cili ka mangësi në plotësimin e kritereve, *për të cilën ngarkohen me përgjegjësi anëtarët e KVO, i përbërë nga* ***T.M.,*** *me funksion Administrator NJA PULT,* ***T.D.,*** *me funksion Administrator NJA Ana e Mali dhe* ***P.M.,*** *me funksion Administrator NJA Guri i Zi.*

| **3. Zhvillimi i Procedurës me objekt : "*Sistemim asfaltim i rrugës "Ramoshaj" në fshatin Trush"*.** | | |
|---|---|---|
| **1. Urdhër Prokurimi**<br>Nr. 972, datë 09.11.2020<br>**2. Lloji i Procedurës –**<br>"*Kërkesë për propozime*" | **3. Hartuesit e Dokumenteve Tenderit**<br>Urdhër nr. 973, datë 09.11.2020<br>1. E.D.<br>2. D.K.<br>3. S.L. | **4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave**<br>Urdhër nr. 973, datë 09.11.2020<br>1. GJ.D.<br>2. A.C.<br>3. P.M. |
| **5. Fondi Limit (pa TVSh)**<br>8,499,194 lekë. | **6. Oferta fituese (pa TVSh)**<br>OE/BOE **"G..."** me ofertë 7,651,951 lekë pa TVSh, sipas kontratës nr. 15987/12 prot, dt. 30.12.2020 me afat 3 muaj. | **7. Diferenca me fondin limit (pa TVSh)**<br>**847,243** lekë ose ----- % |
| **8. Data e hapjes së tenderit**<br>Datë 23.11.2020 | **9. Burimi Financimit**<br>Buxhet i Bashkisë Shkodër | **10. Operatoret Ekonomike**<br>**a)**Pjesëmarrës në tender **4** OE/BOE<br>b) S'kualifikuar 3 OE/BOE,<br>c) Kualifikuar **1** OE/BOE. |
| **11. Ankimime; Ka ankesë-**<br>**AK**- nr. ---------- **APP**-------;<br>**KPP**------- | **12. Përgjigje Ankesës** nga AK<br>Shkresa nr. -------- | **13. Përgjigje** Ankesës nga<br>APP apo AKKP ---------------<br>Shkresa nr. ---- |

Burimi i Financimit: Buxheti i Bashkisë viti 2020 sipas VKB nr.26 datë 30.12.2019 "Për miratimin e Buxhetit te vitit 2020 dhe programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2020-2022 te Bashkisë Shkodër" për investime i detajuar nder vite si me poshtë:

Financimi për vitin 2020 është **6,445,833** lekë pa TVSh;
Financimi për vitin 2021 është **2,053,361** lekë pa TVSh.

**Situata:**
**Hartimi i dokumenteve të tenderit:**
Në hartimin e DT rezulton se nuk ka gjetur zbatim VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, sa vijon:
**Në DT është kërkuar:** Operatori ekonomik ofertues, me anë të një deklaratë (nga Administratori i shoqërisë) duhet të përcaktoje *Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt*, i cili duhet të jetë i përfshirë në licencën e shoqërisë dhe të deklaroje se ai nuk është i angazhuar në kontratat të tjera Bashkëlidhur deklaratës për Drejtuesin Teknik duhet të paraqitet; a) Kontrata e punës e vlefshme dhe Diploma.
Nisur nga fakti se vlera e përllogaritur e kontratës është në shumën **8,499,194** lekë, kjo kërkesë e përcaktuar është në kundërshtim me kreun I, pika 2.1 të UKM nr.2, datë 13.05.2005, "Për zbatimin e punimeve të ndërtimit, ku parashikohet se për punime deri në 30 milion lekë nuk është e detyrueshme qëndrimi i drejtuesit teknik në kantier gjatë gjithë periudhës së punimeve.
**Sa më sipër trajtuar ngarkohet me përgjegjësi NJHDT.**

| 4. **Zhvillimi i Procedurës me objekt : "*Ndërtim trotuare rruga nacionale "Rruga e Tiranës", Bahçallek.*** | | |
|---|---|---|
| **1. Urdhër Prokurimi**<br>Nr. 939, datë 30.10.2020<br>**2. Lloji i Procedurës –**<br>**"***E hapur*" | **3. Hartuesit e Dokumenteve Tenderit**<br>Urdhër nr. 939, datë 30.10.2020<br>1. E.D.<br>2. D.K.<br>3. N.D. | **4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave**<br>Urdhër nr. 940, datë 30.10.2020<br>1. P.M.<br>2. T.M.<br>3. A.C. |
| **5. Fondi Limit (pa TVSh)**<br>12,293,725 lekë. | **6. Oferta fituese (pa TVSh)**<br>OE/BOE **"B..."& "RR..."** me ofertë 10,446,920.58 lekë pa TVSh, sipas kontratës nr. 15475/13 prot., dt. 30.12.2020 me afat 4 muaj. | **7. Diferenca me fondin limit (pa TVSh)**<br>**1,846 mijë** lekë ose 15 % |
| **8. Data e hapjes së tenderit**<br>Datë 02.12.2020 | **9. Burimi Financimit**<br>Buxheti i Bashkisë Shkodër | **10. Operatoret Ekonomike**<br>**a)**Pjesëmarrës në tender **6** OE/BOE<br>b) S'kualifikuar 4 OE/BOE,<br>c) Kualifikuar **2** OE/BOE |
| **11. Ankimime; Ka ankesë -**<br>**AK**- nr. ---------- **APP**-------;<br>**KPP**------- | **12. Përgjigje Ankesës** nga AK<br>Shkresa nr. -------- | **13. Përgjigje** Ankesës nga<br>APP apo AKKP --------------<br>Shkresa nr. ---- |

**Burimi i Financimit**: Buxheti i Bashkisë sipas VKB nr.26 datë 30.12.2019"Per miratimin e Buxhetit te vitit 2020 dhe programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2020-2022 te Bashkisë Shkodër" për investime i detajuar si me poshtë:
Financimi për vitin 2020 është **2,235,833** lekë pa TVSh;
Financimi për vitin 2021 është **5,833,333** lekë pa TVSh;
Financimi për vitin 2022 është **4,224,559** lekë pa TVSh.

**Situata:**
**Hartimi i dokumenteve të tenderit:**
Procesverbali i hartimit të DT mban datën 30.10.2020. Në hartimin e DT rezulton se nuk ka gjetur zbatim VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, sa vijon:

**Në DT është kërkuar:** Operatori ekonomik ofertues, me anë të një deklaratë (nga Administratori i shoqërisë) duhet të përcaktoje *Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt*, i cili duhet të jetë i përfshirë në licencën e shoqërisë dhe të deklaroje se ai nuk është i angazhuar në kontratat të tjera
Nisur nga fakti se vlera e përllogaritur e kontratës është në shumën **12,293,725** lekë, kjo kërkesë e përcaktuar është në kundërshtim me kreun I, pika 2.1 të UKM nr.2, datë 13.05.2005, "Për zbatimin e punimeve të ndërtimit, ku parashikohet se për punime deri në 30 milion lekë nuk është e detyrueshme qëndrimi i drejtuesit teknik në kantier gjatë gjithë periudhës së punimeve.

**Konkluzioni:** Nga sa kemi trajtuar më sipër procedura paraqitet me probleme në aplikimin e kritereve, *për të cilën ngarkohen me përgjegjësi: Anëtarët e NJHDT **E.D.,** me funksion specialist në Njësinë e Prokurimeve, **D.K.,** me funksion specialist në Njësinë e Prokurimeve **N.D.,** me funksion specialist në Drejtoria e Studimeve, Planifikimit dhe Koordinimit të Investimeve*

Nga auditimi rezultoi se arsyet e kualifikimit dhe s`kualifikimit shqyrtuar dhe vlerësuar sipas DST.

| **5. Zhvillimi i Procedurës me objekt : "*Sistemim asfaltim rruga "Prekaj" fshati Sektor, Velipojë.*** | | |
|---|---|---|
| **1. Urdhër Prokurimi**<br>Nr. 933, datë 30.10.2020<br>**2. Lloji i Procedurës –**<br>"*Kërkesë për propozim*" | **3. Hartuesit e Dokumenteve Tenderit**<br>Urdhër nr. 933, datë 30.10.2020<br>1. E.D.<br>2. D.K.<br>3. R.T. | **4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave**<br>Urdhër nr. 934, datë 30.10.2020<br>1. A.K.<br>2. Z.DH.<br>3. P.M. |
| **5. Fondi Limit (pa TVSh)**<br>10,148,333 lekë. | **6. Oferta fituese (pa TVSh)**<br>OE/BOE **"D..."** me ofertë 8,462,496 lekë pa TVSh, sipas kontratës nr. 15472/12, dt. 28.12.2020, me afat 2 muaj. | **7. Diferenca me fondin limit (pa TVSh)**<br>**1,685 mijë** lekë ose 16.6 % |
| **8. Data e hapjes së tenderit**<br>Datë 16.11.2020 | **9. Burimi Financimit**<br>Buxheti i Bashkisë Shkodër | **10. Operatoret Ekonomike**<br>**a)**Pjesëmarrës në tender **6** OE/BOE<br>b) S'kualifikuar 3 OE/BOE,<br>c) Kualifikuar **3** OE/BOE |
| **11. Ankimime; Ka ankesë –**<br>**AK**- nr. ----------<br>**APP**–------;<br>**KPP**------- | **12. Përgjigje Ankesës** nga AK<br>Shkresa nr. -------- | **13. Përgjigje** Ankesës nga<br>APP apo AKKP ---------------<br>Shkresa nr. ---- |

**Burimi i Financimit:** Buxheti i Bashkisë viti 2020 sipas VKB nr.26 datë 30.12.2019"Per miratimin e Buxhetit te vitit 2020 dhe programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2020-2022 te Bashkisë Shkodër" për investime i detajuar nder vite si me poshtë:
Financimi për vitin 2020 është **7,594,166** lekë pa TVSh
Financimi për vitin 2021 është **2,554,166** lekë pa TVSh

**Situata:**
Procesverbali i hartimit të DT mban datën 30.10.2020. Në hartimin e DT rezulton se nuk ka gjetur zbatim VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, sa vijon:
**Në DT është kërkuar:** Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë numrin e nevojshëm të punonjësve për realizimin dhe zbatimin e kontratës. Numri mesatar i punonjësve të siguruar për 3 muajt e fundit duhet te jetë 15.
**Në DT është kërkuar:** Operatori ekonomik ofertues, me anë të një deklaratë (nga Administratori i shoqërisë) duhet të përcaktoje *Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt*, i cili duhet të jetë i

përfshirë në licencën e shoqërisë dhe të deklaroje se ai nuk është i angazhuar në kontratat të tjera Bashkëlidhur deklaratës për Drejtuesin Teknik duhet të paraqitet; a) Kontrata e punës e vlefshme dhe Diploma, në kundërshtim me kreun I, pika 2.1 të UKM nr.2, datë 13.05.2005, "Për zbatimin e punimeve të ndërtimit, ku parashikohet se për punime deri në 30 milion lekë nuk është e detyrueshme qëndrimi i drejtuesit teknik në kantier gjatë gjithë periudhës së punimeve.

**Në DT është kërkuar:** Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë në stafin e tij punonjës të pasqyruar në listë pagesa për të paktën 3 muajt e fundit, te pajisur me kontrate pune (te vlefshme) ose **te** kontraktuar ne rastin kur makineritë janë me qira për manovratorë, me dëshmi kualifikimi të sigurimit teknik (te vlefshme) të lëshuara nga organizma të akredituar për këtë qëllim në Republikën e Shqipërisë, ku nga këta të jenë të paktën: *Teknik ndërtimi 1 punonjës; Manovrator 2 punonjës; Punëtor asfaltimi në rrugë 2 punonjës dhe Murator 1 punonjës.*

Në lidhje më kërkesën sa më sipër, bazuar në VKM nr. 514, datë 20.9.2017, "Për miratimin e listës kombëtare të profesioneve", rezulton se nuk ka emërtim punëtor asfaltimi në rrugë dhe emërtim manovrator.

Nisur nga kuptimi qe ju u keni vënë manovrator janë me kodin 8332 dhe emërtimin "Shoferë të makinave të rënda".

**-Zhvillimi i procedurës së prokurimit:**

Procedura e prokurimit është hapur më datë 16.11.2020 dhe është vlerësuar më datë 24.11.2020. Nga auditimi i dokumentacionit teknik/ligjorë, rezulton se nga 6 OE/BOE pjesëmarrës, KVO ka skualifikuar 3 OE/BOE në përputhje me DST. Në mënyrë të detajuar auditimi i mbi ligjshmërinë e tyre është trajtuar në akt-konstatimin nr. 12, datë 04.06.2021.

Në lidhje me OE të kualifikuar "D...", u konstatua se ka mangësi në plotësimin e kritereve të DST, ku mjeti me targë T...R, të marrë me qira ka paraqitur certifikatë nr.73, datë 12.10.2020 në emër të vet, ndërkohë që duhej ta paraqite në emër të qiramarrësit "K..." shpk, konkretisht:

Sa më sipër është në kundërshtim me Udhëzimit nr.15, datë 24.07.2007 "Për kriteret dhe procedurat e lëshimit të licencave, Autorizimeve dhe certifikatave për ushtrimin e veprimtarisë në Transportin Rrugor", neni 11, si dhe referuar lejes se qarkullimit sipas rekomandimeve te APP.

Theksojmë që për këto arsye ky OE në procedurën me objekt "*Ndërtim trotuari Rruga nacionale (Rruga e "Tiranës"), Bahcallek***"**, është s`kualifikuar për këto mangësi. Në këto kushte duhej skualifikuar dhe në këtë procedurë**.**

| |
|---|
| **Konkluzioni:** Nga sa kemi trajtuar më sipër procedura paraqitet me probleme si në aplikimin e kritereve dhe në shpallje fitues të OE, i cili ka mangësi të njëjta me OE e skualifikuar, veprime të cilat çojnë në paligjshmëri të përdorimit të fondeve të prokuruar, *për të cilën ngarkohen me përgjegjësi: Anëtarët e NJHDT* ***E.D.,*** *me funksion specialist në Njësinë e Prokurimeve,* ***D.K.,*** *me funksion specialist në Njësinë e Prokurimeve* ***R.T.,*** *me funksion specialist në Drejtoria e Studimeve, Planifikimit dhe Koordinimit të Investimeve dhe anëtarët e KVO, i përbërë nga* ***A.K.,*** *me funksion Administratorë në NJA Velipojë,* ***Z.DH.,*** *me funksion specialiste Sektori për planifikimin dhe inspektimin e fondit të ndihmës ekonomike dhe të personave me aftësi ndryshe dhe* ***P.M.*** *me funksion Administratorë në NJA Guri i Zi.* |

| 6. Zhvillimi i Procedurës me objekt : "*Rehabilitim i qendrës në fshatin "Shtoj i Ri"*. | | |
|---|---|---|
| **1. Urdhër Prokurimi**<br>Nr. 767, datë 18.09.2020 | **3. Hartuesit e Dokumenteve Tenderit**<br>Urdhër nr. 767, datë 18.09.2020 | **4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave**<br>Urdhër nr. 768, datë 18.09.2020 |
| **2. Lloji i Procedurës –** | 1. E.D. | 1. F.SH. |

| 6. Zhvillimi i Procedurës me objekt : “*Rehabilitim i qendrës në fshatin “Shtoj i Ri”.* | | |
|---|---|---|
| “*Kërkesë për propozime*” | 2. D.K.<br>3. I.T. | 2. M.M.<br>3. F.K. |
| **5. Fondi Limit (pa TVSh)**<br>10,874,619 lekë. | **6. Oferta fituese (pa TVSh)**<br>OE/BOE **“G...“** me ofertë 9,176,618 lekë pa TVSh, sipas kontratës nr. 13188/12 prot., dt.06.11.2020 me afat 3 muaj. | **7. Diferenca me fondin limit (pa TVSh)** 1,698 mijë lekë ose 15.6 % |
| **8. Data e hapjes së tenderit**<br>Datë 02.10.2020 | **9. Burimi Financimit**<br>Buxheti i Bashkisë Shkodër | **10. Operatoret Ekonomike**<br>**a)**Pjesëmarrës në tender **5** OE/BOE<br>b) S’kualifikuar 4 OE/BOE,<br>c) Kualifikuar **1** OE/BOE |
| **11. Ankimime; Ka ankesë – Nuk ka patur**<br>**AK**- nr. ----------<br>**APP**–-----;<br>**KPP**------- | **12. Përgjigje Ankesës** nga AK<br>Shkresa nr. -------- | **13. Përgjigje** Ankesës nga<br>APP apo AKKP ---------------<br>Shkresa nr. ---- |

**Burimi i Financimit**: Buxheti i Bashkisë viti 2020 sipas VKB nr.26 datë 30.12.2019“Per miratimin e Buxhetit te vitit 2020 dhe programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2020-2022 te Bashkisë Shkodër“ për investime dhe Vendimit te Kryetarit te Bashkisë nr.221 datë 15.09.2020"Per miratimin e rishpërndarjes se fondit te zërave te investimeve brenda te njëjtit program për vitin 2020"i detajuar nder vite si me poshtë:
Financimi për vitin 2020 është 6,987,499 lekë pa TVSh
Financimi për vitin 2021 është 3,887,120 lekë pa TVSh

**Situata:**
Procesverbali i hartimit të DT mban datën 18.9.2020. Në hartimin e DT rezulton se nuk ka gjetur zbatim VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, sa vijon:
**Në DT është kërkuar**: Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë në stafin e tij punonjës të pasqyruar në listëpagesat për të paktën 3 muajt e fundit, te pajisur me kontrate pune (te vlefshme), me dëshmi kualifikimi të sigurimit teknik (te vlefshme) të lëshuara nga organizma të akredituar për këtë qëllim në Republikën e Shqipërisë, ku nga këta të jenë të paktën:

*Teknik ndërtimi 1 punonjës; Manovrator 2 punonjës; Punëtor asfaltimi në rrugë 2 punonjës; Murator 1 punonjës dhe Elektricist 1punonjës.*

Në lidhje më kërkesën sa më sipër, bazuar në VKM nr. 514, datë 20.9.2017, “Për miratimin e listës kombëtare të profesioneve”, rezulton se nuk ka emërtim punëtor asfaltimi në rrugë dhe emërtim manovrator.
Nisur nga kuptimi qe ju u keni vënë manovrator janë me kodin 8332 dhe emërtimin “Shoferë të makinave të rënda”. Gjithashtu nuk është argumentuar me volume punimesh dhe me grafik numri i punonjësve (staf teknik + punëtorë).
**Në DT është kërkuar**: Për kapacitetin teknik: “Operatori ekonomik ofertues, me anë të një deklaratë (nga Administratori i shoqërisë) duhet të përcaktoje Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt, i cili duhet të jetë i përfshirë në Liçensen e shoqërisë dhe të deklaroje se ai nuk është i angazhuar në kontratat të tjera Bashkëlidhur deklaratës për Drejtuesin Teknik duhet të paraqitet; a) Kontrata e punës e vlefshme dhe Diploma**.**
Nisur nga fakti se vlera e përllogaritur e kontratës është nën 30 milion lekë, kjo kërkesë e përcaktuar është në kundërshtim me kreun I, pika 2.1 të UKM nr.2, datë 13.05.2005, “Për zbatimin

e punimeve të ndërtimit, ku parashikohet se për punime deri në 30 milion lekë nuk është e detyrueshme qëndrimi i drejtuesit teknik në kantier gjatë gjithë periudhës së punimeve.

**Konkluzioni:** Nga sa kemi trajtuar më sipër procedura paraqitet me probleme në aplikimin e kritereve, *për të cilën ngarkohen me përgjegjësi: Anëtarët e NJHDT* ***E.D.,*** *me funksion specialist në Njësinë e Prokurimeve,* ***D.K.,*** *me funksion specialist në Njësinë e Prokurimeve* ***I.T.,*** *me funksion specialist në Drejtoria e Studimeve, Planifikimit dhe Koordinimit të Investimeve.*

Nga auditimi mbi shpalljen fitues të OE nuk u konstatuan parregullsi.

| **7. Zhvillimi i Procedurës me objekt : "Shërbimi i riparimit të akseve të rrugëve"**<br>***Loti i "Shërbime riparimi dhe mirëmbajtje në segmentin "Ura e Mesit-Prekal-Kir-Breg lumit-Nderlysaj-Thethë***<br>***Loti II "Riparim të shtresave asfaltike dhe punime mbrojtëse të rritjes së sigurisë rrugore në Njësitë Administrative"*** | | |
|---|---|---|
| **1. Urdhër Prokurimi**<br>Nr. 366, datë 26.05.2020<br>**2. Lloji i Procedurës –**<br>*"E hapur" e llojit Marrëveshje kuadër* | **3. Hartuesit e Dokumenteve Tenderit**<br>Urdhër nr. 366, datë 26.05.2020<br>1. E.D.<br>2. D.K.<br>3.A.S. | **4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave**<br>Urdhër nr. 367, datë -26.05.2020<br>1. P.M.<br>2. V.P.<br>3.T.M. |
| **5. Fondi Limit (pa TVSh)**<br>10,832,492 lekë.<br>Loti i – 3, 666,388<br>Loti II – 7,166,104 | **6. Oferta fituese (pa TVSh)**<br>OE/BOE **"RR..."** me ofertë 7,888,350 lekë pa TVSh, sipas kontratës nr. 7161/20 prot., dt.10.08.2020 me afat 12 muaj. | **7. Diferenca me fondin limit (pa TVSh)**<br>**2,944,142** lekë ose ----- % |
| **8. Data e hapjes së tenderit**<br>Datë 22.06.2020. | **9. Burimi Financimit**<br>Buxhet i Bashkisë Shkodër | **10. Operatoret Ekonomike**<br>**a)**Pjesëmarrës në tender **4** OE/BOE<br>b) S'kualifikuar 1 OE/BOE,<br>c) Kualifikuar 3 OE/BOE |
| **11. Ankimime; Ka ankesë – Nuk ka patur**<br>**AK**- nr. ----------<br>**APP**-------;<br>**KPP**------- | **12. Përgjigje Ankesës** nga AK<br>Shkresa nr. -------- | **13. Përgjigje** Ankesës nga APP apo AKKP ---------------<br>Shkresa nr. ---- |

**Burimi i financimit**: Burimi i Financimit Buxheti i Bashkisë për shpenzime sipas VKB Nr.26 datë 30.12.2019"Per miratimin e Buxhetit te vitit 2020 dhe programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2020-2022 te Bashkisë Shkodër.

**Situata 1**

- **Hartimi i fondit limit:** Me PV nr. 7161, datë 25.05.2020 është hartuar fondi limit dhe specifikimet teknik nga NJHDT, mbi bazën e projektit të hartuar nga specialistët e Bashkisë Shkodër ing. A.S. dhe GJ.GJ., me funksion specialist në Drejtorinë e PZHT, bazuar në VKM nr. 629, datë 15.7.2015 për çmimet sipas manualit.

**Kriteri:**

Veprime në shkelje të nenit 5, të ligjit nr. 8402, datë 109.1998 "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve te ndërtimit", i ndryshuar.

**Konkluzioni:**

Projektet/preventivat është hartuar nga punonjësit e Bashkisë Shkodër me profesion inxhinier, por që asnjëri prej tyre nuk është pajisur me licencë profesionale për hartimin e projekteve**,** veprime të cilat nuk garantojnë cilësinë e projekti, *duke ngarkuar me përgjegjësi grupin e specialistëve* ***ing. A.S. dhe GJ.GJ.****, të cilët kanë marrë përsipër kryerjen e një pune pa licencë përkatëse.*

**Situata:**
Me PV nr. 7161/1, datë 25.05.2020 nga NJHDT janë hartuar kriteret dhe miratuar DST.
**Në DT është kërkuar:** Në të dy lotet është kërkuar që operatori ekonomik ofertues, me anë të një deklaratë (nga Administratori i shoqërisë) duhet të përcaktoje Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt, i cili duhet të jetë i përfshirë në Liçensen e shoqërisë, të figuroje i punësuar me kohe te plote ne listëpagesat.
Bashkëlidhur deklaratës për Drejtuesin Teknik duhet të paraqitet; a) Kontrata e punës e vlefshme dhe b) Diplomë
Nisur nga fakti se vlera e përllogaritur e kontratës është nën 30 milion lekë, kjo kërkesë e përcaktuar është në kundërshtim me kreun I, pika 2.1 të UKM nr.2, datë 13.05.2005, "Për zbatimin e punimeve të ndërtimit, ku parashikohet se për punime deri në 30 milion lekë nuk është e detyrueshme qëndrimi i drejtuesit teknik në kantier gjatë gjithë periudhës së punimeve.

**Konkluzioni:** Nga sa kemi trajtuar më sipër procedura paraqitet me probleme në aplikimin e kritereve, *për të cilën ngarkohen me përgjegjësi: Anëtarët e NJHDT* ***E.D.,*** *me funksion specialist në Njësinë e Prokurimeve,* ***D.K.,*** *me funksion specialist në Njësinë e Prokurimeve* ***A.S.,*** *me funksion specialist në Sektori planifikimit te mirëmbajtjes se Infrastrukturës.*

| **8. Zhvillimi i Procedurës me objekt : "*Rikonstruksion blloku i pallateve "Mehmet Pashë Plaku" (afër Servis Jubanit)*** | | |
|---|---|---|
| **1. Urdhër Prokurimi**<br>Nr. 633, datë 10.08.2020<br>**2. Lloji i Procedurës –**<br>"*E hapur*" | **3. Hartuesit e Dokumenteve Tenderit**<br>Urdhër nr. 633, datë 10.08.2020<br>1. E.D.<br>2. D.K.<br>3. XH.R. | **4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave**<br>Urdhër nr. 634, datë 10.08.2020<br>1. F.SH.<br>2. M.M.<br>3. P.M. |
| **5. Fondi Limit (pa TVSh)**<br>9,644,698 lekë. | **6. Oferta fituese (pa TVSh)**<br>OE "*K...*" me ofertë 7,060,650 lekë pa TVSh, sipas kontratës nr. 11360/15, dt.28.10.2020 me afat 3 muaj. | **7. Diferenca me fondin limit (pa TVSh)**<br>**2,584 mijë** lekë ose 26 % |
| **8. Data e hapjes së tenderit**<br>Datë 14.09.2020 | **9. Burimi Financimit**<br>Buxhet i Bashkisë Shkodër | **10. Operatoret Ekonomike**<br>**a)**Pjesëmarrës në tender **6** OE/BOE<br>b) S'kualifikuar 3 OE/BOE,<br>c) Kualifikuar **3** OE/BOE |
| **11. Ankimime; Ka ankesë**<br>**AK**- nr. 13299 prot., dt. 22.09.2020<br>**APP**–------;<br>**KPP**------- | **12. Përgjigje Ankesës** nga AK<br>Shkresa nr. 13299/1 prot., dt. 28.09.2020 | **13. Përgjigje** Ankesës nga<br>APP apo AKKP ---------------<br>Shkresa nr. ---- |

**Burimi i Financimit**: Burimi i Financimit sipas VKB nr.26 datë 30.12.2019"Per miratimin e Buxhetit te vitit 2020 dhe programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2020-2022 te Bashkisë Shkodër" për investime i detajuar si me poshtë:
Financimi për vitin 2020 është 3,540,000 lekë pa TVSh
Financimi për vitin 2021 është 6,104,698 lekë pa TVSh.

**Situata:**
Në hartimin e DT rezulton se nuk ka gjetur zbatim VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, sa vijon:
**Në DT është kërkuar**: Për kapacitetin teknik: "Operatori ekonomik ofertues, me anë të një deklaratë (nga Administratori i shoqërisë) duhet të përcaktoje Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt, i cili duhet të jetë i përfshirë në Liçensen e shoqërisë dhe të deklaroje se ai nuk është i

angazhuar në kontratat të tjera Bashkëlidhur deklaratës për Drejtuesin Teknik duhet të paraqitet; a) Kontrata e punës e vlefshme dhe Diploma.

Nisur nga fakti se vlera e përllogaritur e kontratës është nën 30 milion lekë, kjo kërkesë e përcaktuar është në kundërshtim me kreun I, pika 2.1 të UKM nr.2, datë 13.05.2005, "Për zbatimin e punimeve të ndërtimit, ku parashikohet se për punime deri në 30 milion lekë nuk është e detyrueshme qëndrimi i drejtuesit teknik në kantier gjatë gjithë periudhës së punimeve.

**Në DT është kërkuar:** Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë në stafin e tij punonjës të pasqyruar në listëpagesat për të paktën 3 muajt e fundit, te pajisur me kontrate pune (te vlefshme), me dëshmi kualifikimi të sigurimit teknik (te vlefshme) të lëshuara nga organizma të akredituar për këtë qëllim në Republikën e Shqipërisë, ku nga këta të jenë të paktën: *Teknik ndërtimi 1 punonjës; Manovrator 2 punonjës;* ***Punëtor asfaltimi në rrugë 1 punonjës****; Murator 1 punonjës; Hidraulik 1 punonjës; Elektricist 1 punonjës.*

Manovratorë duhet të jenë punonjës te specializuar për drejtimin e mjeteve të rënda(ekskavatorist) dhe (Automakinistë) dhe për këtë duhet të paraqesin dëshmi nga Drejtoria e Shërbimit te Transportit Rrugor ndërsa për teknikun e ndërtimit duhet te paraqitet diploma e shkollës/dëshmi nga organe/institute te akredituar.

Në lidhje më kërkesën sa më sipër, bazuar në VKM nr. 514, datë 20.9.2017, "Për miratimin e listës kombëtare të profesioneve", rezulton se nuk ka emërtim punëtor asfaltimi në rrugë dhe emërtim manovrator. Nisur nga kuptimi qe ju u keni vënë manovrator janë me kodin 8332 dhe emërtimin "Shoferë të makinave të rënda".

**<u>Konkluzioni:</u>** Nga sa kemi trajtuar më sipër procedura paraqitet me probleme në aplikimin e kritereve, *për të cilën ngarkohen me përgjegjësi: Anëtarët e NJHDT* ***E.D.,*** *me funksion specialist në Njësinë e Prokurimeve,* ***D.K.,*** *me funksion specialist në Njësinë e Prokurimeve* ***XH.R.,*** *me funksion specialist në Drejtoria e Studimeve, Planifikimit dhe Koordinimit të Investimeve.*

Me shkresën nr.13299 prot datë 22.09.2020 ka paraqitur formularin e ankesës shoqëria "D..." ShPK. Me shkresën nr. 13299/1 prot datë 28.09.2020 Autoriteti Kontraktor i ka kthyer përgjigje ankesës duke mos i marre parasysh pretendimet e shoqërisë "D..." ShPK dhe qëndrimet e KVO janë të sakta.

Nga auditimi rezulton se kualifikimi i OE është në përputhje me kërkesat e DST. Në mënyrë të detajuar auditimi i mbi ligjshmërinë e tyre është trajtuar në akt-konstatimin nr. 12, datë 04.06.2021.

| **9. Zhvillimi i Procedurës me objekt : "*Rikonstruksion rruga "Magjoni"*** | | |
|---|---|---|
| **1. Urdhër Prokurimi**<br>Nr. 964, datë 05.11.2020<br>**2. Lloji i Procedurës –**<br>**"***Kërkesë për propozime*" | **3. Hartuesit e Dokumenteve Tenderit**<br>Urdhër nr. 964, datë 04.11.2020<br>1. E.D.<br>2. D.K.<br>3. S.L. | **4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave**<br>Urdhër nr. 965, datë 05.11.2020<br>1. F.SH.<br>2. M.M.<br>3. F.K. |
| **5. Fondi Limit (pa TVSh)**<br>10,552,322 lekë. | **6. Oferta fituese (pa TVSh)**<br>OE **"K...-"** me ofertë 9,497,074 lekë pa TVSh, sipas kontratës nr. 15915/14, dt. 22.01.2021 me afat 4 muaj. | **7. Diferenca me fondin limit (pa TVSh)**<br>**1,055 mijë** lekë ose 9.9 % |
| **8. Data e hapjes së tenderit**<br>Datë 23.11.2020 | **9. Burimi Financimit**<br>Buxheti i Bashkisë Shkodër | **10. Operatoret Ekonomike**<br>**a)**Pjesëmarrës në tender **4** OE/BOE<br>b) S'kualifikuar 3 OE/BOE,<br>c) Kualifikuar **1** OE/BOE |
| **11. Ankimime;**<br>**AK**- nr. ---------- **APP**-------;<br>**KPP**------- | **12. Përgjigje Ankesës** nga AK<br>Shkresa nr. -------- | **13. Përgjigje** Ankesës nga<br>APP apo AKKP ---------------<br>Shkresa nr. ---- |

**Burimi i Financimit** Buxheti i Bashkisë viti 2020 sipas VKB nr.26 datë 30.12.2019“Per miratimin e Buxhetit te vitit 2020 dhe programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2020-2022 të Bashkisë Shkodër“ për investime i detajuar nder vite si me poshtë:
Financimi për vitin 2020 është 2,400,833 lekë pa TVSh
Financimi për vitin 2021 është 4,166,666 lekë pa TVSh
Financimi për vitin 2022 është 3,984,823 lekë pa TVSh

**<u>Situata</u>:**
Procesverbali i hartimit të DT mban datën 15.11.2020. Në hartimin e DT rezulton se nuk ka gjetur zbatim VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, sa vijon:
**Në DT është kërkuar :** Për kapacitetin teknik: “Operatori ekonomik ofertues, me anë të një deklaratë (nga Administratori i shoqërisë) duhet të përcaktoje Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt, i cili duhet të jetë i përfshirë në Liçensen e shoqërisë dhe të deklaroje se ai nuk është i angazhuar në kontratat të tjera Bashkëlidhur deklaratës për Drejtuesin Teknik duhet të paraqitet; a) Kontrata e punës e vlefshme dhe Diploma**.**
Nisur nga fakti se vlera e përllogaritur e kontratës është nën 30 milion lekë, kjo kërkesë e përcaktuar është në kundërshtim me kreun I, pika 2.1 të UKM nr.2, datë 13.05.2005, “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit, ku parashikohet se për punime deri në 30 milion lekë nuk është e detyrueshme qëndrimi i drejtuesit teknik në kantier gjatë gjithë periudhës së punimeve.
**Në DT është kërkuar:** Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë në stafin e tij punonjës të pasqyruar në listëpagesat për të paktën **3 muajt e fundit**, te pajisur me kontrate pune (te vlefshme), ose **te kontraktuar ne rastin kur makineritë janë me qira për manovratorë,** me dëshmi kualifikimi të sigurimit teknik (te vlefshme) të lëshuara nga organizma të akredituar për këtë qëllim në Republikën e Shqipërisë, ku nga këta të jenë të paktën: *Teknik ndërtimi 1 punonjës; Manovrator 2 punonjës;* ***Punëtor asfaltimi në rrugë 2 punonjës****; Murator 1 punonjës; Hidraulik 1 punonjës; Elektricist 1 punonjës.*
Manovratorë duhet të jenë punonjës te specializuar për drejtimin e mjeteve të rënda(ekskavatorist) dhe (Automakinistë) dhe për këtë duhet të paraqesin dëshmi nga Drejtoria e Shërbimit te Transportit Rrugor ndërsa për teknikun e ndërtimit duhet te paraqitet diploma e shkollës/dëshmi nga organe/institute te akredituar.
Në lidhje më kërkesën sa më sipër, bazuar në VKM nr. 514, datë 20.9.2017, “Për miratimin e listës kombëtare të profesioneve”, rezulton se nuk ka emërtim punëtor asfaltimi në rrugë dhe emërtim manovrator. Nisur nga kuptimi qe ju u keni vënë manovrator janë me kodin 8332 dhe emërtimin “Shoferë të makinave të rënda”.

**<u>Konkluzioni:</u>** Nga sa kemi trajtuar më sipër procedura paraqitet me probleme në aplikimin e kritereve, *për të cilën ngarkohen me përgjegjësi: Anëtarët e NJHDT* ***E.D.,*** *me funksion specialist në Njësinë e Prokurimeve,* ***D.K.,*** *me funksion specialist në Njësinë e Prokurimeve* ***S.L.,*** *me funksion specialist në Drejtoria e Studimeve, Planifikimit dhe Koordinimit të Investimeve.*

Nga auditimi rezulton se kualifikimi i OE është në përputhje me kërkesat e DST. Në mënyrë të detajuar auditimi i mbi ligjshmërinë e tyre është trajtuar në akt-konstatimin nr. 12, datë 04.06.2021**.**

| 10. Zhvillimi i Procedurës me objekt : "*Rikonstruksion Rruga "Besa Shqiptare" dhe rruga "Paqes".* | | |
|---|---|---|
| **1. Urdhër Prokurimi**<br>Nr. 654, datë 12.08.2020<br>**2. Lloji i Procedurës –**<br>**"***Kërkesë për propozime*" | **3. Hartuesit e Dokumenteve Tenderit**<br>Urdhër nr. 654, datë 12.08.2020<br>1. E.D.<br>2. D.K.<br>3. I.T. | **4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave**<br>Urdhër nr. 655, datë 12.08.2020<br>1. F.SH.<br>2. M.M.<br>3.P.M. |
| **5. Fondi Limit (pa TVSh)**<br>10,145,602 lekë. | **6. Oferta fituese (pa TVSh)**<br>OE **"A..."** me ofertë 7,470,332 lekë pa TVSh, sipas kontratës nr.11534/15 prot., dt. 26.10.2020 me afat 4 muaj. | **7. Diferenca me fondin limit (pa TVSh)**<br>**2,675 mijë** lekë ose 16 % |
| **8. Data e hapjes së tenderit**<br>Datë 28.08.2020 | **9. Burimi Financimit**<br>Buxheti i Bashkisë Shkodër | **10. Operatoret Ekonomike**<br>**a)**Pjesëmarrës në tender **7** OE/BOE<br>b) S'kualifikuar 2 OE/BOE,<br>c) Kualifikuar **5** OE/BOE |
| **11. Ankimime; Ka ankesë**<br>**AK**- nr. 13298 prot., dt. 22.09.2020 (D...)<br>**APP**–------;<br>**KPP**------- | **12. Përgjigje Ankesës** nga AK<br>Shkresa nr. 13298/1 prot., dt. 28.09.2020 | **13. Përgjigje** Ankesës nga<br>APP apo KKP – Nuk ka patur<br>Shkresa nr. ---- |

**Burimi i Financimit** Buxheti i Bashkisë sipas VKB nr.26 datë 30.12.2019"Per miratimin e Buxhetit te vitit 2020 dhe programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2020-2022 te Bashkisë Shkodër" për investime i detajuar si me poshtë:
Financimi për vitin 2020 është 3,480, 000 lekë pa TVSh
Financimi për vitin 2021 është 5, 000, 000 lekë pa TVSh
Financimi për vitin 2022 është 1, 665,602 lekë pa TVSh
Projekt/ Preventivi në vlerën 10,145,602 lekë pa TVSh është hartuar nga shoqëria "C...", bazuar në VKM nr. 629, datë 15.7.2015 për çmimet sipas manualit. Ndërsa specifikimet janë hartuar nga NJDT, sipas PV datë 12.8.2020 *(prot nr. 11534)*

**Situata:**
Procesverbali i hartimit të DT mban datën 12.8.2019 *(prot 11534/2)*. Në hartimin e DT rezulton se nuk ka gjetur zbatim VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, sa vijon:
**Në DT është kërkuar:** Për kapacitetin teknik: "Operatori ekonomik ofertues, me anë të një deklaratë (nga Administratori i shoqërisë) duhet të përcaktoje Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt, i cili duhet të jetë i përfshirë në Liçensen e shoqërisë dhe të deklaroje se ai nuk është i angazhuar në kontratat të tjera Bashkëlidhur deklaratës për Drejtuesin Teknik duhet të paraqitet; a) Kontrata e punës e vlefshme dhe Diploma.
Nisur nga fakti se vlera e përllogaritur e kontratës është nën 30 milion lekë, kjo kërkesë e përcaktuar është në kundërshtim me kreun I, pika 2.1 të UKM nr.2, datë 13.05.2005, "Për zbatimin e punimeve të ndërtimit, ku parashikohet se për punime deri në 30 milion lekë nuk është e detyrueshme qëndrimi i drejtuesit teknik në kantier gjatë gjithë periudhës së punimeve.

**Kriteri:** Në shkelje të akteve ligjore e nënligjore të LPP, trajtuar në fillim të Kapitullit III/2.4.

**Konkluzioni:** Nga sa kemi trajtuar më sipër procedura paraqitet me probleme në aplikimin e kritereve, *për të cilën ngarkohen me përgjegjësi: Anëtarët e NJHDT **E.D.,** me funksion specialist në Njësinë e Prokurimeve, **D.K.,** me funksion specialist në Njësinë e Prokurimeve **I.T.,** me funksion specialist në Drejtoria e Studimeve, Planifikimit dhe Koordinimit të Investimeve.*

Me PV nr. 11534/7, datë 27.9.2020, KVO ka vlerësuar procedurën ku nga 7 OE pjesëmarrës janë skualifikuar 3 OE dhe kualifikuar 4 OE. Nga OE e mbetur në garë është shpallur fitues shoqëria "A..." me ofertë më të leverdishme se OE e tjerë të mbetur në garë (gjerësisht trajtuar në akt-konstatimin nr. 12, datë 04.06.2021).
Me vendim nr. 11534/9, datë 22.9.2020, Titullari i AK ka anuluar procedurën me pretekstin se shoqëria 'D..." ka paraqitur ankesë. Me vendim shqyrtimi nr. 11534/10, datë 22.9.2020, Titullari i AK ka caktuar z. E.D. si person përgjegjës për shqyrtimin e ankesës, veprim në kundërshtim me 78 të VKM nr. 914, datë 27.12.2014, i ndryshuar, pasi duhet komision për shqyrtim ankese.

**Ankimim**: **Po ka.**
Me shkresën nr.13298 prot datë 22.09.2020 ka paraqitur formularin e ankesës shoqëria "D..." ShPK. Me shkresën nr. 13298/1 prot datë 28.09.2020 Autoriteti Kontraktor i ka kthyer përgjigje ankesës duke mos i marre parasysh pretendimet e shoqërisë "D..." ShPK. Janë respektuar afatet e ankimimit pranë Komisionit te Prokurimit Publik. Me shkresën nr. 13298/1, datë 28.9.2020 nga AK Bashkia Shkodër është kthyer përgjigje shoqërisë "D..." ShPK, se pretendimet nuk qëndrojë dhe skualifikimi është i drejtë nga KVO.
Nga vlerësimi i dokumentacioni mbi shpalljen fitues OE, konstatohet se është në përputhje me dispozitat e LPP.

| **11. Zhvillimi i Procedurës me objekt : "*Sistemim asfaltim rruga "Myzyraj" loti II*** | | |
|---|---|---|
| **1. Urdhër Prokurimi**<br>Nr. 458, datë 15.06.2020<br>**2. Lloji i Procedurës –**<br>"*Kërkesë për propozime*" | **3. Hartuesit e Dokumenteve Tenderit**<br>Urdhër nr. 458, datë 15.06.2020<br>1. E.D.<br>2. D.K.<br>3.R.T. | **4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave**<br>Urdhër nr. 459, datë 15.06.2020<br>1. V.P.<br>2. T.M.<br>3. P.M. |
| **5. Fondi Limit (pa TVSh)**<br>11,009,064 lekë. | **6. Oferta fituese (pa TVSh)**<br>OE/BOE **"RR..."** me ofertë 7,500,004.23 lekë pa TVSh, sipas kontratës nr. 8409/14 prot., dt. 28.08.2020 me afat 3 muaj. | **7. Diferenca me fondin limit (pa TVSh)**<br>3,509 mijë lekë ose 31.8 % |
| **8. Data e hapjes së tenderit**<br>Datë 29.06.2020 | **9. Burimi Financimit**<br>Buxhet i Bashkisë Shkodër | **10. Operatoret Ekonomike**<br>**a)**Pjesëmarrës në tender **7** OE/BOE<br>b) S'kualifikuar 2 OE/BOE,<br>c) Kualifikuar 5 OE/BOE. |
| **11. Ankimime; Ka ankesë**<br>**AK**- nr. 10240 prot., dt. 20.07.2020<br>**APP**-------;<br>**KPP**------- | **12. Përgjigje Ankesës** nga AK<br>Shkresa nr. 10240/1 prot., dt. 24.07.2020 | **13. Përgjigje** Ankesës nga<br>APP apo KKP – Nuk ka patur<br>Shkresa nr. ---- |

Burimi i Financimit sipas VKB nr.26 datë 30.12.2019"Per miratimin e Buxhetit te vitit 2020 dhe programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2020-2022 te Bashkisë Shkodër" për investime i detajuar si me poshtë:
Financimi për vitin 2020 është 1,430,000 lekë pa TVSh
Financimi për vitin 2021 është 6,666,666 lekë pa TVSh
Financimi për vitin 2022 është 2,912,398 lekë pa TVSh

**Situata:**
Procesverbali i hartimit të DT mban datën 15.6.2020. Në hartimin e DT rezulton se nuk ka gjetur zbatim VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, sa vijon:

**Në DT është kërkuar:** Operatori ekonomik ofertues, me anë të një deklaratë (nga Administratori i shoqërisë) duhet të përcaktoje *Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt,* i cili duhet të jetë i përfshirë në Liçensen e shoqërisë dhe të deklaroje se ai nuk është i angazhuar në kontratat të tjera Bashkëlidhur deklaratës për Drejtuesin Teknik duhet të paraqitet; a) Kontrata e punës e vlefshme dhe Diploma, në kundërshtim me kreun I, pika 2.1 të UKM nr.2, datë 13.05.2005, "Për zbatimin e punimeve të ndërtimit, ku parashikohet se për punime deri në 30 milion lekë nuk është e detyrueshme qëndrimi i drejtuesit teknik në kantier gjatë gjithë periudhës së punimeve.

**<u>Konkluzioni:</u>** Nga sa kemi trajtuar më sipër procedura paraqitet me probleme në aplikimin e kritereve, *për të cilën ngarkohen me përgjegjësi: Anëtarët e NJHDT* ***E.D.,*** *me funksion specialist në Njësinë e Prokurimeve,* ***D.K.,*** *me funksion specialist në Njësinë e Prokurimeve* ***R.T.,*** *me funksion specialist në Drejtoria e Studimeve, Planifikimit dhe Koordinimit të Investimeve.*

Nga auditimi rezulton se kualifikimi i OE është në përputhje me kërkesat e DST. Në mënyrë të detajuar auditimi i mbi ligjshmërinë e tyre është trajtuar në akt-konstatimin nr. 12, datë 04.06.2021**.**

| **12. Zhvillimi i Procedurës me objekt : "*Sistemim asfaltim i rrugës "Vukatanë-Gur i Kuq", Lot I.*** | | |
|---|---|---|
| **1. Urdhër Prokurimi**<br>Nr. 796, datë 28.09.2020<br>**2. Lloji i Procedurës –**<br>**"***Kërkesë për propozim*" | **3. Hartuesit e Dokumenteve Tenderit**<br>Urdhër nr. 796, datë 28.09.2020<br>1. E.D.<br>2. D.K.<br>3. XH.R. | **4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave**<br>Urdhër nr. 797, datë 28.09.2020<br>1. P.M.<br>2. A.SH.<br>3. A.C. |
| **5. Fondi Limit (pa TVSh)**<br>10,019,337 lekë. | **6. Oferta fituese (pa TVSh)**<br>OE/BOE **"S..."** me ofertë 9,313,777 lekë pa TVSh, sipas kontratës nr. 13585/12, dt. 16.11.2020 me afat 3 muaj. | **7. Diferenca me fondin limit (pa TVSh)**<br>**705 mijë** lekë ose 7 % |
| **8. Data e hapjes së tenderit**<br>Datë 12.10.2020 | **9. Burimi Financimit**<br>Buxhet i Bashkisë Shkodër | **10. Operatoret Ekonomike**<br>**a)**Pjesëmarrës në tender **4** OE/BOE<br>b) S'kualifikuar 3 OE/BOE,<br>c) Kualifikuar1 OE/BOE |
| **11. Ankimime;**<br>**AK**- nr. ---------- **APP**–------;<br>**KPP**------- | **12. Përgjigje Ankesës** nga AK<br>Shkresa nr. -------- | **13. Përgjigje** Ankesës nga<br>APP apo AKKP ---------------<br>Shkresa nr. ---- |

Burimi i Financimit Buxheti i Bashkisë viti 2020 sipas VKB nr.26 datë 30.12.2019"Per miratimin e Buxhetit te vitit 2020 dhe programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2020-2022 te Bashkisë Shkodër" për investime i detajuar nder vite si me poshtë:
Financimi për vitin 2020 është 586,666 lekë pa TVSh
Financimi për vitin 2021 është 4,720,833 lekë pa TVSh
Financimi për vitin 2022 është 4,711,838 lekë pa TVSh

**<u>Situata:</u>**
Procesverbali i hartimit të DT mban datën 28.9.2020. Në hartimin e DT rezulton se nuk ka gjetur zbatim VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, sa vijon:
**Në DT është kërkuar:** Operatori ekonomik ofertues, me anë të një deklaratë (nga Administratori i shoqërisë) duhet të përcaktoje *Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt,* i cili duhet të jetë i përfshirë në Liçensen e shoqërisë dhe të deklaroje se ai nuk është i angazhuar në kontratat të tjera Bashkëlidhur deklaratës për Drejtuesin Teknik duhet të paraqitet; a) Kontrata e punës e vlefshme dhe Diploma, në kundërshtim me Kreun I, pika 2.1 të UKM nr.2, datë 13.05.2005, "Për zbatimin

e punimeve të ndërtimit, ku parashikohet se për punime deri në 30 milion lekë nuk është e detyrueshme qëndrimi i drejtuesit teknik në kantier gjatë gjithë periudhës së punimeve.

**Konkluzioni:** Nga sa kemi trajtuar më sipër procedura paraqitet me probleme në aplikimin e kritereve, *për të cilën ngarkohen me përgjegjësi: Anëtarët e NJHDT* ***E.D.,*** *me funksion specialist në Njësinë e Prokurimeve,* ***D.K.,*** *me funksion specialist në Njësinë e Prokurimeve* ***XH.R.,*** *me funksion specialist në Drejtoria e Studimeve, Planifikimit dhe Koordinimit të Investimeve.*

**Zhvillimi i procedurës së prokurimit:** Procedura e prokurimit është hapur më datë 12.10.2020 dhe është vlerësuar më datë 20.10.2020.
Nga vlerësimi i dokumentacionit teknik/ligjorë të OE pjesëmarrës nga 4 OE/BOE pjesëmarrës, KVO ka skualifikuar 3 OE/BOE dhe ka kualifikuar 1 OE/BOE, kua arsyet e skualifikimit janë trajtuar gjerësisht në akt-konstatimin nr. 12, datë 04.06.2021.
Nga auditimi i dosjes së subjekti dhe të dhënat e sistemit, konstatohet se shoqëria në të njëjtën periudhë ka dhe kontrata të tjera të cilat ka deklaruar makineritë, drejtuesi teknik, punonjësit sipas profesioneve dhe numër i punonjësve, brenda së njëjtën periudhë pa mbaruar punimet e kontratave, veprime në kundërshtim me aktet ligjore të LPP, të trajtuara në fillim

**Kriteri:** Në shkelje të akteve ligjore e nënligjore të LPP, trajtuar në fillim të Kapitullit III/2.4.

**Konkluzioni:** Nga sa kemi trajtuar më sipër procedura paraqitet me probleme në shpallje fitues të OE, i cili ka mangësi në plotësimin e kritereve, veprime të cilat çojnë në paligjshmëri të përdorimit të fondeve të prokuruar, *për të cilën ngarkohen me përgjegjësi anëtarët e KVO, i përbërë nga* ***P.M.,*** *me funksion Administrator NJA Guri i Zi - kryetar,* ***A.SH.,*** *me funksion Administrator NJA Postribe dhe* ***A.C.,*** *me funksion Administrator NJA Ana e Mali*

| **13. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt : "*Rikonstruksion i godinave në pronësi të NJVV për strehim social (Rikonstruksion i ish konviktit të shkollës Veterinare)*** | | |
|---|---|---|
| **1. Urdhër Prokurimi**<br>Nr. 700, datë 01.09.2020<br>**2. Lloji i Procedurës –**<br>**"***E hapur*" | **3. Hartuesit e Dokumenteve Tenderit**<br>Urdhër nr. 700, datë 01.09.2020<br>1. E.D.<br>2. D.K.<br>3.XH.R. | **4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave**<br>Urdhër nr. 701, datë 01.09.2020<br>1. T.H.<br>2. S.O.<br>3. P.M. |
| **5. Fondi Limit (pa TVSh)**<br>79,302,921 lekë. | **6. Oferta fituese (pa TVSh)**<br>OE/BOE **"O..."&"SH..."** me ofertë 75,073,897.5 lekë pa TVSh, sipas kontratës nr. 12261/12 prot, dt. 28.10.2020 me afat 12 muaj. | **7. Diferenca me fondin limit (pa TVSh)**<br>**4,229,023.5** lekë ose ----- % |
| **8. Data e hapjes së tenderit**<br>Datë 05.10.2020 | **9. Burimi Financimit**<br>Buxhet i Bashkisë Shkodër + Buxheti i Shtetit | **10. Operatoret Ekonomike**<br>**a)**Pjesëmarrës në tender **6** OE/BOE<br>b) S'kualifikuar 4 OE/BOE,<br>c) Kualifikuar **2** OE/BOE |

Numri i referencës së procedurës/lotit: **REF-70709-09-03-2020**
Fondi limit **79,302,921** (lekë pa TVSh
**Burimi i Financimit**: Ky fond është vënë në dispozicion nga Buxheti i Bashkisë Viti 2020 për investime sipas VKB nr. 34 date 07.08.2020 'Për miratimin e përdorimit te fondit rezerve për zbatimin e projektit: "*Rikonstruksion i godinave ne pronësi te njësive te Vetëqeverisjes vendore për strehim social.* "*Rikonstruksion i ish Konviktit te shkollës veterinare*" dhe Buxheti i Shtetit sipas shkresës nr. 13712/1 prot datë 17.07.2020 nga Ministria e Financave dhe "Njoftim mbi fituesit e projekteve te strehimit për vitin 2020"detajuar si me poshtë:

*Financimi nga Buxheti i Shtetit* me vlere prej **63,449,998** lekë pa TVSh**, i** detajuar nder vite si me poshtë:

**1.** Financimi për vitin 2020 është **20,097,936.67** lekë pa TVSh.

**2.** Financimi për vitin 2021 është **20,833,333.33** lekë me TVSh.

**3.** Financimi për vitin 2022 është **22,518,728** lekë me TVSh

*Financimi nga Buxheti i Bashkisë:* Financimi për vitin 2020 është **15,852,923** lekë me TVSh
Nga vlerësimi i dokumentacionit teknik/ligjorë të OE pjesëmarrës (PV nr. 2, datë 13.10.2020), nga 6 OE/BOE pjesëmarrës, KVO ka skualifikuar 4 OE/BOE dhe ka kualifikuar 2 OE/BOE, kua arsyet e skualifikimit janë trajtuar gjerësisht në akt-konstatimin nr. 12, datë 04.06.2021.
Njoftimi i Klasifikimit është bërë në date 13.10.2020. Midis OE te mbetur në garë KVO, ka kualifikuar si ofertë më të suksesshme BOE "**O..." & "S... "Shpk** me vlerë **75,073,897,5** lekë pa TVSh. Me vendim nr. 12261/8,. Datë 13.10.2020, KVO ka shpallur fitues këtë BOE. Me shkresën nr. 12261/9, datë 21.10.2020 është hartuar dhe dërguar për miratim raporti përmbledhës, ku me shkresën nr. 12261/10, datë 21.10.2020 është bërë miratimi nga Titullari i AK.
Midis investitorit Bashkia Shkodër dhe sipërmarrës BOE "O..." & "S... "Shpk është lidhur kontrata për zbatimin e punimeve nr. 12261/12, datë 28.10.2020 me afat 12 muaj.

**Situata:**

Procesverbali i hartimit të DT mban datën 01.9.2020, nr. 12261/2. Në hartimin e DT rezulton se nuk ka gjetur zbatim VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, sa vijon:
**Në DT është kërkuar:** Kërkesa për paraqitjen e certifikatës së marrjes në dorëzim dhe çertifikatën e marrjes në dorëzim të objekti, janë kritere të tejkaluar, pasi akti i marrjes në dorëzim bëhet për një periudhë kohore 1 – 2 vjeçare, duke tejkaluar në këtë mënyrë afatin tre vjeçar të periudhës së kërkuar.
**Në DT është kërkuar:** Kategoritë e licencave NP-2 dhe NP-12, nuk janë argumentohet me objektin e prokuruar, pasi objekti është rikonstruksion. Gjithashtu për kategorinë NP-12A- *Punime te inxhinierisë mjedisore"*, nuk ka punime bazuar ne përcaktimet e VKM nr.42, datë 16.01.2008.
**Në DT është kërkuar:** Kërkesa për ing. mjedisi është në kundërshtim me zierat e preventivit të punimeve, pasi nuk ka punime mjedisore në koncept të VKM nr.42, datë 16.01.2008.
**Në DT është kërkuar:** Kërkesa për një arkitekt. Në lidhje me kërkesën për arkitekt, sqarojmë se në dokumentet e procedurës së prokurimit autoriteti kontraktor ka publikuar njëherazi "*Preventivin e punimeve"," Relacionin Teknik", "Specifikimet Teknike", "Grafikun e punimeve" dhe "Projektin e Zbatimit*", duke i vënë në dispozicion, informacionin operatorëve ekonomikë pjesëmarrës mbi projektin të cilët këto të fundit do të zbatojnë në rast të fitimit të kontratës. Disponueshmëria e një arkitekti referuar natyrës së punimeve dhe duke marrë në konsideratë faktin se autoriteti kontraktor ka parashikuar në mënyrë të detajuar projektin e zbatimit, specifikimet teknike, nuk shfaqet e nevojshme në proporcion me natyrën dhe volumin e punimeve.
- Është e paargumentuar kriteri për *"Ekspert Mjedisor"; "Ekspert për Auditim energjie "Pergjegjes/koordinator për realizimin e punimeve në fushën e sigurisë dhe të shëndetit gjatë realizmit të punimeve".*
Në dokumentet e procedurës së prokurimit, autoriteti kontraktor ka publikuar njëherazi *"Preventivin e punimeve"," Relacionin Teknik", "Specifikimet Teknike", "Grafikun e punimeve" dhe "Projektin e Zbatimit*". Nga shqyrtimi i dokumentacionit në tërësi, konstatohet se në asnjë rast autoriteti kontraktor nuk ka parashikuar në "Relacionin Teknik", "Specifikimet Teknike", kryerjen

e shërbimit të auditimit të efiçencës së energjisë në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, nga auditues energjetik të licencuar. Gjithashtu autoriteti kontraktor nuk ka parashikuar si zë të veçantë kryerjen e shërbimit të auditimit të efiçencës së energjisë. Sa më sipër, kriteri i mësipërm i vendosur nga autoriteti kontraktor në kriteret e veçanta të kualifikimit, nuk është proporcionale me objektin e procedurës së prokurimit, natyrën, përmasat e kontratës si edhe me qëllimin e kërkuar nga vetë autoriteti kontraktor. Bazuar në detyrimet që rrjedhin nga ligji nr.124/2015 "Për efiçencë e energjisë", autoriteti kontraktor në çdo moment mund të kryejë procesin e auditimit energjetik me një procedurë të veçantë.

- Është e paargumentuar kriteri për *"Ndihmë e parë dhe ndërhyrje ndaj emergjencave"; "për gjegjës për dëmet në mjedis"; "Pergjegjes për sigurinë dhe higjienën ne kantieret e përkohshme te ndërtimit"', "Përgjegjës për dëmet në mjedis", "Pergjegjes për vlerësimin e risqeve ne kantier".* Në lidhje me këtë kërkesë sqarojmë se eksperienca të tilla të kërkuara nga NJHDT nuk janë kusht i nevojshëm për të dëshmuar se OE ka kapacitetin e nevojshëm për ekzekutimin e kontratës. Këto janë kërkesa shtesë dhe të pa argumentuara duke mos qenë të lidhura ngushtë me objektin e procedurës së prokurimit. Si të tilla ato nuk kanë vend për të qenë kritere kualifikuese.

- **Është e paargumentuar kriteri për**; "*Çertifikatën për sistemin e menaxhimit te cilësisë ne saldim EN- ISO 3834-2:2006 ose ekuivalente me te (e vlefshme). (Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO sipas zërave te mallrave apo punimeve që do të marrë përsipër të realizojë sipas akt marrëveshjes).*

Kërkesë e gabuar pasi certifikata EN-ISO 3834-2:2006 "Për sistemin e menaxhimit të cilësisë së saldimit", shërben për prodhimin me saldim, e cila është përgatitur me qëllim të përcaktojë kërkesat e certifikata ENISO 3834-2:2006"Për sistemin e menaxhimit të cilësisë së saldimit", Certifikimi i sipërcituar shërben për prodhimin me saldim, e cila është përgatitur me qëllim të përcaktojë kërkesat e cilësisë për prodhuesit që merren me prodhimin e produkteve me metodën e shkrirjes me saldim. Standarte EN ISO 3834-2 për certifikim ka të bëjë vetëm me burimin dhe cilësinë e produktit që mund të rrjedh nga burimi dhe operimet e ndërlidhura. Standardet janë përdorur si bazë për vlerësimin e cilësisë së saldimit të prodhuesve. Sa më sipër, referuar objektit të prokurimit objekt shqyrtimi, rezulton se nuk jemi në kushtet e blerjes së produkteve të prodhuara me metodën e shkrirjes me saldim, në mënyrë që të kërkohet që prodhuesi i tyre të disponojë certifikimin për standardin EN ISO 3834-2. Në këto kushte, kërkimi nga ana e autoritetit kontraktor për disponimin e certifikatës të sipërcituar, nuk është e lidhur ngushtë me objektin e kontratës dhe për këtë arsye autoriteti kontraktor nuk duhej ta vendoste këtë kërkesë.

- **Është e paargumentuar kriteri për**: "*ISO 50001-2011 ose ekuivalente me te, e përditësuar (e vlefshme). (Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO sipas zërave te mallrave apo punimeve që do të marrë përsipër të realizojë sipas akt marrëveshjes).*

Kërkesë e gabuar pasi certifikata ISO 50001 bazohet në modelin e sistemit të menaxhimit të përmirësimit të vazhdueshëm që përdoret edhe për standarde të tjera të njohura si ISO 9001 ose ISO 14001. Kjo e bën më të lehtë për organizatat të integrojnë menaxhimin e energjisë në përpjekjet e tyre të përgjithshme për të përmirësuar cilësinë dhe menaxhimin e mjedisit.

**<u>Konkluzioni:</u>** Nga sa kemi trajtuar më sipër procedura paraqitet me probleme si në aplikimin e kritereve dhe në shpallje fitues të OE, veprime të cilat çojnë në paligjshmëri të përdorimit të fondeve të prokuruar, *për të cilën ngarkohen me përgjegjësi: Anëtarët e NJHDT* ***E.D.,*** *me funksion specialist në Njësinë e Prokurimeve,* ***D.K.,*** *me funksion specialist në Njësinë e Prokurimeve* ***XH.R.,*** *me funksion specialist në Drejtorinë e PZHT*

**Komente dhe sqarime**:
Nga anëtarët e NJHDT dhe KVO Bashkia Shkodër me shkresën nr. 4597/55, datë 16.7.2021 (prot KLSH nr. 362/16, datë 21.7.2021), janë përcjellë kundërshtitë në lidhje me mangësitë e konstatuara në procedurat e prokurimit për periudhën 01.01.2019 – 31.12.2020, duke kundërshtuar për çdo rast shkeljen e evidentuara nga KLSH, ku sipas Bashkisë Shkodër asnjë nga këto procedura nuk mund të evidentohen në shkelje.
**Sqarim i grupit të KLSH:**
Grupi i KLSH pasi i analizojë të gjitha argumentet e paraqitura nga subjekti Bashkia Shkodër në lidhje me mangësitë e konstatuara në procedurat e prokurimit mbi kriteret dhe shpalljen fitues të OE, të periudhës 2019 – 2020, arrin në konkluzionin se:
a- Të gjitha argumentet e paraqitura janë të së njëjtës natyrë të paraqitur gjatë fazës së akteve, për të cilat KLSH është shprehur në Raportin e Auditimit, duke dhënë dhe argumentet se nuk qëndrojë dhe nuk merren në konsideratë;
b- Nuk ka asnjë argument shtesë për të kundërshtuar konstatimet e KLSH, qoftë ky dhe me dokumentacion mbështetës;
c- Në lidhje me argumentin se në një procedurë prokurim për skualifikimin e një OE kriteret për të cilat ai është skualifikuar nuk është mangësi në OE e tjerë, sqarojmë se argumenti i KLSH është se gjatë zhvillimit të procedura dhe eliminimit të OE janë përdorur disa kritere për vlerësim, të cilat në disa procedura nuk është përdorur dhe në disa të tjera po.
Përfundimisht mangësitë e konstatuara në grupi i KLSH mbi procedurat e zhvilluara në periudhën 01.7.2019 – 31.12.2020, **qëndrojnë dhe argumentet nuk merren në konsideratë**.

*(Më hollësisht janë trajtuar në faqen 87-164 të Projektraport Auditmit)*

- **Procedurat me "Blerjet e Vogla", për periudhën 01.07.2019 -31.12.2020**

Sipas regjistrit të realizimit, për 6 mujorin e dytë të vitit 2019 janë zhvilluar 65 procedura me fond limit 9,325 mijë lekë pa TVSh, dhe vlerë kontrate 7,430 mijë lekë pa TVSh (79.6% e fondit limit), me një diferencë prej 1,805 mijë lekë pa TVSh nga fondi limit. Për vitin 2020 janë zhvilluar 57 procedura me fond limit 10,398 mijë lekë pa TVSh, dhe vlerë kontrate 8,796 mijë lekë (84.5% e fondit limit), me diferencë 1,602 mijë lekë pa TVSh nga fondi limit.

| Nr. | Periudha | Nr. | Vlera në Lekë | | | | | Ecuria e Auditimit /lekë | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | Fondi limit pa TVSh | Fituesit pa TVSh | Diferenca nga fondi limit pa TVSh | Audituar Nr. | Pa audituar Nr. | Audituar në vlerë | Pa audituar në vlerë |
| 2 | 01.07.2019-31.12.2019 | 65 | 9,325,226 | 7,430,200 | 1,895,026 | 26 | 39 | 8,189,926 | 1,135,300 |
| 3 | 01.01.2020-31.12.2020 | 57 | 10,398,749 | 8,796,911 | 1,601,837 | 27 | 30 | 8,759,494 | 1,639,255 |
| | **Gjithsej** | **122** | **19,723,975** | **16,227,111** | **3,496,863** | **53** | **69** | **16,949,420** | **2,774,555** |

-Grupi i auditimit, në vlerësim të riskut dhe materialitetit, ka vlerësuar për të audituar 53 procedura me fond limit 16,949 mijë lekë ose 85% të vlerës së prokuruar nga të cilat 26 procedura 6 mujorin e dytë të vitit 2019 me vlerë 8,189 mijë lekë (87% e fondit) si dhe 27 procedura për vitin 2020 me vlerë 8,759 mijë lekë (84% e fondit).

-Nga auditimi i dosjeve sipas planifikimit për auditim, rezultoi se KBV ka kryer procedurat në përputhje me legjislacionin për prokurimin publik si dhe udhëzimin përkatës. Në dosje është administruar kërkesa për nevojë sipas drejtorive/sektorëve përkatës. Në të gjitha rastet është mbajtur procesverbali për hartimin e fondit limit, duke dokumentuar mënyrën e përllogaritjes. Në të gjitha fazat e vlerësimit janë mbajtur procesverbalet nga Komisioni përkatës për OE të kualifikuar deri në vend të dhjetë. Në të gjitha rastet, punët/mallrat/shërbimet, janë marrë në dorëzim me komision. Faturat tatimore të shitjes janë të gjitha të firmosura nga titullari i AK, si dhe nga KBV. Nuk rezulton të ketë procedura prokurimi me fonde të copëzuar.

### III/2.4.4. Auditim mbi hartimin e projekteve, zbatimin e kontratave të punimeve në investimet publike, kolaudimi dhe marrja në dorëzim e punimeve të kryera, sipas kontratave të lidhura me operatorët ekonomike fitues.

Referuar të dhënave të regjistrit të procedurave të prokurimit të zhvilluara për periudhën 01.07.2019 – 31.12.2020, konstatohet se në fushën e investimeve publike janë gjithsej 52 procedura me kontrata të përfunduara me vlerë kontrate 645,533 mijë lekë, *nga të cilat*: për periudhën 01.07.2019 janë 35 procedura me vlerë kontrate 437,328 mijë lekë dhe për vitin 2020 janë 17 procedura me vlerë kontrate 208,205 mijë lekë.
Mbi bazën e materialitetit dhe kohës në dispozicion, janë vlerësuar për auditimin nga grupi **3** procedura me vlerë kontrate **104,688 mijë** lekë me TVSH ose 16.1% e kontratave të punëve publike të mbyllura. *Pasqyrat bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditmit, aneks III/2.4.4.1*
Nga kjo analizë, janë përzgjedhur për auditim tre objekte në bazë të vlerës së kontratës, si më poshtë:

| Nr. | Objekti | Kontraktori | Vlera e kontratës (me TVSH) |
|---|---|---|---|
| 1 | Rikonstruksion rruga Velipojë Plazh, Loti I-rë", Bashkia Shkodër | "N..." & "A..." | 31,876,487 |
| 2 | "Rikonstruksion rruga Velipojë Plazh, Loti II-të", Bashkia Shkodër | "C..." SHPK | 47,839,706 |
| 3 | "Rikonstruksion rruga Udha kryq", Bashkia Shkodër | "S..." & "S..." | 24,973,654 |

**<u>Nga auditimi i zbatimit të 3 kontratave u konstatua se:</u>**

***a.*** **Procedura me objekt: *"Rikonstruksion rruga Velipojë Plazh, Loti I-rë", Bashkia Shkodër***

| Zbatimi i Kontratës së Punimeve "Rikonstruksion rruga Velipojë Plazh, Loti I-rë", Bashkia Shkodër | | |
|---|---|---|
| **14.Lidhja e kontratës**<br>Nr. 3349/13 prot datë 24.05.2019 | **15.Vlera e kontratës (me TVSh)**<br>31,876,487 lekë<br>**BOE fitues "N..." SHPK & "A..." shpk** | **16.Likuiduar deri dt. 31.12.2020**<br>**31,857,076 lekë** |
| **17- Situacioni Përfundimtar dt. 16.02.2019**<br>**-Vlera me TVSh 31,857,076lekë**<br>**-Vlera pa TVSh 26,547,563 lekë** | **18.Afati i kontratës në dite**<br>Parashikuar 60 ditë, Zbatuar 60 ditë.<br>Fillimi punimeve: 27.05.2019<br>Përfundimi punimeve : 26.07.2019 | **19. Zgjatja e kontratës**<br>Nuk ka |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | | | | |
| **20**. **Mbikëqyrësi i punimeve**<br>“T...” SHPK | Licenca Nr.: MK 0919/10 | Kontrata nr. 6062/18, datë 24.05.2019 | Likuiduar<br>lekë | Pa likuiduar |
| **21**. **Kolaudatori i punimeve**<br>OE “H...” SHPK | Licenca Nr.: MK 3094/1 | Kontrata nr. 14113/5 prot., datë 09.09.2019 | Likuiduar (......lekë) | Pa likuiduar (........ lekë) |
| **22.Akt Kolaudimi**<br>Datë 18.09.2019 | **23.Akt i marrjes në dorëzim** dt. 18.09.2019 | | **24**. Fletë Hyrja Nr.... datë .................lekë<br>(për mallrat) | |

## 1. Titulli i gjetjes: *Diferenca në volume për punime të deklaruara të kryera, për zërat e punimeve B.4, B.6, B.7, B.8 dhe C.9 në rrugët nr.2, nr.3 dhe nr.4*

**Situata:**

*Projektpreventivi*

- Për këtë objekt, me Vendimin nr. 202, datë 16.05.2019 të Bashkisë Shkodër është miratuar deklarata e kryerjes së punimeve.

*Kontratat*

Objekti i mësipërm është kryer sipas kontratës për punë publike me nr. 3349/13 prot datë 24.05.2019 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkia Shkodër, dhe Bashkimit të Operatorëve Ekonomikë “N...” & “A...” SHPK. Vlera e kontratës është 31,876,487 lekë me TVSh. Afati i zbatimit të kontratës është përcaktuar periudha kohore 60 ditë (2 muaj) nga dita e dorëzimit të sheshit të ndërtimit.

Për mbikëqyrjen e punimeve të ndërtimit, është lidhur kontrata përkatëse e këtij shërbimi me shoqërinë “T...” SHPK.

Për kolaudimin e punimeve të ndërtimit, sipas aktit me nr. 14113/5 prot., datë 09.09.2019, është lidhur kontrata përkatëse e këtij shërbimi me OE “H...” SHPK.

Objekti është marrë në dorëzim në datën 18.09.2019 dhe është nënshkruar nga Kontraktori, Mbikëqyrësi i punimeve, Kolaudatori dhe Titullari i AK.

*Zbatimi i punimeve*

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion rezulton se punimet kanë nisur me datë 27.05.2019 dhe kanë përfunduar me datë 26.07.2019, ose brenda afatit kontraktuale të përfundimit të punimeve.

Nga auditimi i situacionit përfundimtar, projektit dhe preventivit bazë, preventivit të rishikuar, si dhe nga verifikimi në terren i punimeve të ndërtimit, lidhur me volumet e punës të situacionuara si dhe atyre të kryera në fakt, rezultuan diferenca në volume apo punime jo të kryera në përputhje me projektin e hartuar nga projektuesi e të miratuar nga Autoriteti Kontraktor, me pasojë dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore në vlerën **1,065,759 lekë pa TVSh**.

Nga auditimi i realizimit të punimeve në objekt, u konstatua se:

Ka patur diferenca në volume dhe çmime në zërat e punës “FV bordura betoni parafabrikat 15x30, çmimi”, “Shtresë stabilizanti t=10 cm për trupin e rrugës”, “Shtresë binderi t=4 cm”, “Shtresë asfaltobetoni t=3 cm” dhe “Kondravalvol ½””, për pasojë vlera e këtyre diferencave janë përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve.

**Kriteri:**

- Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimi”, i ndryshuar, Kreu III, neni 7 dhe neni 12.

- Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 "Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit" e konkretisht Kreu II, Pika 3.
- Kontratën e sipërmarrjes së punimeve sipas aktit me nr. 3349/13 prot datë 24.05.2019.
- Kontratën e shërbimit të mbikëqyrjes së punimeve sipas aktit me nr. 6062/18, datë 24.05.2019.
- Kontratën e shërbimit të kolaudimit të punimeve, sipas aktit me nr. 14113/5 prot., datë 09.09.2019

**<u>Ndikimi/Efekti:</u>**

Si pasojë e mangësive të mësipërme, është shkaktuar dëm ekonomik në fondet e Bashkisë Shkodër

**<u>Shkaku:</u>**

Neglizhencë nga ana e mbikëqyrësit dhe kolaudatorit të punimeve në verifikimin e zbatimit të Projektpreventivi

**<u>Rëndësia:</u> I lartë**

**<u>Rekomandimi:</u>**

Drejtoria e Financës në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike, Bashkia Shkodër të marrë masa për arkëtimin e vlerës prej **1,065,759** lekë pa TVSh nga BOE **"N..." & "A..." SHPK**, në cilësinë e sipërmarrësit të kontratës nr. 3349/13 prot datë 24.05.2019 me objekt *"Rikonstruksion rruga Velipojë Plazh, Loti I-rë",* duke ndjekur të gjitha procedurat administrative e ligjore në të gjitha shkallët e gjykimit, vlerë kjo e cila përfaqëson punimeve të pakryera.

**Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:**

1. **Znj. D.Q.** me detyrë mbikëqyrës i kontratës së sipërmarrjes;
2. **Znj. F.N.** me detyrë kolaudator i punimeve të përfunduara;

**2. Procedura me objekt "Rikonstruksion rruga Velipojë Plazh, Loti II-të", Bashkia Shkodër**

| **Zbatimi i Kontratës së Punimeve "Rikonstruksion rruga Velipojë Plazh, Loti II-të", Bashkia Shkodër** | | | | |
|---|---|---|---|---|
| **14.Lidhja e kontratës**<br>Nr. 3349/12 prot datë 22.05.2019 | **15.Vlera e kontratës (me TVSh)**<br>47,839,706 lekë<br>**OE fitues "C..." SHPK** | | **16.Likuiduar deri dt 31.12.2020**<br>**47,839,200 lekë** | |
| **17- Situacioni Përfundimtar dt 16.02.2019**<br>**-Vlera me TVSh 47,839,200 lekë**<br>**-Vlera pa TVSh 39,866,000 lekë** | **18.Afati i kontratës në dite**<br>Parashikuar 60 ditë, Zbatuar 60 ditë.<br>Fillimi punimeve: 23.05.2019<br>Përfundimi punimeve : 22.07.2019 | | **19. Zgjatja e kontratës**<br>Nuk ka | |
| | | | | |
| **20. Mbikëqyrësi i punimeve**<br>"T..." SHPK | Licenca<br>Nr: MK 0919/10 | Kontrata nr. 6062/16, datë 22.05.2019 | Likuiduar<br>lekë | Pa likuiduar |
| **21. Kolaudatori i punimeve**<br>OE "H..." SHPK | Licenca Nr: MK 3094/1 | Kontrata nr. 14114/5 prot., datë 19.08.2019 | Likuiduar (......lekë) | Pa likuiduar (........ lekë) |
| **22.Akt Kolaudimi**<br>Datë 28.08.2019 | **23.Akt i marrjes në dorëzim** dt 28.08.2019 | | **24.** Fletë Hyrja Nr.... datë .................lekë<br>(për mallrat) | |

**<u>2.</u> Titulli gjetjes:** *Diferenca në volume për punime të deklaruara të kryera, për zërat e punimeve I.B.4, I.C.7, II.C.7, III.B.4, III.C.7, IV.B.6+7+8 dhe IV.C.6.*

**<u>Situata:</u>**

*<u>Kontratat</u>*

Objekti i mësipërm është kryer sipas kontratës për punë publike me nr. 3349/12 prot datë 22.05.2019 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkia Shkodër dhe Operatorit Ekonomik "C..."

SHPK. Vlera e kontratës është 47,839,706 lekë me TVSh. Afati i zbatimit të kontratës është përcaktuar periudha kohore 60 ditë (2 muaj) nga dita e dorëzimit të sheshit të ndërtimit.
Për mbikëqyrjen e punimeve të ndërtimit, është lidhur kontrata përkatëse e këtij shërbimi me shoqërinë "T..." SHPK, me përfaqësues znj. D.Q..
Për kolaudimin e punimeve të ndërtimit, është lidhur kontrata përkatëse e këtij shërbimi me OE "H..." SHPK.
Objekti është marrë në dorëzim në datën 28.08.2019 dhe është nënshkruar nga Kontraktori, Mbikëqyrësi i punimeve, Kolaudatori dhe Titullari i AK.
*Zbatimi i punimeve*
Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion rezulton se punimet kanë nisur me datë 23.05.2019 dhe kanë përfunduar me datë 22.07.2019, ose brenda afatit kontraktual të përfundimit të punimeve.

Nga verifikimi në terren është konstatuar se pusetat vertikale të U... nuk janë realizuar sipas emërtimit në preventiv "Pusetë vertikale p/f 110*65 cm, mure b/a, kapak metalik me çelës", por janë realizuar totalisht metalike. Ky është zë i ri pune dhe duhej bërë negocimi i çmimit.
Nga auditimi i situacionit përfundimtar, projektit dhe preventivit bazë, preventivit të rishikuar, si dhe nga verifikimi në terren i punimeve të ndërtimit, lidhur me volumet e punës të situacionuara si dhe atyre të kryera në fakt, rezultuan diferenca në volume apo punime jo të kryera në përputhje me projektin e hartuar nga projektuesi e të miratuar nga Autoriteti Kontraktor, me pasojë dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore në vlerën **337,290 lekë pa TVSh**.
-Ka patur diferenca në volume dhe çmime në zërat e punës "FV bordura betoni parafabrikat 20x35, çmimi", "Pusetë vertikale p/f 110*65 cm, mure b/a, kapak metalik me çelës", "Shtresë stabilizanti+binder 4 cm+asfaltobeton 3cm", për pasojë vlera e këtyre diferencave janë përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve.
**Kriteri:**
- Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 "Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimi", i ndryshuar, Kreu III, neni 7 dhe neni 12.
- Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 "Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit" e konkretisht Kreu II, Pika 3.
- Kontratën e sipërmarrjes së punimeve sipas aktit me nr. 3349/12 prot datë 22.05.2019.
- Kontratën e shërbimit të mbikëqyrjes së punimeve sipas aktit me nr. 6062/16, datë 22.05.2019.
- Kontratën e shërbimit të kolaudimit të punimeve, sipas aktit me nr. 14114/5 prot., datë 19.08.2019

**Ndikimi/Efekti:**
Si pasojë e mangësive të mësipërme, është shkaktuar dëm ekonomik në fondet e Bashkisë Shkodër
**Shkaku:**
Neglizhencë nga ana e mbikëqyrësit dhe kolaudatorit të punimeve në verifikimin e zbatimit të Projektpreventivi, si dhe të grupit të marrjes së përkohshme në dorëzim
**Rëndësia: I lartë**

**Rekomandimi:**
Drejtoria e Financës në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike, Bashkia Shkodër të marrë masa për arkëtimin e vlerës prej **337,290** lekë pa TVSh nga OE **"C..." SHPK**, në cilësinë e sipërmarrësit të kontratës nr. 3349/12 prot datë 22.05.2019 me "Rikonstruksion rruga Velipojë Plazh, Loti II-të*"*, duke ndjekur të gjitha procedurat administrative e ligjore në të gjitha shkallët e gjykimit, vlerë kjo e cila përfaqëson punimeve të pakryera.
**Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi*:***

1. **Znj. D.Q.** me detyrë mbikëqyrës i kontratës së sipërmarrjes;
2. **Znj. F.N.** me detyrë kolaudator i punimeve të përfunduara;

### 3. Procedura me objekt: “Rikonstruksion rruga Udha kryq”, Bashkia Shkodër

<table>
<tr><th colspan="5">Zbatimi i Kontratës së Punimeve “Rikonstruksion rruga Udha kryq”, Bashkia Shkodër</th></tr>
<tr><td>14.Lidhja e kontratës<br>Nr. 1931/12 prot datë 10.04.2019</td><td colspan="2">15.Vlera e kontratës (me TVSh)<br>24,973,654 lekë.<br>BOE fitues “S...” SHPK & “S...” SHPK</td><td colspan="2">16.Likuiduar deri dt 31.12.2020<br>24,973,654 lekë</td></tr>
<tr><td>17- Situacioni Përfundimtar dt 16.02.2019<br>-Vlera me TVSh 24,973,654 lekë<br>-Vlera pa TVSh 20,811,378 lekë</td><td colspan="2">18.Afati i kontratës në dite<br>Parashikuar 120 ditë, Zbatuar 120 ditë.<br>Fillimi punimeve: 10.04.2019<br>Përfundimi punimeve : 09.08.2019</td><td colspan="2">19. Zgjatja e kontratës<br>Nuk ka</td></tr>
<tr><td></td><td colspan="2"></td><td colspan="2"></td></tr>
<tr><td>20. Mbikëqyrësi i punimeve<br>“D...” SHPK</td><td>Licenca Nr: MK 0919/10</td><td>Kontrata nr. 2364/14, datë 10.04.2019</td><td>Likuiduar lekë</td><td>Pa likuiduar</td></tr>
<tr><td>21. Kolaudatori i punimeve<br>OE “I...” SHPK</td><td>Licenca Nr: MK 3331/1</td><td>Kontrata nr. 14593/5 prot., datë 06.09.2019</td><td>Likuiduar (......lekë)</td><td>Pa likuiduar (........ lekë)</td></tr>
<tr><td>22.Akt Kolaudimi<br>Datë 15.09.2019</td><td colspan="2">23.Akt i marrjes në dorëzim dt 15.09.2019</td><td colspan="2">24. Fletë Hyrja Nr.... datë .................lekë<br>(për mallrat)</td></tr>
</table>

**3. Titulli gjetjes:** *Diferenca në volume për punime të deklaruara të kryera, për zërat e punimeve B.4+5+6, B.7, C.4 dhe D.5.*

**Situata:**

*Kontratat*

Objekti i mësipërm është kryer sipas kontratës për punë publike me nr. 1931/12 prot datë 10.04.2019 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkia Shkodër dhe Bashkimit të Operatorëve Ekonomikë “S...” SHPK & “S...” SHPK. Vlera e kontratës është 24,973,654 lekë me TVSh. Afati i zbatimit të kontratës është përcaktuar periudha kohore 120 ditë (4 muaj) nga dita e dorëzimit të sheshit të ndërtimit.

Për mbikëqyrjen e punimeve të ndërtimit, është lidhur kontrata përkatëse e këtij shërbimi me shoqërinë “D...” SHPK,.

Për kolaudimin e punimeve të ndërtimit, është lidhur kontrata përkatëse e këtij shërbimi me OE “I...” SHPK.

*Projektpreventivi*

- Për këtë objekt, me Vendimin nr. 147, datë 10.04.2019 të Bashkisë Shkodër është miratuar deklarata e kryerjes së punimeve.
- Projekti i zbatimit është hartuar nga “C...” SHPK në vitin 2017.

*Zbatimi i punimeve*

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion rezulton se punimet kanë nisur me datë 10.04.2019 dhe kanë përfunduar me datë 09.08.2019, ose brenda afatit kontraktual të përfundimit të punimeve.

Nga verifikimi i analizave të çmimit të miratuara nga grupi i punës i ngritur nga TAK me UB nr. 597, datë 26.06.2019, me përbërje R.G., V.B. dhe F.H., rezultoi se:

- Në zërat e rinj “FV saraçineska” (të diametrave të ndryshëm), në nënzërin “punëtori”, sasia e orëve të punës është marrë 4.75 op/njësi, ndërkohë që në manualin e çmimeve në fuqi, sasia maksimale për një zë të ngjashëm është 1.47 op/njësi;
- Në zërin “Pusetë kontrolli 1 x 1 x 1 m me b/a, kapak gize”, sasia e orëve të punës është marrë 20 op/njësi, ndërkohë që në manualin e çmimeve në fuqi, sasia maksimale për një zë të ngjashëm është 8 op/njësi.
- Në zërin “Lidhje me rrjetin ekzistues”, në nënzërin “material”, janë marrë rakorderi të ndryshme në vlerën 23,125 lekë, të padetajuar, kur në situacionin përfundimtar, saraçineskat e lidhjes me rrjetin ekzistues janë marrë veçmas.
Këto veprime janë në kundërshtim me UKM nr. 2, datë 13.05.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar, Kreu II, pika 8.3, sipas të cilës “*Çmimet jashtë kontratës caktohen sipas analizave teknike në fuqi, me vlerën ekonomike më të mirë*” dhe *ngarkon me përgjegjësi grupin e punës të ngritur për këtë qëllim.*

Nga auditimi i situacionit përfundimtar, projektit dhe preventivit bazë, preventivit të rishikuar, si dhe nga verifikimi në terren i punimeve të ndërtimit, lidhur me volumet e punës të situacionuara si dhe atyre të kryera në fakt, rezultuan diferenca në volume apo punime jo të kryera në përputhje me projektin e hartuar nga projektuesi e të miratuar nga Autoriteti Kontraktor, me pasojë dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore në vlerën **369,055 lekë pa TVSh**.
Ka patur diferenca në volume dhe çmime në zërat e punës “Shtresë stabilizanti t=10 cm + Shtresë binderi 40cm + Shtresë asfaltobetoni 3 cm”, “Struktura monolite betoni C 20/25”, “FV zhavorr në kanale + ngjeshje në shtresa çdo 25 cm” dhe “FV zhavorr në kanale + ngjeshje në shtresa çdo 25 cm”, për pasojë vlera e këtyre diferencave janë përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve.
**Kriteri:**
- Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimi”, i ndryshuar, Kreu III, neni 7 dhe neni 12.
- Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” e konkretisht Kreu II, Pika 3.
- Kontratën e sipërmarrjes së punimeve sipas aktit me nr. 1931/12 prot datë 10.04.2019.
- Kontratën e shërbimit të mbikëqyrjes së punimeve sipas aktit me nr. 2364/14, datë 10.04.2019.
- Kontratën e shërbimit të kolaudimit të punimeve, sipas aktit me nr. 14593/5 prot., datë 06.09.2019
**Ndikimi/Efekti:**
Si pasojë e mangësive të mësipërme, është shkaktuar dëm ekonomik në fondet e Bashkisë Shkodër.
**Shkaku:**
Neglizhencë nga ana e mbikëqyrësit dhe kolaudatorit të punimeve në verifikimin e zbatimit të Projektpreventivi, si dhe të grupit të marrjes së përkohshme në dorëzim.
**Rëndësia: I lartë**
**Rekomandimi:**
Drejtoria e Financës në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike, Bashkia Shkodër të marrë masa për arkëtimin e vlerës prej **369,055** lekë pa TVSh nga BOE **“S...” & “S...” SHPK**, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 1931/12 prot datë 10.04.2019 me “*Rikonstruksion rruga Udha kryq”,* duke ndjekur të gjitha procedurat administrative e ligjore në të gjitha shkallët e gjykimit, vlerë kjo e cila përfaqëson punimeve të pakryera
**Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi*:***
1. **V.T.,** me detyrë mbikëqyrës i kontratës së sipërmarrjes;
2. **I.S.**, me detyrë kolaudator i punimeve të përfunduara

**<u>Komente dhe sqarime</u>:** Sqarojmë se në kundërshtitë e paraqitura nga subjekti Bashkia Shkodër me shkresën nr. 4597/55, datë 16.7.2021 *(prot KLSH nr. 362/16, datë 21.7.2021)*, nuk gjejnë pasqyrim problematikat e konstatuara nga grupi i KLSH-së në zbatimin e kontratave, duke përjashtuar kundërshtitë e akteve të cilat janë reflektuar në fazën e Projektraport Auditmit, ku dhe janë pasqyruar.

*(Më hollësisht problemet janë trajtuar në faqen 164-174, të Projektraport Auditmit(*

**III/2.5. <u>Auditimi i zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimet e mëparshme</u>.**

*<u>- Hartimi i programit (Plan veprimit) me personat përgjegjës dhe respektimi i afatit prej 20 ditë për kthimin e përgjigjes për zbatimin e rekomandimeve.</u>*

Nga verifikimi rezulton se, KLSH ka dërguar në Bashkinë Shkodër rekomandimet e auditimit me shkresën e saj nr. 610/66 prot, datë 04.12.2020. Bashkia Shkodër për zbatimin e rekomandimeve të KLSH ka kthyer përgjigje me shkresën nr. 19475 prot., datë 23.12.2020 me objekt "Raportim mbi punën e kryer për zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH, në auditimin e fundit në Bashkinë Shkodër miratuar me vendimin e Kryetarit të KLSH-së", brenda afatit 20 ditor.

*<u>- Realizimi i programit (plan veprimi) e raportimi në KLSH për ecurinë e zbatimit të rekomandimeve brenda afatit 6 mujor.</u>*

Përfundimet e auditimit i janë dërguar subjektit të audituar Bashkisë Shkodër, me shkresën e Kryetarit të KLSH nr. 610/66 prot, datë 04.12.2020 dhe duhet të raportonte në KLSH brenda 6 muajve ose brenda datës 20.06.2019 (referuar nenit 30, pika 2 e ligjit nr.154 datë 27.11.2014 "Për funksionimin dhe organizimin e KLSH, për raportimin brenda 6 muajve nga marrja e njoftimit të RPA). Nga Bashkia Shkodër nuk është bërë raportimi brenda afatit 6 mujor.

*<u>- Mbi raportimin rregullisht në Këshillin Bashkiak të ecurisë të zbatimit të rekomandimeve të KLSH, siç përcaktohet në nenin 50 -Auditimi i jashtëm, pika 5, të ligjit nr. 68/2017, datë 27.04.2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore".</u>*

Përfundimet e auditimit i janë dërguar subjektit të audituar Bashkisë Shkodër, me shkresën e Kryetarit të KLSH nr. 610/66 prot, datë 04.12.2020. Rezulton se Bashkia Shkodër nuk ka raportuar në Këshillin Bashkiak për ecurinë e zbatimit të rekomandimeve sipas shkresës së mësipërme.

1. **Titulli i gjetjes:** *KLSH ka konstatuar se Bashkia Shkodër ka vijuar me zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm.*

**Situata:**

**A. Masa Organizative**

**<u>1.5.1.Rekomandim:</u>** Bashkia Shkodër, Drejtoria e Financës në bashkëpunim me Drejtorinë e Mjedisit dhe Pyjeve, të marrë masa për zbatimin e procedurave ligjore për inventarizimin, evidentimin dhe regjistrimin në Pasqyrat Financiare, të pronave, Pyje, kullota, plantacione.

**<u>Nga verifikimi rezultoi se:</u>**

Në zbatim të rekomandimit të KLSH-së, Bashkia Shkodër ka vijuar komunikimin me institucionet përkatëse. Korrespodenca me ASHK ka filluar me daljen e VKM-së nr. 433/2016 "Për transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve e kullotave publike sipas listës së inventarit dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e ish Komunave/Bashkive". Sipas shkresës nr. 5548/1 datë

06.07.2018 të K/Regjistruesit, Bashkia Shkodër është vënë në dijeni se *Regjistrimi i pronave Pyje/Kullota do të kryhet në kuadër të projektit të financiar nga Banka Botërore, SIDA dhe GEF "Për shërbimet mjedisore" i cili do të realizojë inventarin kombëtar të pyjeve dhe kullotave si dhe regjistrimin e tyre.*

Me shkresën nr. 11423 prot., datë 30.12.2019 *"Mbi procesin e regjistrimit fillestar të pasurive të të tipit pyje dhe kullota në pronësi të bashkisë"* MMT kërkon që Bashkia të kalojë për miratim pranë KB listën e rishikuar të fondit pyjor/kullosor të Bashkisë Shkodër, i miratuar me vendimin nr. 6, datë 22.01.2020 të KB, dhe me shkresën nr. 2346 prot., datë 05.02.2020 i është përcjellë Ministrisë së Turizmit e Mjedisit për lista e ndryshuar për procedura te mëtejshme.

Në vijim të këtyre procedurave, Këshilli i Ministrave ka miratuar vendimin nr. 684/2020 e cila bën ndryshimet e miratuara në listën e inventarit pyje/kullota të miratuara nga KB.

Me shkresën nr. 2450 prot., datë 20.08.2020, Drejtoria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, sugjeron Bashkinë Shkodër të veprojë me regjistrimin në pasqyrat financiare të fondit pyjor/kullosor. Kryetari i Bashkisë Shkodër, në vlerësim të kësaj shkrese dhe rekomandimit të KLSH, ka nxjerr urdhrin nr. 688, datë 27.08.2020 "Për ngritjen e grupit të punës për vlerësimin në vlerë financiare të sipërfaqeve pyjore/kullosore me qëllim kontabilizimin". Bazuar në relacionin e grupit të punës, Kryetari i Bashkisë ka nxjerr urdhrin nr. 235, datë 05.10.2020 të Kryetarit të Bashkisë Shkodër "Për regjistrimin në kontabilitet dhe në asetet e Bashkisë Shkodër të vlerës financiare dhe sipërfaqeve pyjore/kullosore të transferuara në pronësi të Bashkisë Shkodër me VKM nr. 433/2016......", ndryshuar me VKM. Nr. 684/2020.

Në vijim, Bashkia Shkodër ka vijuar korrespodencën me MMT, ku i kërkohet informacion për kontabilizimin e sipërfaqeve shkëmbore/inproduktive, dhe në përgjigje të saj MMT sqaron se kontabilizimi i tyre duhet bërë bazuar në vlerat mjedisore, ekologjike etj.

Në lidhje me regjistrimin e pyjeve dhe kullotave në Drejtorinë Rajonale Vendore ASHK Shkodër, është planifikuar realizimi i saj në kuadër të një projekti të financuar nga Banka Botërore, kjo sipas shkresës së ish ZQRPP me nr. 5548/1 prot., datë 06.07.2018.

**Statusi: Në proces zbatimi**

**2.6.1.Rekomandim:** Bashkia Shkodër, Drejtoria e Financës të marrë masa për sistemimin e vlerës 8,059,901 lekë, duke njoftuar subjektet për paraqitjen e dokumenteve, me qëllim sistemimin e vlerave përkatëse, sipas objekteve dhe subjekteve, si dhe të marrë masa për të derdhur sistemuar llogarinë 44 "Institucione të tjera publike" duke derdhur në buxhet të shtetit, vlerën prej 3,000 lekë.

**Nga verifikimi rezultoi se:**

Në zbatim të rekomandimeve të lëna nga KLSH-ja, Kryetari i Bashkisë Shkodër me urdhër përkatës është ngritur grupi i punës për kontrollin e objektit, dokumentacionit përkatës si dhe përgatitjen e Certifikatës Përfundimtare të marrjes në dorëzim të objekteve. Grupi i punës në bashkëpunim me drejtorin e financës ka bërë njoftimin e të gjithë Operatorëve Ekonomikë për paraqitjen e dokumentacionit për likuidimin e 5% "garanci punimesh". Me shkresën nr. 3911/b, datë 03.12.2020, është paraqitur relacioni përmbledhës i grupit të punës drejtuar Kryetarit të Bashkisë.

Me vendimin nr. 323, datë 10.12.2020 të Kryetarit të Bashkisë Shkodër, është vendosur *"Për kalimin e garancive 5% në favor të Bashkisë Shkodër dhe Buxhetit të Shtetit të kontratave të sipërmarrjes të realizuara nga ish Komunat",* për arsyet të statusit ***pasiv*** të këtyre subjekteve, mungesës së dokumentacionit tekniko-financiar etj. Në zbatim të këtij vendimi, drejtoria e financës ka hartuar urdhër shpenzimet për kalim në favor të Bashkisë Shkodër dhe të buxhetit të Shteti vlerat e 5% të garancisë së punimeve, disa prej të cilave janë refuzuar nga thesari (11 urdhër

shpenzime janë pranuar në vlerën 1,047,418, dhe 6 urdhër shpenzime janë refuzuar 119,843). Pas refuzimit të degës së thesarit, nuk është vijuar me urdhrat shpenzimesh për pjesën tjetër të vlerës. Gjithashtu nga drejtoria e financës është bërë sistemimi i llog. 44 "Institucione të tjera publike" në vlerën 3,000 lekë. (Bashkëlidhur mandat pagesa).

**Statusi: Në proces zbatimi**

**3.12.1.Rekomandimi:** Duke vlerësuar punën shumë të mirë të bërë në zbatimin e rekomandimeve, i rikërkojmë Kryetarit të Bashkisë Shkodër të hartojë plan pune të veçantë e të marrë të gjitha masat e duhura ligjore për zbatimin e rekomandimeve të pazbatuara të KLSH në auditimin e mëparshëm, dërguar nga KLSH me shkresën nr. 491/15, datë 30.11.2017 respektivisht :

-Për shpenzime në kundërshtim me principet e 3 E-" është rekomanduar që të analizohet në një masë në vlerën 9,758,551 lekë, si vlerë e përfituar për tre muaj, kur në fakt duhet të ishte përfituar për 7.33 muaj punë në objektin "Shërbimi pastrimit të mbetjeve urbane, Njësia administrative Velipojë".

**-** Të analizojë e nxjerrë përgjegjësinë për shpenzimet me blerje të vogla jo në përputhje me parimet e 3E, të cilat kanë sjellë efekte negative financiare në shpenzimet për mirëmbajtje ambientesh dhe pajisje zyrash në vlerën prej **60,938 lekë,** si dhe të evidentojë përgjegjësinë e anëtarëve të Komisionit me blerje të vogla.

- Për 17 masat të cilat nga auditimi kanë rezultuar të jenë në proces zbatimi, por përtej afateve të përcaktuara në shkresën përcjellëse 491/15, datë 30.11.2017 të auditimit të mëparshëm, të merren masa për përfundimin e zbatimit të tyre dhe njoftimin KLSH-së.

**1. 2.2.1 Rekomandim**: Nga Bashkia Shkodër, të merren masa duke ndjekur të gjitha procedurat e duhura administrative si dhe të gjitha shkallët e gjykimit arkëtimin e shumës **2,524,805 lekë,** sipas aneksit nr.2, bashkangjitur Raportit Përfundimtar të Auditimit, detyrime të pa arkëtuara nga kontratat e qirave.

**Nga verifikimi rezultoi se:**

Drejtoria juridike në zbatim të Urdhrit nr.849, datë 07.10.2019, të Titullarit të Bashkisë dhe planit të veprimit, i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër për kërkimin e detyrimit për subjektit "B..." pf, t'i paguaj paditësit B.SH masën e detyrimit kontraktor (qira mujore) të pashlyer:

- në vlerën 200,000 (dyqind mijë) lekë, për vitin 2017
- në vlerën 1,800,000 (një milion e tetëqind mijë) lekë, për vitin 2018.
- në vlerën 331,000 (dyqind mijë) lekë, për vitin 2019.

Aktualisht çështja ndodhet në Gjykatën e Apelit Shkodër, pasi Gjykata rrethit gjyqësor Shkodër me vendimin nr.1477 datë 17.12.2019 vendosi:

- Pranimin e pjesshëm të kundërpadisë në pjesën e konvertimit të shumës të detyrimeve kontraktore mes kundër paditësit B... dhe të kundër paditurit Bashkia Shkodër.

-Detyrimin e kundër paditësit B... të dëmshpërbleje të kundër padituren Bashkia Shkodër në shumen e mbetur nga konvertimi, detyrim qereje ne shumen prej 1 736 976 lekë, shume e cila do të paguhet me këste me nga 50 000 lekë/muaj duke filluar nga data 01.02.2020.

-Bashkia Shkodër ka ushtruar ankim brenda afateve ligjore të njoftimit me shkresën nr.1326 prot dt.22.01.2020 pranë Gjykatës se Apelit Shkodër.

**Statusi: Në proces zbatimi**

**2. 3.3.1. Rekomandim**: Nga Bashkia Shkodër të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **731,549 lekë pa TVSH,** nga BOE "S..." & "S..." SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 4032/15, datë 22.06.2017, me objekt "Rikonstruksion Rruga e Shirqit", Bashkia Shkodër, vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.

**Nga verifikimi rezultoi se:**
Kryetari i Bashkisë Shkodër në zbatim të detyrimeve të konstatuar nga KLSH-ja dhe sipas kontratës së sipërmarrjes me nr. 4032/15, datë 22.06.2017, ka nxjerr Vendimin nr. 215 date 05.11.2019, "Për kontabilizimin e detyrimeve" si dhe "Kërkimin në rrugë administrative dhe gjyqësore shlyerjen e dëmit ekonomik në vlerën **731,549 lekë**", nga BOE "S..." & "S..." SHPK. Me shkresën nr. 19143 prot date 07.11.2019, është njoftuar BOE "S..." & "S..." SHPK, për ekzekutimin në mënyrë vullnetare të detyrimit të konstatuar nga KLSH-ja. Në kushtet e mos likuidimit të detyrimet Drejtoria Juridike i është drejtuar Gjykatës Administrative të shkallës së Parë Shkodër për kërkimin e detyrimit sipas kërkesë padi nr.5902 datë 27.04.2020. Deri në datën e verifikimit 21.08.2020, çështja ndodhet në gjykim.

**Statusi: Në proces zbatimi**

**3. <u>4.4.1. Rekomandim</u>:** Nga Bashkia Shkodër të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **243,320 lekë pa TVSH** nga OE "P..." SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 13306/33, datë 15.05.2017, me objekt "Zbatim Rikualifikim Urban blloqe banimi "Tepe-tek Fusha e Druve", Bashkia Shkodër, vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.

**Nga verifikimi rezultoi se:**
Kryetari i Bashkisë Shkodër në zbatim të detyrimeve të konstatuar nga KLSH-ja dhe sipas kontratës së sipërmarrjes me nr. 13306/33, datë 15.05.2017, ka nxjerr Vendimin nr. 215 date 05.11.2019, "Për kontabilizimin e detyrimeve" si dhe "Kërkimin në rrugë administrative dhe gjyqësore shlyerjen e dëmit ekonomik në vlerën **243,320 lekë**", nga OE "P..." SHPK . Me shkresën nr. 19145 prot date 07.11.2019, është njoftuar OE "P..." SHPK , për ekzekutimin në mënyrë vullnetare të detyrimit të konstatuar nga KLSH-ja. Në kushtet e mos likuidimit të detyrimet drejtoria juridike i është drejtuar Gjykatës Administrative të shkallës së Parë Shkodër për kërkimin e detyrimit sipas kërkesë padi nr.5903 datë 27.04.2020. Deri në datën e verifikimit 21.08.2020, çështja ndodhet në gjykim.

**Statusi: Në proces zbatimi**

**4. <u>5.5.1. Rekomandim</u>:** Nga Bashkia Shkodër të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **262,860 lekë pa TVSH,** nga OE "S..." SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 4697/15, datë 31.08.2018, me objekt "Sistemim asfaltim rruga Qendër Mes-Qendër Dragoç", Bashkia Shkodër, vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.

**Nga verifikimi rezultoi se:**
Kryetari i Bashkisë Shkodër në zbatim të detyrimeve të konstatuar nga KLSH-ja dhe sipas kontratës së sipërmarrjes me nr. 4697/15, datë 31.08.2018, ka nxjerr Vendimin nr. 215 date 05.11.2019, "Për kontabilizimin e detyrimeve" si dhe "Kërkimin në rrugë administrative dhe gjyqësore shlyerjen e dëmit ekonomik në vlerën **262,860 lekë**", nga OE "S..." SHPK.. Me shkresën nr. 19144 prot date 07.11.2019, është njoftuar OE "S..." SHPK, për ekzekutimin vullnetar të detyrimin. Nga ana e OE "S..." SHPK është bërë kundërshtimi i detyrimit në Gjykatës Administrative të shkallës së Parë Shkodër sipas kërkesë padi së ardhur në datë 26.11.2019. Deri në datën e verifikimit 21.08.2020, çështja ndodhet në gjykim. (Bashkëlidhur praktika përkatëse)

**Statusi: Në proces zbatimi**

**5. <u>1.1.1. Rekomandim</u>:** Bashkia Shkodër, nëpërmjet Drejtorisë së të Ardhurave të marrë masa si dhe të ndjekë të gjitha procedurat administrative dhe ligjore për arkëtimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë për ndërtimet pa leje në vlerën **235,048,927 lekë**.

**<u>Nga verifikimi rezultoi se</u>:**

Nga ana e Drejtorisë së të Ardhurave është bërë njoftimin për likuidim të detyrimeve të prapambetura në total 2403 subjekteve në qershor 2019 si dhe është dërguar mediave me njoftim zyrtar me numër 1609 Prot. date 27.01.2020 thirrja për banoret e Bashkisë Shkodër për paraqitjen pranë sporteleve të Drejtorisë së të Ardhurave. Pas veprimeve të sipërcituara është hartuar urdhri i bllokimit të llogarive bankare të gjitha bankave të nivelit të dytë me shkresën nr. 4541 prot datë 11.03.2020, si dhe urdhër bllokim llogarie për individ nr. 1449 prot., datë 14.10.2020.

| Nr. | Natyra e debitorëve | Rekomanduar KLSH, debitor 18.08.200 | | Arkëtuar deri 31.12.2020 | | Debitorë me 31.12.2020 | | Shkresa nr. datë e njoftimit |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | Person | Lekë | Persona | Lekë | Preso | Lekë | Dërguar faturat për Arkëtim U. Bllokimi |
| 1 | Bashkia Shkodër | | | | | | | |
| 1/1 | Taksa e ndikimit në infrastrukturë | 890 | 229,195,866 | 64 | 8,815,211 | 826 | 220,380,655 | Urdhër bllokim llogarie për individ, nr. 14495 prot., datë 14.10.2020 |

*Shënim: Burim i të dhënave Bashkia Shkodër*.

Nga vlera e rekomanduar nga KLSH për **890 persona** debitorë të taksës së ndikimit në infrastrukturë në vlerën totale **229,195,866 lekë,** deri më datën 31.12.2020 është arkëtuar shuma prej **8,815,211** lekë ose në masën 3.8 % duke mbetur debitorë deri në datën 31.12.2020, në shumën **220,380,655 lekë.**

**Statusi: Në proces zbatimi**

**6. <u>2.2.1 Rekomandim</u>:** Drejtoria e të Ardhurave, Bashkia Shkodër, të marrë masat duke ndjekur të gjitha rrugët administrative e ligjore për arkëtimin detyrimeve të pa arkëtuara të subjekteve fizik/juridik, për të gjitha detyrimet tatimore të pa mbledhura ndaj **4195 subjekteve për vlerën 543,695,300 lekë** (sipas pasqyrave që disponon, marrë në CD), bazuar në nenin 70 pika 3 "E drejta për të nxjerrë njoftimin e vlerësimit tatimor", të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 "Për Procedurat tatimore" me ndryshime, duke ndjekur rrugët e mëposhtme:

-T'u dërgohen bankave të nivelit të dytë urdhër bllokimet e llogarive bankare, sipas nenit 90, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë";

-Të dërgohet në Drejtorinë Rajonale të Transportit, kërkesa për vendosjen e barrës siguruese (për mjetet) dhe në ZVRPP (për pasuritë e paluajtshme), sipas nenit 91, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 "Për procedurat tatimore Republikan e Shqipërisë" me ndryshime;

-Në funksion të mbledhjes së detyrimit të papaguar, Drejtoria e Tatimeve, Tarifave Vendore dhe Mbledhjes së të Ardhurave, të angazhojë strukturat e saj për të verifikuar dhe monitoruar në vend aktivitetin tregtar të tatim paguesit, me qëllim konfiskimin në fund të çdo dite të një shume jo më pak se 50 % të qarkullimit të realizuar;

-Nëse edhe pas njoftimeve zyrtare Bizneset, nuk pranojnë të paguajnë detyrimet, në vite nga ana e Drejtorisë së Tatimeve, Tarifave Vendore dhe Mbledhjes së të Ardhurave dhe Drejtoria Juridike, të marrin masa administrative apo sekuestro dhe pas marrjes së këtyre masave të bëhet kallëzim penal, bazuar në Kodin Penal të R.SH, miratuar me ligjin nr. 7895, datë 27.1.1995 me ndryshimet e mëvonshme, neni 181 "Mospagimi i taksave dhe tatimeve".

**<u>Nga verifikimi rezultoi se</u>:**

Nga zyra e taksave dhe tarifave vendore është bërë njoftimin për likuidim të detyrimeve të prapambetura të biznesit të vogël dhe biznesit të madhe, në total 4057 subjekteve. Nga të cilat u është dërguar urdhër bllokim për llogarite bankare 4195 subjekte sipas shkresave numër 20335 Prot . date 25.11.2019, nr. Prot. 203311-20339 date 25.11.2019, nr. 20309-20317 Prot. date 25.11.2019, nr. 20354-20366 date 25.11.2019, Nr. 20684-20693 date 02.12.2019 etj., si dhe është vendosur barra siguruese dhe hipotekore mbi pasurinë e tatim paguesit për subjektet qe i janë bllokuar me pare llogarite por nuk është kthyer përgjigje nga ASHK (Agjencia Shtetërore e

Kadastrës) për veprime të marra nga ana e tyre.
Për detyrimet për taksat dhe tarifat vendore për vitin 2020 gjithë subjektet tregtare janë njoftuar në lidhje me detyrimet në muajin mars në rruge zyrtare me shërbim postar.

| Nr. | Natyra e debitorëve | Rekomanduar KLSH debitorë 18.08.2020 | | Arkëtuar deri 31.12.2020 | | Debitorë me 31.122020 | | Shkresa nr. Date e njoftimit |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | Lekë | | Lekë | | Lekë | Dërguar faturat për Arkëtim U. Bllokimi |
| 1 | Bashkia Shkodër | | | | | | | |
| | Debi biznes vogël + biznes i madh | 4057 | 525,604,148 | 394 | 13,359,410 | 3663 | 512,244,738 | |

*Shënim: Burim i të dhënave Bashkia Shkodër.*

Nga vlera e rekomanduar nga KLSH për 4057 subjekte debitorë të biznesit të vogël dhe biznesit të madh në vlerën totale 525,604,148 **lekë,** deri më datën 31.12.2020 është arkëtuar shuma prej **13,359,410** lekë ose në masën 2.5 % duke mbetur debitorë deri në datën 31.12.2020, në total në shumën **512,244,738 lekë.**

**Statusi: Në proces zbatimi**

**7. <u>3.3.1 Rekomandim</u>**: Drejtoria e të Ardhurave, Bashkia Shkodër në bashkërendim me U... Shkodër, të marrë masa dhe të kërkojë arkëtimin debitorëve për **37302 familje për vlerën gjithsej 351,468,284 lekë,** sipas të dhënave të disponon, duke dërguar njoftim vlerësimet abonentëve familjarë me postë, për:
-Taksë toke në vlerën 12,917,007 lekë;
-Taksë ndërtese në vlerën 129,754,321 lekë;
-Taksë trualli në vlerën 3,516,124 lekë;
-Tarifa shërbimi në vlerën 205,280,832 lekë.

**<u>Nga verifikimi rezultoi se</u>**:
Nga zyra e taksave dhe tarifave vendore Sektori Familjar është bërë njoftimin për likuidim të detyrimeve të prapambetura të familjareve për taksen e ndikimit ne infrastrukture, në total 2403 subjekteve/familjare. Nga të cilat u është dërguar urdhër bllokim për llogarite bankare 2403 subjekteve/familjare si dhe është vendosur barra siguruese dhe hipotekore mbi pasurinë e tatim paguesit sipas shkresës numër 19534 Prot. date 13.11.2019 për të cilën Bashkia Shkodër ska marre asnjë përgjigje nga ASHK (Agjencia Shtetërore e Kadastrës).

| Nr. | Natyra e debitorëve | Rekomanduar KLSH | | Arkëtuar deri 31.12.2020 | | Debitorë me 18.08.2020 | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | Person | Lekë | Person a | Lekë | Preso | Lekë |
| 1 | Bashkia Shkodër | | | | | | |
| 1/1 | Taksë toke | 5,280 | 6,730,025 | 24 | 183,992 | 5,256 | 6,546,033 |
| 1/2 | Takse ndërtesë | 14,998 | 102,150,015 | 100 | 2,621,221 | 14,898 | 99,528,794 |
| 1/3 | Takse trualli | 15,625 | 2,918,574 | 275 | 96,506 | 15,350 | 2,822,068 |
| 1/4 | Tarifa shërbimi | 16,954 | 186,788,757 | 357 | 4,750,855 | 16,597 | 182,037,902 |
| | **Gjithsej** | **16,954** | **298,587,371** | **357** | **7,652,574** | **16,597** | **290,934,797** |

*Shënim: Burim i të dhënave Bashkia Shkodër***.**

Nga vlera 298,587,371 lekë e rekomanduar nga KLSH, janë likuiduar deri me 31.12.2020 në total 7,652,574 lekë ose 2.5 % duke mbetur debitorë deri në datën 31.12.2020, në total në shumën **290,934,797 lekë.**

**Statusi: Në proces zbatimi**

**B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI**

**<u>1.1.1.Rekomandim</u>:** Nga Bashkia Shkodër, të merren masa duke ndjekur të gjitha procedurat e duhura administrative si dhe të gjitha shkallët e gjykimit për arkëtimin e shumës **8,000,000 lekë**, detyrime të pa arkëtuara nga mos likuidimi i licencës së tregtimit me pakicë të karburanteve.

**Nga verifikimi rezultoi se:**

-Me shkresën nr.11715, date 18/08/2020, është njoftuar subjekti "E..." për shlyerjen e detyrimit;
-Me shkresën nr.11715, date 18/08/2020, është njoftuar subjekti "A..." për shlyerjen e detyrimit;
-Me shkresën nr.11715, date 18/08/2020, është njoftuar subjekti "L..." për shlyerjen e detyrimit;
-Me shkresën nr.11715, date 18/08/2020, është njoftuar subjekti "J..." për shlyerjen e detyrimit;
-Me shkresën nr.11715, date 18/08/2020, është njoftuar subjekti "L..." për shlyerjen e detyrimit;
-Me shkresën nr.11715, date 18/08/2020, është njoftuar subjekti “L...” për shlyerjen e detyrimit;
-Me shkresën nr.11715, date 18/08/2020, është njoftuar subjekti "D..." për shlyerjen e detyrimit;
-Me shkresën nr.11715, date 18/08/2020, është njoftuar subjekti "A..." për shlyerjen e detyrimit.

Në vijim të njoftimeve për shlyerjen e detyrimeve të mësipërme, janë likuiduar tarifat për 3 pika të tregtimit të karburanteve me pakicë, konkretisht 2 fatura likuidimi për subjektin “L...” shpk në vlerën 2,000,000 lekë, dhe 1 tarifë likuidimi për subjektin “L...” shpk në vlerën 1,000,000 lekë. Për 5 subjektet tjera, Bashkia Shkodër është mjaftuar vetëm me njoftimin e subjektit, duke mos kryer asnjë veprim tjetër për të bërë të mundur arkëtimin e vlerës së mbetur prej 5,000,000 lekë.

**Statusi: Në proces zbatimi**

**<u>Kriteri</u>:**
Ligji Nr. 154, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” neni 15, “Të drejtat e KLSH”, germa j), **S**hkresa Nr. 610/60 prot, datë 04.12.2020 “Për zbatimin e rekomandimeve në auditimin e kryer në Bashkinë Shkodër”.

**<u>Shkaku</u>:**
Mos ndjekja e gjitha procedurave për të bërë të mundur arkëtimin e vlerës 5,000,000 lekë.

**Ndikimi/Efekti:** Ndikon në të ardhurat e buxhetit të Bashkisë Shkodër.

**Rëndësia:** *E Mesme*

**Rekomandimi:**
Kryetari i Bashkisë Shkodër të analizojë situatën e mos zbatimit plotësisht të rekomandimeve të dërguara nga KLSH-ja me shkresën nr. 610/66 prot, datë 04.12.2020, duke nxjerrë përgjegjësitë e personave përgjegjës, si dhe të hartojë plan pune të veçantë e të marrë të gjitha masat e duhura ligjore për rizbatimin e plotë të tyre, respektivisht:

a-Për **7** masa organizative me vlerë **1,027,797 mijë lekë**, konkretisht për pikat;
b-Për **1** masë shpërblim dëmi në **vlerën 8,000 mijë lekë.**

*(Më hollësisht problemet janë trajtuar në faqen 174-181, të Projektraport auditimit)*

## III/2.6. <u>Mbi zbatimin e kërkesave të ligjit 107/2014 "Për Planifikimin Dhe Zhvillimin E Territorit" i Ndryshuar.</u>

1. **Titulli gjetjes:** *Miratimi i lejeve të zhvillimit. - nr. Prot. 7808/2, datë 07.07.2020 dhe lejes së ndërtimit nr. Prot 11938/5 datë 17.12.2020 me objekt "Objekt banimi dhe shërbime 6 dhe 7 kate me bodrum)"; - nr. Prot 5699/2, datë 30.04.2020 dhe lejes së ndërtimit nr. Prot 6170/5 datë 22.05.2020 me objekt "Qendër Kulturore Polifunksionale" dhe - nr.prot.11780 datë 05.07.2019 dhe lejes së ndërtimit nr. Prot 15522 datë 13.09.2019 me objekt "Banesë 2 kate + bodrum".*

**Situata:**

***Leja e zhvillimit nr.prot.7808/2, datë 07.07.2020 dhe lejes së ndërtimit nr. Prot 11938/5 datë 17.12.2020 me objekt "Objekt banimi dhe shërbime 6 dhe 7 kate me bodrum)".***

*I/II- Dhënia e Lejes së Ndërtimit, krahasimi si dhe zbatimi i treguesve parametrik*

Në përfundim të shqyrtimit teknik të dosjes, raportit teknik dhe pagesës së Taksës së Ndikimit në Infrastrukturë, është marrë vendimi nr.320 datë 03.12.2020 dhe është bërë lajmërimi i aplikuesit për lejen e ndërtimit me nr. Prot 11938/5 *datë 17.12.2020* dhe lejen e zhvillimit nr7808/2, datë 07.07.2020në nënnjësisë strukturore (pasaporta) SH026.UB-4 për "Objekt banimi dhe shërbime 6 dhe 7 kate me bodrum", paraqitur nga zhvilluesit dhe ndërtuesi shoqërinë "E..." SHPK, projektuar nga "T..." e përfaqësuar nga arkitekti T.D., miratuar nga Kryetari i Bashkisë Shkodër zj. V.A.

Në Rregulloren e Planit të Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Shkodër të miratuar me Vendimit nr.27, datë 20.04.2017 të Këshillit Kombëtar të Territorit "Për miratimin e Planit të Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Shkodër" janë përcaktuar njësitë strukturore të qytetit të Shkodër me treguesit parametrik (lartësia maksimale e ndërtimit, numri i kateve, KSHT, KSHP, KSHR, Intesiteti etj.) të aplikueshëm në secilën njësi. Në tabelën e mësipërme kemi hedhur të dhënat për në nënnjësisë strukturore (pasaporta) SH026.UB-4 si dhe të dhënat e planvendosjen dhe projektit arkitektonik të miratuar nga Kryetari i Bashkisë Shkodër si dhe nga Arkitekt T.D. . Gjithashtu pasi është bërë vlerësimi i plan-vendosjes dhe janë matur distancat në Autocad Map,.

***Fig.1. Plani i vendosjes së strukturave për lejen zhvillimi nr. 7808/2, datë 07.07.2020 dhe lejes së ndërtimit nr. Prot 11938/5 datë 17.12.2020 me objekt "Objekt banimi dhe shërbime 6 dhe 7 kate me bodrum distancat nga objektet përreth.***

***Distancat minimale midis ndërtimeve***

Nisur dhe nga Fig.1 për sa i përket rrethimit të pronës nga objekte të tjera, theksojmë se ajo kufizohet;

- *Në veri nga ndërtes 1 katëshe*
- *Në jug nga ndërtes 1 katëshe*
- *Në lindje nga dy ndërtes , 1 dhe 2 katëshe*

Distanca në veri, për të cilën kufizimi është 3.8 metra dhe 1.3 metër në lindje, është projektuar duke pasur parasysh nenin 34 pika 3 ku citohet për të cilën është identifikuar mospërputhja ligjorë e objektit ndaj objekteve kufizuese është me ndërtesën 1 katëshe në veri . Sipas planvendosjen, distanca është 3.8 metra. Sipas përcaktimeve të VKM nr. 408, datë 13.05.2015 "Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit" të ndryshuar, neni 34 pika 2 ku citohet : "Distanca minimale për faqet pa dritare dhe pa çarje fasade të çdo lloji tjetër, të cilat ndodhen përballë njëra-tjetrës dhe për të cilat nuk sigurohet deklaratë e të dyja palëve për kallkan, në kushtet e mos cenimit të sigurisë

së secilit objekt duhet të jetë jo më ***pak 2 (dy) metra***, ku secila ndërtesë mbart detyrimin për respektimin e distancës jo më pak se 1 (një) metër nga kufiri i pronës"

Miratimi i lejes është bërë bazuar në dokumentacionin e kërkuar nga neni 15 i VKM 408 datë 13.05.2015 "Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit" të ndryshuar, megjithatë projektet arkitektektonik , strukturor si dhe çdo projekt për të cilën jep opinion Instituti i Ndërtimit, nuk është paraqitur nga zhvilluesi Oponenca Teknike. Kjo kërkesë është kusht i domosdoshëm për projekte me vlerë të preventivuar mbi 100 milion të reja, siç është dhe rasti konkret me zhvillues "E... SHPK", bazuar në nenin 6 të ligjit nr.8402 datë 10.09.1998 i ndryshuar.

***Leja e zhvillimit nr. Prot. 5699/2, datë 30.04.2020 dhe lejes së ndërtimit nr. Prot 6170/5 datë 22.05.2020 me objekt "Qendër Kulturore Polifunksionale".***

Në përfundim të shqyrtimit teknik të dosjes, raportit teknik dhe pagesës së Taksës së Ndikimit në Infrastrukturë, është marrë vendimi nr.100 datë 20.05.2020 dhe është bërë lajmërimi i aplikuesit për lejen e ndërtimit me nr. Prot 6170/5*datë 22.05.2020* dhe lejen e zhvillimit nr. 6170/5 datë 22.05.2020 në nënnjësisë strukturore (pasaporta) SH028.UB-10 për "Qendër Kulturore Polifunksionale", paraqitur nga zhvilluesit "V..." dhe ndërtuesi shoqërinë "V..." SHPK, projektuar nga arkitekti F.H., miratuar nga Kryetari i Bashkisë Shkodër V.A.

Në Rregulloren e Planit të Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Shkodër të miratuar me Vendimit nr.27, datë 20.04.2017 të Këshillit Kombëtar të Territorit "Për miratimin e Planit të Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Shkodër" janë përcaktuar njësitë strukturore të qytetit të Shkodër me treguesit parametrik (lartësia maksimale e ndërtimit, numri i kateve, KSHT, KSHP, KSHR, Intesiteti etj.) të aplikueshëm në secilën njësi. Në tabelën e mësipërme kemi hedhur të dhënat për në nënnjësisë strukturore (pasaporta) SH028.UB-10 si dhe të dhënat e planvendosjen dhe projektit arkitektonik të miratuar nga Kryetari i Bashkisë Shkodër si dhe nga Arkitekt F.H. . Gjithashtu pasi është bërë vlerësimi i plan-vendosjes dhe janë matur distancat në Autocad Map,

***Fig.1. Plani i vendosjes së strukturave për lejen zhvillimi nr. 5699/2, datë 30.04.2020 dhe lejes së ndërtimit nr. Prot 6170/5 datë 22.05.2020 me objekt "Qendër Kulturore Polifunksionale"***

***Distanca e gjurmës së ndërtimit nga kufijtë e pronës***

*a) Distanca e gjurmës së ndërtimit nga kufiri verior dhe lindor i pronës*

Siç mund të shihet dhe në Tabelën 1. të mësipërme, si dhe nga matjet në programin Autocad MAP 3D të distancës së objektit nga kufiri i verior dhe lindor i pronës, ka rezultuar se kjo distancë ka qenë 1 metër nga kufiri verior i pronës. Fasadat nga ana veriore dhe lindore e objektit, referuar projektit konstruktiv, janë fasada kallkan. Duke qenë të tilla, kjo distancë është bazuar në nenin neni 34 pika 4 e VKM 408 datë 13.05.2015 "Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit" të ndryshuar .

Nisur dhe nga Fig.1 për sa i përket rrethimit të pronës nga objekte të tjera, theksojmë se ajo kufizohet;

- *Në veri nga ndërtes 2 katëshe*
- *Në jug nga ndërtes 3 katëshe*
- *Në lindje nga dy ndërtesa , 3 dhe 3 katëshe*

Distanca nga ndërtesat, referuar plan vendosjes së miratuar, janë respektivisht

- në veri 19 metër
- në jug 20.2 metër
- në lindje 21.2 metër

pra respektojnë formulën e përcaktuar në VKM nr. 408, datë 13.05.2015 "Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit" të ndryshuar, neni 34 pika 2 ku citohet : Distanca minimale

e lejuar midis dy ndërtimeve do të matet me shumën e numrit të kateve mbi tokë të ndërtimeve që përballen plus 2m, sipas formulës më poshtë: **d = nr. k obj.A + nr. k obj.B +2m**, ku:
d - distanca minimale midis dy ndërtimeve dhe
nr. k - numri i kateve

*Megjithatë nga ana e Bashkisë Shkodër, nuk është marrë në shqyrtim fakti që brenda truallit që po zhvillohet, ekziston një ndërtesë, në pronësi të vet zhvilluesit "V...", referuar vërtetimit hipotekor, dhe duhej të jepej një deklaratë nga po vet zhvilluesi për lejimin e ndërtimit të ri në kufij me ndërtesën egzistuese.*

***Leja e zhvillimit nr.prot.11780 datë 05.07.2019 dhe lejes së ndërtimit nr. Prot 15522 datë 13.09.2019 me objekt "Banesë 2 kate + bodrum".***

Në përfundim të shqyrtimit teknik të dosjes, raportit teknik dhe pagesës së Taksës së Ndikimit në Infrastrukturë, është marrë vendimi nr.395 datë 13.09.2019 dhe është bërë lajmërimi i aplikuesit për lejen e ndërtimit me nr. Prot 15522 *datë 13.09.2020* dhe lejen e zhvillimit nr. 11780 datë 05.07.2019 në nënnjësisë strukturore (pasaporta) SH002.UB për "Banes 2 kate + Bodrum", paraqitur nga zhvilluesit A.P. dhe L.P. dhe ndërtuesi shoqërinë " M.K. " SHPK, projektuar nga arkitekti E.K., miratuar nga Kryetari i Bashkisë Shkodër zj. V.A.

Në Rregulloren e Planit të Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Shkodër të miratuar me Vendimit nr.27, datë 20.04.2017 të Këshillit Kombëtar të Territorit "Për miratimin e Planit të Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Shkodër" janë përcaktuar njësitë strukturore të qytetit të Shkodër me treguesit parametrik (lartësia maksimale e ndërtimit, numri i kateve, KSHT, KSHP, KSHR, Intesiteti etj.) të aplikueshëm në secilën njësi. Në tabelën e mësipërme kemi hedhur të dhënat për në nënnjësisë strukturore (pasaporta) SH002.UB si dhe të dhënat e planvendosjen dhe projektit arkitektonik të miratuar nga Kryetari i Bashkisë Shkodër si dhe nga Arkitekt E.K. . Gjithashtu pasi është bërë vlerësimi i plan-vendosjes dhe janë matur distancat në Autocad Map,

***Fig.1. Plani i vendosjes së strukturave për lejen zhvillimi nr. 11780 datë 05.07.2019 dhe lejes së ndërtimit nr. Prot 15522 datë 13.09.2019 me objekt "Banes 2 kate + Bodrum"***

***1) Distanca e gjurmës së ndërtimit nga kufijtë e pronës***

*a) Distanca e gjurmës së ndërtimit nga kufiri verior i pronës*

Siç mund të shihet dhe në Tabelën 1. të mësipërme, si dhe nga matjet në programin Autocad MAP 3D të distancës së objektit nga kufiri i verior i pronës, ka rezultuar se kjo distancë ka qenë 2.2 metër nga kufiri verior i pronës. Distanca minimale sipas nenit 35 të VKM nr. 408, datë 13.05.2015 "Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit" dhe pikës 3.4.3 të Rregullores së Planit të Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Shkodër duhet të ishte : **d= nr. k +1m= 2 +1 = 3 metra**

**Kriteri:**

Ky veprim është bërë në kundërshtim me nenin 35 të VKM nr. 408, datë 13.05.2015 "Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit" të ndryshuar.

Ligjin Nr.107 datë 31.07.2014 "Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit" të ndryshuar, nenet 34 dhe 35 të VKM nr. 408, datë 13.05.2015 "Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit" të ndryshuar si dhe në kundërshtim me përcaktimet e Planit të Përgjithshëm vendor të Bashkisë Shkodër

**Ndikimi/Efekti:**

Miratimi i këtyre lejeve në kundërshtim me ligjin Nr.107 datë 31.07.2014 "Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit" të ndryshuar, nenet 34 dhe 35 të VKM nr. 408, datë 13.05.2015 "Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit" të ndryshuar nga Kryetari i Bashkisë Shkodër

nuk ka siguruar zhvillimin e qëndrueshëm të territorit duke mos krijuar kushte të përshtatshme e të drejta dhe shanse të barabarta për banim

**Shkaku:**

Mos respektimi i përcaktimeve të Ligjin Nr.107 datë 31.07.2014 "Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit" të ndryshuar, të VKM nr. 408, datë 13.05.2015 "Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit" të ndryshuar si dhe Planit të Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Sarandë

**Rëndësia: I lartë**

**Rekomandimi:**

Titullari i Bashkisë Shkodër në bashkëpunim me Drejtorinë e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit, të marrin masa që në vazhdimësi të miratojnë leje zhvillimore dhe leje ndërtimi vetëm atëherë kur distancat e objektit të zhvilluar plotësojnë qartazi treguesit e distancave në 3 nivele; distancë ndërmjet ndërtesave, ndërmjet ndërtesës dhe kufirit të pronës si dhe ndërmjet ndërtesës dhe trupit të rrugës

***Për veprimet e mësipërme ngarkohet me përgjegjësi S.Z. me detyrë Përgjegjës Sektori i Lejeve të Ndërtimit dhe Kontrollit mbi Territorin.***

**2. Titulli gjetjes:** *Investimi i FSHF-së në stadiumin "Loro Borici" pa leje ndërtimi*

**Situata:**

Nga auditimi i procedurave të prokurimit me objekt "Ruajtje e godinës për Administrimin dhe Mirëmbajtjen e Stadiumit Loro Boriçi" dhe "Shpenzime të tjera për Administrim dhe Mirëmbajtje e Stadiumit 'Loro Borici'", u konstatua se investimi primar mbi stadiumin "Loro Borici" ishte "Ndërtimi i tribunës kryesore në perëndim dhe të tribunës në jug, rikonstruksion i tribunës kryesore në veri dhe në lindje në stadiumin Loro Borici". Ky investim, ka ardhur pas nënshkrimit të marrëveshjes së protokolluar në Bashkinë Shkodër me nr. prot 11445 datë 07.12.2015, midis "Federatës Shqiptare të Futbollit" dhe "Bashkisë Shkodër". Kjo marrëveshje konsiston në vullnetin dhe kërkesën e FSHF-së për të investuar në rikonstruksionin e stadiumit "Loro Borici". Origjina e financimit të këtij investimi është përcaktuar në VKM nr. 732 datë 02.09.20015 "Për bashkëfinancimin e Stadiumit Loro Borici", ku nga buxheti i shtetit i akordohej fondi prej 1.5 miliard lekësh i cili i vihet në dispozicion Ministrisë së Arsimit dhe të Sporteve, në programin buxhetor 08140 "Programi për Sportin" dhe pas miratimit nga Komiteti i Ndihmës Shtetërore, i transferohet "Federatës Shqiptare të Futbollit". Pjesa tjetër e investimit do të mbulohet nga UEFA, FIFA dhe vet FSHF ( e gjithë procedura është zhvilluar nga FSHF dhe MA, kurse Bashkia Shkodër është thjeshtë përfitues e investimit).

Për sa i përket pronësisë së stadiumit "Loro Borici", theksojmë se nëpërmjet VKM-së nr.421 datë 02.06.2010 " *Për miratimin e listës përfundimtare (të pjesshme) të pronave të paluajtshme publike, që transferohen në pronësi ose në përdorim të bashkisë Shkodër, të qarkut të Shkodrës*", është transferuar ndër te tjera nga lista e inventarit publik edhe stadium "Loro Borici" nga lista e inventarit të pronave publike në listën e inventarit të Bashkisë Shkodër. Megjithatë, pas përpjekjeve të njëpasnjëshme të bashkisë dhe përcjelljeve të kërkesave për regjistrim në ZVPP Shkodër (sot ASHK Shkodër) dhe ZQPP deri tek Ministri i Drejtësisë, pas pagesës së faturave të shërbimit pranë ASHK-së Shkodër për regjistrim të objekteve në inventarin e saj, nuk është arritur të merret një përgjigje se përse ASHK Shkodër nuk ka regjistruar listën e pronave të transferuara nëpërmjet VKM-së nr.421 datë 02.06.2010, përfshirë në këtë listë edhe stadiumin "Loro Borici".

Në konkludon kjo pronë është e paregjistruar si dhe nuk bën pjesë në Aktivet Afatgjata Materiale të Pasqyrave Financiare të Bashkisë Shkodër.
Duke marrë shkas nga sa më sipër, në mbështetje të marrëveshjes së FSHF-së dhe Bashkisë Shkodër, e cila u miratua me Vendim të KB nr. 50 datë 04.12.2015, u sigurua dhe leja e ndërtimit për objektin nga ana e Këshillit Kombëtar të Territorit me vendim të KKT nr.1 datë 01.04.2015. Në këtë vendim të KKT-së, përcaktohet qartë se subjekti kërkues për leje është Federata Shqiptare e Futbollit, e cila, sipas pikës 4 të vendimit, duhet ti jepej Formular i Lejes së Ndërtimit (zbardhja e lejes së ndërtimit nga Bashkia Shkodër) vetëm pasi subjekti kërkues FSHF të ketë paguar taksën e ndikimit në infrastrukturë për llogari të Bashkisë Shkodër. Pas ballafaqimit me subjektin Bashkia Shkodër, u arrit në konkluzionin se taksa e ndikimit ne infrastrukturë nuk ishte llogaritur për shkak se nuk është bërë një aplikim për leje ndërtimi nga ana e subjektit kërkues që është Federata Shqiptare e Futbollit (referuar dhe Vendimit të KKT-së nr.1 datë 01.04.2015 pikës 1 dhe 4)
Referuar paketës fiskale të vitit 2015, seksioni "A.4 Taksa e Ndikimit në Infrastrukturë nga Ndërtimet" citohet;

*Baza e taksës është vlera në lekë e investimit që kërkohet të kryhet. Kjo mbështetur ne ligjin nr 107/2014 date 31.7.2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit", dhe aktet nënligjore ne zbatim te tij, si dhe Ligji Nr. 9482, date 03.04.2006 "Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje" i ndryshuar Mbështetja ligjore : Ligji Nr.9632 , dt.30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore". Niveli i taksës sipas kategorive dhe nënkategorive për klasifikimin e investimeve, është si me poshtë:*

| ***Taksa e ndikimit ne infrastrukture nga ndërtime te reja*** | ***Njësia*** | ***Taksa*** |
|---|---|---|
| Objekte banimi, administrative, shërbimi etj., pavarësisht nga vendodhje ne territorin e bashkisë: | | |
| Ndikim Infrastrukture | % e vl.inves | 3% |
| Infrastrukturë rrugë, ujësjellës., kanalizime, ndriçim publik, telefoni etj.: | | |
| Ndikim Infrastrukture | % e vl.inves | 2% |

Struktura e ngarkuar për llogaritjen dhe pagesën e taksës së ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja është Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit të Territorit.

| ***Taksa e ndikimit ne infrastrukture per ndërtesat qe janë ne proces legalizim*** | ***Njësia*** | ***Taksa*** |
|---|---|---|
| | % e vl.inves | 0.5% |

Struktura e ngarkuar për llogaritjen dhe marrëdhëniet shkresore rakorduese është Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit të Territorit.
Gjithashtu referuar ligjit 145/2015, datë 17.12.2015 "Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin Nr.9632, datë 30.10.2006, "Për Sistemin e Taksave Vendore", të ndryshuar neni 27 citon;

"2. *Në rastin e ndërtimeve për qëllime banimi apo njësi shërbimi nga shoqëritë e ndërtimit, të cilat nuk destinohen për përdorim në sektorin e turizmit, industrisë apo përdorim publik, taksa e ndikimit në infrastrukturë është në masën 4 për qind deri 8 për qind të çmimit të shitjes për metër katror. Baza e taksës është vlera në lekë për metër katror e çmimit të shitjes së njësive të shërbimit apo ndërtesave për qëllime banimi. Çmimi i shitjes për metër katror bazohet në vlerën referuese të vlerës së tregut, sipas përcaktimeve në udhëzimin e Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e kostos mesatare të ndërtimit të banesave nga Enti Kombëtar i Banesave", që miratohet çdo vit.*

3. *Në rastin e ndërtimeve të <u>ndryshme nga ato të përcaktuara në pikën 2, të këtij neni, niveli i taksës shprehet si përqindje e vlerës së investimit dhe është 1 deri në 3 për qind e kësaj vlere</u>, ndërsa për Bashkinë e Tiranës është 2 deri 4 për qind e saj. Për projektet e infrastrukturës, për ndërtimin e rrugëve kombëtare, të porteve, aeroporteve, tuneleve, digave, ndërtimit të infrastrukturës në energji, përfshirë makineritë dhe pajisjet për këto projekte, taksa e ndikimit në infrastrukturë të ndërtimeve të reja është 0,1 për qind e vlerës së investimit, por jo më pak se kostoja e rehabilitimit të infrastrukturës së dëmtuar, kur kjo kosto nuk është përfshirë në preventivin e investimit. Për ndërtesat, të cilat janë në proces legalizimi, taksa e ndikimit në infrastrukturë e ndërtimeve të reja është 0,5 për qind e vlerës së investimit".*

Si konkluzion, nisur nga ligji 145/2015, datë 17.12.2015 dhe nga Paketa Fiskale e vitit 2015, taksa e ndikimit në infrastrukturë që duhet të ishte llogaritur nga Drejtoria e Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit si dhe paguar nga Federata Shqiptare e Futbollit, llogaritet si më poshtë;
<u>Llogaritja sipas situacionit përfundimtar;</u>
Nisur nga situacioni përfundimtar i sjellë nga ndërtuesit "T...", vlera e TNI-së llogaritur sipas legjislacionit të sipërpërmendur është:
***TNI=*** Situacioni përfundimtar pa pjesën e financimit të buxhetit të shtetit x 2% = 720,914,773 lekë x 2%= 14,418,295 lekë**.**
Vlera prej **14,418,295 lekë** për shkak të mosllogaritjes së taksës së ndikimit në infrastrukturë, *<u>përbën dëm ekonomik shkaktuar buxhetit të Bashkisë Shkodër</u>*
**<u>Kriteri:</u>**
Ligjin Nr.107 datë 31.07.2014 "Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit" të ndryshuar, VKM nr. 408, datë 13.05.2015 "Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit" të ndryshuar ligji 145/2015, datë 17.12.2015 dhe nga Paketa Fiskale e vitit 2015, ligji nr.9870 datë 16.07.2007 "Për Inspektoriatin dhe Mbrojtjen e Territorit nga Ndërtimet e Kundërligjshme" i ndryshuar
**<u>Ndikimi/efekti:</u>**
Kryerja e punimeve pa leje ndërtimi si dhe mos aplikimi për tu pajisur me leje, ka shkaktuar dëm ekonomik në buxhetin e Bashkisë Shkodër
**<u>Shkaku:</u>**
Mos respektimi i përcaktimeve të Ligjin Nr.107 datë 31.07.2014 "Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit" të ndryshuar, të VKM nr. 408, datë 13.05.2015 "Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit" të ndryshuar, , ligji nr.9870 datë 16.07.2007 "Për Inspektoriatin dhe Mbrojtjen e Territorit nga Ndërtimet e Kundërligjshme" i ndryshuar
**<u>Rëndësia:</u> E lartë**
**<u>Rekomandimi:</u>**
Titullari i Bashkisë Shkodër në bashkëpunim me Drejtorinë e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit dhe Drejtorinë Juridike Bashkia Shkodër, të marrin masa për arkëtimin e vlerës **<u>44,418,295</u> lekë nga "Federata Shqiptare e Futbollit",** duke ndjekur procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit.

Nga subjekti Federata Shqiptare me shkresën nr. 1095 prot, datë 21.6.2021 (prot KLSH nr. 362/13, datë 22.6.2021), janë përcjellë kundërshtitë në lidhje me mangësitë e konstatuara, si më poshtë vijon:
**<u>Komente dhe sqarime</u>:**

"Bashkia Shkodër, bazuar në një akt konstatim të Kontrollit të Lartë të Shtetit, pas 6 vitesh nga miratimi *i Lejes së Ndërtimit rikonstruksionit dhe dorëzimit po tek Bashkia Shkodër të stadiumit "Loro Borici", kërkon që nga FSHF të paguhet fatura e Taksës së Ndikimit në Infrastrukturë në vlerën 44,418,295 lekë. Kjo kërkesë është jo vetëm e pazakontë por dhe e papranueshme nga ana e FSHF, për faktin se Taksa e Dnikimit në Infrastrukturë (TNI) parashikohet në këto dispozita ligjore;..citohet neni 46 i ligjit nr. 107/2014 Për planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit si dhe neni 27 i ligjit nr. 9632 datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore". Objekti për të cilin është lëshuar leja e ndërtimit, stadiumi "Loro Borici", referuar dhe marrëveshjes nr.11445 datë 07.12.2015 (prot. I Bashkisë Shkodër) lidhur midis FSHF dhe Bashkisë Shkodër është pasuri e paluajtshme e Bashkisë Shkodër. Po sipas marrëveshjes, FSHF nuk ka asnjë pretendim pronësie mbi objektin.*

*Investimi për realizimin e objektit bazohet mbi fondin e miratuar nga Këshilli i Ministrave me Vendim nr. 732 datë 02.09.2015 "Për bashkëfinancimin e Stadiumit Loro Borici Shkodër".... Sa më lartë dërgimi i një fature të tillë pranë FSHF nuk gjen asnjë bazë ligjore, për faktin thelbësor se ky objekt nuk është në pronësi të Bashkisë Shkodër.*

**Sqarim i grupit të auditimit**.

Nga ana e grupit të auditimit theksohet se Vendimi i KKT-së nr.1 datë 01.04.2015, "Për miratimin e lejes së ndërtimit për objektin "Ndërtim i Tribunës kryesore....si dhe infrastrukturës përreth stadiumit Loro Borici" në pikat 1 dhe 4 specifikohet:

"1. Miratimin e Lejes së Ndërtimit për objektin "Ndërtim i Tribunës në Perëndim dhe Jug, Rikonstruksion i Tribunës egzistuese në Veri dhe në Lindje, si dhe Infrastrukturës përreth Stadiumit "Loro Borici", Bashkia Shkodër, me subjekt kërkues **"Federata Shqiptare e Futbollit**".

4. Formulari i Lejes së Ndërtimit i jepet subjektit kërkues vetëm pas pagesës së taksës së ndikimit në infrastrukturë, për llogari të Njësisë së Qeverisjes Vendore*"*.

Pra theksohet se subjekti kërkues është "Federata Shqiptare e Futbollit", të cilës i është miratuar leja e ndërtimit nga KKT-ja, dhe me kusht që ti zbardhet leja e ndërtimit nga Qeverisja Vendore, duhet të paguaj taksën e ndikimit në infrastrukturë, si subjekt kërkues që është.

Gjithashtu sipas dokumentacionit nuk disponohet asnjë dokument si nga Ministria e Arsimit dhe të Sporteve dhe nga Bashkia Shkodër për lehtësimin nga kjo taksë, pra mos kryerjen e pagesës, por është theksuar vetëm fakti që leje të lëshohet pasi të jetë likuiduar TNI-ja**.**

Nga ana tjetër, nëse i referohemi që në krye të herës marrëveshjes me nr. Prot 11445 datë 07.12.2015 që është bërë mes Bashkisë Shkodër dhe FSHF-së, neni 5 pika 3 "Detyrimet e Federatës " ku citohet;

"Federata merr përsipër dhe detyrohet;

3.*Kryerjen e të gjitha procedurave ligjore për realizimin e këtij investimi, si ; plotësimin e të gjithë dokumentacionit të nevojshëm për nxjerrjen e lejes së ndërtimit,* kryerjen e punimeve, e veprave të tjera që kanë lidhje me këto punime."

Qartësisht detyrimi për nxjerrjen e lejes së ndërtimit, referuar dhe kësaj marrëveshje, është detyrë e FSHF-së. Nga sa trajtuam, grupi i auditmit nuk merr në konsideratë pretendimet e FSHF-së.

***(****Më hollësisht trajtuar në faqen 181-189, të Projektraport Auditmit)*

## III/2.7. TË NDRYSHME TË DALA GJATË AUDITIMIT.

Nga grupi i KLSH-së, u verifikua ankesa e shtetasit "GJ.M.", protokolluar në KLSH me shkresën nr. 1048 prot., datë 20.10.2020.
Ky shtetas, ankohet ndaj Kryetares së Bashkisë Shkodër znj. V.A. për mos ekzekutimin e vendimeve për prishjen e një objekti. Ky shtetas deklaron se ka blerë një pronë në vitin 1982. Pas vitit 1997 nipi i ish pronares pa lidhur marrëveshje me ne, ka ndërtuar kasolle pa kriter. Në vitin 2009, filloi të ndërtoj në truallin tim, dhe pavarësisht se janë nxjerrë 5 vendime për prishje, situata vijon të jetë sërish e njëjtë.
Me datë 14.10.2010 deklaron se INUK ka dërguar shkresë zyrtare për vendosjen e sanksioneve ligjore, por ish Kryetari i Komunës z. N.M. miraton një leje mashtruese *Për ndërtim me materiale të çmontueshme pa përdorur struktura betoni*. Me datë 03.03.2012, kanë ardhur makineritë e INUK për të ekzekutuar 5 vendimet për prishje, por sërish me marrëveshje është kërkuar që të bëhet personalisht heqja e materialeve. Në vitin 2013 INUK dërgon sërish punëtor për të ekzekutuar me krah, dhe pas heqjes së disa llamarinave janë larguar. INUV pas inspektimit konstaton se objekti ishte rifutur në funksion, dhe bëjnë kallëzim penal, i regjistruar me nr. 1864 i vitit 2014. Pas 60 seancash gjyqësore, është marrë vendimi për rikthimin e dosjes në prokurori për hetime të mëtejshme.
Denoncimi ndaj Bashkisë Shkodër rezulton në faktin se strukturat e prishura në mënyrë vullnetare janë akoma funksionale, nuk ka objekt *stallë bagëtish,* nuk ka struktura betoni.
-Audituesit e KLSH, kërkuan informacion nga Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit Vendor të Bashkisë Shkodër në lidhje me situatën objekt ankese.
Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion, rezulton se z. GJ.M., ka kallëzuar penalisht shtetasin GJ.GJ. duke kërkuar lirimin e truallit të shtëpisë. Kjo konstatohet nëpërmjet vendimit të gjykatës së rrethit gjyqësor Shkodër, e cila me vendimin nr. 51-2015-3975, datë 07.10.2015 ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të pushimit të procedimit penal nr. 734, datë 14.06.2012 me kërkues shtetasin GJ.M.. Sipas vendimit të gjykatës, vendimet për prishjen e objekteve nuk janë ekzekutuar për shkak të mungesës së mjeteve nga ana e INUV Komuna Velipojë, gjë e cila ka sjellë tejkalimin e afateve për ekzekutimin e vendimit. Gjithashtu, sipas vendimit të gjykatës për lënien në fuqi të vendimit të pushimit të prokurorisë, argumenton se kërkuesi pavarësisht se përsëriste faktin se konflikti kishte lindur pasi shtetasi GJ.GJ. kishte ndërtuar disa stalla bagëtish dhe se për këtë disponpremte të gjitha dokumentet, rezulton se pretendimet e tij nuk mbështeteshin në asnjë argument apo dokument ligjor. Në lidhje me kërkesën e ankuesit për lirim trualli, gjykata ka çmuar se këto pretendime nuk janë objekt i këtij gjykimi, dhe kërkuesi duhet ti drejtohet gjykatës civile.
Nga ana e IMTV Bashkia Shkodër, na është vënë në dispozicion vendimi i gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër me nr. 51-2018-2513, datë 20.06.2018, sipas të cilit Prokuroria pranë kësaj gjykate ka kërkuar pushimin e çështjes së procedimit penal, me kallëzues shtetasin GJ.M. dhe të kallëzuar shtetasin GJ.GJ. për veprën penale "Ndërtim i paligjshëm". Sipas vendimit të mësipërm, gjykata ka vendosur pranimin e kërkesës së prokurorisë për pushimin e çështjes, pasi nuk jemi në kushtet e ndërtimit të paligjshëm. Sipas akteve të administruara nga prokuroria objekt gjykimi, rezulton se Njësia Administrative Velipojë dhe IMTV Bashkia Shkodër nuk kanë konfirmuar akte administrative për ndërtim pa leje ndaj shtetasit GJ.GJ..
Audituesi e KLSH, kanë administruar gjithashtu korrespodencën ndërmjet Bashkisë Shkodër dhe institucioneve tjera ku objekt i tyre janë ankesat e shtetasit GJ.M..
1. Shkresa drejtuar Kryeministrisë me nr. 757/1 prot., datë 01.02.2016 e Kryeinspektorit të IMT.
2. Shkresa drejtuar Drejtorisë Vendore të Policisë Shkodër nr. 3733 prot., datë 04.04.2016 e nën kryetares së Bashkisë Shkodër.

3. Shkresa drejtuar Prokurorisë Shkodër me nr. 5474 prot., datë 13.05.2016.
4. Shkresa drejtuar Inspektoratit Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit me nr. 7589/1 prot., datë 06.07.2016 e Kryetares së Bashkisë Shkodër.
5. Shkresa drejtuar Kryeministrisë me nr. 10260 prot., datë 22.08.2016 e Kryetares së Bashkisë Shkodër.
6. Shkresa drejtuar Inspektoratit Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit me nr. 10785/ prot., datë 30.07.2019 e Kryetares së Bashkisë Shkodër.
7. Dokumentet e pronësisë së shtetasit GJ.GJ. (Planimetri e vendosjes së banesës, AMTP, leja për ndërtim të përkohshëm si dhe foto të "objektit").

*Në të gjitha shkresat e mësipërme, nga Bashkia Shkodër sqarohet se nga inspektimet në terren nuk janë konstatuar punime ndërtimi.*

Sa më sipër, audituesit e KLSH-së, sqarojnë se ankesa e shtetasit GJ.M., objekti i së cilës është prishja e ndërtimeve pa leje, rezulton çështje e hetuar nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Shkodër në të paktën 2 raste. Sipas konkluzioneve përfundimtare të hetimit për të cilat prokuroria i ka kërkuar gjykatës pushimin e çështjes, nuk jemi në kushtet e ndërtimit të paligjshëm nga ana e shtetasit GJ.GJ.. Sipas organit të akuzës, pas konfirmimit edhe nga Njësia Administrative Velipojë dhe IMT Bashkia Shkodër, nuk ka punime ndërtimi në objektin e ankesës. Gjithashtu, gjykata në vendimin e pushimit, ka argumentuar se shtetasi GJ.M. nuk ka provuar me dokumentacion ligjor se është pronar i truallit objekt ankese, dhe çështja duhet të jetë objekt i një gjykimi civil. Gjithashtu, nga fotografitë e administruara nga IMT Bashkia Shkodër, konstatohet se objektet e ankesës, janë disa llamarina të mbështetura mbi blloqe betoni në dukje ekzistuese. Sa më sipër, nga audituesit e KLSH, nuk konstatohet mos përmbushje e detyrimeve për kontrollin e territorit, dhe marrjen e masave për parandalimin e ndërtimeve të paligjshme nga IMT Bashkia Shkodër.

## IV. <u>GJETJE DHE REKOMANDIME</u>

## A. <u>MASA ORGANIZATIVE</u>

**1. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i zbatimit të dispozitave ligjore për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin e Brendshëm u konstatua se gjendja aktuale e sistemit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, nisur nga vetëvlerësimi dhe rezultatet e testimeve të kryera, tregon se aspektet e kontrollit të brendshëm kuptohen dhe funksionojnë mirë përgjatë gjithë strukturave të njësisë.
Me mangësi rezultojnë disa elementë të "*Mjedisit të Kontrollit*" dhe "*Menaxhimit të Riskut*".
Në zbatim të nenit 51, të Rregullores së Brendshme të Bashkisë Shkodër, nuk janë hartuar rregulloret e drejtorive/sektorëve, veprime në kundërshtim me ligjin nr. 10296, datë 8.7.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" neni 20, 21.
Në strukturën e miratuar, Inspektorati Vendor i Mbrojtjes së Territorit (IVMT), rezulton nën varësinë e Drejtorisë së Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit, pozicion ky i papërshtatshëm, pasi në zbatim të dispozitave ligjore, IVMT kontrollon punën e Drejtorisë së PZHT për lejet e dhëna.
Drejtoria e Burimeve Njerëzore, nuk ka hartuar një plan strategjik për trajnimin e punonjësve, duke u mjaftuar vetëm me trajnimet e organizuara nga ASPA, si dhe nuk është mbajtur regjistri i riskut sipas drejtorive/sektorëve, duke mos bërë evidentimin dhe vlerësimin e riskut dhe caktimin e detyrave konkrete për punonjësit sipas detyrave funksionale *(Më hollësisht trajtuar në pikën III/2.1, faqe 29-37, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**1.1. <u>Rekomandimi</u>:** Kryetari i Bashkisë Shkodër, në cilësinë e Nëpunësit Autorizues, të marrë masa për njohjen dhe menaxhimin nga stafi të ligjit për MFK dhe manualit përkatës të tij, për hartimin dhe miratimin e një strategjie të risqeve, me qëllim menaxhimin e riskut, ku të bëhet identifikimi, analiza dhe kontrolli i risqeve që mund të kenë impakt në arritjen e objektivave të institucionit.
Të hartohen rregulloret sipas drejtorive/sektorëve përkatës për përcaktimin sa më të qartë të detyrave për çdo pozicioni pune.
**1.2. <u>Rekomandimi</u>:** Drejtoria e Burimeve Njerëzore për hartimin e programe të trajnimeve për ngritjen profesionale të stafit dhe të mos mbetet vetëm tek trajnimet e zhvilluara nga ASPA.
Në bashkëpunim me Kryetarin e Bashkisë Shkodër të krijojë si strukturë me vetë Inspektorati Vendorë i Mbrojtjes së Territorit (IVMT), e pavarur nga Drejtoria e Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit, strukturë e cila të miratohet dhe në Këshillin Bashkiak.

**Menjëherë dhe në vijimësi**

**2. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i dokumentacionit në Njësinë e Auditit të Brendshëm (NJAB), u konstatua se plani i auditimeve për periudhën objekt auditimi nuk është realizuar, duke qenë në masën 70%. Në dosjet e auditimit mungojnë dokumentet e planifikimit të angazhimit për auditim, mungon dokumenti i takimit të hapur prezantues, mungojnë letrat e punës dhe vlerësimi i brendshëm i cilësisë sipas kërkesave të Manualit të Auditit të Brendshëm. Njësitë e audituara në përgjithësi nuk kanë paraqitur plan veprimet për zbatimin e rekomandimeve, si dhe nuk është bërë ndjekja e tyre nga Njësia e Auditit, situatë e cila sjell një mungesë të informacionit në lidhje me statusin e rekomandimeve të lëna. Mungojnë angazhimet në sektorët me risk të lartë siç janë Njësia e Prokurimeve dhe Drejtoria e Financës, të cilat pavarësisht planifikimit, nuk janë audituar, veprime në kundërshtim me ligji nr. 114/2015 "Për auditimin e brendshëm në sektorin publik","
neni 8 germa (c), neni 14 germa; Manuali i Auditit të Brendshëm, urdhër i Ministrit të Financave me nr. 100 datë 25.10.2016, Kapitulli IV, pika 4.1.1, pika 4.1.4 Hapi 3, pika 4.1.8 Hapi 7, Kapitulli VII, pika 7.1.1 *(Më hollësisht trajtuar në pikën III/2.1.2, faqe 29-37, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
**2.1 <u>Rekomandimi</u>:** Sektori i Njësisë së Auditit të Brendshëm (NJAB), të marrë masa të kryej monitorimin e zbatimit të rekomandimeve.
Drejtuesi i Auditimit Brendshëm të vendosë dhe të mirëmbaje një sistem për monitorimin e trajtimit të rezultateve të komunikuara menaxhimit sipas Manualit AB.
Në hartimin e planeve vjetore të planifikohen sektorë me fusha me risk, siç janë zbatimi i procedurave të prokurimit, dhënia e lejeve të ndërtimit/zhvillimit, administrimi i taksave e tarifave vendore, si dhe institucionet e varësisë të Bashkisë Shkodër.

**Menjëherë dhe në vazhdimësi**

**3. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i dokumentacionit mbi zbatimin e buxhetit, u konstatua se:
-*Për vitin 2019* buxheti është realizuar në masën 79% ose nga 3,670,148 mijë lekë të planifikuara, janë realizuar 2,897,989 mijë lekë, ndërsa *për vitin 2020* është realizuar në masën 76% ose nga 3,671,412 mijë lekë të planifikuara, janë realizuar 2,774,458 mijë lekë.
- Niveli i realizmit të investimeve të planifikuara është shumë i ulët, ku *për vitin 2019* paraqitet në masën 65 %, ose nga vlera planifikuar prej 939,887 mijë lekë është realizuar vlera prej 609,647 mijë lekë dhe në *vitin 2020* në masën 58 %, ose nga vlera planifikuar prej 731,594 mijë lekë është realizuar vlera prej 425,959 mijë lekë, pavarësisht faktit se niveli i investimeve nga njëra periudhë në tjetrën është në ulje për vlerën 208 milion lekë.
Në planifikimin e buxheteve për investime, konstatohet se të gjitha investimet janë planifikuar me afat pagese nga 2 - 3 vjeçare, të cilat janë miratuar në PBA respektive, në vlera të vogla që variojnë

nga 10 deri në 20 milionë lekë dhe me afat zbatimi deri në 60 ditë, ku subjektet sipërmarrëse kanë paraqitur në afat situacioni përfundimtarë dhe faturën bashkëshoqërues, por që pagesa nuk është bërë në vlerën e plotë të sajë, duke bërë copëzim të faturës dhe mbi bazën e PBA të miratuara, veprime në kundërshtim me nenet 42,43,47,50,51,52 dhe 65, të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 "Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar; pika 101 dhe 102 të udhëzimi të MFE nr. 2, datë 06.02.2012 "Për Procedurat Standarde të Zbatimit të Buxhetit" me ndryshime; neni 47 të ligjit nr. 68/2017 "Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore"; nenet 79 -80 -81, të udhëzimit të MFE nr. 9,datë 20.03.2018 "Për Procedurat Standarde të Zbatimit të Buxhetit" me ndryshime; Ligji nr. 68-2017, "Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore", Ligji nr. 139/2015, datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore", Udhëzimi nr. 23 datë 22.11.2016, "Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm" dhe Vendimet përkatëse të Këshillit Bashkiak dhe Udhëzimin e MF nr. 2 datë 06.02.2012 "Për procedurat standarte të zbatimit të Buxhetit" i ndryshuar, pikat 253 dhe 354 *(Më hollësisht trajtuar në pikën III/2.3, faqe 37-54, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**3.1. Rekomandimi:** Drejtoria e Analizës dhe e Programimit Buxhetor në bashkëpunim me Drejtoritë/ Sektorët e tjerë Bashkia Shkodër, gjatë hartimit dhe miratimit të buxhetit të planifikojë fonde për investime në raport me nivelin e të ardhurave të realizuara për vitin dhe grandeve të planifikuara nga buxheti qendror, në raport me përqindjen e planifikuar për këtë zë.

Planifikimi i të ardhurave të bëhet mbi baza reale dhe shpërndarja e fondeve buxhetore të bazohet në parashikimin e fluksit të hyrjeve të parasë dhe të angazhimeve, ku të sigurohet një përdorim efiçent i burimeve financiare, duke rritur financimet nga të ardhurat e veta.

**Menjëherë dhe në vazhdimësi**

**4. Gjetje nga auditimi:** Nga të dhënat e pasqyrës, rezulton se gjendja e faturave të pa likuiduara në fund të **vitit 2019** është në shumën 375,509 mijë lekë dhe në fund të **vitit 2020** është në shumën 196,658 mijë lekë, pra me një ulje për shumën 178,851 mijë lekë.

Në të dy periudhat peshën kryesore të faturave të palikuiduara e zënë investimet (llog 231), ku për vitin 2019 zënë 74.4% dhe për vitin 2020 zënë 78% të totalit të faturave.

Nga krahasimi i të dhënave të analizës së faturave të palikuiduara me raportet e detyrimeve të prapambetura në MFE dhe me gjendjet e llogarive të klasës 4 në bilanc në fund të periudhave ushtrimore, rezultoi se:

*Për vitin 2019*, detyrimet e raportuara në MFE janë vlerën 54,532 mijë lekë, ndërsa në PF të vitit 2019 gjendjet e llogarive të klasës 4 të detyrimeve (pasiv bilancit) janë në vlerën 375,509 mijë lekë, pra me një diferencë prej 320,970 mijë lekë më pak në të dhënat e dërguara në MFE.

*Për vitin 2020*, detyrimet e raportuara në MFE janë vlerën 51,304 mijë lekë, në PF të vitit 2020 gjendjet e llogarive të klasës 4 të detyrimeve (pasiv bilancit) janë në vlerën 196,658 mijë lekë, pra me një diferencë prej 145,354 mijë lekë më pak në të dhënat e dërguara në MFE**.**

**-** Nga auditimi i pagesave të kryera nëpërmjet Bankës dhe testimi i tyre në lidhje me respektimin afatit 30-ditor të paraqitjes në Degën e Thesarit Shkodër të urdhër-shpenzimit me dokumentacionin shoqërues nga data e faturës së operatorit ekonomik, u konstatua se për periudhën objekt auditimi, janë kryer pagesa mbi afatin 30 ditor të faturave për shpenzime/ shërbime/investime të mbërritura në institucion në 29 raste në vlerën 55,314 mijë lekë.

- Është konstatuar se nuk janë ndjekur në të gjitha rastet hapat për realizmin e pagesave sipas afateve, megjithëse dokumentacioni që shoqëron pagesën është i plotë, pasi ka kontrata të cilat nuk paguhen, pavarësisht faktit se investimet janë planifikuar si financim në periudha 2 – 3 vjeçare, konstatohet se financimet e periudhës përkatëse nuk është mundësuar likuidimi i tyre, kjo për mungesë fondesh nga realizmi i të ardhurave, *konkretisht*:

Ne periudhën e vitit 2019 nga vlera e kontrata të planifikuara për likuidim prej 558,352 mijë lekë është likuiduar për këtë periudhë vlera 469,449 mijë lekë, duke mos likuiduar shumën 88,902 mijë lekë. Ndërsa për *aktivitetin e vitit 2020* nga vlera e planifikuar për likuidim prej 584,976 mijë lekë është likuiduar vlera 287,211 mijë lekë duke lënë për likuidim vlera 297,764 mijë lekë, të dhëna këto të nxjerra nga pagesat e kryera sipas procedurave në vitet respektove.

Për të dy periudhat, mos pagesën lidhet me faktin me faktin se nga Bashkia Shkodër, nuk janë realizuar të ardhurat e planifikuara dhe të destinuara për likuidimin e fondeve të prokuruar. Pra nga sa mësipërm nuk janë respektuar dhe këstet e parashikuara në PBA, veprime në kundërshtim me nenin 40 të ligjit 139/2015, datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore"; paragrafin e parë të nenit 40 dhe neni 52 të ligjit nr.9936, datë 26.06.2008 "Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar; nenin 40, 47 pika 3 dhe 48 të ligjit 68/2017, "Për financat e vetëqeverisjes vendore"; UMF nr. 5, datë 27.12.2014 "Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura", pikat 82-91*(Më hollësisht trajtuar në pikën III/2.3, faqe 37-54, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**<u>4.1. Rekomandimi</u>** Drejtoria e Financë Bashkia Shkodër, të marrë masa për sigurimin e likuiditeteve në kohë, në mënyrë që të mos krijojë kufizime limiti të arkës *(përjashtuar kufizimet e MFE),* për likuidimin e faturave, me qëllim që të mos akumulohet borxh për fatura të palikuiduara dhe përfshirjen e institucionit në vështirësi financiare.

Gjithashtu, planifikimi i procedurave të prokurimit të jetë në raport të drejtë me fondet në dispozicion, vlerën e faturave të palikuiduara në fund të periudhës dhe vlerën e kontratave të lidhura me likuidim me këste, veprime të cilat do të ulnin vlerën e faturave të palikuiduara në fund të periudhave ushtrimore.

**<u>4.1. Rekomandimi:</u>** Kryetari i Bashkinë në cilësinë e Nëpunësit Autorizues, në bashkëpunim me Drejtorin e Financës në cilësinë e Nëpunësit Zbatues dhe Drejtorin e Buxhetit, të marrin masa që në hartimin e buxheteve të viteve në vijim, të planifikojnë procedura prokurimi me fonde publike në raport të drejtë me fondet në dispozicion, vlerën e faturave të palikuiduara në fund të periudhës dhe vlerën e kontratave të lidhura me likuidim me këste, veprime të cilat do të ulnin vlerën e faturave të palikuiduara në fund të periudhave ushtrimore.

**Menjëherë dhe në vazhdimësi**

**5. Gjetje nga auditimi:** Nga të dhënat, konstatojmë se struktura e DAV Bashkia Shkodër ka probleme dhe nuk është në funksion të realizmit e të ardhurave, pasi evidentohet mos krijimi i Sektorit të Masave Shtrënguese si një nga sektorët më të rëndësishëm në administrimin e të ardhurave, ku vlera e detyrimeve të pa arkëtuara në fund të periudhave është në rritje nga njëri vit në tjetrin, e cila në fund të vitit 2020 paraqitet gjithsej 20478 subjekte/abonentë familjarë për vlerën 1,174,117 mijë lekë. Alternim i këtij sektori në përbërje të Sektorit të Kontrollit Terren është i papërshtatshëm, nisur nga fakti se kanë natyra të ndryshme pune dhe se arkëtimi i debitorëve është procedurë më vetë dhe afate të përcaktuara.

Gjithashtu në strukturën organizative të DAV Bashkia Shkodër, konstatohet se ka mungesë Përgjegjës i Sektorit të Kontrollit në Terren dhe mos prezenca e specialistëve të fushës *(inxhinier me profil urbanist),* për evidentimin e sipërfaqeve të hapësirave publike të lokaleve, plazheve si dhe të ndërtesave gjatë punës kontrollues në terren, pasi evidentohet raste të shfrytëzimit ose mos deklarimit të sipërfaqeve dhe nuk llogaritet detyrimet fiskale për këto mos deklarime, veprime në kundërshtim me pikën (ç) të nenit 5 të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore" i ndryshuar dhe në Kreun XI- "*Mbledhja me forcë e detyrimit tatimor të papaguar",* nenet 88 – 104, të ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008 "Për Procedurat Tatimore në RSH" me ndryshime *(Më hollësisht trajtuar në pikën III/2.2.6, faqe 54-83, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**5.1. <u>Rekomandimi</u>** Kryetari i Bashkisë Shkodër në bashkëpunim me Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse, të marrë masa për plotësimin e stafit të DAV Bashkia Shkodër me specialit të fushës dhe përshtatja e strukturës sipas natyrës së menaxhimit të të ardhurave, duke krijuar Sektorin e Menaxhimit të Borxhit.

**Menjëherë dhe në vazhdimësi**

**6. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi u konstatua se, ndjekja e taksës së hotelit aplikohej bazuar në akt-konstatimet të Sektorit të Kontrollit Terren çdo datë 5 fillim muaj me tarifën e përcaktuar në Vendimin e KB është 70 lekë/natë/personi.
Ky dokument (akt-konstatimi), nuk është i saktë, pasi në të nuk paraqitej panorama e plotë e lëvizjes (akomodimit) të personave në hotel dhe netëve të fjetura, por thjeshtë bëhej një konfirmim i deklaratës së subjektit (vetë deklarim). Pra nuk evidentohej, sa dhoma ka hoteli diponibël për aktivitet, sa shterët janë për dhomë dhe gjithsej, sa dhoma janë aktive dhe sa jo, sa netë kanë fjetur personat, etj. Të gjitha këto mangësi bëjnë që kjo taksë të mos jetë planifikuar sakë për numrin e personave që akomodohen në hotelet e Bashkisë Shkodër, kryesisht kjo në sezonin verorë ku numër i personave që akomodohen në hotele është edhe më i lartë, veprime të cilat çojnë në mungesë të ardhurash në buxhetin e Bashkisë Shkodër nga mos planifikimin i saktë të të ardhurave nga kjo taksa.
Mungesa e dokumentacionit ose mos evidentimi i saktë i personave që akomodohen në hotel dhe lëvizjet e shpeshta të personave, duke mos i regjistruar ato në regjistrat e hotelit, lind si e nevojshme që nga ana e Bashkisë Shkodër në miratimin e paketës fiskale të vitit 2022 të bëjë ndryshimin e mënyrës së llogaritjes, duke aplikuar tarifë fikse për shtretër/nata**,** gjithmonë duke ruajtur nivelin ligjorë +/- 30% .
Nga auditimi, u konstatua se nga DAV Bashkia Shkodër nuk ka marrë informacion dhe nuk është bërë ndarja e hotele në "Yje", të dhëna këto të cilat kërkohen nga Ministria e Turizmit *(Më hollësisht trajtuar në pikën III/2.2.6, faqe 54-83, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
**6.1. <u>Rekomandimi</u>:** Drejtoria e të Ardhurave Vendore Bashkia Shkodër në bashkëpunim me Policinë Bashkiake, të ngrejë një grup pune me specialit të fushës për të evidentuar numrin e hoteleve që operojnë në territorin e Bashkisë Shkodër, duke evidentuar numrin e dhomave dhe shtretërve aktiv, si dhe të shikohet mënyra e taksimit të fjetjes në hotel të personave (lekë/shtretër/nata), duke ruajtur nivelet ligjore +/- 30%.
**6.2. <u>Rekomandimi</u>:** Drejtoria e të Ardhurave Vendore në bashkëpunim me Drejtorinë e Turizmit dhe Policinë Bashkiake, të evidentojnë hotelet me 4-5 yje me miratim të Ministrisë së Turizmit për një aplikim të saktë të taksës sipas VKB. Të mos lejojnë përdorimin e simboleve (yjeve) nga subjektet hoteliere pa leje përkatëse të Ministrisë së Turizmit dhe në rast kundërshtimi të aplikohet tarifa e miratuar me VKB për 175 lekë/natë/personi dhe 70 lekë/natë/personi.

**Menjëherë dhe në vazhdimësi**

**7. Gjetje nga auditimi:** Në lidhje me punën e Agjentëve Tatimorë u konstatua se:
Nga të dhënat e paraqitura nga DAV Bashkia Shkodër, për periudhën objekt auditimi janë mbajtur akt-rakordimet çdo muaj dhe vjetorë, por që janë të paplota, pasi nuk evidentohet se sa është numri i personave që duhet të paguajnë detyrimin, sa nga këto persona plotësojnë kriteret për pagesa, sa kanë paguar, sa nuk paguajnë dhe nëse vlera e arkëtuar nga agjentët tatimorë janë likuiduar në afat apo jo, kjo për agjentët tatimorë si: Drejtoria Rajonale Vendore ASHK Shkodër (*nga shitja e pasurisë),* Drejtoria e Transportit (*për mjetet qarkullues),* Drejtoria Rajonale Tatimore Shkodër (*tatim fitim thjeshtuar)* dhe Ndërmarrjen e U... sh.a *(abonentët familjarë).*

Gjithashtu, Bashkia Shkodër nuk ka krijuar baza të plota të dhënash për detyrimet që vilen nëpërmjet agjentëve tatimorë, në bazë të të cilave të bëjë akt-rakordimet.
Në lidhje me mosrealizimet e taksave nga agjentët tatimorë, Bashkia Shkodër, duhet të marrë masa për evidentimin e diferencave të pa mbledhura sipas llojit të taksës/tarifës, të cilat përbëjnë mungesë të ardhurash për buxhetin e saj dhe të fillojë procedurat për gjobitjen e këtyre agjentëve tatimorë me 50% të shumës së plotë të taksave/tarifave të pa mbledhura apo të shmangura,
Sipas DAV Bashkia Shkodër, mos arkëtimet nga ana e Drejtoria Vendore ASHK Shkodër, janë për shkak të anashkalimit të arkëtimit të këtyre detyrimeve për taksën e infrastrukturës, për të cilat nga Bashkia Shkodër është kërkuar vazhdimisht në rrugë zyrtare që të mos i kryejnë veprimet e regjistrimit të pronës nga këto lloj subjektesh, pa paraqitur dokumentin e pagesës së kësaj takse, veprime në kundërshtim me nenin 117 të ligjit nr. 9920, dt. 19.5.2008, "*Për Procedurat Tatimore*", ku parashikohet se "*Dënimet për agjentët e mbajtjes së tatimit në burim, agjentët e taksave dhe agjentët e tarifave*" *(Më hollësisht trajtuar në pikën III/2.2.6, faqe 54-83, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
**7.1 <u>Rekomandimi:</u>** Drejtoria e të Ardhurave Vendore, Bashkia Shkodër, të marrë masa për:
- Evidentimin e diferencave të pa mbledhura nga Agjentët Tatimore, sipas llojit të taksës/tarifës, të cilat përbëjnë mungesë të ardhurash për buxhetin e saj dhe të fillojë procedurat për penalizmin e Agjentëve Tatimore me 50% të shumës së plotë të taksave/tarifave të pa mbledhura apo të shmangura.
- Të krijojë bazën të dhënave për subjektet, tarifat apo taksat të cilat mblidhen nga Agjentët Tatimore, të kryqëzojë informacionet me institucioni e tjera përkatëse dhe rakordimet të bëhen në fund të çdo muaj sipas formularit përkatës të miratuar nga Ministria e Financave.

**Menjëherë dhe në vazhdimësi**

**8. Gjetje nga auditimi**: Nga auditimi i pasqyrave financiare të vitit 2020, u konstatua se:
- Llogaria 466 "*Kreditore për mjete nën ruajtje*", sipas Pasqyrës së Pozicionit Financiar të Bashkisë Shkodër, në fund të vitit 2019 paraqitet në vlerën 92,179,959 lekë dhe në fund të vitit 2020 paraqitet në vlerën 93,508,882 lekë, e cila përfaqëson vlerën e garancisë së kontratave në masën 5%.

Nga analiza e kësaj llogarie rezultoi se vlera në fund të vitit 2019 dhe 2020, ka pasur në përbërje të llogarisë detyrime për garanci punimesh të bashkisë ndaj subjekteve privatë, garanci këto të cilave u ka kaluar afati i përcaktuar në kontratat përkatëse të investimit dhe përsëri janë akoma gjendje në llogarinë 466. Sistemimi i vlerës totale të llogarisë 466 "Kreditore për mjete nën ruajtje" duhet të bëhet duke njoftuar subjektet për paraqitjen e dokumentacionit të nevojshëm për të sistemuar dhe pastruar garancitë të cilat tashmë u ka kaluar afati i përcaktuar në kontratën e investimit përkatës.
Përfundimisht për vitin 2019 dhe 2020 llogaria 466 "Kreditore për mjete nën ruajtje" është mbivlerësuar për 3,670,249 lekë për vitin 2020 dhe 690,238 lekë për vitin 2019, për të cilat duhet të bëhet sistemimi i llogarisë.
- Llogaria 401- 408 "*Furnitorë e llogari te lidhura me to" si dhe* 467 "*Kreditorë të ndryshëm*" ***"*** përfaqësojnë detyrimet e vitit si dhe detyrimet e prapambetura ndaj të tretëve, për shpenzime, shërbime apo investime të kryera. Është vënë re fenomeni i likuidimit pjesor të faturave që janë pranuar nga Drejtoria e Financës. Kjo ka ardhur si shkak i lidhjes së kontratave të investimeve, zbatimi i të cilave nuk përputhet në kohë me kohën e financimit të tyre. Praktikisht zbatimi i kontratave arrin nga 3 deri në 6 muaj, ndërsa financimi i pikërisht këtyre kontratave shkon deri në 3 vjet, sipas planit të pagesave dhe PBA 3 vjecare. Duke analizuar faturat e investimeve të regjistruara për vitet 2019, u vu re se regjistrimi i disa prej tyre nuk ishte bërë për vlerën e plotë

të faturës. Për pasojë llogaria 401-408 ""Furnitorë e llogari të lidhura me to"" është nënvlerësuar për 22,586,833 lekë dhe llogaria 467 "Kreditorë të ndryshëm" është nënvlerësuar me 4,099,781 lekë llogarisë *(Më hollësisht trajtuar në pikën III/2.3, faqe 83-90, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**8.1. <u>Rekomandimi</u>:** Drejtoria e Financës në bashkëpunim me Drejtorinë e Shërbimeve Publike, të marrin masa për të bërë sistemimin e llogarisë 466 "*Kreditore për mjete nën ruajtje*", duke rakorduar drejtoritë njëra me tjetrën çdo muaj, si dhe njoftuar subjektet për paraqitjen e dokumentacionit të nevojshëm për të sistemuar dhe pastruar garancitë të cilat tashmë u ka kaluar afati i përcaktuar në kontratën e investimit përkatës.

**8.2. <u>Rekomandimi</u>:** Nga Drejtoria e Financës, të merren masa për të bërë sistemimin e llogarisë 401-408 "*"Furnitorë e llogari të lidhura me to"*" dhe 467 "*Kreditorë të ndryshëm*", të cilat janë nënvlerësuar përkatësisht me 22,586,833 lekë dhe 4,099,781 lekë për vitin 2019. Gjithashtu, pas saktësimit të detyrimeve të prapambetura, duhet të merren masa për raportimin e tyre në Ministrinë e Financave, raportim i cili aktualisht nuk është real. **Menjëherë dhe në vazhdimësi**

**9. Gjetje nga auditimi:** Duke marr shkas nga mënyra e financimit të kontratave të investimit të cilat, si afat zbatimi dhe për pasoj dhe afat faturimi dhe stacionimi ndaj Bashkisë Shkodër, janë të ndryshme nga afati i financimit të tyre, kjo detyrimisht do të çoj në lindjen e detyrimeve të prapambetura, përderisa likuidimi i një fature sot, shkallëzohet në periudhat e tjera ushtrimore (vitet 2019, 2020 dhe 2021 sipas planit të pagesave dhe PBA-së). Duke analizuar faturat e investimeve të cilat janë klasifikuar si 401-408 por që në fakt kontrata e investimit të të cilave ka filluar në vitin 2019 dhe likuidimi i tyre kalon në vitet 2020 dhe 2021, duhet ri klasifikuar në 467 si detyrime të prapambetura, si dhe duhen debituar në kundërparti llogari 486 "Shpenzime te periudhave te ardhshme". Sistemimi kontabël në nivel fature paraqitet ne **aneksin 2** për vitet 2019 dhe 2020 llogarisë *(Më hollësisht trajtuar në pikën III/2.3, faqe 83-90, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**9.1 <u>Rekomandimi</u>:** Nga Drejtoria e Financës, të merren masa për të bërë sistemimin e llogarisë 481- *"Shpenzime për tu shpërndarë"*, e cila duhet të sistemohet në vlerë duke kaluar në llogarinë 486- *"Shpenzime të periudhave të ardhshme"*, si dhe llogaria *401-404 "Furnitorë e llogari të lidhura me to",* për të gjitha faturat e aneksit 2 të cilat duhet të sistemohet në llogarinë *467 Kreditorë të ndryshëm,* duke qenë se këto fatura për investime përbëjnë detyrime të prapambetura.

**Menjëherë dhe në vazhdimësi**

**10. Gjetje nga auditimi:** Regjistrimi në kontabilitet i debitorëve, të cilët në analizën e tyre përbëhen nga debitorët nga taksat dhe tarifat vendore për subjektet private, abonentë familjar, gjobat e IMTV ndër vite, debitorët e trashëguar ndër vite nga ish- Komunat, sot Njësit Administrative, si dhe nga kamatëvonesa të cilat përbëjnë të ardhura të pa arkëtuara, për vitin 2020, si më poshtë;

*Llogaria 468 "Debitorë të ndryshëm"* në shumën 1,174,224,674 lekë te 475 *"Te ardhura për t'u regjistruar vitet pasardhëse"* në shumën 1,174,224,674 lekë.

Në nivel llogarie, regjistrimi i të ardhurës sipas dhe udhëzimit nr. 8 datë 9.3.2018, "*Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme*", në momentin e njohjes apo konstatimit të të ardhurës, në varësi të llojit të të ardhurës, bëhet regjistrimi kontabël dhe debitohet 468 "*Debitorë të ndryshëm*" e vitit përkatës, duke kredituar klasa 70 "*Të ardhurave të vitit përkatës*", në të cilën është njohur debitori. Pra debitorët, në rastin konkret si kundërparti kanë pasur llogarinë 475 "*Te ardhura për t'u regjistruar*

*vitet pasardhëse*", kur në fakt duhej të kreditohej klasa 7, pra e ardhura përkatëse e çdo viti në të cilin është njohur debitori.
Përfundimisht për vitin 2020 duhet të bëhet sistemimi i llogarisë 475 "*Te ardhura për t'u regjistruar vitet pasardhëse"* për vlerën 1,174,224,674 lekë në 2020, duke transferuar njohjen e të ardhurave përkatëse në secilin vit llogarisë *(Më hollësisht trajtuar në pikën III/2.3, faqe 83-90, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
**10.1. <u>Rekomandimi</u>:** Nga Drejtoria e Financës, të merren masa për të bërë sistemimin në kontabilitet të llogarive kontabël 475 Te ardhura për t'u regjistruar vitet pasardhëse si dhe llogarive vjetore të të ardhurave të klasës 70 "Tatime dhe taksat dhe tatimet". Gjithashtu të sistemohet e ardhura e akumuluar ndër vite nga taksat dhe tarifat vendore për secilin vit përkatës në llogarinë 1210 "Rezultat i mbartur i seksionit të funksionimit" të vitit në vazhdim.

**Menjëherë dhe në vazhdimësi**

**11. Gjetje nga auditimi:** Për vitin fiskal 2020, llogaritë 150 "*Shuma të parashikuara për rreziqe e shpenzime"* dhe 683 *"Shuma të parashikuara të shfrytëzimit*" paraqiten në vlerat zero lekë. Duke marrë informacion në lidhje me vendimet gjyqësore të formës së prerë *(aneksi 3),* konstatuam se nuk janë kontabilizuar dhe paraqitur në bilancin kontabël 2020. Për vitin 2020 duhet të debitohej llogaria 683 "*Shuma të parashikuara të shfrytëzimit*" për 29,911,758 lekë dhe të kreditohej kundërparti llogaria 150 "*Shuma të parashikuara për rreziqe e shpenzime***"** në shumën 29,911,758 lekë, veprime në kundërshtim me ligjin 9228 datë 29.04.2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare" neni 6, 7, 9 dhe 10; ligji 10296 datë 8.7.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" neni 6, udhëzimin nr.8 datë 9.3.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme" pika 34 , urdhrit nr.64 datë 22.07.2014 " Për shpallje të Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit të Përmirësuara" dhe Standartit Kombëtar të Kontabilitetit nr.6 "Provizionet, detyrimet dhe aktivet e kushtëzuara *(Më hollësisht trajtuar në pikën III/2.3, faqe 83-90, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
**11.1. <u>Rekomandimi</u>:** Nga Bashkia Shkodër, nëpërmjet Nëpunësit Zbatues, të marrë masa për të bërë sistemimet në kontabilitet të llogarisë 150 "*Shuma të parashikuara për rreziqe e shpenzime*" dhe llogarisë 683 "*Shuma të parashikuara të shfrytëzimit*".

**Me mbylljen e pasqyrave financiare viti 2021**

**12. Gjetje nga auditimi**: Nga auditimi i zbatimit të procedurës për leje ndërtimi u konstatua se lejet e zhvillimit dhe ndërtimit;
- nr. Prot. 7808/2, datë 07.07.2020 dhe lejes së ndërtimit nr. Prot 11938/5 datë 17.12.2020 me objekt "Objekt banimi dhe shërbime 6 dhe 7 kate me bodrum)",
- nr. Prot 5699/2, datë 30.04.2020 dhe lejes së ndërtimit nr. Prot 6170/5 datë 22.05.2020 me objekt "Qendër Kulturore Polifunksionale",
- nr.prot.11780 datë 05.07.2019 dhe lejes së ndërtimit nr. Prot 15522 datë 13.09.2019 me objekt "Banesë 2 kate + bodrum,

janë miratuar pa plotësuar kushtin e ruajtjes së distancës midis gjurmës së ndërtimit nga kufiri i pronës dhe objektit në ndërtim nga objektet ekzistuese (*distanca ndërtes nga ndërtes*), veprim në kundërshtim me nenet 34, 35 të VKM nr. 408, datë 13.05.2015 *"Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit"* të ndryshuar, si dhe me pikën 3.4.3 të Rregullores së Planit të Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Shkodër *(Më hollësisht trajtuar në pikën III/2.6, faqe 153-160, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
**<u>12.1 Rekomandimi</u>:** Titullari i Bashkisë Shkodër në bashkëpunim me Drejtorinë e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit, të marrin masa që në vazhdimësi të miratojnë leje zhvillimore dhe leje ndërtimi vetëm atëherë kur distancat e objektit të zhvilluar plotësojnë qartazi

treguesit e distancave në 3 nivele; distancë ndërmjet ndërtesave, ndërmjet ndërtesës dhe kufirit të pronës si dhe ndërmjet ndërtesës dhe trupit të rrugës.

**Menjëherë dhe në vazhdimësi**

**13. Gjetje nga auditimi:** Për zbatimin e rekomandimeve për përmirësimin e gjendjes nga auditimi i fundit të kryer në Bashkinë Shkodër, sipas shkresës nr. 610/60, datë 04.12.2020, u konstatua se: Bashkia Shkodër për zbatimin e rekomandimeve të KLSH, ka kthyer përgjigje me shkresën nr. 19475 prot., datë 23.12.2020 brenda afatit 20 ditor, ndërkohë nuk ka raportuar brenda 6 muajve nga data e njoftimit të raportit të auditimit mbi zbatimin e rekomandimeve sipas pikës 2 të nenit 30 të ligjit nr. 154/2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit".

Nga verifikimi i zbatimit të detyrave të lënë nga auditimi i fundit, u konstatua se: nga 7 masa organizative, vijojnë të jenë në proces zbatimi 7 masa. Nga 1 masa shpërblim dëmi për 8 subjekte në vlerën 8,000,000 lekë, janë zbatuar pjesërisht për 3 subjekte në vlerën 3,000,000 lekë, janë nisur njoftimet për 5 subjekte në vlerën 5,000,000 lekë, por ende nuk kanë filluar arkëtimet ose proceset gjyqësore *(Më hollësisht trajtuar në pikën IV/6, faqe 146-153, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**13.1. <u>Rekomandimi</u>:** Kryetari i Bashkisë Shkodër të analizojë situatën e mos zbatimit plotësisht të rekomandimeve të dërguara nga KLSH-ja me shkresën nr. 610/66 prot, datë 04.12.2020, duke nxjerrë përgjegjësitë e personave përgjegjës, si dhe të hartojë plan pune të veçantë e të marrë të gjitha masat e duhura ligjore për *rizbatimin* e plotë të tyre, *respektivisht*:

a-Për **7** masa organizative me vlerë **1,027,797 mijë lekë**.

b-Për **1** masë shpërblim dëmi në vlerën **8,000 mijë lekë**.

**Menjëherë dhe në vazhdimësi**

**14. Gjetje nga auditimi**: Nga auditimi i dosjeve teknike të zbatimit të punimeve civile të kontratës me nr. 3349/12 prot datë 22.05.2019, me objekt "Rikonstruksion rruga Velipojë Plazh, Loti II-të", Bashkia Shkodër dhe nr. 1931/12 prot datë 10.04.2019, me objekt "Rikonstruksion rruga Udha kryq", Bashkia Shkodër, u konstatua se janë realizuar zëra të rinj dhe nuk është bërë negocim çmimi, duke kryer analiza çmimi, në kundërshtim me UKM nr. 2, datë 13.05.2005 "Për zbatimin e punimeve të ndërtimit", i ndryshuar, Kreu II, pika 8.3 *(Më hollësisht trajtuar në pikën III/2.4.4, faqe 140-146, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)***.**

**14.1. <u>Rekomandim</u>:** Drejtoria e Shërbimeve Publike, ndjekjes së Investimeve të infrastrukturës, si autoriteti që ndjek zbatimin e punimeve të kontratave të investimeve, të marrë masa që për të gjithë zërat e rijnë të realizuar jashtë kontrate, të bëhet negocimi i çmimit dhe analizat teknike të hartohen sipas analizave teknike në fuqi, me vlerën ekonomike më të mirë.

**Menjëherë dhe në vazhdimësi**

**15. Gjetje nga auditimi:** Autoriteti kontraktor për llogaritjen e çmimit të karburanteve nuk është mbështetur në buletinet e APP në çmimet referuar bursës REUTERS për datën e furniturës lëvruar *sipas kushtit CIF-Shqipëri në këtë moment,* sipas raporteve të analizave nga Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial për sasinë e importuar**,** gjithashtu janë shtuar elementë fiskalë si "*taksa e markimit*" jo në përputhje me ligjin nr. 9975, datë 28.07.2008, "*Për taksat Kombëtare*", të ndryshuar, pasi është shtuar dhe taksa e shënjimit të naftës bruto dhe nënprodukteve të naftës sipas VKM nr. 498, datë 30.05.2013 dhe në kundërshtime me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik"*, neni 77, pika 5 *(Më hollësisht trajtuar në pikën III/2.3, faqe 83-90, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**15.1. <u>Rekomandimi</u>:** Autoriteti Kontraktor Bashkia Shkodër, në hartimin e kontratave të furnizimit me karburant, gazoil, benzol dhe karburant për ngrohje të marrin parasysh kriteret për vlerësimin e furniturës, si çmimin e bursës sipas Reuters, lëvruar sipas kushtit CIF Shqipëri,

elementeve fiskalë, etje, referuar rregullave të prokurimit publik dhe Dokumenteve Standarde të Tenderit.
Urdhër shpenzimet për vlerat e likuiduara nga autoriteti kontraktor për karburante, të shoqërohen me faturat tatimore, raportin e analizave nga Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial për sasinë e produktit të importuar për të vërtetuar cilësinë dhe standardet e furniturës lëvruar sipas kushtit CIF-Shqipëri dhe kushteve të kontratës.
Nga ana e Bashkisë Shkodër, në llogaritjen e çmimit të karburanteve, duhet të mbështetet në buletinet e APP, me çmimet referuar bursës REUTERS për datën e furniturës, sipas *kushtit CIF-Shqipëri*, raporteve të analizave sipas datës respektive të lëshuara nga Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial për sasinë e produktit të importuar, referuar elementëve fiskalë të përcaktuara me ligj.

**Menjëherë dhe në vazhdimësi**

**16. <u>Rekomandimi</u>:** Kryetari i Bashkisë Shkodër në mbledhjen e radhës të Këshillit Bashkiak të analizojë Raportin Përfundimtar të Auditimit të kryer në Bashkinë Shkodër për periudhën e veprimtarisë ekonomike 01.7.2019 – 31.12.2020, duke analizuar të gjitha shkeljet dhe rekomandimet e dhëna nga KLSH për nxjerrjen e përgjegjësive të personave përgjegjës dhe marrjen e masave për zbatimin e rekomandimeve dhe përmirësimin e punës në të ardhmen, kjo në zbatim të pikës 4 e nenit 50, të ligjit nr. 68/2017, datë 27.4.2017 "Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore".

**Në mbledhjen e radhës së Këshillit Bashkiak**

## B. <u>MASA PËR SHPËRBLIM DËMI:</u>

Bazuar në ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit" neni 15 "Të drejtat dhe detyrat e KLSH-së", germa (b) dhe (c), si dhe mbështetur në ligjin nr. 44/2015, datë 30.04.2015 "Kodi i procedurave administrative në Republikën e Shqipërisë" nenet 98-102, ligjin nr. 139/2015, datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore" nenet 21-33 dhe udhëzimin e Ministrit të Financave nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", pika 93, nga **Titullari i Njësisë Publike**, me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit, të nxirren aktet administrative përkatëse dhe të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit. **Nëpunësi Zbatues** të ndjekë procesin dhe të kryejë regjistrimet e nevojshme kontabël përfundimtare, me qëllim shpërblimin e dëmit në vlerën **16,429,467 lekë** ndaj **5 subjekteve**, si më poshtë:

**1. Gjetje nga auditimi**: Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt *"Rikonstruksion rruga Velipojë Plazh, Loti I-rë",* me vlerë 31,876,487 lekë me TVSh, fituar nga BOE "N..." & "A...", rezultuan diferenca në volume pune të pakryera në fakt në vlerën 1,065,759 lekë pa TVSh, veprimet në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes nr. 3349/13 prot datë 24.05.2019 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkia Shkodër dhe BOE "N..." & "A..." *(Më hollësisht trajtuar në pikën III/2.4.4, faqe 140-146, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
**1.1. <u>Rekomandim</u>:** Drejtoria e Financës në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike, Bashkia Shkodër të marrë masa për arkëtimin e vlerës prej **1,065,759 lekë pa TVSh** nga BOE "N..." & "A...", në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 3349/13 prot datë 24.05.2019, me objekt

"*Rikonstruksion rruga Velipojë Plazh, Loti I-rë*", duke ndjekur të gjitha procedurat administrative e ligjore në të gjitha shkallët e gjykimit, vlerë kjo e cila përfaqëson punimeve të pakryera.

**Brenda datës 31.12.2021**

**2. Gjetje nga auditimi**: Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt *"Rikonstruksion rruga Velipojë Plazh, Loti II-të",* me vlerë 47,839,706 lekë me TVSh, fituar nga OE "C..." SHPK, rezultuan diferenca në volume pune të pakryera në fakt në vlerën 337,290 lekë pa TVSh, veprimet në kundërshtim me kontratën nr. 3349/12 prot datë 22.05.2019 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkia Shkodër dhe OE "C..." *(Më hollësisht trajtuar në pikën III/2.4.4, faqe 140-146, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**2.1. <u>Rekomandim</u>:** Drejtoria e Financës në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike, Bashkia Shkodër të marrë masa për arkëtimin e vlerës prej **337,290 lekë pa TVSh** nga OE "C...", në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 3349/12 prot datë 22.05.2019, me objekt *"Rikonstruksion rruga Velipojë Plazh, Loti II-të*", duke ndjekur të gjitha procedurat administrative e ligjore në të gjitha shkallët e gjykimit, vlerë kjo e cila përfaqëson punimeve të pakryera.

**Brenda datës 31.12.2021**

**3. Gjetje nga auditimi**: Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt *"Rikonstruksion rruga Udha kryq"*, me vlerë të kontratës 24,973,654 lekë me TVSh, fituar nga BOE "S..." & "S..." SHPK, rezultuan diferenca në volume pune të pakryera në fakt në vlerën 369,055 lekë pa TVSh, veprimet në kundërshtim me kontratën nr. 1931/12 prot datë 10.04.2019 të lidhur mes AK Bashkia Shkodër dhe BOE "S..." & "S..." *(Më hollësisht trajtuar në pikën III/2.4.4, faqe 140-146, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**3.1. <u>Rekomandim</u>:** Drejtoria e Financës në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike, Bashkia Shkodër të marrë masa për arkëtimin e vlerës prej **369,055 lekë pa TVSh** nga BOE "S..." & "S...", në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 1931/12 prot datë 10.04.2019, me objekt "*Rikonstruksion rruga Udha kryq*", duke ndjekur të gjitha procedurat administrative e ligjore në të gjitha shkallët e gjykimit, vlerë kjo e cila përfaqëson punimeve të pakryera

**Brenda datës 31.12.2021**

**4. Gjetje nga auditimi:** Autoriteti kontraktor për llogaritjen e çmimit të karburanteve nuk është mbështetur në buletinet e APP në çmimet referuar bursës REUTERS për datën e furniturës lëvruar *sipas kushtit CIF-Shqipëri në këtë moment,* sipas raporteve të analizave nga Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial për sasinë e importuar**,** gjithashtu janë shtuar elementë fiskalë si "*taksa e markimit*" jo në përputhje me ligjin nr. 9975, datë 28.07.2008, "*Për taksat Kombëtare*", të ndryshuar, pasi është shtuar dhe taksa e shënjimit të naftës bruto dhe nënprodukteve të naftës sipas VKM nr. 498, datë 30.05.2013 dhe në kundërshtime me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik"*, neni 77, pika 5. Nga auditimi i zbatimit të kontratave të blerjes së karburantit rezultoi se në likuidimin e sasisë së karburantit gazoil dhe benzol nga Bashkia Shkodër, nuk është respektuar çmimi i miratuar sipas kontratës për furniturën referuar bursës REUTERS për datën e furniturës *lëvruar sipas kushtit CIF-Shqipëri në këtë moment,* gjithashtu si element i çmimit është llogaritur edhe markimi i karburantit, si rrjedhojë janë kryer pagesa të tepërta për gazoilin dhe benzolin e likuiduar në vlerën **239,068 lekë** me TVSh e cila duhet ti kthehet bashkisë nga subjekti "K..." ShPK. me NIUS pasi është përfituar në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", neni 77, pika 5 *(Më hollësisht trajtuar në pikën III/2.3, faqe 83-90, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**4.1. <u>Rekomandimi</u>:** Nga ana e Bashkisë Shkodër dhe Drejtorisë së Financës, të ndiqen të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, për

arkëtimin e vlerës prej **239,068 lekë me TVSh** e cila duhet ti kthehet bashkisë nga subjekti "K... " ShPK me NIUS

**Brenda datës 31.12.2021**

**5. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i procedurave të prokurimit me objekt "Ruajtje e godinës për Administrimin dhe Mirëmbajtjen e Stadiumit "Loro Boriçi" dhe "Shpenzime të tjera për Administrim dhe Mirëmbajtje e Stadiumit 'Loro Borici'", u konstatua se investimi primar mbi stadiumin "Loro Borici" ishte "Ndërtimi i tribunës kryesore në perëndim dhe të tribunës në jug, rikonstruksion i tribunës kryesore në veri dhe në lindje në stadiumin Loro Borici". Ky investim, ka ardhur pas nënshkrimit të marrëveshjes së protokolluar në Bashkinë Shkodër me nr. prot 11445 datë 07.12.2015, midis Federatës Shqiptare të Futbollit dhe Bashkisë Shkodër. Kjo marrëveshje konsiston në vullnetin dhe kërkesën e FSHF-së për të investuar në rikonstruksionin e stadiumit "Loro Borici". Origjina e financimit të këtij investimi është përcaktuar në VKM nr. 732 datë 02.09.20015 "Për bashkëfinancimin e Stadiumit Loro Borici" ku nga buxheti i shtetit i akordohej fondi prej 1.5 miliard lekësh i cili i vihet në dispozicion Ministrisë së Arsimit dhe të Sporteve, në programin buxhetor 08140 "Programi për Sportin" dhe pas miratimit nga Komiteti i Ndihmës Shtetërore, i transferohet Federatës Shqiptare të Futbollit. Pjesa tjetër e investimit do të mbulohet nga UEFA, FIFA dhe vet FSHF.

Për sa i përket pronësisë së stadiumit "Loro Borici", theksojmë se nëpërmjet VKM-së nr.421 datë 02.06.2010 "Për miratimin e listës përfundimtare (të pjesshme) të pronave të paluajtshme publike, që transferohen në pronësi ose në përdorim të bashkisë Shkodër, të qarkut të Shkodrës" është transferuar ,ndër te tjera nga lista e inventarit publik , edhe stadium "Loro Borici" nga lista e inventarit të pronave publike në listën e inventarit të Bashkisë Shkodër. Megjithatë, pas përpjekjeve të njëpasnjëshme të bashkisë, dhe përcjelljeve të kërkesave për regjistrim në ZVPP Shkodër (sot ASHK Shkodër) dhe ZQPP deri tek Ministri i Drejtësisë, pas pagesës së faturave të shërbimit pranë ASHK-së Shkodër për regjistrim të objekteve në inventarin e saj, nuk është arritur të merret një përgjigje se përse ASHK Shkodër nuk ka regjistruar listën e pronave të transferuara nëpërmjet VKM-së nr.421 datë 02.06.2010, përfshirë në këtë listë edhe stadiumin "Loro Borici". Kjo pronë është e paregjistruar si dhe nuk bën pjesë në Aktivet Afatgjata Materiale të Pasqyrave Financiare të Bashkisë Shkodër.

Duke marrë shkas nga sa më sipër, në mbështetje të marrëveshjes së FSHF-së dhe Bashkisë Shkodër , e cila u miratua me Vendim të Këshillit Bashkiak nr. 50 datë 04.12.2015., u sigurua dhe leja e ndërtimit për objektin nga ana e Këshillit Kombëtar të Territorit me vendim të KKT nr.1 datë 01.04.2015. Në këtë vendim të KKT-së, përcaktohet qartë se subjekti kërkues për leje është Federata Shqiptare e Futbollit, e cila, sipas pikës 4 të vendimit, duhet ti jepej Formular i Lejes së Ndërtimit (zbardhja e lejes së ndërtimit nga Bashkia Shkodër) *vetëm pasi subjekti kërkues FSHF të ketë paguar taksën e ndikimit në infrastrukturë për llogari të Bashkisë Shkodër*. Pas ballafaqimit me subjektin Bashkia Shkodër, u arrit në konkluzionin se taksa e ndikimit ne infrastrukturë nuk ishte llogaritur për shkak se nuk është bërë një aplikim për leje ndërtimi nga ana e subjektit kërkues që është Federata Shqiptare e Futbollit (referuar dhe Vendimit të KKT-së nr.1 datë 01.04.2015 pikës 1 dhe 4) Si konkluzion, nisur nga ligji 145/2015, datë 17.12.2015 dhe nga Paketa Fiskale e vitit 2015, taksa e ndikimit në infrastrukturë që duhet të ishte llogaritur nga Drejtoria e Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit si dhe paguar nga Federata Shqiptare e Futbollit, llogaritet si më poshtë;

*Llogaritja sipas situacionit përfundimtar;*

Nisur nga situacionit përfundimtar i sjellë nga ndërtuesit "T...", vlera e TNI-së llogaritur sipas legjislacionit të sipërpërmendur është:

TNI= Situacioni përfundimtar pa pjesën e financimit të buxhetit të shtetit x 2% = 720,914,773 lekë x 2%= 14,418,295 lekë.

Vlera prej **14,418,295 lekë** për shkak të mosllogaritjes së taksës së ndikimit në infrastrukturë, përbën dëm ekonomik shkaktuar buxhetit të Bashkisë Shkodër *(Më hollësisht trajtuar në pikën III/2.6, faqe 153-160, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**5.1.Rekomandimi:** Titullari i Bashkisë Shkodër në bashkëpunim me Drejtorinë e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit, të marrin masa për arkëtimin e vlerës **14,418,295 lekë** nga **Federata Shqiptare e Futbollit,** duke ndjekur procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit.

**Brenda datës 31.12.2021**

## C. MASA PËR ELIMIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICENCE DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE.

**1. Gjetje nga auditimi:** Në Bashkinë Shkodër për periudhën objekt auditimi 01.7.2019 – 31.12.2019, janë realizuar gjithsej **260** procedura me fond limit 1,633,987 mijë lekë dhe vlerë kontrate 1,422,698 mijë lekë. Grupi i KLSH-[së], referuar të dhënave të riskut nga **260** procedura me fond limit 1,633,987 mijë lekë ka vlerësuar për auditim **89** procedura me fond limit 1,102,197 mijë lekë ose 67.4% të fondit të prokuruar.

Nga auditimi i 89 procedura me fond limit 1,102,197 mijë lekë, u konstatua se në **11** procedura mos zbatimit të kërkesave ligjore gjatë zhvillimit të procedurave të prokurimit publik, si në aplikimin e kritereve dhe në shpalljen fitues të operatorë ekonomikë të cilët nuk plotësojnë disa nga kriteret e veçanta për kualifikim, të përcaktuara në DT, duke përdorur fonde publike në kundërshtim me kërkesat ligjore, në vlerën **135,672 mijë lekë** ose 13 % e fondit limit të audituar, veprime në kundërshtim me ligji nr. 9643, datë 20.11.2006, "Për prokurimin publik", i ndryshuar, përkatësisht: neni 2, *"Parimet e përzgjedhjeje",* neni 24, *"Anulimi i një procedure",* neni 46, *"Kualifikimi i ofertuesve"*, pika 1, neni 47, "*S`kualifikimi i ofertuesve*", neni 53, *"Shqyrtimi i ofertave",* neni 55, *"Kriteret e përcaktimit të ofertës",* neni 58, *"Njoftimi i fituesit dhe nënshkrimi i kontratës"*, pika 1; VKM nr. 914, datë 29.12.2014, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, nenet: 26, "*Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave*", pika 5, neni 66, "*Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave*", neni 67, *"Klasifikimi i ofertave"*, neni 69, *"Njoftimi i fituesit"*, neni 70 *"Lidhja e kontratës"*, neni 78 "*Ankesat në autoritetin kontraktor,* si dhe Vendimi i KM nr. 514, datë 20.9.2017 "Për miratimin e listës kombëtare të profesioneve (LKP)", të rishikuar *(Më hollësisht trajtuar në pikën IV/2.4, faqe 90-140, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**1.1. Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë Shkodër, në cilësinë e Titullarit të AK, të marrë masa që në komisionet e NHDT dhe KVO, të emërojë persona me profil sipas llojit të procedurës, ku të aplikojnë kritere në përputhje me natyrën e procedurës së zhvilluar.

Gjithashtu të analizojë arsyet e kualifikimit të padrejtë të operatorëve ekonomikë, dhe të marrë masa për eliminimin e praktikave të tilla, kjo për të bërë të mundur përdorimin më me efektiv të fondeve të prokura.

**Menjëherë dhe në vazhdimësi**

## D. TË ARDHURAT E MUNGUARA

**1. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i dokumentacionit të paraqitur nga DAV Bashkia Shkodër, u konstatua se referuar Vendimit të KB për paketën fiskale, taksa e ndërtesës për familjarët në mungesë të dokumentacionit ligjorë *(genplani për sipërfaqet ose të dhënave nga ASHK)* është lënë 100 $m^2$, mbi të cilën janë aplikuar tarifat sipas ligjit (çmim/$m^2$). Kjo mënyrë e aplikimit të taksës së ndërtesës për familjarët, favorizon disa dhe penalizon disa të tjerë, pasi pas viteve 90 ka shumë ndërtime me sipërfaqe mbi 100 $m^2$ *(2 dhe 3 kate)*, të cilat nuk janë identifikuar, duke bërë që ndajë tyre të mos aplikohet saktë taksa e ndërtesës, veprime të cilat çojnë në mungesë të ardhurave nga kjo takes.

Gjithashtu, referuar të dhënave të marra nga Drejtoria e Planifikim Zhvillim Territorit (PZHT) Bashkia Shkodër, u konstatua të jenë dhënë këto leje ndërtimi/ zhvillimi investitorëve të ndryshëm, ndajë të cilave DAV Bashkia Shkodër nuk ka aplikuar saktë taksës e ndërtesës sipas sipërfaqeve të ndërtimit që ato disponojnë, sipas të dhënave të marra në DPZHT për **6** subjekte, duke krijuar të ardhura të munguara në buxhetin e Bashkisë Shkodër në shumën **648,359 lekë** për vitin 2020**,** veprime në kundërshtim me nenet 20, 21 dhe 22, të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 "Për Taksat vendore" i ndryshuar dhe pikës 4 të VKM nr. 132, datë 7.3.2018 "Për metodologjinë për përcaktimin e vlerës së taksueshme të pasurisë së paluajtshme "ndërtesa", e bazës së taksës për kategori specifike, natyrën dhe prioritetin e informacionit dhe të dhënave për përcaktimin e bazës së taksës, si dhe të kritereve dhe rregullave për vlerësimin alternativ të detyrimit të taksës" *(Më hollësisht trajtuar në pikën III/2.2.6, faqe 54-83, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**1.1. <u>Rekomandimi:</u>** Drejtoria e të Ardhurave Vendore Bashkia Shkodër në bashkëpunim me strukturat e tjera të Bashkisë Shkodër, të marrë masa për evidentimin e objekteve të abonentëve familjarë dhe jo vetëm me sipërfaqe mbi 100 $m^2$, duke aplikuar saktë taksën e ndërtesës, kryesisht të objekteve të dyta dhe të ndërtuara pas viteve 90.

**1.2. <u>Rekomandimi:</u>** Drejtoria e të Ardhurave Vendore, të ndjekë të gjitha proçedurat administrative e ligjore për arkëtimin e taksës së ndërtesë ndaj **6** subjekteve për vlerën **648,359 lekë**, të pataksuar si më poshtë:

**- vlera 271,788 lekë**, ndajë subjektit "C...".
**- vlera 157,992 lekë**, ndajë subjektit "A...".
**- vlera 74,820 lekë**, ndajë subjektit "P...".
**- vlera 17,910 lekë**, ndajë subjektit "V...".
**- vlera 103,617 lekë**, ndajë subjektit "D....

**Menjëherë dhe në vazhdimësi**

**2. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i dokumentacionit mbi planifikimin e taksës së tokës bujqësore për vitet 2019 – 2020, u konstatuan rezerva në planifikim, pasi sipas të dhënave të marra nga Drejtoria e Bujqësisë, Zhvillimit rural dhe trajtimit te AMTP, mbi ndarjen e tokës bujqësore për familje dhe boniteti, evidentohet mos planifikim në vlerën 7,170 mijë lekë.

Kështu sipas të dhënave të pasqyrës sipërfaqja gjithsej e tokës së ndarë sipas fshatrave dhe familjeve është 16043.25 ha. Për këtë sasi toke të ndarë, referuar boniteti të tokës sipas fshatrave dhe çmimit për bonitet të miratuara në paketat fiskale me VKB, planifikim i kësaj takse për një vit ushtrimorë duhej të ishte në vlerën 25,321 mijë lekë, por në fakt nga DAV Bashkia Shkodër është planifikuar një vlerë prej 21,736 mijë lekë ose më pak për shumën 3,585 mijë lekë dhe për dy vite objekt auditimi në shumën **7,170 mijë lekë,** një e ardhur munguar në buxhetin e Bashkisë Shkodër, veprime në kundërshtim me nenin 20, 21 dhe 22 të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 "Për Sistemin e Taksave Vendore" i ndryshuar *(Më hollësisht trajtuar në pikën III/2.2.6, faqe 54-83, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**<u>2.1. Rekomandimi:</u>** Drejtoria e të Ardhurave Vendore Bashkia Shkodër në bashkëpunim me Drejtorinë e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Trajtimit te AMTP, të marrë masa për evidentimi e të gjithë familjeve me tokë bujqësore sipas të dhënave të Drejtorisë së Bujqësisë, duke evidentuar familjet me tokë bujqësor dhe të pataksuar, si dhe të ndiqen të gjitha rrugët administrative e ligjore për planifikimin dhe arkëtimin e detyrimeve të pataksuara dhe pa arkëtuara gjatë periudhave ushtrimore në vlerën **7,170 mijë lekë**.

**Menjëherë dhe në vazhdimësi**

**3. Gjetje nga auditimi:** Sipas dokumentacionit të paraqitur nga DAV Bashkia Shkodër mbi aktivitetin e Sektorit të Kontrollit në Terren, konstatohet se për vitet 2019 dhe 2020 nga ana e këtij sektori janë evidentuar një numër subjektesh të regjistruar në Bashkinë Shkodër që shfrytëzojnë hapësira publike pa lidhur kontratë dhe papaguar detyrimet përkatëse sipas tarifës së përcaktuar në VKB. Me shkresë përcjellëse, akt-konstatimet i janë dërguar Policisë Bashkiake për penalizim dhe bllokim të aktivitetit deri në fazën e lidhjes së kontratës, <u>por nga Policia Bashkiake nuk është kryer asnjë veprim.</u>

Kështu, referuar të dhënave të paraqitura nga DAV Bashkia Shkodër dhe kundërshtive paraqitur me shkresën nr. 4597/39, datë 11.06.2019 *(port KLSH nr. 362/8, datë 14.06.2021)*, të cilat janë marrë në konsideratë nga grupi i KLSH, rezulton se për periudhën 2019- 2020, mbeten subjekte që shfrytëzojnë hapësira publike, por që nuk i nënshtrohen pagesës, gjithsej për **45** subjekte me një vlerë mesatare detyrimi prej **1,823,223 lekë**, **e ardhur e munguar në buxhetin e Bashkisë Shkodër**, *nga e cila:* për aktivitetin e vitit 2019 në vlerën 523,333 lekë dhe për aktivitetin e vitit 2020 në vlerën 1,294,890 lekë, *të dhëna sipas Tabelave 1 dhe 2, si vijon.*

**Tabela 1. Subjekte debitorë viti 2019**

| Nr. | Emri i subjektit | Detyrimi/lek |
|---|---|---|
| 1 | B... | 40,635 |
| 2 | D... | 35,280 |
| 3 | M... | 29,232 |
| 4 | D... | 8,400 |
| 5 | L.... | 7,840 |
| 6 | S... | 19,600 |
| 7 | G... | 7,840 |
| 8 | S... | 11,740 |
| 9 | E... | 15,680 |
| 10 | A... | 7,560 |
| 11 | R... | 6,300 |
| 12 | F... | 6,300 |
| 13 | S... | 34,020 |
| 14 | I... | 45,360 |
| 15 | G... | 45,360 |
| 16 | R... | 33,600 |
| 17 | E... | 5,712 |
| 18 | E... | 3,780 |
| 19 | A... | 11,760 |
| 20 | A... | 27,440 |
| 21 | D... | 16,800 |
| 22 | S... | 11,424 |
| 23 | K... | 7,560 |
| 24 | E... | 5,040 |
| 26 | P... | 3,780 |
| 27 | A... | 5,880 |
| 28 | V... | 57,120 |
| | **Shuma** | **528,333** |

**Tabela 2. Subjekte debitorë, viti 2020**

| Nr. | Emri i subjektit | Detyrimi/lek |
|---|---|---|
| 1 | A... | 110,880 |
| 2 | D... | 415,800 |
| 3 | A... | 33,075 |
| 4 | J... | 29,400 |
| 5 | A... | 58,800 |
| 6 | E... | 15,750 |
| 7 | A... | 48,510 |
| 8 | F... | 27,000 |
| 9 | G... | 16,905 |
| 10 | M... | 20,475 |
| 11 | A... | 113,400 |
| 12 | B... | 55,125 |
| 13 | E... | 90,720 |
| 14 | G... | 66,150 |
| 15 | B... | 77,400 |
| 16 | I... | 56,700 |
| 17 | S... | 58,800 |
| | **Shuma** | **1,294,890** |

Nga DAV Bashkia Shkodër (Sektori i Kontabilitetit), nuk është ndërmarrë asnjë masë për llogaritjen dhe arkëtimin e tarifës së zënies së hapësirës publike nga subjektet dhe të konstatuar nga kontrolli në terren, por është mjaftuar vetëm në njoftimin e Policisë Bashkiake, duke lënë të lirë subjektet të shfrytëzojnë ato dhe mos paguajnë detyrime, si dhe duke krijuar pabarazi fiskale në subjektet që e pengojnë këtë lloj tarifë dhe krijuar evazion fiskal, veprime të cilat nuk janë kryer dhe nga Policia Bashkiake për penalizmin dhe bllokimin e aktivitetit deri në llogaritjen dhe pagesën e taksës së hapësirës publike, veprime në kundërshtim me nenin 35, të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 "Për Sistemin e Taksave vendore" i ndryshuar dhe kapitulli III.4.11 – Tarifa për zënie hapësirë publike *(Më hollësisht trajtuar në pikën III/2.2.6, faqe 54-83, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**3.1. <u>Rekomandimi</u>:** Drejtoria e të Ardhurave Vendore në bashkëpunim me Drejtorinë e Studimeve, Planifikimit dhe Koordinimit të Investimeve dhe Policinë Bashkiake, të ngrejë një grup pune me specialit të fushës për saktësimin e sipërfaqes së hapësirës publike të zënë **45** subjekte, si dhe të ndjek të gjitha rrugët administrative e ligjore për arkëtimin e vlerës së prej **1,823,223 lekë**, e ardhur e munguar në buxhetin e Bashkisë Shkodër.

**Menjëherë dhe në vazhdimësi**

**4. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i dokumentacionit mbi pasjen me Liçensë tregtimi për subjektet që tregtojnë hidrokarbure dhe derivatet e tyre, u konstatua se ka mangësi në plotësimin e të dhënave të këtyre subjekteve në përgjithësi dhe debitorëve në veçanti, si mos aplikimin e tarifës së licencës dhe lejimin e subjekteve të ushtrojnë aktivitet pa paguar këtë taksë dhe mos ndjekjen e detyrimeve për subjektet të cilat janë pajisur dhe nuk e kanë paguar tarifën.

Sipas të dhënave të paraqitura nga DAV Bashkia Shkodër dhe Drejtoria e Shërbimeve për vitin 2019 ushtrojnë aktivitet në këtë fushë **43** subjekte, ku vetëm 1 subjekt është licencuar për vlerën 1,000,000 lekë (e paguar). Ndërsa për vitin 2020 ushtrojnë këtë aktivitet **45** subjekte, ku vetëm 13 prej tyre janë licencuar. Nga vlera e tarifës prej 10,069,966 lekë është paguar vlera 9,769,966 lekë, duke mbetur pa arkëtuar vlera 300,000 lekë, kjo për 13 subjektet e liçensuar, pasi pagesa është ndarë me këste mujore.

Nga të dhënat e mësipërme, konstatohet se nuk janë licencuar me leje tregtim karburanti, gjithsej **40** subjekte të cilët ushtrojnë aktivitet dhe papaguar detyrimin fiskal në **vlerën 40,000,000 lekë,** e ardhur e munguar në buxhetin e Bashkisë Shkodër**,** *të dhëna të cilat paraqiten në pasqyrën Aneks III/2.6.3, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit*.

Konstatohet se ndajë këtyre subjekteve nga instancat përgjegjëse (DAV Bashkia Shkodër dhe Policia Bashkiake), nuk është ndërmarrë asnjë masë për bllokimin dhe penalizmin e veprimtarisë në zbatim të nenit 25 të ligjin nr. 8450, datë 24.2.1999, "Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre", të ndryshuar, veprime në kundërshtim me ligji nr. 8450, datë 24.2.1999 "Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre", i ndryshuar me ligjin nr. 71/2014 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8450, datë 24.2.1999, "Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre", të ndryshuar, neni 4, neni 20, pika 2 dhe VKM-së nr. 344, datë 19.04.2017, kreu II, pika 9 dhe 10 *(Më hollësisht trajtuar në pikën III/2.2.6, faqe 54-83, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**4.1. <u>Rekomandimi</u>:** Drejtoria e Shërbimeve Publike në bashkëpunim me Drejtorinë e të Ardhurave Vendore dhe Policinë Bashkiake, Bashkia Shkodër, të ndjekë të gjitha rrugët administrative e ligjore për pajisen me liçensa të subjekteve që tregtojnë hidrokarbure dhe derivatet e tyre dhe arkëtimin e tarifës së pataksuar prej **40,000,000 lekë** ndajë **40** subjekteve, *sipas pasqyrës Aneks III/2.6.3 bashkëlidhur Projekt Raport Auditmit*.

**Menjëherë**

**5. Gjetje nga auditimi:** Nga të dhënat konstatohet se, si në planifikim dhe në realizim tarifat për pastrim/gjelbërim dhe ndriçim të abonentëve familjare, vijnë në ulje ku nga 222 milion lekë të planifikuara në vitin 2019 në vitin 2020 është planifikuar vlera 205 milionë lekë, pra më pak për shumën 17 milionë lekë**,** si mungesë të ardhurash në buxhetin e Bashkisë Shkodër**.**
Në lidhje me pagesën e tarifës së pastrim/gjelbërim/ndriçim nga abonentët familjarë, këto administrohen nga agjenti tatimorë “Nd. U...” sha Shkodër, ku referuar të dhënave që përcillen nga DAV Bashkia Shkodër bëhej faturimi tek abonentët që janë me kontratë me U... dhe pas pagesës bëhej xhirimi për llogarit të Bashkisë Shkodër. Por ka dhe një kategori tjetër familjesh të cilat nuk kanë kontratë me U... dhe faturohen vetëm për tarifat vendore.
Nga të dhënat e Gjendej Civile Bashkia Shkodër, evidentohet një numër abonentësh familjarë, gjithsej **10643** familje të pataksuara për taksa/ tarifa vendore, për të cilat DAV Bashkia Shkodër nuk ka ndërmarrë asnjë veprime ligjore për identifikimin dhe taksimin e tyre, veprime këto në mungesë të ardhurash për buxhetin e Bashkisë Shkodër.
Referuar paketës fiskale të miratuara në Bashkinë Shkodër, ku çdo familje paguan taks ndërtese *(100 m$^2$ x 29 lekë)*, taksa tokë, taks trualli *(100 m$^2$ x 0.42 lekë*, tarifë pastrim/gjelbërim/ndriçim (3450 + 600 + 1200), detyrimi i munguar nga mos identifikimi, llogaritja dhe arkëtimi i detyrimeve për abonentët familjarë të pataksuar, përllogaritët në vlerën **118,320,360 lekë** për periudhën objekt çuditmi (2019 – 2020), **si e ardhur e munguar në buxhetin e Bashkisë Shkodër,** veprime në kundërshtim me ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar dhe paketat fiskale të viteve respektive 2019 – 2020 *(Më hollësisht trajtuar në pikën III/2.2.4, faqe 54-83, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
**5.1. <u>Rekomandimi:</u>** Drejtoria e të Ardhurave Vendore Bashkia Shkodër, të marrë masa për evidentimi e të gjithë familjeve të pataksuara me taksa/tarifa vendore, si dhe të ndiqen të gjitha rrugët administrative e ligjore për planifikimin dhe arkëtimin e detyrimeve të pataksuara dhe paarkëtuara gjatë periudhave ushtrimore 2019 -2020 dhe jo vetëm, për vlerën **118,320,360 lekë**.

**Menjëherë dhe në vazhdimësi**

## E/1. MASA PËR ULJEN E BORXHIT TATIMOR.

**1. Gjetje nga auditimi:** Sipas të dhënave për strukturën organike të DAV Bashkia Shkodër, konstatohet se nuk ka një strukturë përgjegjëse për menaxhimin e borxhit (debitorëve nga taksat/ tarifat vendore). Kështu referuar të dhënave të paraqitura nga kjo drejtori, detyrimet për taksat e tarifat vendore për subjektet fizik/juridik dhe abonentë familjare paraqitet si vijon:

*Në 000/lekë*

| Lëvizja e Debitorëve | Subjekte juridik/Institucioni Shtetërore | | Subjekte fizik | | bonentë familjare | | Totali | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | Nr. | Vlerë | Nr. | Vlerë | Nr. | Vlerë | Nr. | Vlere |
| Gjendje 31.12.2018 | 749 | 67,528 | 3472 | 116,002 | 10861 | 819,474 | **15082** | **1,003,004** |
| Shtuar Viti 2019 | | 378,660 | | 331,346 | | 169,846 | **0** | **879,852** |
| Pakësuar Viti 2019 | | 252,587 | | 186,062 | | 362,169 | **0** | **800,818** |
| Gjendje me 31.12.2019 | 788 | 193,601 | 3347 | 188,463 | 4479 | 406,771 | **8614** | **788,835** |
| Shtuar Viti 2020 | | 305,382 | | 227,995 | | 145,899 | **0** | **679,276** |
| Pakësuar viti 2020 | | 275,996 | | 115,826 | | 195,375 | **0** | **587,197** |
| Gjendje me 31.12.2020 | 1647 | 222,987 | 11697 | 300,632 | 4691 | 357,295 | **18035** | **880,914** |

Nga të dhënat konstatohet se detyrimet debitorë paraqiten në rritje nga njëra periudhë në tjetrën, ku nga 8614 subjekte me vlerë 788,835 mijë lekë në fund të vitit 2019, në fund të vitit 2020 kjo gjendje paraqitet për 18035 subjekte me vlerë 880,914 mijë lekë, *pra shtuar për 9421 subjekte me vlerë 92,079 mijë lekë ose shtuar për 8.5%.*
Peshën kryesorëve të detyrimeve për taksat e tarifat vendore e zënë abonentët familjarë, ku në fund të vitit 2020 paraqiten me një vlerë prej 357,295 mijë lekë ose 40.8%, detyrime të cilat mblidhen nga agjenti tatimorë "U..." sh.a.
Konstatohet se çdo vit gjendja e detyrimeve të pa arkëtuara është më e lartë se arkëtimet e vitit, kjo për vlerën e detyrimeve të mbetura.
Referuar dokumentacionit të paraqitur nga DTTV mbi masat e marra në lidhje me punën e kësaj drejtorie ne arkëtimin e debitorëve, në zbatim të ligji nr. 9920, datë 19.05.2008 **"**Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë**"**, me ndryshime, Udhëzimit nr. 24, datë 02.09.2008 **"**Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë**"**, me ndryshime, rezulton se në shkresat përcjellëse (trajtuar në akt-konstatim), nuk janë përcaktuar vlerat për të cilën është kërkuar bllokim dhe sa rezultat ka pasur ky veprim. Nuk i janë dërguar shkresa adresuar Drejtorisë së Transportit për marrjen e masave në arkëtimin e vlera të subjekteve që disponojmë mjete.
Në raport me numrin e subjekteve debitorë në fund të periudhave ushtrimore dhe subjekteve për të cilat është kërkuar në zbatim të ligjit masa shtrënguese, konstatohet se është shumë i vogël, kështu nga 11697 subjekte fizik/ juridik me vlerë 300,632 mijë lekë është zbatuar marrje masa vetëm për 984 subjekte ose 8.4% e totalit të subjekteve. Nuk konstatohet të jenë dërguar njoftim detyrimi për vlerën e borxhit, bllokim të aktivitet për mos likuidim të detyrimeve, vendosja sekuestro dhe deri në kallëzim penal për mos pagës taksa në zbatim të kodi penal, nisur dhe nga fakti se një pjesë e subjekteve janë debitorë në vite dhe për çdo vit ju planifikohen detyrime fiskale të vitit ne vijim.
Për një pjesë të subjekteve nuk janë nxjerre njoftim detyrimet për vlerën e borxhit, por është kaluar direkt në zbatimin e hapave të mëvonshme.
Në momentin e nxjerrjes së urdhër bllokimi të llogarive bankare, në shumicën e rasteve, nuk ka konfirmim nga banka për gjendjen e llogarive të subjektit. Nga ana e DAV Bashkia Shkodër disa herë bankave të nivelit të dytë i është kërkuar zbatimi i urdhër bllokimeve të subjekteve debitorë mbi vlerën e detyrimeve të paarkëtuara, por këto të fundit nuk kanë vepruar.
Nuk janë respektuar afatet ligjore nga një procedurë në një tjetër, duke çuar kështu në mos mbledhjen në kohën e duhur të detyrimit.
Nuk u konstatuan raste për vendosje barrë siguruese dhe hipotekore, apo Njoftim për bllokim të dokumentacionit të mjeteve në pronësi, nga institucionet përkatëse, pothuajse në shumicën e rasteve nuk ka konfirmim të pronës apo mjeteve që subjekti ka në pronësi, dhe mbi të gjitha nuk është vepruar.
Mos zbatimi i plotë i masave shtrënguese, ku për subjektet me vlera të konsiderueshme dhe që janë me status aktiv, janë lejuar të ushtrojë aktivitet ndërkohë që vlera e borxhit vjen në rritje nga njëra periudhë në tjetër, duke pritur nga ndonjë amisti fiskale ose parashkrim të gjobave.
Nga DAV Bashkia Shkodër nuk është ndërhyrë në zbatimin e dispozitave ligjore, deri në padi gjyqësore për arkëtimin e borxhit në zbatim të nenit 15, të Kodit Civil në Republikën e Shqipërisë dhe nenit 203 të Kodit të Punës në Republikën e Shqipërisë, apo të parashikimit të vendimeve (vlerave) të gjobave të përcaktuara në nenin 46 të ligjit "Për Kundërvajtjet Administrative" (brenda 2 viteve), duke u bërë përgjegjës për rritjen e nivelit të borxhit.
Veprimet e mos veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Pikat 3,4, 5 dhe 5, të nenin 45 – *"Çregjistrimi i subjekteve tatimore"* dhe Kreun XI-*Mbledhja me forcë e detyrimit tatimor të*

*papaguar,* të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", me ndryshimet dhe Udhëzimit nr. 24, datë 02.09.2008 **"**Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë**"**, me ndryshime; ligjin nr. 7895, datë 27.01.1995, me ndryshimet e mëvonshme, neni 181 -Mospagimi i taksave dhe tatimeve *(Më hollësisht trajtuar në pikën III/2.2.6, faqe 54-83, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**1.1. <u>Rekomandimi:</u>** Drejtoria e të Ardhurave Vendore Bashkia Shkodër, bazuar në nenin 70 pika 3 "*E drejta për të nxjerrë njoftimin e vlerësimit tatimor*", të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 "Për Procedurat tatimore në R.SH", i ndryshuar, të marrë masa për nxjerrjen e njoftim vlerësimet tatimore për debitorët duke ndjekur të gjitha rrugët për arkëtimin e detyrimeve për taksat dhe tarifat vendore në vlerën **880,914 mijë lekë** *(sipas listave që disponon DAV Bashkia Shkodër, paraqitur në CD),* duke ndjekur procedurat si më poshtë vijon**:**

k- Tu dërgohen bankave të nivelit të dytë urdhrat e bllokimit të llogarive bankare.

l- Të dërgohet në Drejtorinë Rajonale të Transportit, kërkesa për vendosjen e barrës siguruese (për mjetet) dhe në AKSH (për pasuritë e paluajtshme).

m- Për subjektet të cilët nuk kanë paguar detyrimet tatimore në afat, ndaj tyre të aplikohet llogaritja e gjobës në masën 0.06% të shumës së detyrimit të papaguar për çdo dit gjatë së cilës pagesa nuk është kryer, por jo më shumë se 365 ditë (gjobë).

n- Në rast se bizneset private edhe pas njoftimeve zyrtare dhe dërgimit të urdhër bllokimeve në bankë nuk kryejnë pagesën e detyrimeve, pasi të merren masat administrative apo sekuestro, të bëhet kallëzim penal, bazuar në Kodin Penal të RSH, miratuar me ligjin nr. 7895, datë 27.1.1995 me ndryshimet e mëvonshme, neni 181 "Mospagimi i taksave dhe tatimeve".

o- Drejtoria e të Ardhurave Vendore Bashkia Shkodër, në bashkëpunim me Njësitë Administrative, të evidentojë listat emërore të debitorëve familjarë në mënyrë elektronike, duke të njoftojë nëpërmjet postës (dhe jo vetëm) familjet të cilët nuk kanë paguar detyrimet për taksën e tokës/ tarifën e pastrimit, ndriçimit, banesave dhe gjelbërimit.

- Të bashkëpunimet me QKB për mos lejimin e mbylljes së aktivitetit ose kalimi në pasiv të subjekteve me detyrime të paarkëtuara, të cilat kanë premisë për kalimin në debitorë pa shpresë arkëtimi, si dhe të kryhen kontrolle të vazhdueshme në bashkëpunim dhe me Policinë Bashkiake për evidentimin dhe vjeljen e detyrimeve debitorë.

**1.2. <u>Rekomandimi</u>:** Kryetari i Bashkisë Shkodër në bashkëpunim me Drejtorinë e të Ardhurave vendore, të marrin masa që brenda strukturës së DAV Bashkia Shkodër, të krijojnë "Sektorin e Menaxhimit të Borxhit", si një sektor i rëndësishëm në punën për arkëtimin e debitorëve, nisu kjo dhe nga vlera e lartë e detyrimeve të paarkëtuara dhe që vijnë në rritje nga njëra periudhë në tjetrën.

**Menjëherë dhe në vazhdimësi**

**2. Gjetje nga auditimi:** Nga të dhënat konstatohet se taksa e infrastrukturës për ndërtimet e reja dhe në proces legalizimi, në asnjërin nga vitet objekt auditimi nuk është realizuar, fakt ky i cili varet nga niveli i lejeve zhvillimit/ ndërtimit që jepen nga Drejtoria e PZHT sipas periudhave, ku nuk mundësohet dhënia e lejeve të parashikuara për mungesë kërkesash nga personat e interesuar. Ky planifikim i lartë nga njëra periudhë në tjetrën, ku niveli i realizmit nuk kalon 30% është i pabazuar dhe jo real që ndikon në buxhetet e viteve, pasi referuar këtyre shifrave të larta *(por të parealizuara),* Bashkia Shkodër planifikon procedura prokurimi për investime etj., me pretendimin se do realizohen të ardhurat nga taksa e ndikimit në infrastrukturë, ku në totalin e planit të të ardhurave kjo taksa zë 16% të planit.

Në këtë taksë përfshihet dhe taksa nga ndërtimet pa leje, ku sipas dokumentacionit që disponon Drejtoria e të Ardhurave, Bashkia Shkodër në lidhje me legalizimet e ndërtimeve pa leje dhe listave

që disponon për pagesën e taksës së ndikimit në infrastrukturë, u konstatua se nga Drejtoria Rajonale e ASHK Shkodër janë dërguar zyrtarisht me shkresë lista e qytetarëve shoqëruar me leje legalizimi dhe destinuara për regjistrim në ZVRPP Shkodër.

Për periudhën nga 01.01.2016 deri më 31.12.2020, sipas listave të vëna në dispozicion me leje legalizimi dhe kryqëzimi i tyre me personat që kanë bërë të mundur likuidimin e taksës së ndikimit në infrastrukturës, rezulton se detyrimi për këtë taksë është në vlerën 250,613,179 lekë për 2016 persona, kanë paguar detyrimet 115 persona me vlerë 30,232,524 lekë dhe kanë mbetur për likuidim deri datë 31.12.2020 gjithsej **1901** persona me vlerë **220,380,615 lekë,** *e ardhur e munguar në buxhetin e Bashkisë Shkodër (sipas listës të administruar në CD)*.

Nga dokumentacioni i paraqitur, nuk u evidentuan raste që Bashkia Shkodër ti jetë drejtuar ASHK Dega Shkodër, për bllokimin e pasurisë dhe mos kryerjen veprimeve hipotekore ose bllokimin e marrjes së lejes së legalizimit dhe certifikatës pa bërë më parë pagesën taksës së ndikimit në infrastrukturë, veprime në kundërshtim me nenin 27 pika (d), të ligjit nr. 9482, datë 03.04.2006 "Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje,,,"; VKM nr. 860, datë 10.12.2014 "Për përcaktimin e mënyrës së mbledhjes dhe administrimit të të ardhurave për ndërtimet pa leje dhe vlerave të zbatueshme për legalizim" i ndryshuar, pika 5 dhe ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 "Për Sistemin e Taksave vendore", i ndryshuar, neni 27- *Taksa e ndikimit në infrastrukturë*, pika 2/1 *(Më hollësisht trajtuar në pikën III/2.2.6, faqe 54-83, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**2.1. Rekomandimi:** Drejtoria e të Ardhurave Vendore Bashkia Shkodër, të marrë masa duke ndjekur të gjitha procedurat administrative dhe ligjore për arkëtimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë për ndërtimet pa leje në vlerën **220,380,615 lekë** ndaj **1901** personave.

**2.2. Rekomandimi:** Drejtoria e Planifikim Zhvillim Territorit në bashkëpunim me Drejtorinë e të Ardhurave Vendore Bashkia Shkodër, për personat të cilat nuk kanë kryer pagesën e taksës së ndikimit në infrastrukturë për ndërtimet pa leja, t'i kërkojnë Drejtorisë Rajonale Vendore ASHK Shkodër, vendosjen e urdhër kufizimit mbi pasurinë, deri në pagesës e taksës së ndikimit në infrastrukturë.

**2.3 Rekomandimi:** Drejtoria e Planifikim Zhvillim Territorit, në planifikimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë të bazohet në kërkesat e personave për leje dhe faktin e vitit që mbyllet dhe të mos aplikojë apriori vlera të cilat nuk kanë bazë.

**Brenda datës 31.12.2021**

**3. Gjetje nga auditimi**: Nga të dhënat e marra nga Policia Bashkiake, konstatohet se për periudhën 01.01.2019 – 31.12.2020 janë aplikuar gjithsej 550 gjoba me vlerë 1,196,500 lekë, *nga e cila:* janë arkëtuar deri me datë 31.12.2020, gjithsej 170 gjoba me vlerë 243,000 lekë dhe mbetet për arkëtim 380 gjoba me vlerë **953,500 lekë**, e ardhur e munguar në buxhetin e Bashkisë Shkodër. *Sipas llojit të gjobës të dhënat bashkëlidhur Aneksi III/2.6.4, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit*.

Referuar të dhënave të gjobave të Policisë Bashkiake, konstatohet se aktiviteti i tyre nuk është përqendruar në punën kryesore, ndjekjen e shkresave të DAR Bashkia Shkodër dhe Drejtorisë Shërbimeve, të cilat lidhen me të ardhurat munguara në buxhetin e kësaj njësie vendore, pasi nuk evidentojmë të jenë paralizuar subjekte për hapësira publike, subjekte që shfrytëzojnë parkime të rezervuara pa kontratë, subjektet e pikave të karburantit të cilat ushtrojnë aktivitet pa u pajisur me leje bashkie, subjekte debitorë, etj., *(Më hollësisht trajtuar në pikën III/2.2.6, faqe 54-83, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**3.1. <u>Rekomandimi</u>:** Policinë Bashkiake në bashkëpunim me Drejtoria e të Ardhurave Vendore, të marrë masat administrative e ligjore në të gjitha shkallët e gjykimit për arkëtimin e vlerës së gjobave të paarkëtuara prej **953,500 lekë**
Të ndjek me korrektësi zbatimin e shkresave të dërguara nga Drejtoritë/Sektorët e tjerë që kërkojnë mbështetje për të mundësuar realizmin e të ardhurave të munguara nga parregullsitë ligjore të evidentuara.

**Brenda datës 31.12.2021**

**4. Gjetje nga auditimi:** Në lidhje me auditimin e kryer të dokumenteve të vëna në dispozicion nga zyra e IVMT Bashkia Shkodër, për ushtrimin e kontrollit në terren të kontrollit mbi territorin e Bashkisë, nga IVMT, rezultoi se janë mbajtur gjithsej 197 procesverbale konstatimi për ndërtime pa leje.
Janë nxjerrë 197 vendime gjobash për ndërtime të kundërligjshme nga persona të ndryshëm fizik dhe juridik, sipas aneksit bashkëlidhur këtij akti, *nga e cila:* për gjashtë mujorin e dytë të vitit 2019, janë nxjerrë 59 vendime për gjobë për shkelje të legjislacionit në fushën e ndërtimit me vlerë 23,660,000 lekë, *janë likuiduar 10 gjoba me vlerë 1,250,000 lekë.*
Ndërsa për **vitin 2020**, janë nxjerrë 138 vendime me vlerë 51,480,000 lekë, *janë likuiduar 25 gjoba me vlerë 2,020,000.* Gjobat e nxjerra për 5 mujorin e parë të vitit 2020, i janë përcjellë gjykatës për kthimin e tyre në titull ekzekutiv, ndërkohë që nuk ka vendimmarrje për asnjë nga kërkesat e vitit 2020. Pjesa tjetër e gjobave rezultojnë në proces hartimi të kërkesë padisë.
Nga ana tjetër, IMT ka përcjellë gjithashtu pranë Drejtorisë së të Ardhurave të gjitha gjobat nëpërmjet sistemit. Është bërë kontabilizimi i tyre.
Nga sa trajtuam më sipër, për periudhën objekti auditimi nga IVMT janë penalizuar për shkelje të aktive ligjore e nënligjore të ndërtimit, gjithsej 197 vendime me gjobë për vlerën 75,140,000 lekë, ku arkëtuar për këtë periudhë janë 35 gjoba me vlerë 3,270,000 lekë, duke mbetur për arkëtim vlera **71,870,000 lekë,** si mungesë të ardhurash në buxhetin e Bashkisë Shkodër**.**
Në strukturën organizative të IVMT, konstatohet se ka të punësuar vetëm 2 inxhinierë të cilët përmbushin kriteret ligjore për kryerjen e inspektimit, ndërkohë që pjesa tjetër janë ndihmës inspektorë. Duke qenë se territori i Bashkisë Shkodër ka një shtrirje të madhe dhe në përbërje të saj janë dhe zona me rëndësi kombëtare si Plazhi i Velipojës, Parku Kombëtar i Thethit, Liqeni i Shkodrës etj., inspektimi me juristë dhe ndihmës inspektorë mund të jetë jo cilësor. Gjithashtu, rritja e kapaciteteve me inxhinierë është e nevojshme edhe për mbajtjen e akteve të kontrollit për objektet e pajisura me leje ndërtimi sipas fazave të përcaktuara, veprime në mos përputhje me ligjin nr. 9780, datë 16.07.2007 "Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme" i ndryshuar, nenet 11, 12 13 *(Më hollësisht trajtuar në pikën III/2.2.6, faqe 54-83, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
**4.1. <u>Rekomandimi</u>:** Inspektorati Vendor i Mbrojtjes së Territorit në bashkëpunim me Sektorin Juridik në Bashkinë Shkodër, të marrë masa duke ndjekur të gjitha rrugët administrative e ligjore për arkëtimin e vlerës **71,870,000 lekë** ndajë **162 personave** për ndërtime të paligjshme, si dhe mos lejimin e parashkrimit të tyre.
**4.2. <u>Rekomandimi</u>:** Kryetari i Bashkisë Shkodër në bashkëpunim me Drejtorinë e Burimeve Njësore, të vlerësojë mundësinë e strukturimit të IVMT Bashkia Shkodër me specialist me kualifikim në fushën e inxhinierisë (mundësisht të ndërtimit), për të rritur cilësinë e inspektimit dhe kontrollin e lejeve të ndërtimit.

**Brenda datës 31.12.2021**

## F. MASA ADMINISTRATIVE:

Referuar shkeljeve të konstatuara në fushën e ndërtimit, përcaktuar në nenit 7 dhe 12, Kreu III, nenet 15 e 16 të ligjit nr. 8402, datë 10.9.1998 *"Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit"* i ndryshuar me Ligjin nr. 120/2020, datë 07.10.2020 dhe Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 *"Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit"* i ndryshuar, Kreu II, pika 3, bazuar në nenin 15 dhe nenin 30, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014, *"Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit"*, **i rekomandojmë**, Kryetarit të Bashkisë Shkodër t'i kërkojë **Kryeinspektorit të Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit Vendor**, Bashkia Shkodër, të vlerësojë shkeljet e konstatuara dhe të vendosë marrjen e masës disiplinore ndaj dy mbikëqyrës dhe dy kolaudatorët, si më poshtë:

**1. Ing. D.Q.**, në cilësinë e mbikëqyrësit të punimeve, për shkeljet e konstatuara në kontratën nr. 3349/13 prot datë 24.05.2019 me objekt *"Rikonstruksion rruga Velipojë Plazh, Loti I-rë", Bashkia Shkodër*, me sipërmarrës punimesh BOE "N..." SHPK & "A..." SHPK, me pasojë dëm ekonomik në vlerën 1,065,759 lekë pa TVSH dhe në kontratën nr. 3349/12 prot datë 22.05.2019 me objekt *"Rikonstruksion rruga Velipojë Plazh, Loti II-të", Bashkia Shkodër*, me sipërmarrës punimesh OE "C..." SHPK, me pasojë dëm ekonomik në vlerën 337,290 lekë pa TVSH, si rrjedhojë e diferencave në volume pune të likuiduara por të pakryera në fakt.

**2. Ing. F.N.**, në cilësinë e kolaudatorit të punimeve, për shkeljet e konstatuara në kontratën nr. 3349/13 prot datë 24.05.2019 me objekt **"***Rikonstruksion rruga Velipojë Plazh, Loti I-rë", Bashkia Shkodër*, me sipërmarrës punimesh BOE "N..." SHPK & "A..." SHPK, me pasojë dëm ekonomik në vlerën 1,065,759 lekë pa TVSH dhe në kontratën nr. 3349/12 prot datë 22.05.2019 me objekt *"Rikonstruksion rruga Velipojë Plazh, Loti II-të", Bashkia Shkodër*, me sipërmarrës punimesh OE "C..." SHPK, me pasojë dëm ekonomik në vlerën 337,290 lekë pa TVSH, si rrjedhojë e diferencave në volume pune të likuiduara por të pakryera në fakt.

**3. Ing. V.T.**, në cilësinë e mbikëqyrësit të punimeve, për shkeljet e konstatuara në kontratën nr. 1931/12 prot datë 10.04.2019 me objekt **"***Rikonstruksion rruga Udha kryq", Bashkia Shkodër*, me sipërmarrës punimesh BOE "N..." SHPK & "A..." SHPK, me pasojë dëm ekonomik në vlerën 369,055 lekë pa TVSH, si rrjedhojë e diferencave në volume pune të likuiduara por të pakryera në fakt.

**4. Ing. I.S.**, në cilësinë e kolaudatorit të punimeve, për shkeljet e konstatuara në kontratën nr. 1931/12 prot datë 10.04.2019 me objekt *"Rikonstruksion rruga Udha kryq", Bashkia Shkodër*, me sipërmarrës punimesh BOE "N..." SHPK & "A..." SHPK, me pasojë dëm ekonomik në vlerën 369,055 lekë pa TVSH, si rrjedhojë e diferencave në volume pune të likuiduara por të pakryera në fakt.

**Brenda datës 31.12.2021**

## G. MASA DISIPLINORE:

### G/1. Për punonjësit që janë pjesë e shërbimit civil.

Mbështetur në nenin 15, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", germat (b, c, ç) e nenin 58-"*Llojet e masave disiplinore*", të ligjit nr. 152/2013 "Për nëpunësin civil", në VKM nr. 115, datë 05.03.2014 "Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin

